



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME

KONVENTA PER ELEMENIMIN E TE GJITHA FORMAVE
TE DISKRIMINIMIT NDAJ GRAVE
(CEDAW)

RAPORTI I III-të KOMBETAR PERIODIK

Tiranë 14.04.2008

PERMBAJTJA

Hyrje	Paragrafi 1	Faqe 3
I.Konsiderata të Përgjithshme	2-13	4-6

II. Masat e ndërmara për implementimin e Neneve 1-16 të Konventës dhe të Rekomandimeve të Komitetit CEDAW

KAPITULLI I

Nenet 1-3 Masat Politiko-Legjislative kundër diskriminimit ndaj grave....	14-57	7-20
Neni 4 Masa të përkohshme të veçanta për të përsheptuar barazinë..	58-65	20-22
Neni 5 Roli i seksit dhe Stereotipeve.....	66-95	22-31
Neni 6 Shfrytëzimi i grave (trafikimi dhe prostitucioni).....	96-142	31-44

KAPITULLI II

Neni 7 Jeta Politike dhe Publike.....	143-171	44-51
Neni 8 Përfaqësimi ndërkombëtar dhe Pjesëmarrja.....	172-174	52
Neni 9 Shtetësia.....	175-178	53

KAPITULLI III

Neni 10 Arsimi.....	179-216	54-62
Neni 11 Punësimi.....	217-272	62-76
Neni 12 Kujdesi Shëndetsor.....	273-341	76-92
Neni 13 Ndihmat Sociale dhe Ekonomike.....	342-362	93-98
Neni 14 Gruaja Fshatare.....	363-392	98-106

KAPITULLI IV

Neni 15 Barazia para Ligjit edhe në Çështjet Civile.....	393-404	106-109
Neni 16 Martesa dhe Jeta në Familje.....	405-424	109-114
III. Konkluzione	425-438	114-117

IV. Anekset

A. Komente të Avokatit të Popullit.....	118-120
B. Komente të OJF-ve.....	120-134
C. Të dhëna Statistike nga INSTAT.....	135-157

V. Bibliografia.....158-163

A)- Aktet Ligjore, Aktet Nënligjore dhe ndryshimet kryesore administrative gjatë periudhës 2003-2007.

B)- Publikime.

SHKURTIME

AV	Avokati i Popullit
CEDAW	Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
DPSHB	Drejtoria e Politikave të Shanseve të Barabarta
IOM	Organizata Ndërkombëtare e Migracionit
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
ISSH	Instituti i Sigurimeve Shoqërore.
ITAP	Instituti i Trainimit të Administratës Publike
IST	Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme
INSTAT	Instituti i Statistikave
KE	Këshilli i Europës
MPÇSSHB	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
MTKRS	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
MICS	Multi Indicator Cluster Survey
MBUMK	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
MSH	Ministria e Shëndetsisë
OJF	Organizatë Jo - Fitimprurëse
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetsisë
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë
PNUD	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin
PF	Planifikimi Familjar
QKPVT	Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit
QSH	Qeveria Shqiptare
QSUT	Qendra Spitalore Universitare Tiranë
RSH	Republika e Shqipërisë
SKBGJ & DHF	Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

HYRJE

1. Raporti i Tretë Kombëtar Periodik përmban informacion të aktualizuar në lidhje me masat që ka ndërmarë Qeveria e Republikës së Shqipërisë (RSH) në zbatim të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (në vijim do të emërtohet si CEDAW), në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga dispozitat e nenit 18-të, të saj. Nëpërmjet këtij raporti, Shqipëria paraqet progresin e bërë në këtë drejtim gjatë viteve 2003-2007, në veçanti ndryshimet e bëra në aspektin ligjor dhe administrativ për zbatimin e 16 neneve të para të Konventës CEDAW. Raporti i Parë dhe i Dytë i Kombinuar, i cili është dërguar pranë Komitetit CEDAW më 22 maj 2002 ka shërbyer gjithashtu, si një pikë referimi për hartimin e Raportit të III-të Periodik.

I. KONSIDERATA TE PERGJITHSHME

2. Shqipëria e ka ratifikuar Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) nëpërmjet ligjit nr.7767, të votuar në Parlamentin shqiptar datë, 09.11.1993 dhe publikuar në Fletoren Zyrtare nr.13, në dhjetor 1993. Ky moment shënoi pikën e fillimit për integrimin e standarteve ligjore ndërkombëtare në ligjin e brëndshëm, i cili aktualisht vazhdon të jetë në fuqi dhe nëpërmjet Kushtetutës së RSH sigurohet zbatimi i tij, duke i angazhuar institucionet qeveritare që të respektojnë dhe të promovojnë të drejtat që garanton Konventa CEDAW.

3. Pas ratifikimit me ligj nga Parlamenti kjo Konventë duke qënë një Marrëveshje Ndërkombëtare, sipas nenit 122 të Kushtetutës së RSH, *“përbën pjesë të sistemit të brëndshëm juridik, zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të”*. Ky fakt është shprehje e qartë e rëndësisë që i kanë kushtuar si organet ekzekutive, ashtu edhe Parlamenti shqiptar zbatimit të detyrimeve që burojnë nga nenet e Konventës në fjalë.

4. Mbi këtë bazë ligjore, Qeveria e RSH e ka vendosur çështjen e barazisë gjinore në qëndër të axhendës së saj prioritare duke konsideruar se, zhvillimi ekonomik e social i vendit nuk mund të kuptohet pa një trajtim dhe pa arritje konkrete në këtë drejtim të rëndësishëm. Ajo i qëndron parimit të artikuluar në kuadër të Samitit të vitit 2005, ku të gjitha vendet anëtare të OKB-së pranuan se, *“progresi për gratë është progres për të gjithë dhe një prerogativë e domosdoshme për vendosjen e barazisë dhe drejtësisë së vërtetë”*.

5. Në intervalin e kohës që ka kaluar që nga momenti i paraqitjes së Raportit të Parë dhe të Dytë të Kombinuar, në lidhje me shkallën e zbatimit të Konventës CEDAW nga ana e Qeverisë së RSH janë shënuar hapa përpara, për sa i përket plotësimit të paketës së legjislacionit dhe masave të tjera administrative, të cilat synojnë arritjen e barazisë ndërmjet burrit dhe gruas.

6. Një ndër arritjet më të rëndësishme ligjore të realizuara në intervalin kohor 2003-2007 është miratimi nga Parlamenti Shqiptar i ligjit *“Për Barazinë Gjinore në Shqipëri”*. Ky ligj sanksionon vendosjen e dy sekseve në pozita të barabarta në fushën e punësimit, arsimimit dhe vendimmarrjes. Ky akt ligjor, jo vetëm që është kundër diskriminimit, por parashikon njëkohësisht edhe ndëshkim ligjor në rastin kur konstatohen shkelje të tij. Proçesi i rishikimit të këtij ligji, i cili ka filluar që në vitin 2006 sjell shumë elementë të rinj, të cilët do të garantojnë zbatimin në praktikë të tij duke synuar realisht eliminimin e diskriminimit gjinor.

7. Politikat gjinore të Qeverisë kanë patur si objektiv fuqizimin e statusit të gruas, me qëllim që t'i krijohet asaj në vazhdimësi një akses më i madh në tregun e punës dhe në shanset për karrierë zyrtare, politike e biznesi. Programi i punës së Qeverisë Shqiptare parashikon angazhimin e plotë të pushtetit ekzekutiv për të eliminuar dhunën ndaj grave e vajzave dhe shfrytëzimin e tyre për qëllime prostitucioni, apo për qëllime të tjera denigruese. Si rrjedhim, programi është qartësisht i orientuar ndaj politikave dhe masave për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe krimin në familje, zbatimi i të cilave kërkon gjithashtu, që ato të zenë një vënd të rëndësishëm në të gjitha nivelet e qeverisjes.

8. Për të përmirësuar situatën e barazisë gjinore në vend, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB), në cilësinë e autoritetit përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore, u angazhua në hartimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit për Veprim të Barazisë Gjinore 2007-2010. Strategjia është hartuar gjatë një procesi gjithëpërfshirës dhe në të përcaktohen fushat më të rëndësishme të ndërhyrjes operative, politike e legjislative në nivel mbarëkombëtar. Kjo Strategji u miratua me VKM nr. 913, datë, 19.12.2007.

9. Në të njëjtën kohë, Qeveria Shqiptare ka bashkëpunuar me Zyrën e PNUD-it në Tiranë, Këshillin i Europës, OSBE-në dhe me një numur organizatash jo-fitimprurëse (OJF-të), të huaja dhe lokale për të nxitur lidhësimin e gruas në shoqërinë shqiptare, përmes rritjes së ndërgjegjësimit të publikut të gjerë, të medias dhe sektorit privat në përgjithësi, në lidhje me rëndësinë e çështjeve gjinore në mirëqeverisje, arsimim dhe zhvillimin e mëtejshëm të vendit.

10. Hartimi dhe zbatimi i programeve gjinore në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile e në radhë të parë me organizatat e specializuara në çështjet e barazisë gjinore është një nga angazhimet më të rëndësishme që përfshihet në politikën e Qeverisë shqiptare. Drejtoria e Politikave të Shanseve të Barabarta, (në MPÇSSHB) ndër detyrat e veta kryesore parashtron bashkëpunimin me OJF-të, të cilat janë aktive në fushën e shanseve të barabarta për projekte apo veprimtari të përbashkëta.

11. Nëpërmjet një Urdhri të veçantë të Kryeministrit është ngarkuar Ministria e Punëve të Jashtme me detyrën e hartimit të Raporteve Kombëtare Periodike, duke realizuar një bashkëpunim ndërmjet institucioneve qeveritare, Avokatit të Popullit (AV) dhe OJF-ve, me qëllim që raporti të pasqyrojë sa më realisht jo vetëm progresin dhe situatën aktuale në vend, por edhe problemet më shqetësuese në fushën e barazisë gjinore. Mbështetur në Urdhërin e Kryeministrit të RSH (nr. 201, datë, 05.12.2007) u ngrit Grupi Ndërdikasterial i Punës, në të cilin morën pjesë përfaqësues të 10 ministrive (Min. e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Min. e Drejtësisë, Min. e Brëndshme, Min. e Shëndetësisë, Min. e Arsimit dhe Shkencës, Min. e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, Min. e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Min. e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Min. e Financave) dhe të dy institucioneve shtetërore (Instituti i Sigurimeve Shoqërore - ISSH dhe Instituti i Statistikave - INSTAT), të cilat kontribuan në sigurimin e informacionit të nevojshëm për hartimin e këtij Raporti.

12. Raporti i Tretë Periodik është konceptuar në përputhje me udhëzimet specifike (*guidelines*) të Komitetit CEDAW, mbasi marrja në konsideratë e këtyre udhëzimeve krijoi mundësinë e harmonizimit midis formës dhe përmbajtjes, në procesin e hartimit të raportit në fjalë. Parë në këtë këndvështrim ky raport përmban:

- Informacione dhe komente mbi ndryshimet më të rëndësishme që janë bërë për arritjen e barazisë gjinore në Shqipëri, që nga koha e miratimit të Raportit paraardhës (Raporti i Parë dhe i Dytë i Kombinuar CEDAW), pra për periudhën 2003-2007. Në mënyrë të veçantë janë pasqyruar ndryshimet në aspektin e përgjithshëm dhe rezultatet më të rëndësishme të veprimtarive që janë realizuar gjatë kësaj periudhe në fushën e barazisë gjinore në Shqipëri.

- Duke respektuar të dhënat e paraqitura në Raportin e Parë dhe të Dytë të Kombinuar, Raporti i Tretë Periodik i RSH evidenton gjithashtu përmirësimet e kuadrit ligjor, nënligjor dhe masat e tjera administrative që janë ndërmarrë me synim kryesor eliminimin gjithmonë e më shumë të diskriminimit ndaj grave dhe përmirësimin e procesit të integritetit të tyre në jetën politike, sociale, ekonomike dhe kulturore të vendit. Bashkë me aktet e reja ligjore u vlerësua që në këtë raport të pasqyrohen edhe disa akte ligjore të rëndësishme që i takojnë periudhës para vitit 2003, mqs ato nuk kanë qënë evidentuar në Raportin e Parë dhe të Dytë të Kombinuar.
- Një vëmendje e veçantë në këtë raport i është kushtuar edhe problemeve që janë ngritur nga Komiteti CEDAW, në materialin e përgatitur nga ana e tij në sesionin e 28 të OKB-së (dt.13-31 janar 2003), pas dorëzimit nga Qeveria e RSH të Raportit të Parë dhe të Dytë të Kombinuar (në veçanti Paragrafi 45 i Rekomandimeve të Komitetit). Për këtë arsye, në raport janë përfshirë edhe përgjigjet për Komentet dhe Rekomandimet e bëra nga Komiteti CEDAW.
- Vend të posaçëm ka zënë dhe pasqyrimi i atyre masave që janë ndërmarrë nga institucionet shtetërore dhe veprimtaritë e kryera nga OJF-të, në lidhje me zbatimin e Deklaratës së Pekinit dhe Platformës për Veprim, të Rezolutave dhe të Dokumentave të tjera të OKB-së për këtë çështje. (Rekomandimet e Komitetit, Paragrafi 44).
- Qeveria shqiptare i ka marrë në konsideratë analizat dhe sugjerimet e dhëna nga ana e shoqërisë civile, si dhe raportet alternative të hartuara prej OJF-ve, në kuadrin e Konventave ku Shqipëria është palë dhe në veçanti kjo për Konventën CEDAW. Prandaj, organizatat jo-fitimprurëse dhe institucioni i Avokatit të Popullit u angazhuan në mënyrë aktive, si në drejtim të implementimit të Konventës, ashtu edhe në përgatitjen e Raportit të III-të Periodik. Këto institucione u ftuan të bashkëpunojnë dhe komentet e tyre janë përfshirë në Anekset bashkëlidhur këtij raporti, së bashku me të dhënat statistikore të INSTAT-it. Ndërkohë u konsultuan nga afër edhe informacionet që gjenden në faqet *web* të disa prej OJF-ve (që nuk kanë marrë pjesë në konsultime), në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të grave në Republikën e Shqipërisë (RSH).

13. Ky Raport është i ndarë në 4 kapituj dhe seksione të veçanta, të cilat korrespondojnë me vetë Konventën CEDAW në tërësi dhe me 16 nenet e para të saj, në veçanti. Për secilin nen janë pasqyruar fillimisht ndryshimet në kuadrin ligjor dhe në vijim masat që janë ndërmarrë nga Qeveria shqiptare, në funksion të përmbushjes së detyrimeve respektive që burojnë prej Konventës CEDAW, si dhe rezultatet e arritura duke evidentuar njëkohësisht edhe vështirësitë, apo mangësitë e konstatuara në drejtim të implementimit të saj në praktikë.

II. MASAT E NDERMARRA PER IMPLEMENTIMIN E DISPOZITAVE 1-16 TE KONVENTES DHE TE REKOMANDIMEVE TE KOMITETIT CEDAW

KAPITULLI I

NENET 1-3 MASAT POLITIKO – LEGJISLATIVE KUNDER DISKRIMINIMIT NDAJ GRAVE

I. Përcaktimi i Diskriminimit sipas legjislacionit Shqiptar

14. Parimi i barazisë së grave dhe burrave ze një vënd të rëndësishëm në Kushtetutën e RSH dhe në legjislacionin e brëndshëm. Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, (në nenin 18, pika 2) parimi i mosdiskriminimit formulohet në këtë mënyrë: *"Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja"*. Megjithëse në Kushtetutë nuk jepet shprehimisht përkufizimi i diskriminimit ajo ka parashikuar që marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat RSH është palë bëhen pjesë e legjislacionit të brëndshëm, madje kanë epërsi mbi legjislacionin vendas që bie në kundërshtim me të (Neni 122/2 i Kushtetutës). Duke qenë se Konventa e OKB-së CEDAW është e vetë zbatueshme, atëhere për diskriminimin gjinor është përdorur përkufizimi i diskriminimit sipas Neni 1 të kësaj Konvente.

15. Përveç kësaj edhe Kodi i Punës përmban një përkufizim më të hollësishëm të diskriminimit në marrëdhëniet e punës, i cili është cituar edhe në Raportin e Parë dhe të Dytë të Kombinuar për Konventën CEDAW, ndërkohë që gjatë periudhës 2003-2007 nuk ka patur ndonjë inisiativë për të dhënë përkufizim të ri në Kodin e Punës, lidhur me diskriminimin gjinor. Neni 9/1 i këtij Kodi ndalon të gjitha format e diskriminimit në punë dhe profesion, ndërsa paragrafi 2 i këtij neni parashikon përkufizimin e diskriminimit në marrëdhëniet e punës sipas të cilit, *"Diskriminimi është dallimi, përjashtimi, ose preferenca e bërë në bazë të racës, ngjyrës, seksit, moshës, besimit, opinionit politik, përkatësisë etnike, ose origjinës sociale, dëmtimit fizik, ose mendor, që cënojnë të drejtën e individit për të qënë i barabartë në punësim dhe trainim"*. (ai pasqyron dispozitat e Konventës ILO, Nr. 111).

16. Në dt. 01.07.2004 u miratua ligji Nr. 9198 *"Për barazinë gjinore në shoqëri"*, i cili jep gjithashtu një përkufizim të diskriminimit gjinor si *"dhunim i të drejtave të barabarta për gratë dhe burrat"*, ose *"diskriminim janë veprimet aktive, ose pasive që shprehin nënvlerësim, përbuzje dhe kufizim të të drejtave, ose të privilegjeve për arsye të seksit të personit"*. Me qëllim arritjen e standarteve të barazisë gjinore në përputhje me dokumentat ndërkombëtare dhe për ta bërë ligjin e mësipërm të zbatueshëm në praktikë, që në vitin 2006 ka filluar procesi për rishikimin e tij. Projekt-ligji është në fazën e miratimit në Kuvendin e Shqipërisë. Në parimet e përgjithshme të projekt-ligjit të paraqitur thuhet se: Ky ligj bazohet në parimin e barazisë e të mosdiskriminimit dhe në parimet e tjera të sanksionuara nga Kushtetuta e RSH, nga Konventa "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas", si dhe nga të gjitha aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë (RSH).

17. Duke synuar arritjen e standarteve më bashkëkohore për barazinë gjinore më pas u propozua rishikimi i këtij ligji dhe kjo bëri që të hartohet projekt-ligji i ri, "Për barazinë gjinore në shoqëri" (Nr. 9534, datë 15.5.2006). Ky projekt-ligj jep një përkufizim më të plotë të diskriminimit gjinor duke u përputhur plotësisht me përkufizimin e diskriminimit të dhënë nga CEDAW. Përkufizimi i diskriminimit, sipas projekt-ligjit të ri është formuluar në këtë mënyrë: *"Diskriminim për shkak të gjinisë, përbën çdo dallim, përjashtim, ose kufizim mbi baza gjinore, që ka për qëllim, ose për pasojë dëmtimin, mosnjohjen, mosgëzimin dhe mosushtimin në mënyrë të barabartë nga secila gjini, të të drejtave të njeriut dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligje, në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile"*.

II. Përmirësimet në Legjislacion, në Aktet Nënligjore dhe Masa të tjera specifike për eliminimin e diskriminimit gjinor

18. Në vitet e fundit Legjislacioni shqiptar, veçanërisht ai penal ka ndryshuar në mënyrë progresive dhe cilësore, duke reflektuar në përmbajtje edhe aktet e ndryshme ndërkombëtare ku Shqipëria është bërë palë. Institucionet zyrtare shqiptare, në veçanti Ministria e Drejtësisë, Min. e Brëndshme, Min. e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB), Ministria e Arsimit, etj kanë ndërmarrë inisiativa ligjore për përmirësimin e kuadrit ligjor që siguron barazi gjinore, si dhe masa konkrete në drejtim të aplikimit të drejtpërdrejtë të neneve të Konventës në Shqipëri.

19. Parë në këtë prizëm dhe në përmbushje të Rekomandimeve të Komitetit CEDAW (Paragrafet 42 dhe 43) pala shtetërore shqiptare është shprehur dakort:

1. Për kryerjen e ndryshimeve në nenin 20, të paragrafit të parë të Konventës CEDAW, lidhur me kohën e takimit të Komitetit. (paragrafi 42 i Rekomandimeve)
2. Parlamenti shqiptar e ka ratifikuar Protokollin Opsional të Konventës me Ligjin Nr. 9052, datë, 17.04.2003 (paragrafi 43 i Rekomandimeve).

20. Krahas përmirësimeve të legjislacionit vëndas, Shqipëria ka ratifikuar gjatë periudhës 2003-2006 një sërë aktesh ndërkombëtare që synojnë ndër të tjera edhe eliminimin e diskriminimit ndaj grave. Ndër këto mund të përmenden:

- Protokollin Nr. 12 i Konventës Evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, i ratifikuar me ligjin Nr. 9264, datë 29.07.2004, subjekt i të cilit është ndalimi i diskriminimit në përgjithësi.
- Protokollin Opsional i Konventës “Kundër torturës dhe trajtimit, ose dënimit të egër, ç’njerëzorose poshtërues”, ratifikuar me ligjin nr.9094, datë 03.07.2003.
- Konventa Evropiane “Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme” e ratifikuar me ligjin nr. 9265, datë 29.07.2004.
- Konventa e Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qënieve njerëzore” e ratifikuar me ligjin, nr. 9642, datë, 20.11.2006.

21. Po ashtu, në përgjigje të Shqetësimeve dhe Rekomandimeve të Komitetit, në lidhje me progresin e bërë në fushën e ligjeve (Paragrafet 18, 19, 20 dhe 21) mund të thuhet se, Konventa CEDAW, pas ratifikimit është bërë pjesë e legjislacionit të brëndshëm dhe gëzon epërsi në renditjen e normave juridike. Përmirësimet që i janë bërë legjislacionit shqiptar kanë krijuar mundësinë që gjithmonë e më shumë grave t’iu afrohen procedura adekuate, të hapura dhe të përballeshme, si mjete ligjore në mbrojtje të dhunimit të të drejtave të tyre. Në kuadër të eliminimit të plotë të diskriminimit gjinor, në vijim pasqyrohen ato dispozita të legjislacionit shqiptar penal dhe civil, të cilat kanë pësuar ndryshime nga periudha e dorëzimit të Raportit të Parë dhe të Dytë të Kombinar.

22. Duke marrë për bazë këto ndryshime, mund të thuhet që legjislacioni shqiptar përputhet relativisht mirë me nenin 2 të Konventës CEDAW. Parimi i barazisë mes burrave dhe grave, (sikundër u përmënd më lart në shpjegimet e nenit 1) parashikohet në Kushtetutë, ashtu si parashikohet edhe ndalimi i diskriminimit.

23. Miratimi i ligjit nr. 9198 dt. 01.07.2004 *“Për barazinë gjinore në shoqëri”*, shënoi një hap pozitiv në hartimin e legjislacionit të ri për barazi gjinore. Pavarësisht se kjo ishte një iniciativë e mirë e lëvizjes së gruas, praktika tregoi se ligji pati një sërë mangësish, ku mund të përmenden: mos përmeshja siç duhej e funksioneve të tij, paqartësitë që krijoi në rastin e ish-Komitetit Për Barazi Gjinore, apo mosdalja e akteve nënligjore. Kufizimi i zbatimit të këtij ligji vetëm në disa nga fushat që mbulon CEDAW, si dhe mungesa e dispozitave në ligje të tjera që ndalojnë dhe vendosin sanksione për diskriminimin gjinor e lenë individin pa *“mjete ligjore”*, me të cilat ai mund të çojë në gjykatë rastet e diskriminimit. Përgjithësisht një qytetar në sistemin ligjor shqiptar kërkon më shumë vënien në vend të një të drejte ligjore, sesa vënien drejtpërdrejt në vend të një të drejte kushtetuese. Me fjalë të tjera kërkon vënien në vend të një të drejte që buron nga një ligj specifik, i cili është hartuar në bazë dhe për zbatim të një dispozite të caktuar të Kushtetutës. Kështu, kërkuesi apo paditësi kërkon nga gjykata një të drejtë, duke vënë në dukje edhe nenin konkret të një ligji të caktuar, ku e mbështet kërkesën e tij dhe jo një të drejtë të përgjithshme të parashikuar në Kushtetutë.

24. Për të përmirësuar më tej legjislacionin ekzistues, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPCSSHB), si autoriteti përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore, ashtu siç u theksua edhe më lart, u angazhua në procesin e rishikimit të ligjit Nr. 9198, datë, 01.07.2004 *“Për barazinë gjinore në shoqëri”* për hartimin e një Projekt-ligji të ri, (Nr. 9534, datë, 15.05.2006), sipas vendimit të marë në mbledhjen e Komitetit Ndërmintor të Barazisë Gjinore. Projekt-ligji i ri u hartua si një domosdoshmëri për sigurimin e mundësive të barabarta midis burrave dhe grave, me qëllim eliminimin e diskriminimit direkt dhe indirekt, bazuar në gjininë dhe në jetën publike të vendit. Iniciativa për rishikim është ndërmarrë nga MPCSSHB dhe për këtë janë përzgjedhur ekspertë të fushës ligjore dhe të çështjeve gjinore, të mbështetur nga OSBE dhe PNUD.

25. Projekt-ligji u miratua në Këshillin e Ministrave në janar 2008 dhe në vijim është diskutuar në Komisionin Parlamentar të Shëndetësisë, Punës dhe Çështjeve Sociale dhe janë bërë ndryshime në draftin e paraqitur, sidomos përsa i përket përfaqësimit të barabartë gjinor ku janë parashikuar dhe kuotat për këtë përfaqësim (neni 20). Projekt-ligji pritet të kalojë së shpejti në seancë plenare për miratim.

26. Qëllimi kryesor i këtij projekt-ligji është mbrojtja e qytetarëve nga çdo lloj diskriminimi që kryhet mbi bazë gjinie, garantimi i mundësive dhe shanseve të barabarta si për meshkujt edhe për femrat, për të arritur standarte sa më të larta në fushën e barazisë gjinore. Kjo do të realizohet sidomos, përmes përmirësimit të funksioneve në fushën e barazisë gjinore që do të përmeshen nga ky projekt-ligj, si dhe forcimit të mekanizmave institucionalë që do të zbatojnë kuadrin ligjor të kësaj fushe. Projekt-ligji fut përkufizime të reja si ai i diskriminimit gjinor, integritimit gjinor, kuotave dhe jep një përkufizim më të plotë të shqetësimeve seksuale në vendin e punës dhe ngacmimeve të tjera.

27. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë: Me iniciativën e Ministrisë së Drejtësisë u miratua ligji Nr. 9686, datë 26.02.2007, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë, 27.01.1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë - i ndryshuar”*, në nenin 6 të të cilit parashikohet si rrethanë rënduese kryerja e veprës penale e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, fenë, kombësinë, gjuhën, bindjet politike,

fetare, ose sociale. Në dispozitat e Kodit Penal nuk bëhen dallime gjinore në parashikimin e veprave penale. Nga ana e MPCSSHB janë përgatitur aktet nënligjore të Ligjit Nr. 9669 dt.18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Kodi Penal përmban sanksionet më të rënda për diskriminimin. Neni 253 thotë që, *“dallimet mbi bazë origjine, seksi të kryera nga ana e punonjësit shtetëror, apo në shërbim publik që konsiston në krijimin e privilegjeve të padrejta, ose në refuzimin e një të drejte, ose përfitimi që buron nga ligji dënohen me gjobë, ose me burgim gjer në 5 vjet”*.

28. Edhe Kodi i Punës përmban sanksione të tilla. Neni 9, paragrafi 1 ndalon çdo lloj diskriminimi në punësim dhe veprimtarinë profesionale, pa specifikuar punëdhënësin, i cili mund të jetë një institucion publik, apo person privat. Diskriminimi mund të sjellë si pasojë sanksione me shuma deri në 50% të pagës minimale mujore. Për eliminimin e diskriminimit në sektorin privat Inspektoriati i Punës në MPCSSHB kontrollon dhe siguron që, legjislacioni mbi kushtet e punës dhe sigurimin shëndetsor të ndiqet edhe në sektorin privat. Megjithatë, sektori privat është më pak i sistemuar, në lidhje me procedurat që sigurojnë përputhje me ligjet antidiskriminuese. Marrja në punë i lihet kryesisht preferencave të punëdhënësit. Më shumë duhet punuar për të eliminuar praktikat kulturore që kufizojnë mundësitë e grave për të përfituar punësim.

29. Shkelja e parimit të mos-diskriminimit në punë sanksionohet në ligj me një gjobë deri në 50% të pagës minimale. (neni 202 i Kodit të Punës). Disa prej dispozitave kryesore të këtij kodi janë: Neni 10: “Pjesëmarrja në Sindikata”, Neni 32/1: “Detyrimi i punëdhënësit për të respektuar dhe mbrojtur personalitetin e të punësuarit”, Neni 32/2: “Ndalimi i ngacmimit seksual”, Kapitulli 8, nenet 39-75: “Shëndeti dhe sigurimi në vendin e punës”, Kapitulli 9, nenet 76-97: “Orët e punës dhe leja e paguar”, Kapitulli 10, nenet 98-108: “Masa të veçanta mbrojtëse për gratë dhe fëmijët” dhe Kapitulli 11, nenet 109-134: “Shpërblimi”.

30. Kodi i Procedurës Penale: Në përputhje me dispozitat e këtij Kodi, legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojtë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë për forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutës e të ligjeve të shtetit. Për gratë që dënohen për vepra penale janë të disponueshme shërbimet e nevojshme ligjore, në mënyrë që të garantohet mbrojtja ligjore e të drejtave të tyre. Vlen të përmendet fakti që, në forcat e policisë dhe në të gjitha strukturat policore, duke përfshirë dhe Ministrinë e Rendit Publik është rritur ndjeshëm numri i juristëve dhe i grave në funksione të tjera të këtyre strukturave, gjë që ka çuar në krijimin e një mentaliteti të ri në profesionin juridik në tërësi edhe në forcat policore, në veçanti. Në rastet kur gratë nuk kanë mundësi të përballojnë mbrojtjen nëpërmjet ndihmës juridike private, ato përfaqësohen profesionalisht falas nga juristë të dhënë nga shteti.

31. Kodi i Procedurave Administrative, i cili zbatohet nga të gjitha Organet e Administratës Publike gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre nëpërmjet akteve individuale sanksionon parimet e përgjithshme të veprimtarisë administrative, si parimi i ligjshmërisë, parimi i mbrojtjes së interesit publik dhe ai i të drejtave të personave private, parimi i përgjegjshmërisë, parimi i drejtësisë dhe i paanësisë, si dhe parimin e barazisë dhe proporcionalitetit.

32. Kodi Civil: Neni 1 parashikon që, çdo person fizik gëzon zotësi të plotë dhe të barabartë për të pasur të drejta dhe detyrime civile, brenda kufijve të caktuar me ligj,

pa e kushtëzuar gëzimin e të drejtave civile me përkatësinë etnike, apo të origjinës sociale, si dhe pa parashikuar preferenca të veçanta në bazë të racës, ngjyrës, *seksit*, moshës, apo besimit.

33. Kodi i Procedurës Civile, gjithashtu cakton rregulla të detyrueshme, të njëjta e të barabarta, për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile që parashikohen në të, duke mos parashikuar rregulla të veçanta për individë me përkatësi etnike, *gjini*, moshë, apo racë të veçantë.

34. Kodi i ri i Familjes u miratua pas një pune të gjatë disavjeçare, me ligjin Nr. 9062, dt. 08.05.2003. Kodi i Familjes, kur jep përkufizimin e martesës deklaroi barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve si një parim bazë të rëndësishëm të jetës. Po ashtu vlen të evidentohet fakti që, legjislacioni shqiptar e trajton në veçanti dhunën mbi baza gjinore, përfshi edhe dhunën në familje. Dhuna ndaj gruas mbulohet nga disa seksione të Kodit Penal, të cilat janë pasqyruar në tabelën në vijim:

Seksionet e Kodeve	Vepra penale kundër lirisë së personit	Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit	Vepra penale kundër fëmijëve martesës dhe familjes	Krime seksuale
Veprat penale	-Rrëmbimi - Trafikimi i femrave - Heqja e paligjshme e lirisë	Shfrytëzimi i prostitucionit	Shtrengimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë	- Marrëdhënie seksuale me dhunë (të mitura, ose të rritura) - Marrëdhënie seksuale me persona në gjini, ose nën kujdestari

35. Ligji nr. 9669, datë, 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” ka për qëllim “Parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore, si dhe garantimin e mbrojtjes me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat e dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara”. Ky ligj (Nr. 9669) është një ligj administrativo-civil, i cili synon krijimin e rrjetit të koordinuar të institucioneve qeveritare për t’iu përgjigjur në kohë rasteve të dhunës në familje, si dhe lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes nga gjykatat.

36. Ligji nr. 9888, miratuar nga Parlamenti datë, 10.03.2008, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. Ky ligj u hartua nga rishikimi që ju bë ligjit Nr.8328, datë, 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”. Neni 5 i këtij ligji parashikon se ekzekutimi i dënimit me burgim bëhet duke respektuar dinjitetin e të dënuarit dhe përshkohet nga ndjenja njerëzore. Gjithashtu, po aty parashikohen parimet kryesore për trajtimin e të dënuarve, *si paanshmëria, apo mos diskriminimi për shkak të seksit*, kombësisë, racës, gjendjes ekonomike dhe shoqërore, pikëpamjeve politike dhe besimit fetar. Të dënuarve duhet t’iu sigurohen kushte jetese të tilla që ulin në minimum efektet paragjyquese negative të burgimit dhe ndryshimet me jetën e shtetasve të tjerë. Institucioni përaktës ka filluar hartimin e amendimit të këtij ligji, me synim

përmirësimin e kushteve dhe të drejtave të personave të dënuar me burgim, në përputhje me aktet më të rëndësishme ndërkombëtare. Kjo iniciativë është realizuar në bashkëpunim me EURALIUS (European Assistance Mission for the Albanian Justice System) dhe UNICEF-in.

37. Në zbatim të këtij ligji është miratuar Rregullorja e Përgjithshme e burgjeve, ku ndër të tjera parashikohet detyrimi i administratës së burgjeve për realizimin e trajtimit njerëzor dhe edukues të të dënuarve nëpërmjet mënyrave efektive moderne të administrimit, pa diskriminim për arsye race, ngjyre, *seksi*, gjuhe, feje, mendimi politik, origjinës kombëtare, ose shoqërore, gjëndjes ekonomike etj. Sipas kësaj rregulloreje, çdo i dënuar duhet të njihet me të drejtat dhe detyrimet e tij që burojnë nga ligji, nga kjo rregullore dhe nga rregullorja e brëndshme e burgut. Për këtë qëllim, nga biblioteka e institucionit grave të dënuara ju vihen në dispozicion aktet e nevojshme ligjore e nënligjore. Për të dënuarit që nuk dinë shkrim e këndim, komunikimi i akteve bëhet me gojë nga shërbimi i edukimit.

38. Në përgjigje të rekomandimeve të Komitetit CEDAW (Paragrafi Nr. 22 dhe 23) në Tab. 8.1 të INSTAT-it është pasqyruar numri i të dënuarve për krime dhe kundërvajtje, sipas Kodit Civil dhe Penal, gjatë viteve 2000-2006. Gjithashtu, në tabelat e mëposhtme jepet një pasqyrë e atyre neneve të Kodit Penal, ku Konventa ka gjetur një aplikim të drejtpërdrejtë të saj, brenda kuadrit ligjor kombëtar të RSH.

Informacion statistikor rreth çështjeve të arkivuara në gjykatë dhe vendimet gjyqësore (2003-2007)

LLOJI I VEPRES PENALE	Neni	Viti	Çështje Penale për Gjykim	Çështje e Pushuar Përfunduar	Vendim Fajësie	Vendim Pafajësie	Inkompetencë
<u>Ndërprerja e Shtatzanisë pa pëlqimin e gruas</u>	Neni 93	2003	0		0		
		2004	0		0		
		2005	0		0		
		2006	0		0		
		2007	0		0		
<u>Marrëdhënie Seksuale, ose Homoseksuale me të mitur</u>	Neni 100/1	2003	12		11		
		2004	15		10		
		2005	10		10		
		2006	10	1 (kthyer për plotësim hetimesh)	7		
	100	2007	10		7		1
<u>Marrëdhënie Seksuale, ose Homoseksuale, me dhunë, me të mitur mosha 14-18 vjeç</u>	Neni 101	2003	0		0		
		2004	3		0		
		2005	0		0		
		2006	9		6	1	
		2007	5		2		1

<u>Marrëdhënie</u> Seksuale me dhunë me të rritura	Neni 102	2003	12		20		
		2004	8		14		
		2005	11		10		
		2006	16	2	10	1	3 (pa përfunduar)
		2007	10	1	4		5 (pa përfunduar)
<u>Marrëdhënie</u> Seksuale, ose homoseksuale, me persona të pazotë për tu mbrojtur	Neni 103	2003	0		0		
		2004	0		0		
		2005	1		1		
		2006	1		1		
		2007	0				
<u>Marrëdhënie</u> Seksuale, ose homoseksuale, me kërcënim, me perdorimin e armës	Neni 104	2003	2		2		
		2004	0		0		
		2005	0		0		
		2006	0				
		2007	0				
<u>Marrëdhënie</u> Seksuale, ose homoseksuale, duke shpërdoruar detyrën	Neni 105	2003	0		0		
		2004	0		0		
		2005	0		0		
		2006	0				
		2007	0				
<u>Marrëdhënie</u> Seksuale, ose homoseksuale, me persona në gjini, ose nën kujdestari	Neni 106	2003	0		0		
		2004	2		2		
		2005	0		0		
		2006	2	2			
		2007	1			1	
<u>Shfytëzimi i</u> Prostitucionit	Neni 114	2003	22		21		
		2004	73		46		
		2005	18		22		
		2006	23	13 pa përfunduar	8	1	
		2007	14	3 pa përfunduar	9	2	

Shfytëzimi i Prostitucionit në rrethana rënduese	Neni 114/a	2003	58		73		
		2004	19		54		
		2005	60		69		
		2006	44	16 pa përfunduar 1 kthyer për plotësim hetimesh	24	2	1
		2007	46	28 pa përfunduar, 1 kthyer për plotësim hetimesh	16		1

Burimi : Ministria e Drejtësisë.

39. Në këtë pasqyrë jepen të dhënat statistikore për periudhën 2003-2006 dhe 9-mujorin e parë të vitit 2007, në lidhje me vendimet penale të gjykatave që i referohen dhunimit të të drejtave në përgjithësi, apo që i referohen atyre veprave penale subjekt i kryerjes së të cilave, në bazë të praktikës janë femrat. Ministria e Drejtësisë nëpërmjet Buletinit Statistikor Vjetor evidenton vetëm vendimet e dhëna të gjykatave shqiptare respektive, sipas përcaktimeve të bazës ligjore (nenet përkatëse).

40. Po ashtu, në përgjigje të Rekomandimeve të Komitetit (Paragrafet 24, 25 dhe 46) mund të thuhet që, nga ana e personelit që merret me aplikimin e ligjit dhe nga OJF-të për të drejtat e njeriut dhe të grave janë bërë më shumë përpjekje për të rritur shkallën e familjaritetit me Konventën për të sensibilizuar gratë dhe opinionin publik për rëndësinë e Konventës CEDAW, trajnime, biseda në TV e Radio publike, shpërndarje të tekstit të Konventës në gjuhën shqipe, etj. Megjithatë, përsëri situata nuk mund të konsiderohet e kënaqshme. Nga vëzhgimet dhe intervistat që janë bërë në të gjithë vendin me persona të moshave dhe profesioneve të ndryshme vihet re që, Konventa nuk ka përhapje të gjerë dhe nuk ka të dhëna që të tregojnë mënyrën dhe shkallën e zbatimit të Konventës dhe Protokollit Shtesë të saj për të mbrojtur të drejtat e dhunuara të grave.

41. Gjatë vitit 2006 MPÇSSHB në kuadrin e projektit “Hartimi i Strategjisë Kombëtare dhe Planit për Veprim për Barazinë Gjinore” dhe me mbështetjen e agjensive të specializuara të OKB-së realizoi një vëzhgim mbi gjëndjen aktuale në Shqipëri për çështjet e barazisë gjinore. Ky vëzhgim konsistonte në plotësimin e një pyetësori të përgatitur nga stafi i Drejtorisë së Politikave të Shanseve të Barabarta dhe u shpërnda në të gjithë territorin e Shqipërisë nëpërmjet rrjetit të pikave të kontaktit të Prefekturave.

42. Nga përpunimi i pyetësorëve për Legjislacionin dhe Instrumentat ndërkombëtare u konstatua se, në lidhje me pyetjen, *Çfarë njihni nga dokumentat ndërkombëtare që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave ?*, nga të intervistuarat gra, 70.6% njihnin Kartën e të Drejtave të Njeriut, 4.9% njihnin CEDAW-n dhe 7.6% njihnin Platformën për Veprim të Pekinit-1995. Nga të intervistuarit burra, 77.9% njihnin Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, 5% CEDAW-n dhe 1.1% Platformën për Veprim të Pekinit. Në lidhje me pyetjen: *Çfarë njihni nga legjislacioni*

vendas për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave ? rezultoi se, 2% e të intervistuarave gra dhe 17.8% e të intervistuarve burra njihnin ligjin “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”.

43. Për të realizuar sensibilizimin e opinionit publik në përgjithësi dhe në veçanti për punonjësit e administratës publike në nivel qendror dhe lokal, MPÇSSHB ka zhvilluar një sërë veprimtarish të tjera, si për barazinë gjinore, ashtu edhe për parandalimin e dhunës në familje. Këtu mund të përmenden:

- Kryerja e dy studimeve “Situata e barazisë gjinore në Shqipëri” dhe “Dhuna në familje”, të cilat janë botuar dhe shpërndarë në institucionet dhe grupet e tjera të interesit.
- Cikël me shkrime në gazetën e përditshme “Standard” për çështjet e barazisë gjinore.
- Përgatitja dhe shpërndarja e posterave për dhunën dhe barazinë gjinore.
- Emisione në Radio dhe TV Publik.
- Ekspozitë pikturë me tematikë dhunën dhe në kuadrin e 8 Marsit u hap një ekspozitë me foto të grave nga dy fototeka të njohura.
- Panair për gruan biznesmene.
- Tryeza të rrumbullakta për legjislacionin, barazinë gjinore dhe dhunën në familje.
- Aktivitet tematiko-ndërgjegjësues për ditën ndërkombëtare të 8 Marsit 2008, “Progresi është me mua, bashkohu edhe ti” me pjesëmarrjen e Presidentit të Republikës dhe Kryeministrit, deputetëve, përfaqësues të institucioneve të tjera, OJF-ve, organizatave ndërkombëtare që veprojnë në vend.
- Ndërgjegjësimi me Strategjinë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje (SKBGJ & DHF) 2007-2010, nëpërmjet tryezave të rrumbullakta në 12 prefekturat e vendit dhe shpërndarja e Strategjisë.

44. Në SKBGJ & DHF, në Kapitullin, të Drejtat, Legjislacioni dhe Mekanizmi Institucional, një nga objektivat që parashikohet të arrihet për periudhën 2007-2010 është: Përkthimi dhe publikimi i të gjitha dokumentave ndërkombëtarë për çështjet e barazisë gjinore dhe në veçanti Konventa CEDAW. Në këtë aspekt janë realizuar:

1- Ribotimi i Konventës CEDAW dhe Protokollit Shtesë në gjuhën shqipe në formën e një broshure, me një parathënie shpjeguese. Broshura është shpërndarë në institucionet qendrore dhe vendore, si dhe pjesëmarësve në aktivitetin e 8 Marsit, të titulluar, “Progresi është me mua - bashkohu edhe ti”.

2- Përkthimi i akteve ligjore ndërkombëtarë që lidhen me barazinë gjinore të OKB-së, KE dhe BE si dhe botimi. Materili i botuar është shpërndarë në të gjitha institucionet qendrore dhe vendore si dhe OJF-ve që punojnë në këtë fushë.

45. Gjatë vitit 2008-2009 është planifikuar të kryhet një fushatë ndërgjegjësuese “Të drejtat e grave janë të drejta të njeriut”, ku përveç emisioneve në TV dhe Radio publike, shkrimeve në gazeta përfshihen edhe 12 tryeza të rrumbullakta në prefekturat e vendit, ku pjesëmarësit do të trajnohen dhe njihen nga afër me legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar (veçanërisht CEDAW, Protokollin shtesë i tij, Platforma e Pekinit, Konventa e ILO, etj)

46. Qendra Shqiptare e së Drejtës Ndërkombëtare (organizatë jo-qeveritare) ka botuar dhe shpërndarë kohët e fundit në përmbledhje në shqip të akteve kombëtare dhe

ndërkombëtare, lidhur me çështjet e barazisë ligjore ku përfshihen një numër i madh Konventash Ndërkombëtare, përfshirë CEDAW-n. Gjithashtu, Ministria e Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve ka organizuar ditë informative me tematikë “Promovimi i të Drejtave të Njeriut” dhe në këto veprimtari informative pjesë e rëndësishme e materialeve informuese ka qenë edhe Konventa CEDAW.

III. Mekanizmat kombëtarë për barazinë gjinore

47. Diskriminimi ndaj grave në Shqipëri mund të reduktohet, ose të eliminohet nëpërmjet punës së shumë aktorëve dhe në këtë proces aktore kryesore është Qeveria Shqiptare (QSH). Ngritja e një numuri të konsiderueshëm mekanizmesh, apo strukturash qeveritare në funksion të garantimit të barazisë gjinore, tregon indirekt që legjislacioni shqiptar përputhet pozitivisht edhe me nenin 3 të Konventës CEDAW.

48. Krahas kësaj, duke patur parasysh edhe Rekomandimet e Komitetit CEDAW (Paragrafet 26 dhe 27) janë marrë masa konkrete për forcimin e mekanizmit ekzistues të barazisë gjinore, në nivel kombëtar dhe lokal. Përgjegjësia e shtetit për problemet gjinore gjatë harkut kohor 2003-2008 ka qenë e shpërndarë në disa struktura qeveritare, në nivel kryeministri, ministri, apo prefekturë. Pas vitit 2000, në Shqipëri ka pasur zhvillime të rëndësishme institucionale dhe strukturore për përparimin dhe emancipimin e mëtejshëm të grave dhe vajzave në shoqërinë shqiptare, si dhe për të siguruar pjesëmarrjen aktive të tyre njëjloj si burrat në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore të vendit.

Mekanizmi qeveritar për Barazinë Gjinore gjatë viteve 2004-2006

49. Ligji për Barazinë Gjinore nr.9198, datë, 01.07.2004 krijoi disa struktura të ngarkuara për të marrë masat e nevojshme dhe për të zbatuar ligjet kundër diskriminimit. Në këtë drejtim Komiteti Për Mundësi të Barabarta ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të koordinuar iniciativat shtetërore me angazhimin gjithnjë e më në rritje të shoqërisë civile. Në vitin 2002 Komiteti Për Mundësi të Barabarta, i cili përfaqësonte mekanizmin qeveritar për gruan, hartoi një platformë për të përmirësuar statusin e grave në Shqipëri, e titulluar “Platforma e Qeverisë Shqiptare për Mundësi të Barabarta midis burrit dhe gruas 2002-2005”. Kjo platformë nuk ka qenë e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, megjithatë në Programin e Qeverisë për 2002-2005 është marrë në konsideratë zbatimi i objektivave të kësaj Platforme, nëpërmjet zhvillimit të veprimtarive konkrete.

50. Miratimi i Ligjit “Për Barazi Gjinore në Shoqëri” (nr.9198 dt.01.07.2004) parashikonte krijimin e dy strukturave dhe konkretisht: **1).** Komitetin Ndërministror, me rol këshillimor për politikën e barazisë gjinore. **2).** Komitetin “Për barazi gjinore”. Deri në miratimin e Ligjit për Barazinë Gjinore, Komiteti për Mundësi të Barabarta, një strukturë që i parapriu krijimit të Komitetit për Barazi Gjinore kishte pika kontakti në çdo ministri dhe prefekturë. Çështjet gjinore nuk ishin në përkrahimin e punës së këtyre pikave të kontaktit dhe puna shtesë bëhej pa pagesë. Këto pika kontakti siguronin sipas kërkesës së mekanizmit qeveritar (Komitetit për Mundësi të Barabarta) statistika të ndara sipas gjinisë, apo angazhoheshin në tryeza të rrumbullakta dhe në aktivitete të tjera.

51. Megjithatë këto struktura nuk mund të luanin rolin për të cilin ishin ngritur sepse nuk kishin qartësi, fuqi dhe burime të mjaftueshme financiare. Komiteti Ndërministror u mblodh vetëm një herë në maj 2005, ku evidentoi mangësitë dhe pazbatueshmërinë

e ligjit nr.9198, dt.01.07.2004, “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri” dhe la si detyrë rishikimin e këtij ligji. Në ligj nuk flitej për Komitetin Për Barazi Gjinore, por vetëm për Kryetar të këtij Komiteti. Pikërisht kjo mangësi krijoi një mosfunksionim dhe paqartësi të mekanizmit qeveritar për barazinë gjinore. Me ndryshimin e bërë në projekt-ligjin Për Barazinë Gjinore në qershor 2006, autoriteti përgjegjës për barazi gjinore bëhet Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Mekanizmi qeveritar për barazi gjinore nga viti 2006 e në vazhdim.

52. Përparimi i gruas dhe arritja e barazisë gjinore janë konsideruar si politika prioritare të rëndësishme edhe nga ana e qeverisë së dalë nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2005 dhe përsëri theksi është vënë në fuqizimin e mekanizmit qeveritar. Për këtë arsye, në MPÇSBSH (institucion i konsideruar si autoritet përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore) u krijua Drejtoria e Politikave të Shanseve të Barabarta (DPSHB), pas ndryshimeve që pësoi ligji nr.9198, dt.01.07.2004 “Për barazinë gjinore në shoqëri”. Kjo Drejtori zëvendësoi nga pikëpamja strukturore ish-Komitetin për Mundësi të Barabarta (Komitetin për Barazi Gjinore)

53. DPSHB ka si mision kryesor të saj: *“formulimin dhe zhvillimin e politikave për nxitjen e barazisë në fusha të tilla si, barazia gjinore, barazinë/pabarazinë në aftësi, problemet e pakicave etnike, etno-kulturore dhe gjuhësore, pabarazinë moshore, atë brezore e racore etj”*. Në veçanti për çështjet e barazisë gjinore drejtoria ka për qëllim: *“të nxisë barazinë gjinore dhe një pjesëmarrje të gjerë të gruas në jetën ekonomike, politike e kulturore të vendit”*. Detyrat kryesore të kësaj drejtorie (DPSHB) për çështjet e barazisë gjinore janë:

- Të formulojë politika për shanse të barabarta të fokusuar në perspektivën e barazisë gjinore dhe mbrojtjen e të drejtave të kategorive të tjera të shoqërisë, ashtu siç janë të përmëndura edhe në misionin e saj.
- Të propozojë nisma për studim dhe analiza në fushën e gjithë gamës të politikave për shanse të barabarta dhe shfrytëzimin e këtyre studimeve në procesin e politikave të zhvillimit.
- Të hartojë akte ligjore të nevojshme për arritjen e barazisë në fusha të ndryshme dhe të zbatojë e monitorojë dispozitat e ligjit për barazi dhe rregulloret e miratuara në bazë të tij.
- Të mbikqyrë zbatimin e marrëveshjeve dhe akteve ndërkombëtare me fushën që mbulon, duke patur dhe miratimin e Qeverisë.
- Të bashkëpunojë me organizatat jo-fitimprurëse, të cilat janë aktive në fushën e shanseve të barabarta.
- Të koordinojë punën për përgatitjen e Programeve Kombëtare për shanse të barabarta për kategoritë e popullsisë që mbulon objekti i DPSHB.

54. Hartimi i Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje (SKBGJ & DHF) miratuar me VKM Nr. 913, dt.19.12.2007 ishte një nga detyrat kryesore të DPSHB. Hartimi përfshin periudhën qershor 2006 - maj 2007 dhe ishte fryt i një procesi ndërveprues dhe gjithëpërfshirës, i cili angazhoi institucione të qeverisjes qëndrore, lokale, të shoqërisë civile, shoqatave jo-qeveritare, grupe të ndryshme interesi, përfaqësues të forcave politike në vend, përfaqësues të fushës akademike, si dhe partnerë ndërkombëtare. Kjo strategji u mbështet nga UNIFEM dhe UNFPA ndërkohë që OSBE ndihmoi procesin me 2 konsulentë. Synimi kryesor i

strategjisë është përfshirja e çështjeve gjinore dhe të dhunës në familje, në politikat publike nëpërmjet planeve konkrete të veprimit për të hedhur bazat për avancimin e barazisë gjinore dhe minimizimin e fenomenit të dhunës në familje në të ardhmen, duke u mbështetur në dokumentat, rekomandimet dhe instrumentat ndërkombëtare, si dhe duke patur parasysh kushtet konkrete të Shqipërisë.

55. Disa nga prioritetet strategjike të këtij dokumenti, të cilat bazohen në fushat përkatëse që mbulon ai janë :



1. Forcimi i mekanizmave ligjorë dhe institucionalë mbrojtës me qëllim sigurimin e barazisë gjinore në Shqipëri;
2. Fuqizimi i gruas nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së saj në vendimmarrje;
3. Fuqizimi ekonomik i gruas dhe rritja e mundësive të saj për punësim dhe kualifikim profesional;
4. Promovimi i aksesit të barabartë të grave dhe vajzave në arsimin cilësor;
5. Përmirësimi i situatës sociale të grave në rrisht nëpërmjet rritjes së qasjes së tyre ndaj shërbimeve sociale cilësore;
6. Mbrojtja e shëndetit të popullsisë duke përmirësuar sistemin shëndetsor në funksion në nevojave të veçanta të popullsisë në këtë fushë;
7. Përmirësimi i rolit të medias për një mentalitet të ri, që i përgjigjet zhvillimit të kohës, lidhur me barazinë gjinore në shoqëri dhe rritjen e përfaqësimit të grave në këtë profesion;
8. Rritja e ndërgjegjësimit ndaj dukurisë së dhunës, mbrojtje ligjore dhe administrative, si dhe mbështetje për individë të prekur nga dhuna në familje dhe dhunuesit.

56. Qëllimet strategjike të këtij dokumenti janë formuluar duke u bazuar në zbërthimin e prioritetëve strategjike. Për çdo fushë, qëllimet strategjike janë detajuar më tej në objektiva specifike e në veprime konkrete që duhet të ndërmerren.

Një nga objektivat e tjera të DPSHB është edhe përfshirja e çështjeve gjinore në nivel qendror dhe vendor, i cili realizohet nëpërmjet rrjetit të pikave të kontaktit. Krijimi dhe fuqizimi i rrjetit të pikave të kontaktit në nivel ministrie (14 persona) dhe në prefektura (12 persona) ka bërë të mundur bashkëpunimin institucional dhe koordinimin e punës për përfshirjen e politikave gjinore në nivel qendror dhe lokal. Aktualisht po punohet në 65 bashkitë e vendit për ngritjen e rrjetit në nivel bashkie. Pikat e kontaktit janë trainuar me çështjet e përkatësisë gjinore nga niveli fillestar deri në atë më të avancuar. Trainimi për çështjet e integritimit gjinor është realizuar edhe në linjën e ministrive. Qëllimet kryesore të këtij trainimi janë:

- Personat e caktuar për ndjekjen e problemeve të përkatësisë gjinore të shërbejnë si urë lidhëse midis MPÇSSHB dhe ministrive përkatëse, duke lehtësuar rregullisht përcjelljen e informacionit respektiv nga ministria dhe prefektura tek DPSHB dhe anasjelltas.
- Të marrin pjesë në aktivitetet e DPSHB dhe të japin kontributin e tyre në dhënien e mendimeve në lidhje me projekt- ligjet e ndryshme që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, apo strategji për këto çështje.
- Të sigurojnë të dhënat e nevojshme statistikore të ndara sipas gjinisë, që kërkohen nga drejtoria.
- Të punojnë për ndërgjegjësimin e punonjësve të tjerë për problemet e përkatësisë gjinore.
- Të marrin pjesë në trainimet mbi problemet e përkatësisë gjinore.

Rrjeti i Strukturave dhe Nëpunësve Gjimore në Ministri dhe në Qarqe



57. Projekt-ligji i ri “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri” synon të ngrejë mekanizma të reja të tilla si:

1) Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore i kryesuar nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe me anëtarë përfaqësues nga Ministrinë e Linjës, nga OJF-të e fushës dhe nga fusha akademike. Ky këshill do të luajë rol këshillimor.

2) Rrjeti i nëpunësve gjinorë në ministri dhe prefektura. Ky rrjet tashmë institucionalizohet nëpërmjet një baze ligjore. Personat përgjegjës do të mbulojnë çështjet për barazinë gjinore në mënyrë funksionale në përputhje me Ligjin “Për statusin e nëpunësit civil”. Projekt-ligji lë të hapur mundësinë e institucionalizimit të nëpunësve gjinorë edhe në nivel bashkie.

3) Komisioneri i Barazisë Gjinore, etj.

Neni 4 MASA TE PERKOHSHME TE VEÇANTA PER TE PERSHPEJTUAR BARAZINE

1. Masat e përkohshme të veçanta

58. Në legjislacionin shqiptar masat e përkohshme të veçanta, të cilat synojnë përsheptimin *de facto* të barazisë gjinore janë të pakta, ndërsa më i kompletuar paraqitet kuadri ligjor lidhur me masat e posaçme për mbrojtjen e amësisë. Ligji për Barazinë Gjinore, Nr. 9198, datë, 01.07.2004, (neni 10, pika d), parashikon për herë të parë konceptin e masave të veçanta të përkohshme në legjislacionin shqiptar, duke iu referuar pjesëmarrjes së barabartë në procesin e vendimmarrjes. Konkretisht në këtë nen thuhet se: *“Për të rregulluar raportet gjinore në institucione, në procesin e vendimmarrjes gjatë procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve me vlerësime të barabarta në testim e kualifikime dhe eksperiencë të njëjta, përparësi duhet të ketë zgjedhja e një konkurrenti grua, në raport me konkurrentin burrë”*.

59. Megjithatë, ky ligj deri tani ka mbetur i pazbatuar në disa aspekte dhe është i paqartë lidhur me atë se me çfarë kuptohet me proces vendimmarrje, për cilat institucione bëhet fjalë, etj. Këto dhe arsye të tjera të lartpërmendura bënë që të hartohet projekt-ligji i ri “Për Barazinë Gjinore”, si një inisiativë e Qeverisë Shqiptare. Ky projekt-ligj (neni 7) parashikon marrjen e masave të veçanta të përkohshme ku përfshihen: **a).** kuotat për të arritur përfaqësim të barabartë gjinor, të cilat propozohen të jenë jo më pak se 30% për rritjen e pjesëmarrjes së gjinisë më pak të përfaqësuar në vendimmarrje dhe në jetën publike; **b).** fuqizimin ekonomik dhe të pozitës së personave të secilës gjini në fushën e punës; **c).** përmirësimin në mënyrë të barabartë të nivelit arsimor, si dhe masa të tjera në çdo fushë, ku personat e njëjës gjini nuk gëzojnë pozitë të barabartë me personat e gjinisë tjetër.

60. Qeveria Shqiptare në mënyrë progresive ka inkurajuar punësimin e kategorive të veçanta të grave për t'i integruar ato në tregun e punës. Për shëmbull, Strategjia Shtetërore mbi Punësimin dhe Trainimin Profesional 2003-2008, që hyri në fuqi në janar 2003 i kushtoi vëmendje të veçantë grave të papuna. Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM), nr. 632, datë 18.09.2003, “Për Programin e Promovimit të Punësimit për Gratë e Papunësuara të Rregjistruara”¹ i jep prioritet të veçantë promovimit të punësimit të grave. Sipas kësaj VKM, të dalë në zbatim të ligjit nr.7995, datë,

¹ Ky akt nën-ligjor nuk është pasqyruar në Raportin e I dhe të II të Kombinuar

20.09.1995 "Për nxitjen e punësimit" mbështeten financiarisht punëdhënësit, të cilët punësojnë femra dhe sidomos të kategorive të tilla si: femra romë; femrat mbi 35 vjeç; femra të divorcuara me probleme sociale dhe femra me aftësi të kufizuara. Këtu vlejnë të përmenden edhe një sërë masash të marra pas vitit 2003 në lidhje me politikën qeveritare për punësimin, të cilat kanë synuar në punësimin dhe kualifikimin e një kategorie të caktuar grash.

61. Ligji nr.8872, datë, 29.03.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"² garanton të drejtën e shprehur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë për arsimimin dhe formimin profesional gjatë gjithë jetës, mundësinë e kryerjes së arsimit fillestar profesional, si dhe të fitimit të njohurive profesionale të nevojshme për punësim, duke krijuar shanse të barabarta për të gjithë. Në zbatim të këtij ligji ka dalë edhe Udhëzimi i Ministrit të Punës nr. 2222, datë 31.10.2002 "Mbi këshillimin dhe orientimin në formimin profesional."

62. Shërbimi Kombëtar i Punësimit e zbaton këtë udhëzim nëpërmjet zyrave të punësimit, ku janë caktuar punonjës për të realizuar këshillim dhe orientim profesional për të gjithë personat që e kërkojnë atë. Kujdes i veçantë në këshillim dhe orientim iu kushtohet grupeve të veçanta punëkërkuesish siç janë: nënat me shumë fëmijë, personat me moshë mbi 50 vjeç, të rinjtë nën 18 vjeç, të papunët afatgjatë, personat nga familje nën nivelin e varfërisë, viktimat e trafikut, personat që përfitojnë nga programet e mbështetjes me të ardhura, (ky program përfshin pagesën e papunësisë që shkon nga 8 muaj-1 vit dhe ndihmën ekonomike) personat që dalin të papunë nga ndërmarrjet dhe institucionet që janë në proces reformimi, ristrukturimi dhe privatizimi, vajzat-nëna të papuna, femrat e divorcuara me probleme sociale, personat që kthehen nga emigracioni me probleme ekonomike, personat e sapo diplomuar e të paorientuar në tregun e punës, personat që kanë vuajtur dënimin me burgim, personat me aftësi të kufizuara, romët dhe jetimet që e kanë fituar këtë status.

63. Urdhri i Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale nr.394, datë, 23.02.2004, "Për Tarifat e Sistemit të Formimit Profesional" përcakton se, tarifat e rregjistrimit në kurset e formimit profesional të ofruara nga Qëndrat Publike të Formimit Profesional janë falas për kategori të tilla si, komuniteti rom, vajzat dhe gratë e trafikuar. Ky Urdhër parashikon një reduktim të konsiderueshëm të pagesës, ose trainim profesional falas për kategoritë e lartpërmëndura.

2. Masat e posaçme që synojnë mbrojtjen e Amësisë

64. Ndër masat e posaçme që synojnë mbrojtjen e amësisë mund të përmenden:
- Kushtetuta e RSH në nenin 54 të saj përcakton se, "Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatëzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti".
 - Ligji Nr. 9198, dt. 01.07.2004 "Për barazinë gjinore në shoqëri" në nenin 2 (përkufizime) thuhet se, "nuk përbën diskriminim, apo dhunim të të drejtave të barabarta midis burrit dhe gruas mbrojtja e posaçme e grave gjatë shtatëzënisë, lindjes dhe sëmundjes".
 - Ligji Nr. 8876, dt. 07.04.2002 "Për shëndetin riprodhues" garanton mbrojtje të posaçme të shëndetit të nënës dhe fëmijës.

² Ky akt ligjor nuk është pasqyruar në Raportin e I dhe të II të Kombinuar

- Këshilli i Ministrave me VKM nr. 397, datë, 20.05.1996, ndryshuar me VKM nr. 185, datë, 03.05.2002 ka miratuar vendimin "Për mbrojtjen e veçantë të grave shtatzëna dhe të amësisë". Sipas këtyre vendimeve në pikën 5, kur flitet për kohëzgjatjen e punës për gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë në gji përcaktohet se, *ato nuk mund ta fillojnë punën para orës 05 në verë (06 në dimër) dhe as ta vazhdojnë atë pas orës 20.00. Gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë në gji kanë të drejtë të bëjnë pushime të paguara herë pas here gjatë ditës, jo më pak se 20 minuta për çdo tre orë pune të vazhdueshme*.
- Sipas nenit 108 të Kodit të Punës ndalohet puna e natës për gratë shtatzëna. Këshilli i Ministrave është organi, i cili vendos rregulla të veçanta për rastet kur lejohet puna e natës për gratë. Në Kodin e Punës janë parashikuar rregulla të veçanta për mbrojtjen e gruas punëtore. Neni 54/3 parashikon që, *gruaja shtatzënë që punon vazhdimisht në këmbë, në çdo 4 orë duhet të pushojë të paktën 20 minuta*. Pika 2 e nenit 100 të Kodit të Punës së RSH thekson se, Këshilli i Ministrave vendos rregulla të posaçme për kohëzgjatjen e punëve të vështira, ose të rrezikshme për të miturit nën 16 vjeç dhe gratë shtatzëna. Mbi këtë bazë, Këshilli i Ministrave me VKM të veçantë ka përcaktuar rregulla të posaçme për mbrojtjen e grave shtatzëna. Gjithashtu ai ndalon punësimin e grave shtatzëna dhe atyre me fëmijë në gji, në veprimtari që i ekspozojnë ato ndaj faktorëve dhe kushteve të punës me rrezikshmëri për shëndetin e tyre. Lista e punëve që paraqesin rrezik ndaj ekspozimit me agjentë, ose kushtet e punës që vënë në rrezik sigurinë dhe shëndetin e grave shtatzëna, lehona, apo grave me fëmijë në gji është miratuar me VKM nr.207, datë, 09.05.2002, "Për përcaktimin e punëve të vështira, ose të rrezikshme".
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë i konsideron kushtet e këqia të punës një akt kriminal kundër grave shtatzëna, (neni 50/e), ndërsa neni 79/b parashikon burgim të përjetshëm për rastet kur shkaktohet vdekja e gruas shtatzënë.

65. Në Projekt-Ligjin e Ri të Barazisë Gjinore janë parashikuar masa të veçanta për mbrojtjen e amësisë dhe në këtë drejtim ky projekt-ligj garanton:

a) mbrojtjen e posaçme të grave gjatë shtatzanisë dhe lindjes të nënave të reja, si dhe të prindërve të rinj, mbas lindjes natyrore, ose adoptimit prej tyre të fëmijës, duke krijuar kushte për mbrojtjen dhe lehtësimin e tyre në punë; në sigurimet shoqërore e ndihmat sociale; në sigurimin e ndihmës së nevojshme shëndetsore për nënën e fëmijën; në sigurimin dhe nxitjen e sistemit të shërbimeve sociale duke favorizuar zhvillimin e rrjetit të çerdheve e kopshteve;

b) marrjen e masave për të lehtësuar e ndihmuar personat që kanë përgjegjësi të veçanta në familje, për arsye të përkujdesjes së përditshme ndaj antarëve të paaftë të familjes, për arsye të moshës, paaftësisë fizike a mendore, ose për shkaqe të tjera paaftësie.

c) kufizimet për të punuar në disa sektorë të punëve të rënda dhe të rrezikshme për gratë shtatzëna dhe ato me fëmijë në gji. Këto kufizime do të rishikohen periodikisht, në varësi të njohurive shkencore e teknike dhe sipas nevojave që paraqiten.

Neni 5

ROLI I SEKSIT DHE STEREOTIPIVE

(a) Situata aktuale dhe masat e mara për eliminimin e stereotipeve gjinore.

66. Steriotipet gjinore ende mbeten një problem i shoqërisë shqiptare i forcuar kjo nga tradita *maskiliste*, e cila pengon gruan të avancojë në realizimin *de facto* të të drejtave

të saj. Realiteti shoqëror dhe kulturor mbështet konkluzionin, që vajzat më shpesh dhe më shpejt se djemtë braktisin shkollën për të dhënë kontributin e tyre në ekonominë familjare, apo për t'u martuar në moshë tepër të re. Steriotipet tradicionale për gruan janë aplikuar sidomos në media, ku figura e kësaj pjese të shoqërisë paraqitet nga njëra anë si e varur ekonomikisht, emocionalisht e dobët, e pazonja profesionalisht dhe nga ana tjetër paraqitet si shtëpiake e përkushtuar, familjare, nënë dhe bashkëshorte e denjë.

67. Karakterizimi i figurës së femrës shpesh shoqërohet me leksik jo etik, fyes dhe denigrues. Ndodh që publikimi i ngjarjeve reale bëhet nën dritën e paragjykitimit dhe ngjarjet pasqyrohen nën ndikimin e steriotipeve negative. Pavarësisht nga përpjekjet që bëhen vazhdimisht për eliminimin e steriotipive gjinore, ato përsëri ekzistojnë dhe vazhdojnë të evidentohen dhe nga mediat. Ende në mediat shqiptare vihet re mungesa e prezantimit të rolit të shumëfishtë të gruas në familje, si dhe kontributi i saj në shoqëri. Në fakt, media përforcon kuptimet tradicionale të maskulitetit, feminitetit dhe roleve gjinore, ku mashkulli konsiderohet gjithmonë si primar dhe shtylla e familjes, ndërsa femra është nënë e përkushtuar dhe edukatore e denjë për fëmijët e saj dhe pjestarët e tjerë të familjes etj.

68. Gazetarët dhe reporterët vijnë nga një mjedis ku ka mjaft stereotipe që diskriminojnë gratë dhe përgjithësisht janë të prirur të reflektojnë këtë realitet. Për shëmbull, shpesh ndodh që kronikat që bëhen me rastin e Ditës Ndërkombëtare të gruas (8 marsi) pasqyrojnë arritjet e mëdha të grave në arsimim, por nuk përmendin që në nivelin universitar shumica e pozicioneve udhëheqëse në arsim, ende mbahen nga burrat. Pavarësisht se gratë janë të mirë arsimuara dhe të kualifikuara njësoj si edhe burrat, ato janë më pak të punësuara dhe mbajnë më pak pozicione drejtuese. Në fakt, gratë punojnë në sektorë ku shpërblimi është më i ulët. Ato punojnë në punë të tilla si, infermiere, punonjëse në sistemin parashkollor, mësuese në arsimin nëntëvjeçar dhe arsimin e mesëm, kurse në sektorin privat punojnë si rrobaqepëse, infermiere etj, punë të cilat rrjedhimisht janë më pak të paguara.

69. Përpara këtij realiteti dhe duke qënë e mbështetur edhe nga PNUD-i, Qeveria Shqiptare gjatë periudhës 2003-2005 ka ndërmarrë disa analiza në këndvështrimin gjinor në kuadrin e Projektit “*Ngritja e Kapaciteteve të Integritit Gjinor*”. Synimi i këtyre analizave ka qënë që të evidentohen legjislacioni, politikat dhe strategjitë qeveritare në fushën e punësimit, arsimin, shëndetsisë dhe buxhetimit gjinor me qëllim nxjerrjen e mangësive dhe dhënien e udhëzimeve për përmirësimin e situatës së barazisë gjinore në këto fusha, duke synuar njëkohësisht edhe përmbyshjen e Rekomandimeve të Komitetit CEDAW për këtë çështje (Paragrafet 28 dhe 29).

70. Gjatë periudhës 2004-2005 nga mekanizmi qeveritar për mundësi të Barabarta (ish – Komiteti për Mundësi të Barabarta) janë zbatuar disa projekte, të cilat kanë synuar në trainimin e medias me elementë të barazisë gjinore dhe eliminimin e stereotipeve në masmedia. Gjatë vitit 2004 është zhvilluar një cikël trainimesh, lidhur me perspektivën gjinore për gazetarët e medias së shkruar. Gjatë vitit 2005 është realizuar një cikël tjetër trainimi me studentët e vitit të fundit të gazetarisë në lidhje me problemet gjinore në shëndetsi, të cilët janë trainuar për çështjet e etikës së gazetarit, njohjen e legjislacionit gjinor në fushën e shëndetsisë, etj. Gjithashtu, në kuadrin e fushatave sensibilizuese janë zhvilluar cikle emisionesh televizive në TV Kombëtarë për sensibilizimin e opinionit për çështjet gjinore.

71. Gjatë viteve 2006 e në vazhdim, nga ana e Qeverisë ka patur përpjekje të vazhdueshme, të cilat kanë synuar në eliminimin e këtyre stereotipeve. Kjo është realizuar nëpërmjet emisioneve në TV publik dhe privat, me përgatitje dhe shpërndarje posterash, organizim tryezash të rrumbullakta në nivel qendror dhe vendor, trainime të punonjësve të administratës publike me konceptet *gender* dhe të drejtat e grave, etj. Në kuadrin e përmirësimit tërësor të kurrikulave shkollore, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) në bashkëpunim me Institutin e Kurrikulës dhe Trainimit ka shtruar si kërkesë integrimin e perspektivës gjinore nëpërmjet:

(1) hartimit të programeve në arsimin parauniversitar dhe universitar;

(2) hartimit të teksteve të reja shkollore;

(3) hartimit të udhëzimeve dhe materialeve metodologjike për integrimin e perspektivës gjinore në kurrikula.

72. Aktualisht ka përfunduar korniza kurrikulare e gjithë arsimit parauniversitar dhe në programet shkollore trajtimi i përkatësisë gjinore ndryshon sipas niveleve. Në arsimin nëntëvjeçar ky trajtim është i shtirë dhe i integruar në to. Gjithnjë e më e domosdoshme është bërë përfshirja në programet e shkollave të mesme dhe të larta e lëndëve dhe temave që studiojnë përkatësinë gjinore. Zakonisht, në shkollat e mesme komponenti gjinor prezantohet në lëndët shoqërore si, njohuri për shoqërinë, histori, letërsi etj. Në shkollat e larta lëndët mbi çështjet e përkatësisë gjinore ofrohen në programin e Punës Sociale, Psikologjisë, Sociologjisë, Gazetarisë, Politikave sociale etj, si dhe në lëndët letërsi, psikologji, shkenca politike, filozofi dhe kulturë. Një pjesë e fakulteteve përgatit studentët si specialistë në çështjet e përkatësisë gjinore për të punuar në sektorin publik, shoqërinë civile etj. Në Fakultetin e Shkencave Sociale, departamenti i Punës Sociale ka filluar Programi Master 2-vjeçar “Përkatësia gjinore dhe zhvillimi”. Ky program, i cili në dy vitet e para ka qënë mbështetur nga PNUD-i (krijimi i bibliotekës, ardhja e pedagogëve të huaj) filloi në 2007 dhe gjatë vitit të parë e ndoqën gjithsej 19 studentë, nga të cilët 18 femra dhe 1 mashkull.

73. Për shkak të ndryshimit të sistemit arsimor nga 8 në 9 vjet, duke filluar nga viti shkollor 2004-2005 e deri në vitin shkollor 2008-2009 janë hartuar tekstet e reja për të gjitha klasat e arsimit të detyruar (I-IX). Tekstet shkollore të reja kanë përmirësime në shumë drejtime dhe kjo është bërë me pikësynimin për të eliminuar stereotipet që edukojnë pabarazinë gjinore. Hartimi i këtyre teksteve është tregues edhe i një transformimi të ndjeshëm, për sa i përket vetë autorëve të teksteve, përzgjedhjes së materialit, ndërtimit të aparatit pedagogjik etj. Duke ju referuar teksteve të reja të shkencave shoqërore të cilat përdoren në kurrikulën shkollore nga 22 autorë, 17 janë femra. Dhe pikërisht kjo autorësi ka bërë që shumë stereotipe gjinore të eliminohen dhe gjithë materiali mësimor të ketë frymëmarrje më të gjerë.

74. Përgjithësisht, tekstet shkollore të rishikuara kanë përmirësime në drejtim të eliminimit të stereotipeve që edukojnë pabarazinë gjinore, si në përzgjedhjen e shëmbujve, ashtu dhe në psikologjinë që përshkon materialin ilustrues, apo dhe në detyrat e dhëna nga aparati pedagogjik. Megjithatë, në tekstet e përdorura për të përgatitur mësues këndvështrimi gjinor është thujse fare i pandjeshëm. Për më tepër, në përgatitjen fillestare të tyre mësuesit përballen me një trajtim të pamjaftueshëm të komponentit gjinor, ndërsa kualifikimi i mësuesve në shërbim (në punë), përgjithësisht përqëndrohet në kualifikimin e tyre sipas lëndëve dhe në kualifikimin metodik të mësimit dhe të të nxënësve. Komponenti gjinor nuk është pjesë integrale e këtyre kualifikimeve.

75. Strategjia e Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje, miratuar me VKM Nr.913 dt.19.12.2007 synon që, nëpërmjet programeve të ndërmerren veprime konkrete për eliminimin e dallimeve gjinore në të gjitha fushat. Në zonat më sensitive të vendit si Tiranë, Shkodër, Malësi e Madhe, Korçë, Elbasan, Berat, Fier etj, MASH në bashkëpunim me UNICEF ka zhvilluar trainime të mësuesve. Ndërkohë mësuesit nga ana e tyre kanë organizuar takime me prindër për ndryshimin e skemave dhe modeleve të sjelljes shoqërore dhe kulturore të burrit dhe gruas, për stereotipitë, kanunin (kryesisht kundër gjakmarrjes), kodet tradicionale, paragjykimet dhe praktikat zakonore.

76. Një ndër drejtimet kryesore të punës së shkollës ka qënë dhe ajo kundër dhunës në shkollë e në familje, në veçanti atje ku pjesë e saj janë gratë e vajzat. Për këtë MASH ka nxjerrë Qarkoren nr.8373, datë, 26.11.2006. *“Për marrjen e masave për përmirësimin e punës edukative në shkollë dhe parandalimin e dhunës”*. Në zbatim të kësaj qarkoreje dhe të rekomandimeve të studimit “Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri” të realizuar nga UNICEF u hartua një plan aktivitetesh në shkallë kombëtare siç ishte psh, shpallja e aksionit kombëtar në arsim për t’i thënë *“Stop dhunës ndaj fëmijëve në shkollë”*. Në kuadër të këtij aksioni u morën këto masa:

- Adoptimi dhe realizimi i një kodi sjelljesh për të gjithë stafin dhe nxënësit e shkollës që t’i kundërvihet të gjitha formave të dhunës dhe sjelljeve që mbartin diskriminim.
- Nga çdo Drejtori Arsimore Rajonale dhe Zyrë Arsimore (DAR & ZA), si dhe çdo drejtori kopshti dhe shkolle janë analizuar shfaqjet e formave të ndryshme të përdorimit të dhunës (fizike, emocionale - psikologjike, seksuale) në mjediset edukative arsimore.
- Në nivel Drejtorie Arsimore Rajonale dhe Zyre Arsimore (DAR & ZA) me drejtuesit e të gjitha kopshteve dhe shkollave janë organizuar seminare për evidentimin e formave të dhunës që ushtrohen në mjediset arsimore dhe mënyrat e parandalimit të tyre.
- Në nivel kopshti dhe shkolle janë organizuar takime të mësuesve të shkollave me punonjësit e “Qëndrave të Shërbimit Psikologjik” për të marrë njohuri për format e ndryshme të dhunës ndaj fëmijëve dhe pasojat afatgjata që ato kanë në zhvillimin e tyre.
- Në planet e punës së specialistëve të Qëndrave të Shërbimit Psikologjik janë përfshirë edhe veprimtari për identifikimin, trajtimin dhe parandalimin e formave të ndryshme të dhunës në shkollë.
- Janë realizuar biseda, anketime, pyetësorë etj, me nxënës, mësues dhe prindër për të identifikuar rastet e dhunës.
- Është punuar për të forcuar bashkëpunimin me institucione dhe shoqata që veprojnë në fushën psiko-sociale dhe në atë të zgjidhjes së konflikteve për trajtimin e fëmijëve me probleme në sjellje.
- Janë organizuar aktivitete të veçanta me prindërit për mënyrën e trajtimit të fëmijëve dhe menaxhimit të sjelljeve të tyre.
- Mësuesit kujdestarë të klasave I-XII në orët e veprimtarive ekstra-kurrikulare kanë programuar sipas klasave zhvillimin e veprimtarive mësimore, bazuar në Udhëzimin e Përgjithshëm të Drejtorisë së Zhvillimit të Kurrikulave në MASH, në lidhje me “Zhvillimin e temave të dhunës së mësuesve mbi nxënësit”.

- Në nivel kopshti dhe shkolle është ndërmarrë një diskutim i gjërë nga mësues, nxënës dhe prindër për tërësinë e sjelljeve dhe marrëdhënieve që mbartin dhunë dhe që janë të dënueshme midis mësuesve dhe nxënësve, midis vetë nxënësve dhe midis prindërve, fëmijëve dhe mësuesve. Në këtë diskutim ka marrë pjesë aktivisht edhe komuniteti i prindërve.
- Janë organizuar ekspozita me vizatime, karikatura dhe krijime letrare me temë “Dhuna ndaj fëmijëve”.
- Në nivel lokal, temat dhe diskutimet e ndryshme janë prezantuar në mediat televizive nëpërmjet ballafaqimeve të shkollës, nxënësve dhe prindërve për dhunën në shkollë e në familje.
- MASH, në bashkëpunim me UNICEF ka zbatuar një projekt të veçantë të quajtur “COMBI”, i cili synonte formimin tek nxënësit të sjelljeve të qëndrueshme kundër dhunës.

77. Një pjesë e mirë e fushatave kombëtare informuese, të cilat kanë patur si qëllim eliminimin e stereotipeve gjinore, janë ndërmarrë nga OJF-të e specializuara në çështjet gjinore. Sesione trainimi me grupe grash dhe burrash të grupmoshave, niveleve arsimore dhe profesioneve të ndryshme, janë bërë pothuajse në të gjithë Shqipërinë.

(b) Përgjegjësia e përbashkët e të dy prindërve në rritjen e fëmijëve.

78. Tradicionalisht gratë mbajnë barrën kryesore të mirëqënies në familje, megjithatë ato kanë më pak mundësi se burrat në përdorimin e burimeve dhe mjeteve që nevojiten për të përbushur përgjegjësitë familiare. Për shkak të mbulimit të të dyja përgjegjësive, si të sigurimit të ushqimit, ashtu dhe atë të përkujdesjes, gratë punësohen në punë me orare të shkurtuara që nuk kërkojnë lëvizshmëri, apo orare të zgjatura dhe njohuri të avancuara profesionale. Për pasojë, ato kanë paga më të ulëta, pasiguri të vendit të punës, mos sigurim shoqëror dhe shëndetsor, janë të mbingarkuara (punë me pagesë në tregun e punës dhe pa pagesë në shtëpi), janë përkujdesëse të vetme, shpesh siguroese të vetme të ushqimit, janë të konsumuara psikologjikisht e për rrjedhojë reflektojnë gjithçka edhe tek fëmijët apo familjet e tyre.

79. Duke synuar përmirësimin e kësaj situate, ndër të tjera, MPCSSHB zbatoi të gjitha procedurat për ratifikimin e Konventës Nr. 156 të ILO-s “*Mbi punonjësit me përgjegjësi familjare*”. Kjo Konventë u ratifikua nga Shqipëria në Korrik 2007 dhe zbatimi i saj është konsideruar si një detyrim për shtetin në aspektin e hartimit të programeve dhe politikave në favor të ofrimit të mundësive të barabarta midis burrave dhe grave, si dhe të krijimit të kushteve për hartimin dhe zbatimin e programeve lehtësuese për punonjësit me përgjegjësi familjare. Ratifikimi i kësaj Konvente ka patur rëndësi edhe për çështjet e eliminimit të stereotipeve gjinore dhe sensibilizimin e opinionit, në lidhje me ndarjen në mënyrë të barabartë të përgjegjësive familjare (kujdesi për fëmijët, personat e paaftë dhe mosha e tretë).

80. Në Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje 2007-2010 janë parashikuar fushata sensibilizimi në lidhje me të drejtat e grave, ku janë përfshirë edhe sesione trainimi për ndarjen e përgjegjësive familjare. Po në këtë plan veprimi, në masat legislative do të propozohet një shtesë në Ligjin e Sigurimeve Shoqërore, lidhur me marrjen e lejes prindërore nga babai pas lindjes së

fëmijës, duke i dhënë mundësi babait të kontribuojë në kujdesin ndaj fëmijës dhe nënës nga baballarët. Kjo bëhet në kuadrin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë ndërkombëtar dhe veçanërisht me atë të BE-së.

81. Gjithashtu, Projekt-ligji i ri i “Për Barazinë Gjinore” parashikon marrjen e masave specifike për të lehtësuar e ndihmuar personat që kanë përgjegjësi të veçanta në familje, për shkak të përkujdesjes së përditshme ndaj anëtarëve të paaftë të familjes, për shkak të moshës, paaftësisë fizike a mendore, ose për shkaqe të tjera paaftësie.

Dhuna në Familje

82. Lobimi i bërë nga shoqëria civile për gati tre vjet në të gjithë zonat e vendit bëri që të siguroheshin 20.000 firma dhe si rezultat i inisiativës qytetare të këtyre zgjedhësve u bë i mundur miratimi në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë i ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Ky ligj është përgatitur në bashkëpunim me grupet e interesit, si: OJF-të, organizatat për mbrojtjen e të drejtave të grave, Avokati i Popullit, etj. Ai u diskutua gjerësisht në Komisionet Parlamentare, u konsultua edhe me institucionet qeveritare, ku u dhanë mendime edhe nga MPCSSHB dhe pasi u bënë ndryshimet përkatëse, u miratua në dhjetor të vitit 2006.

83. Ligji hyri në fuqi më qershor 2007 dhe aktualisht sipas detyrimit ligjor janë miratuar disa akte nënligjore, të cilat kanë të bëjnë me ngritjen e strukturave përgjegjëse për çështjet e dhunës në familje. Ndër to mund të përmenden: **a)** Urdhri i Kryeministrit nr.202, dt.05.12.2007 “Për ngritjen në MPCSSHB të strukturës për masat ndaj dhunës në familje”; **b)** Disa Urdhra të Ministrit të Shëndetsisë, të cilat kanë të bëjnë me pajisjen e personave të dhunuar në familje me raport mjekësor, evidentimin e rasteve në rregjistrin dhe kartelën individuale, si dhe trajtimin mjekësor në institucionet shëndetsore të personave të dhunuar; **c)** Urdhri nr.379, dt.3.3.2008, “Për masat që do të merren nga Policia e Shtetit për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje”. Proçesin e udhëheq MPCSSHB, ku është krijuar edhe *Spektori për Masa ndaj Dhunës në Familje*, i cili luan rol koordinues dhe mbikqyrës sipas ligjit.

84. Lidhur me këtë çështje, qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe reduktimi i dhunës në familje në të gjitha format e saj, si dhe garantimi i mbrojtjes me masa ligjore i pjestarëve të familjes, të cilët janë viktimat e dhunës në familje. Në përputhje me këtë ligj, “*dhunë konsiderohet çdo veprim, apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik*”. Edhe Kodi i Familjes, për rastet e dhunës në familje parashikon marrjen e masave urgjente nga gjykata, sipas kërkesës së bashkëshortit tjetër për rastin kur njëri nga bashkëshortët nuk plotëson në mënyrë të dukshme detyrimet e tij dhe vë në rrezik interesat e familjes. Në nenin 62, me titull “Masat kundër dhunës” parashikohet që, “*bashkëshorti ndaj të cilit ushtrohet dhunë ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës me kërkesë për vendosjen si masë urgjente largimin nga banesa bashkëshortore të bashkëshortit që ushtron dhunë*”.

85. Nga ana tjetër Kodi i Procedurës Penale i RSH parashikon ndihmën falas nga një mbrojtës për të pandehurin, i cili nuk ka mjete të mjaftueshme financiare. Konkretisht, neni 49 i Kodit Penal me titull, “Mbrojtësi i caktuar” parashikon se, “*i pandehuri që nuk ka zgjedhur mbrojtës, ose që ka mbetur pa mbrojtës ndihmohet nga një mbrojtës i caktuar nga organi që proçedon, në qoftë se ai e kërkon atë*”. Kur i pandehuri nuk ka mjete të mjaftueshme, shpenzimet e bëra për mbrojtjen paguhen

nga shteti. Kur i pandehuri është nën moshën 18 vjeç, apo me të meta fizike, ose psikike që e pengojnë për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes, ndihma nga një mbrojtës është e detyrueshme. Në këto raste edhe OJF-të e ndryshme ofrojnë ndihmë ligjore falas për subjekte të caktuara. Të tilla janë: Nisma Ligjore Qytetare, Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve, Zyra Ligjore për të Mitur, etj. Në këtë drejtim po punohet nga Ministria e Drejtësisë për nxjerrjen e akteve nënligjore, të cilat parashikojnë ndihmë ligjore falas për viktimat e dhunës në familje.

86. Në zbatim të Ligjit Nr. 9669, datë 18.12.2006 dhe në përgjigje të Rekomandimeve të Komitetit CEDAW për këtë çështje (Paragrafet Nr 32, 33), Policia e Shtetit ka ndërmarrë edhe një plan masash të nevojshme për të luftuar dhunën ndaj grave në Shqipëri, si dhe për trainimin e oficerëve të policisë në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së problemeve që kanë të bëjnë me dhunën në familje. Po kështu, funksionarët e ngarkuar me këto çështje, në përputhje me ligjin janë urdhëruar të rregjistrojnë të gjitha ankesat e dhunës bashkëshortore që janë objekt hetimi, si dhe të forcojnë bashkëpunimin me organizatat që janë në gjendje të ofrojnë asistencë për viktimat e dhunës bashkëshortore.


87. Ministria e Brëndshme është një nga autoritetet përgjegjës për krijimin e sektorëve të veçantë për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje. (Neni 7/1/a, i Ligjit nr.9669, datë, 18.12.2006). Në zbatim të këtij detyrimi, në korrik 2007 u ngritën struktura të veçanta në nivel qendror dhe rajonal, të cilat aktualisht janë në procesin e vënies së tyre në efencë. Në nivel qendror, në Drejtorinë Kundër Krimeve të Rënda, (Departamenti për Hetimin e Krimeve) këto struktura quhen “Sektorë”, kurse në Drejtoritë e Policive në Qarqe, në nivel rajonal ato quhen “Seksione” për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunën në Familje.

88. Këto struktura kanë për funksion parandalimin dhe goditjen e dhunës në ambientet familjare, dhunën ndaj të miturve, si dhe mbledhjen në mënyrë sistematike të të dhënave statistikore që kanë të bëjnë me këtë fenomen. Këto të dhëna do të raportohen çdo tremujor gjatë vitit 2008 e në vazhdimësi. Sipas të dhënave të tremujorit të parë të vitit 2008 rezultoi të kenë kërkuar mbrojtje nga policia 184 viktima të dhunës në familje. Nga monitorimi që i është bërë zbatimit të ligjit nr. 9669, datë, 18.12.2006 nga ana e Sektorit *Për Masa Ndaj Dhunës në Familje*, për periudhën janar-mars 2008, nga strukturat e policisë së qarqeve janë përgatitur e dërguar në gjykatat e rretheve respektive, 74 kërkesë-padi "Për lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes", 61 prej të cilave janë përgatitur nga Drejtoria e Policisë Qarkut Tiranë.

89. Nga studimi i rasteve të dhunës ndaj gruas dalin në pah dukuri që lidhen me të kaluarën jo të largët të shoqërisë shqiptare, sidomos në marrëdhëniet në çift të tilla si, martesat e sforcuara me mblesëri, migracioni i meshkujve dhe pasojat negative sociale në lidhjet familjare, diferencat në punësim, në shpërblim, diskriminimi në zonat e thella të vendit, si dhe problemet e pronësisë të shoqëruara me dhunë brënda familjes. Numri i rasteve të keqtrajtimit sistematik psikologjik të denoncuar nga gratë rezultoi të jetë i ulët. Kjo për arsye se, ende komuniteti kryesisht në zonat rurale nuk ka emancipimin e duhur për të denoncuar në polici rastet flagrante të dhunës së burrit ndaj gruas, të babait ndaj vajzës, apo të fëmijëve ndaj prindërve pleq, etj.

90. MPÇSSHB, në bashkëpunim me Qendrën e Aleancës Gjinore për Zhvillim (OJF) realizuan një studim të titulluar “*Dhuna në Familje – Situata aktuale*”, i cili merrete në analizë situatën në Shqipëri, në lidhje me fenomenin e dhunës në familje. Ky studim u krye nga një grup ekspertësh me përvojë dhe kualifikim në këtë fushë, të cilët në analizën e tyre morrën për bazë të dhënat e periudhës 2000-2005, të siguruar nga organizatat dhe qendrat që ofrojnë shërbime sociale në ndihmë të viktimave të dhunës në familje Gjithashtu, të dhëna lidhur me përhapjen e dhunës në familje për vitin 2005 janë marrë edhe nga Ministria e Brëndshme. Ky studim i parapriu hartimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit për Veprim Kundër Dhunës në Familje.

91. Duke iu referuar këtij studimi nga të dhënat e grumbulluara në të gjitha qendrat dhe shoqatat (duke mos përfshirë linjën e këshillimit të Tiranës) që kanë për objekt të punës së tyre luftën kundër dhunës ndaj gruas dhe që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës rezulton që: nga 7799 raste të trajtuara prej tyre, 6199 janë raste që kërkojnë ndihmë për t’i shpëtuar situatës së dhunshme në familje. (shih Grafikun e mëposhtëm). Natyrisht që këto shifra nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë si tregues definitivë të përmasave të fenomenit të dhunës në familje, por nga ana tjetër ky informacion nuk duhet neglizhuar, pasi ai është shprehje e faktit që gratë dhe vajzat në të shumtën e rasteve iu drejtohen qendrave të shërbimit, pikërisht për arsye të dhunës së ushtruar në familje. Sipas të dhënave të Qendrës së Këshillimit për Gra dhe Vajza në Tiranë, për periudhën 2000-2005, nga 9834 raste të rregjistruara, 9405 prej tyre kanë qënë raste në të cilat është ushtruar dhunë. (95.6%).



92. Nga ky studim u nxorrën dhe disa konkluzione të rëndësishme, në lidhje me format më të përhapura të dhunës, të cilat rezultuan si më poshtë:

1. Dhuna emocionale është forma e dhunës në familje, e cila haset më shpesh.
2. Dhuna ekonomike takohet më shumë në zonat urbane.
3. Dhuna fizike raportohet më shumë në zonat rurale.
4. Dhuna seksuale është forma më pak e raportuar.
5. Më të rrezikuara janë gratë me aftësi të kufizuara, gratë migrante, gratë rome dhe gratë e zonave rurale.

6. Grup moshat që përjetojnë më shumë dhunë janë dy: 18-23 vjeç dhe 37- 45 vjeç.

93. Për vitin 2005, Ministria e Brëndshme³ ka rregjistruar rastet e dhunës në familje dhe duke u bazuar në evidentimin e ngjarjeve kriminale u evidentuan 102 raste të ushtrimit të dhunës në familje. Nga klasifikimi që i është bërë këtyre rasteve prej specialistëve të ministrisë rezulton që dhuna është shprehur në format e mëposhtme:

Format e dhunës	Nr. i rasteve
Raste vrasjeje	21
Tentative vrasjeje	10
Kanosje për vrasje	15
Plagosje	8
Marëdhënie seksuale me dhunë	1
Heqje e paligjshme e lirisë	2
Fyerje dhe rrahje	23
Vjedhje të pasurisë	3
Detyrim për të abortuar	2
Vepra të turpshme	1
Braktisje të foshnjës	1
Shkaktim të vetëvrasjes	3
Shkatërrim prone	5

94. Gjatë vitit 2006, nga Drejtoria Kundër Akteve Terroriste dhe Krimeve të Hapura, (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë) janë evidentuar gjithsej 208 raste të dhunës familjare të denoncuar nga viktimat, ose të afërmit e tyre. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2005 ka një rritje me 112 raste. Kjo rritje nuk është reale, por ka të bëjë me evidentimin më të saktë dhe vlerësimin më serioz që po i bëhet këtij fenomeni kriminal nga ana e strukturave vendore të policisë. Veprat penale në marëdhëniet bashkëshortore gjatë vitit 2006 përbëjnë 108 raste, ku bashkëshortët dominojnë me 95 raste, si autorë të veprave të mëposhtme:

Format e dhunës	Nr. i rasteve
Raste vrasjeje të bashkëshortëve	8
Tentative vrasjeje	4
Kanosje për vrasje	29
Plagosje	17
Shtytje për prostitucion	1
Fyerje dhe rrahje	25
Shtrengim për bashkëjetesë	3
Shkaktim të vetëvrasjes	2

³ Ministria e Brëndshme, Mars 2006

95. Në përputhje me Rekomandimet e Komitetit CEDAW, (Paragrafi 25) është punuar për hartimin e programeve të edukimit dhe trainimit rreth Konventës, në veçanti kjo për personelin juridik dhe ligjor. Shkolla e Magjistraturës ka trajtuar gjerësisht në të gjitha llojet e aktiviteteve të organizuara (si në trainimin fillestar për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë, ashtu edhe në sesionet trainuese për gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë) tema të ndryshme të të drejtave të njeriut dhe tema të tjera, të cilat kanë të përfshira në to elementë të rëndësishëm të diskriminimit. Në programin e formimit të vazhdueshëm profesional për gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë, në Shkollën e Magjistraturës gjatë viteve të fundit janë zhvilluar aktivitete për të trajtuar tematikën e të drejtave të njeriut, ndër të cilat mund të përmenden:

- Sesioni studimor mbi Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore me temë: “E drejta e jetës, e drejta për të mos iu nënshtruar torturës dhe trajtimeve ç’njerezore dhe degraduese dhe e drejta për liri e siguri, sipas neneve 2, 3 dhe 5 të Konventës CEDAW”.
- Tetor 2003 - Kuptimi i veprave penale të trafikimit të qënieve njerëzore. Teknikat e hetimit dhe gjykimi i tyre. (2 sesione trainuese).
- 2004 - Familja, martesë, divorci – probleme ligjore që burojnë dhe prekin antarët e familjes. (dy sesione trainuese me këtë temë janë zhvilluar në prill, dy në maj, dy në qershor dhe dy në korrik).
- Nëntor 2004 - E drejta e refugjatëve dhe çështjet e azilit.
- Maj 2005 - Mbrojtja e viktimave të trafikimit të qënieve njerëzore në Proçedurat Penale. (trajtimi i grave viktime të trafikimit)
- Qershor 2005 - Kuptimi i veprave penale të trafikimit të qënieve njerëzore.
- Qershor 2005 - Përdorimi i standarteve ndërkombëtare të punës dhe e drejta e punës në Shqipëri (diskriminimi i trajtuar si një çështje tërësisht më vete).
- Tetor 2005 - Drejtësia për të miturit. (4 sesione trainuese).
- Tetor 2005 - Trafikimi i qënieve njerëzore dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit.
- Nëntor 2005 - E drejta e refugjatëve dhe çështjet e azilit.
- Nëntor 2005 - Martesa dhe bashkëjetesa. Bashkëshortët, divorci, regjimi pasuror martesor. Konflikti i ligjeve në të drejtën familjare.

Neni 6

SHFRYTEZIMI I GRAVE (TRAFIKIMI DHE PROSTITUCIONI)

Kuadri ligjor për luftën kundër trafikimit dhe prostitucionit

96. Fusha e luftës kundër krimit të organizuar dhe trafikeve të paligjshme është një ndër fushat prioritare për Qeverinë Shqiptare, si dhe një element shumë i rëndësishëm në kuadër të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Angazhimet e ndërmarra dhe objektivat e përcaktuara shkojnë në një linjë me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA-nenet 4,78,81 dhe 85). Në raportet kombëtare e ndërkombëtare Shqipëria nuk konsiderohet një vend tranziti, apo destinacioni për trafikimin e njerëzve, por mbetet ende një vend origjine. Ajo ka bërë përparime jo vetëm në goditjen e autorëve të kësaj veprë penale dhe të veprave të tjera penale që kanë lidhje me të, por dhe në ngritjen e strukturave proaktive të mbrojtjes dhe asistencës së viktimave të trafikimit. Gjithashtu, progres është arritur edhe në miratimin e ligjeve për antitrafikun sipas standarteve ndërkombëtare dhe si rezultat Shqipëria ka aktualisht një kuadër të mirë ligjor për ndëshkimin e këtij krimi të rëndë.

97. Krahas dispozitave përkatëse të Kodit Penal për trafikimin dhe për veprat e tjera që lidhen me të, ekzistojnë një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore që plotësojnë kuadrin ligjor për goditjen e krimit të organizuar në përgjithësi dhe trafikimin e qënieve njerëzore në veçanti. Këto dispozita përputhen me Konventën e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe dy Protokollet shtesë të saj, të cilat aktualisht janë të ratifikuara. Është bërë rishikimi dhe hartimi i legjislacionit që garanton liritë dhe të drejtat e grave nga njëra anë dhe ndëshkimin e autorëve të përfshirë në këto veprimtari kriminale, nga ana tjetër. Ndër ndryshimet më të rëndësishme të kryera në kuadrin ligjor mund të përmendim:

1. Ligjin Nr. 9284, datë, 30.09.2004, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar".
2. Ligjin Nr. 9188, datë 12.02.2004, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë, 27.01.1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë- i ndryshuar".
Në kuadrin e luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore me ndryshimet që i janë bërë Kodit Penal nëpërmjet ligjit nr. 9188, datë, 12.02.2004 janë shtuar vepra të reja penale, ose janë ndryshuar ato ekzistueset, në përputhje me dispozitat e konventave të ndryshme të ratifikuara.
3. Ligjin Nr.9205, datë, 15.03.2004, "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë".
4. Ligjin Nr. 9509, datë, 03.04.2006, "Për shpalljen e moratoriumit për mjetet motorike lundruese të Republikës së Shqipërisë." Miratimi i këtij ligji është shprehje e përpjekjeve serioze për forcimin e masave të kontrollit të trafikeve të paligjshme në kufi. Ai është plotësuar më tej edhe me akte të tjera nënligjore, siç janë VKM-të dhe Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Brëndshëm dhe atij të Mbrojtjes.
5. Ligjin Nr. 9642, datë, 20.11.2006, nëpërmjet të cilit u ratifikua nga Parlamenti Shqiptar Konventa e Këshillit të Europës "Për Masat kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore".
6. Ligjin Nr. 9686, datë, 26.02.2007, nëpërmjet të cilit u miratuan ndryshimet në nenin 298 të Kodit Penal, "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve", ku janë përfshirë elementë të veprës penale të kontrabandimit të qënieve njerëzore krijon mundësi edhe për hetimin e rasteve të kontrabandimit edhe në ato shtete që nuk kanë kufij tokësorë me Shqipërinë. Me miratimin e këtij neni në Kodin Penal është bërë i mundur edhe dallimi ndërmjet veprës penale të trafikimit të personave, nga kontrabandimi.
7. Ligjin Nr. 9859, datë, 21.01.2008, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë,27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë - i ndryshuar". Më konkretisht, nenet e shtuara janë: **a).** neni 124/b, "Keqtrajtimi i të miturve", i cili ndër të tjera dënon fenomenin e shfrytëzimit të fëmijëve për punë të detyruar, lypjen dhe shërbime të tjera të detyruara; **b).** shtesa e një paragrafi në nenin 117 "Pornografia", ku trajtohet pornografia me të miturit; **c).** shtesa në nenin 128/b, "Trafikimi i të miturve", ku tashmë penalizohet me ligj jo vetëm rekrutimi, fshehja, pritja etj, por dhe shitja e të miturve.

98. Ndryshimet në legjislacionin penal e sollën Shqipërinë më pranë standarteve ndërkombëtare dhe duke u bazuar në këto ndryshime mund të thuhet, që legjislacioni shqiptar përputhet mjaft mirë me nenin 6 të Konventës CEDAW. Dispozitat e reja në fushën e trafikimit, duke përfshirë trafikimin e femrave përdorin thuajse të njëjtat përkufizime që përdoren edhe në dokumentat ndërkombëtare për këtë çështje siç është psh: Protokollin Shtesë për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të

personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve. Këto ndryshime të shoqëruara edhe me ndryshime të tjera legislative në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, futjen e teknikave të reja hetimore, si dhe paketën ligjore anti-mafia, synojnë që së bashku të luftojnë të gjitha format e trafikimit të femrave.

99. Kodi Penal (ligji nr.9188, datë, 12.02.2004) në nenin 114/b me titull “Trafikimi i femrave” ka parashikuar një dispozitë të veçantë për trafikimin e femrave ku përcaktohet se, “dënohet rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja, ose pritja e femrave nëpërmjet kërcënimit, ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës, ose përfitimit nga gjëndja shoqërore, fizike a psikike, ose dhënies apo marrjes së pagesave, ose përfitimeve, për të marrë pëlqimin e një personi që kontrollon një person tjetër me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve, ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës, ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit, ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim, ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, me burgim nga 7-15 vjet dhe me gjobë nga 3-6 milionë lekë”.

100. Kodi Penal shqiptar është një ndër të paktët, në mos i vetmi në Europë që i ngarkon edhe prostitutat me përgjegjësi penale. Komentet e mëposhtme të disa paragrafëve të nenit 114/b të Kodit Penal të RSH reflektojnë shkallët e ndryshme të dënimit të veprës penale të trafikimit të femrave. Konkretisht:

- Sipas paragrafit të II-të të nenit 114 organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të femrave dënohen me burgim nga 10-15 vjet dhe me gjobë nga 5-7 milionë lekë.
- Paragrafi i III-të, “kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim, ose më shumë se një herë apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike, ose psikike ndaj të dëmtuarës, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se 15 vjet, si dhe me gjobë nga 6-8 milionë lekë”.
- Paragrafi i IV-t, “kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarës dënohet me burgim të përjetshëm, si dhe me gjobë nga 7-10 milionë lekë”.
- Paragrafi i V-të, “kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror, ose shërbimit publik dënimi me burgim dhe gjoba shtohen me 1/4 e dënimit të dhënë”.

101. Në po këtë ligj është shtuar neni 128/b, me titull “Trafikimi i të miturve”. Kjo është një dispozitë e veçantë në të cilën trajtohen veprat penale të kryera ndaj të miturve, së bashku me sanksionet e ashpra që parashikon kjo dispozitë për këto lloj veprash penale. Sipas nenit 128/b, “dënohet rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja, ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit, ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës, ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit, ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim, ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit”.

102. Vlen të përmendet edhe neni 110/a me titull, “Trafikimi i personave” (i shtuar me Ligjin Nr. 9188, datë, 12.02.2004, neni 1), sipas të cilit dënohet rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja, ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit, ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës, ose përfitimit nga gjëndja shoqërore, fizike apo psikike, ose dhënies apo marrjes së pagesave, ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një

person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të tjerëve, ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit, ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim, ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit. Trafikimi i personave dhe kur ka sjellë si pasojë vdekjen dënohet me burgim jo më pak se 20 vjet, ose me burgim të përjetshëm, si dhe me gjobë nga 7-10 milionë lekë.

Masat kryesore që janë ndërmarrë kundër trafikimit të grave

103. Në përgjigje edhe të Rekomandimeve të Komitetit CEDAW, (Paragrafët 30 dhe 31) Qeveria Shqiptare ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Luftën Kundër Trafikut të Qënieve Njerëzore për vitin 2005-2007 dhe ka ndjekur detyrimet që rrjedhin prej saj. Parandalimi dhe lufta kundër trafikimit të qënieve njerëzore vazhdon të jetë një nga prioritetet kryesore të Qeverisë, mbasi ai konsiderohet si një fenomen me ndikim të theksuar negativ në shoqërinë shqiptare. Kjo luftë është përqëndruar në 3 drejtime kryesore :

1. Hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të trafikimit,
2. Mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave dhe të dëshmitarëve,
3. Ndërmarrjen e hapave konkrete për parandalimin e trafikimit dhe ritrafikimit.

Këto orientime kanë gjetur pasqyrim dhe janë kthyer në objektiva dhe masa konkrete për çdo institucion të administratës qendrore, për institucionet e pavarura, si dhe për aktorë të tjerë të shoqërisë që janë përfshirë në luftën ndaj këtij fenomeni në kuadrin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore, 2005-2007.

104. Të gjitha rezultatet e arritura në tre drejtimet kryesore të luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore (hetim, ndjekje penale, mbrojtje dhe parandalim), përmbledhen në raporte 6-mujore dhe vjetore mbi realizimin e Strategjisë Kombëtare Shqiptare të Luftës kundër Trafikut të Qënieve Njerëzore. Në këto raporte janë dhënë rregullisht informacione, jo vetëm për arritjet në bazë të treguesve të efikasitetit, por edhe për problemet që ndeshen në praktikë. Njëkohësisht, atje përcaktohen edhe masat konkrete për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të trafikimit, mbrojtjen dhe integrimin e viktimave të trafikimit dhe të dëshmitarëve të drejtësisë, si dhe parandalimin e trafikimit të njerëzve në vend. Aktualisht, kësaj strategjie i ka mbaruar afati dhe është bërë monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të detyrimeve që përcaktonte ky dokument strategjik. Ndërkohë, po punohet për hartimin e Strategjisë së re Kombëtare të Luftës kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore dhe Planin e saj të Veprimit për periudhën 2008-2010, si dhe Strategjinë e re Kombëtare të Luftës kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Viktima të Trafikimit dhe Planin e saj të Veprimit për periudhën 2008-2010. Hartimi i këtyre strategjive kombëtare është parashikuar të përfundojë në 6-mujorin e parë të vitit 2008.

Strukturat e Luftës kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore

105. Për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Trafikut të Qënieve Njerëzore, gjatë viteve të fundit prioritet i është dhënë jo vetëm përmirësimit të kuadrit ligjor, por dhe ngritjes së strukturave të reja parandaluese në funksion të kësaj strategjie. Po ashtu, rëndësi e veçantë i është kushtuar dhe marrjes së masave mbrojtëse dhe mbështetëse ndaj viktimave dhe kategorive sociale në risk, si dhe forcimit të kapaciteteve të subjekteve që kanë të bëjnë me zbatimin direkt të ligjit.

106. Ndër Strukturat e reja të luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore mund të përmëndim:

1. Ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Shtetëror të Luftës kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore i kryesuar nga Ministri i Brëndshëm, i cili ka në përbërjen e tij përfaqësues të lartë të nivelit politik të institucioneve qëndrore, përgjegjës për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore në fushat përkatëse.

2. Krijimi i Zyrës së Koordinatorit Kombëtar e drejtuar nga Zëvendësministri i Brëndshëm për Antitrafikimin, e cila është pika kyçe për koordinimin e veprimeve antitrafik në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo Zyrë është ngritur për herë të parë në tetor 2005, me riorganizimin e Qeverisë pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2005. Roli kryesor i Koordinatorit Kombëtar është bashkërendimi i veprimeve të të gjithë aktorëve të përfshirë në luftën dhe parandalimin e trafikimit të personave, qofshin këto agjensi qeveritare, apo jo-qeveritare për të patur një informacion sa më të plotë dhe një përgjigje të koordinuar ndaj trafikimit në vend.

3. Koordinatori Kombëtar asistohet në punën e tij nga Njësia Antitrafik, detyrat kryesore të së cilës janë monitorimi i aktiviteteve të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Antitrafikimin, koordinimi midis institucioneve, si dhe mbledhja e informacionit dhe e të dhënave për rastet e trafikimit.

4. Në zbatim të Urdhrit të përbashkët të Ministrisë të Brëndshëm, Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, "*Për ngritjen e Autoritetit përgjegjës për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave të trafikimit dhe përcaktimin e detyrave të institucioneve të përfshira në këtë proces*") u ngrit Autoriteti Përgjegjës. Ai garanton mbrojtjen dhe ndihmën ndaj viktimave të mundshme të trafikimit. Qëllimi i ngritjes së këtij Autoriteti është bashkërendimi dhe monitorimi i procesit të referimit për ndihmë, mbrojtje, riintegrim të viktimave aktuale apo viktimave të mundshme të trafikimit, si dhe rregjistrimi dhe raportimi periodik i rasteve të trafikimit të referuara tek organizatat, apo institucionet e tjera. Ky proces kryhet në bashkëpunim të ngushtë me ministrinë e lartpërmendura, me institucione të tjera të përfshira në këtë proces dhe me qendrat strehuese të viktimave të trafikimit.

5. Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.139, datë,19.06.2006 "Për krijimin e Komiteteve Rajonale të Luftës Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore" u ngritën Komitetet Rajonale kundër trafikimit të qënieve njerëzore në 12 qarqet të vendit, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm për identifikimin e rasteve potenciale të trafikimit dhe vlerësimin e kategorive të tyre.

6. Në aspektin operacional, në Ministrinë e Brëndshme u ngrit Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Personave të Veçantë, e cila ka në përbërje të saj sektorë të rëndësishëm siç është ai i luftës kundër trafikeve të paligjshme, sektori i mbrojtjes së dëshmitarëve, etj.

7. Ndërsa në fushën e Gjyqësorit vlen të përmendet krijimi në vitin 2004 i Gjykatës së Krimeve të Rënda dhe Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Ndër veprat penale që shqyrtojnë këto institucione janë edhe rastet e trafikimit.

8. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (Departamenti për Hetimin e Krimeve) funksionon Sektori Kundër Trafikeve të Paligjshme (Drejtoria e Krimit të Organizuar), i cili ka për objekt kryesor të punës së tij parandalimin dhe goditjen e aktiviteteve kriminale të tilla si, trafikimi i femrave dhe shfrytëzimi i tyre për prostitucion.

9. Ngritja e Sektorëve të Mbrojtjes së të Miturve dhe Dhunës në Familje në drejtorinë e policive në qarqe.

107. Këto institucione në sajë të seriozitetit të treguar nga ana e qeverisë, si dhe falë mbështetjes së ofruar nga organizatat europiane dhe ato ndërkombëtare kanë mundur të ushtrojnë kontrolle më të shpeshta dhe kanë rritur efektivitetin në goditjen e trafikimit të qënieve njerëzore duke arrestuar dhe dënuar shumë autorë të këtij krimi. Vlen të theksohet fakti që, po vazhdohet të bëhet një punë intensive në drejtim të plotësimit të mëtejshëm të kuadrit ligjor, me qëllim plotësimin në këtë fushë të standarteve të kërkuara ndërkombëtare. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe në veçanti strukturat kundër trafikeve të paligjshme bashkëpunojnë me shumë institucione dhe organizata, të cilat ofrojnë trainime, donacione të ndryshme për viktimat e trafikut në qendrat pritëse, shkëmbim informacioni, etj. Rritja e bashkëpunimit mes aktorëve dhe komunikimi i përmirësuar ndërmjet tyre ka bërë që të arrihen rezultate të dukshme në uljen e këtij fenomeni në Shqipëri. Në nivel qendror, përpunimi i të dhënave statistikore realizohet nga “Qendra e Përpunimit dhe Mbrojtjes të të Dhënave”. Kjo është një strukturë e posaçme, e cila është në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

108. Nga statistikat zyrtare të kriminalitetit rezulton se, në Republikën e Shqipërisë (RSH), gjatë viteve 2003-2006 numri i krimeve të trafikimit të femrave të ketë pësuar ulje të ndjeshme nga viti në vit. Shqipëria që nga viti 2004 ka dalë nga lista e vendeve që shërbejnë si vende tranzit për trafikimin e femrave. Gjatë vitit 2006, në të gjitha rastet e evidentuara të trafikimit të femrave nuk ka patur asnjë rast që femrat të kenë qënë të huaja, apo të jenë trafikuar nga një shtet tjetër nëpërmjet Shqipërisë. Kjo ka dalë edhe nga kontaktet me partneret e vendeve fqinjë. Në tabelën e mëposhtme janë dhënë

Numri total i femrave të dëmtuara nga veprat penale gjatë viteve 2003-2007 dhe llojet e veprave penale.

Nr.	Viti	Nr. total i Femrave të dëmtuara	Veprat penale					Vepra të tjera penale
			Vrasje	Krime kundër shëndetit	Krime seksuale	Krime kundër lirisë së personit	Krime kundër moralit	
1	2003	587	22	14	84	10	3	454
2	2004	558	15	12	64	0	4	463
3	2005	664	21	6	70	9	0	558
4	2006	921	23	18	64	28	3	785
5	2007	551	24	9	78	14	0	426

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

109. Ngritja në Shqipëri që nga fillimi i vitit 2004 i një gjykate me juridiksion të veçantë (Gjykatën e Krimeve të Rënda), si dhe ndryshimet procedurale që u kryen më vonë kanë bërë që të gjitha rastet e trafikimit të personave të drejtohen në Gjykatën e Krimeve të Rënda dhe jo më në ato të juridiksionit të zakonshëm. Ngritja e sistemit të Gjykatës së Krimeve të Rënda me juridiksion të veçantë për rastet e trafikimit dhe llojet e tjera të krimit të organizuar e ka rritur efektivitetin dhe shkallën e reagimit të shtetit ndaj kësaj dukurie. Burimet nga Gjykata e Krimeve të Rënda tregojnë se, numri i rasteve të trafikimit që janë trajtuar nga kjo gjykatë në 6-mujorin e parë të vitit 2005 ka rezultuar shumë më i lartë, në krahasim me numrin e rasteve të trafikimit të

trajtuara nga gjykata me juridiksion normal, në tre vitet para ngritjes së këtij institucioni.

Prostitucioni

110. Duke patur si qëllim pasqyrimin e standarteve bashkëkohore, përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga antarësimi i Shqipërisë në akte të ndryshme ndërkombëtare, si dhe në përgjigje të Rekomandimeve të Komitetit CEDAW, (Paragrafet 30 dhe 31), për të luftuar shfrytëzimin e prostitucionit janë bërë ndryshime dhe përmirësime të vazhdueshme të legjislacionit penal. Kështu, në zbatim të Konventës së OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional dhe Protokollit përkatës, në Kodin Penal të RSH janë bërë ndryshime e shtesa, të cilat parashikojnë dënime të ashpra ndaj atyre që organizojnë, financojnë dhe shfrytëzojnë prostitucionin. Konkretisht:

111. Në bazë të nenit 114 të Kodit Penal të RSH, shtytja, ndërmjetësimi, ose marrja shpërblim për ushtrimin e prostitucionit, dënohet me gjobë, ose me burgim deri në 5 vjet. Në këtë Kod Penal është shtuar neni 114/a në të cilin përcaktohet se, “shfrytëzimi i prostitucionit i kryer me të mitur; ndaj disa personave; me persona me të cilët ekzistojnë lidhje të afërta gjinie, krushqie, kujdestarie, ose duke përfituar nga raportet zyrtare; me mashtrim, shtërngim, ose duke përfituar nga paaftësia fizike, ose mendore e personit; ndaj një personi që shtyhet, ose shtërngohet për të ushtruar prostitucion jashtë territorit të RSH, ose e kryer në bashkëpunim, ose më shumë se një herë nga persona të ngarkuar me funksione shtetërore, ose publike, dënohet nga 7-15 vjet burgim”.

112. Ministria e Drejtësisë, në ligjin nr.9686, datë, 26.02.2007, “Për disa ndryshime në Kodin Penal”, ndër të tjera ka parashikuar si rrethanë rënduese motivin diskriminues si motiv për kryerjen e krimit. Konkretisht, në nenin 50 të Kodit Penal të titulluar “Rrethana rënduese”, pas pikës (i), është shtuar pika (j) me përmbajtje si vijon: “Kryerja e veprës i shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me racën, gjininë, fenë, kombësinë, gjuhën, bindjet fetare, ose sociale dhe bindjet politike”.

113. Për të realizuar një bashkëpunim më të mirë midis aktorëve kyç në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, më 18.07.2005 u firmos “Marrëveshja e Bashkëpunimit për krijimin e një Mekanizmi Kombëtar Referues për Identifikim dhe Asistencë të Përmirësuar për Viktimat e trafikut të Qënieve Njerëzore”. Kjo marrëveshje përcakton përgjegjësitë që palët e përfshira kanë për identifikimin, referimin, akomodimin, asistencën dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit. Zyra e Koordinatorit Kombëtar ka punuar intensivisht për të siguruar zbatimin e kësaj marrëveshje nga palët, në përputhje me detyrimet dhe të drejtat që janë të përcaktuara qartë në të.

Në tabelat e mëposhtme pasqyrohen Shfrytëzimi i Prostitucionit dhe Rrethanat Rënduese gjatë viteve 2006-2007

2006 - Vepra Penale	Ngjarje	Autor	Arrestuar	Ndaluar	Gj.Lirë	Kërkim
Shfryt. Prost. Rrethana rënduese	24	31	10	5	15	1
Shfrytëzim Prostitucioni	18	30	2	1	16	-

Burimi : Ministria e Brëndshme.

2007 - Vepra Penale	Ngjarje	Autor	Arrestuar	Ndaluar	Gj. Lirë	Kërkim
Shfryt. Prost. Rrethana rënduese	32	41	6	9	25	1
Shfrytëzim Prostitucioni	40	53	26	4	16	6

Burimi : Ministria e Brëndshme.

114. Në lidhje me kompensimin dhe trajtimin e viktimave është në proces reflektimi i detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, por meqenëse ky proces ka faturë të lartë financiare zgjidhja po diskutohet me Ministrinë e Financave me qëllim ngritjen paraprake të një fondi për kompensim. Në të njëjtën mënyrë po veprohet edhe për masat që do të ndërmeren për programet e kompensimit në përgjithësi, me synim dhënien e asistencës sociale dhe integrimin social të viktimave. Megjithatë, për t'iu ardhur në ndihmë grave të viktimizuara janë krijuar dhe funksionojnë Qëndrat për Viktimat e Trafikimit dhe janë vendosur marrëdhënie partneriteti me organizata dhe qendra që kanë si objektive të punës së tyre mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Gjithashtu, është ofruar një program për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe janë ndërmarrë një sërë veprimtarish specifike që synojnë parandalimin e këtyre aktiviteteve kriminale.

115. Për të mbrojtur viktimat e trafikimit dhe për t'iu dhënë atyre ndihmë konkrete, në Shqipëri është krijuar një qendër shtetërore e quajtur, Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit (QKPVT). Kjo qendër, duke u bazuar në Planin e Veprimit dhe Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore 2005-2007 i kushton vëmendje të veçantë përmirësimit të cilësisë së punës rehabilituese, në përputhje me mundësitë dhe kushtet që ofron institucioni, nëpërmjet shfrytëzimit në maksimum të mbështetjes së donatorëve. Kjo qendër ofron shërbime cilësore për tre grupe kryesore: **1).** gra e vajza të trafikuar, ose në rrezik trafikimi, **2).** fëmijët e pashoqëruar dhe në rrezik trafikimi, **3).** migrantët e parregullt. QKPVT bashkëpunon për nevoja specifike (asistenca teknike dhe financiare, trainimet etj) edhe me donatorë të tjerë si, IOM, UNICEF, UNHCR, OSCE, USAID dhe Fondacioni Soros. Krahas QKPVT, ekzistojnë edhe qendra të tjera të specializuara që menaxhohen nga OJF-të, të cilat përveç strehimit ofrojnë shërbime të ndryshme për t'iu ardhur në ndihmë grave dhe vajzave viktimat të trafikimit, ose atyre që janë në rrezik trafikimi.

116. Shërbimet e ofruara nga këto qendra, në bashkëpunim edhe me aktorë të tjerë të përfshirë në këtë proces janë: strehimi i përkohshëm, mbulimi i të gjitha nevojave emergjente që paraqet përfituesi, si ushqim, veshje, asistencë psiko-sociale (jepet nga stafi i kualifikuar i punonjësve sociale, Klinika Ligjore për të Mitur), asistencë mjekësore (ofrohet nga Qendra IOM, Instituti i Shëndetit Publik, Qendra Spitalore Universitare, "Nënë Tereza", etj), asistencë ligjore (stafi i trainuar në fushën legale, Klinika Ligjore për të Mitur, etj), siguri dhe mbrojtje të garantuar të dëshmitarëve (Ministria e Brëndshme, Policia e Shtetit), aktivitete profesionale rehabilituese e integruese, kthim dhe bashkim me familjen dhe kur është e mundur ndjekje të viktimave edhe pasi largohen nga Qendra. Të gjitha këto ofrohen nga një staf multi-disiplinar, i cili është i përbërë nga profesionistë të fushave përkatëse.

117. Është punuar gjithashtu, për krijimin e standarteve për mbrojtjen ligjore dhe fizike të viktimave të trafikimit/dëshmitarëve të drejtësisë gjatë procesit penal në gjykatë dhe është propozuar që të shihet mundësia e kompensimit të tyre duke

përdorur burimet financiare që sigurohen nga neutralizimi i veprimtarisë kriminale të trafikantëve.

118. Ndër masat rehabilituese dhe ri-integruese për gratë dhe vajzat që kanë qënë viktimat të trafikimit vlen të përmendet dhe bashkëpunimi i MPCSSHB me OJF-të që ofrojnë shërbime parandaluese, mbështetëse, rehabilituese dhe ri-integruese për viktimat, ose për gratë që përbëjnë rrezik për trafikim. Organizatat më të njohura në këtë drejtim janë: Unicef, Qendra "Vatra", "Tjetër Vizion", "Different and Equal", "Shërbimi Social Ndërkombëtar", "Terre des Homes", Ndhmë për Fëmijët", "Qendra Komunitare Ballsh", "Komisioni Ndërkombëtar Katolik për Migracionin", "Save the Children", "Klinika Ligjore për të Miturit", "Në dobi të gruas", "Strehëzat", "Organizata Ndërkombëtare për Migracionin", "Linja e këshillimit për gra dhe vajza", "Qendra Shqiptare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve" dhe Koalicioni i OJF-ve "Bashkë kundër trafikimit të fëmijëve".

119. Gjithashtu, një masë tjetër ndihmuese në këtë drejtim është dhe dalja e Urdhrit të Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, nr.782, datë, 04.04.2006, "Për tarifat e sistemit të formimit profesional". Ky urdhër parashikon që tarifat e regjistrimit për punëkërkuarit e papunë të rregjistruar në zyrat e punësimit, të cilët duan të ndjekin kurse të formimit profesional, të jenë falas për grupe të veçanta, përfshirë këtu gra dhe vajza të trafikuar. Këto kurse ofrohen nga Qendrat Publike të Formimit Profesional.

120. Ndër projektet e rëndësishme të kësaj fushe është edhe projekti ILO-MIGRANT, "*Mundësi punësimi, formimi profesional dhe masa politikash migratore për parandalimin dhe reduktimin e trafikimit të femrave në Shqipëri, Moldavi dhe Ukrainë*". Ky projekt u zbatua nga Zyra Ndërkombëtare e Punës, Programi Ndërkombëtar i Migracionit (ILO-MIGRANT) dhe u financua nga Qeveria Irlandeze. Në kuadrin e këtij projekti po punohet për mikro-kreditimin. Ndër rezultatet që janë arritur mund të përmenden:

- Në Mars 2007, zbatuesit e projektit nënshkruan me Fondin Besa një Kontratë Shërbimi, lidhur me zbatimin e mikrokredisë për viktimat e trafikimit (objektivi final: mikrokreditimi i 6 deri 10 vajzave viktimat të trafikimit).
- Në Prill 2007, Fondi Besa zhvilloi trainimin mbi ngritjen dhe menaxhimin e një biznesi të vogël për 15 viktimat trafikimi të referuara nga OJF-të, "Të ndryshëm dhe të Barabartë", Qendra "Vatra" dhe "Tjetër Vizion". Programi u koordinua me një program të ngjashëm të OSBE-së në Tiranë.
- Në qershor 2007, Komiteti i Kreditimit i përbërë nga përfaqësues të Fondit Besa, të qëndrave referuese dhe të Programit ILO dhe OSBE mori në shqyrtim plan bizneset e aplikuesve. U miratuan 3 kredi për llogari të projektit ILO, përkatësisht për *fast-food*, parukeri dhe shitje konfeksionesh të reja, apo të përdorura. Tre të tjera u miratuan për llogari të projektit të OSBE-së.

121. Për t'iu ardhur në ndihmë atyre që dëshirojnë të kthehen pranë familjeve të tyre, punonjësit socialë iu ofrojnë ndihmë për ndërmjetësim dhe bashkim familjar të gjithë viktimave të trafikimit. Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Antitrafikimin është e ngarkuar me zgjidhjen e problemeve të rehabilitimit dhe të ri-integrimit. Kjo zyrë angazhohet edhe me gjetjen e fondeve shtesë për trainime profesionale dhe krijimin e mundësive të punësimit për viktimat e trafikimit. Ky proces realizohet me ndërmjetësimin e komiteve lokale, zyrave të punësimit, sipërmarrjeve lokale, si dhe në bashkëpunim me MPÇSSHB dhe me aktorë të tjerë për të siguruar kontributet e tyre për këtë qëllim.

122. Institucionet shtetërore dhe qendrat pritëse në veçanti kanë bërë një punë mjaft të mirë për ndërgjegjësimin e viktimave të trafikimit, lidhur me rëndësinë që ka bashkëpunimi i tyre me autoritetet përkatëse. Gjatë gjithë ecures së ndjekjes së rasteve nga organet kompetente sigurohet mbrojtja e të drejtave të tyre për tu informuar për të drejtat ligjore që ato kanë dhe shërbimet që janë vënë në dispozicion të tyre. Qendrat raportojnë se kanë bashkëpunuar ngushtësisht me Ministrinë e Brëndshme në ruajtjen e sigurisë për viktimat e trafikimit.

Bashkëpunimi me Agjensitë dhe Organizatat Ndërkombëtare.

123. Në vijim të përmbushjes së Rekomandimeve të Komitetit CEDAW (paragrafi 31) një rëndësi e veçantë i është kushtuar bashkëpunimit të ngushtë me agjencitë dhe organizatat ndërkombëtare që operojnë me projekte të hartuara posaçërisht për antitrafikimin. Konkretisht:

a). Me UNICEF janë organizuar trainime me oficerë të policisë mbi praktikat më të mira të intervistimit të fëmijëve të kategorizuar si viktimat të mundshme të trafikimit;

b). IOM dhe Zyra e OKB-së kundër Drogave dhe Krimeve, ka asistuar Zyrën e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore për ngritjen e një linje telefonike pa pagesë për denoncimin e rasteve të trafikimit dhe informimin për migracionin e rregullt. Linja telefonike u aktivizua në nëntor 2006 (Nr. i telefonit: 08001212).

c). OSBE ka asistuar Zyrën e Koordinatorit Kombëtar në ngritjen e një baze të dhënash për viktimat e trafikimit, e cila do të shërbejë për ndjekjen, vlerësimin dhe analizën e rasteve të trafikimit të qënieve njerëzore. Gjithashtu, OSBE ka asistuar Zyrën e Koordinatorit Kombëtar në zhvillimin e disa takimeve ndërkufitare në Maqedoni e Kosovë, të cilat kishin si qëllim intensifikimin e përpjekjeve ndërkufitare në lidhje me përmirësimin e veprimeve identifikuese, referuese dhe mbështetëse për viktimat e trafikimit.

d). Përsa i takon përmirësimin të dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale të RSH, në përputhje me standardet ndërkombëtare, Ministria e Drejtësisë ka kërkuar ekspertizën e ekspertëve të Këshillit të Evropës/PAMECA, (Misioni i Asistencës Policore të Komunitetit Europian) me qëllim rishikimin tërësor të këtyre dispozitave. Procesi i rishikimit të legjislacionit penal është në vazhdim dhe në varësi të sugjerimeve të ekspertëve ndërkombëtarë dhe të Komisionit të Reformës Ligjore do të konkludohet me një propozim konkret për rishikimin e dispozitave të kodeve të sipërpërmendura. (Misioni PAMECA përfundoi mandatin e tij në fund të vitit 2007)

Marrëveshjet Bilaterale dhe Shumëpalëshe

124. Shqipëria ka ndërmarrë gjithashtu disa nisma rajonale dhe më gjërë, në drejtim të hartimit dhe nënshkrimit të marrëveshjeve multi dhe bilaterale, të cilat synojnë parandalimin e aktiviteteve kriminale që kanë të bëjnë me trafikimin e femrave, fëmijëve, shkëmbimin e informacioneve, etj. Të tilla marrëveshje janë nënshkruar me Maqedoninë, Kosovën, Greqinë, Italinë, etj.

125. Qeveria Shqiptare vazhdon të forcojë marrëdhëniet me fqinjët dhe bashkëpunimin ndërkombëtar dypalësh dhe rajonal me vendet e tjera të origjinës, tranzitit dhe destinacionit të trafikimit të grave dhe vajzave. Qëllimi kryesor është krijimi i mekanizmave funksionale për mbrojtjen, ri-atdhesimin dhe ri-integrimin e

viktimave të trafikimit. Një rëndësi e veçantë i është dhënë intensifikimit të bashkëpunimit ndërkuftar dhe për këtë qëllim gjatë vitit 2007 janë organizuar dy takime ndërkuftare me autoritetet maqedonase dhe kosovare. Me qeveritë e vendeve fqinje Shqipëria ka nënshkruar disa protokolle bashkëpunimi, ku mund të përmenden

- Me Maqedoninë është nënshkruar Protokoli Shtesë me Ministrinë e Brëndshme Maqedonase “Për Intensifikimin e Bashkëpunimit në Luftën kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore përmes kufijve shtetërorë dhe për intensifikimin e identifikimit, njoftimit, referimit dhe kthimit të viktimave, si dhe personave të dyshuar si viktima të trafikimit të qënieve njerëzore”.
- Me Kosovën është hartuar dhe është gati për nënshkrim i njëjti Protokoll Shtesë që është nënshkruar me Maqedoninë.
- Me Greqinë u nënshkrua në shkurt të vitit 2006 “Marrëveshja për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve viktima të trafikimit”, e cila u ratifikua nga Parlamenti Shqiptar në maj 2006. Aktualisht, pritet ratifikimi i kësaj marrëveshjeje dhe nga pala greke për të mundësuar më tej marrjen e masave konkrete për zbatimin me efektivitet të saj.
- Së shpejti është programuar që të organizohen takimet zyrtare po për këtë qëllim edhe me Malin e Zi.

126. Në kuadër të zgjerimit të këtij bashkëpunimi janë nënshkruar dhe ratifikuar një sërë marrëveshjesh ripranimi, ku ndër më të rëndësishmet mund të përmëndim Marrëveshjen ndërmjet RSH dhe Komunitetit European, “Për ripranimin e personave”, nënshkruar më 14 prill 2005, e cila tashmë ka hyrë në fuqi për shtetasit shqiptarë dhe në një fazë të mëvonshme për personat nga vendet e treta.

127. Marrëveshje dypalëshe të ripranimit janë nënshkruar edhe me: Italinë, Belgjikën, Republikën Federale Gjermane, Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, Hungarinë, Maqedoninë, Bullgarinë, Rumaninë, Kroacinë dhe Zvicrën. Gjatë vitit 2006 nga autoritetet policore të vendeve të huaja u deportuan 978 femra, prej të cilave 228 nën moshën 18 vjeç, ndërsa nga strukturat e policisë kufitare janë ndaluar të dalin jashtë vendit 49 femra, ndër të cilat 8 në moshën 18 vjeç, të cilat dyshoheshin se mund të ishin viktima të trafikut për qëllim prostitucioni.

128. Me Qeverinë e Republikës së Polonisë, Qeveria Shqiptare ka miratuar në parim, marrëveshjen “Për bashkëpunim në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të tjera” (Vendimi nr.264, datë, 05.03.2008). Marrëveshja është gati për nënshkrim për palën shqiptare, kurse nga pala polake pritet përgjigja e tyre lidhur me përfundimin e procedurave të brëndshme ligjore për nënshkrimin e marrëveshjes.

129. Po në këtë kuadër, Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështjet e Luftës kundër Trafikimit ka ndërmarrë hapa konkrete për përgatitjen e marrëveshjeve të reja për mbrojtjen e viktimave të trafikut edhe me vende të tjera të rajonit, duke e zgjeruar fushën e aktiviteteve jo vetëm për fëmijët, por edhe për grupe të tjera të cënueshme. Një rol të rëndësishëm në parandalimin dhe goditjen ndaj këtij fenomeni ka luajtur dhe bashkëpunimi i ngushtë me shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare që janë të përfshira në këtë proces, të tilla si, CAAHT-USAID, OSBE, IOM, ARSIS (OJF-Greke), ICMPD, ILO, UNICEF, Terre des Hommes, etj.

Mbrojtja e dëshmitarëve

130. Në Mekanizmin Kombëtar Referues përcaktohen qartë, jo vetëm detyrimet që kanë palët për mbrojtjen e viktimave të trafikimit, por ofrohen edhe programe të mbrojtjes së dëshmitarit kur vlerësohet që, situatat janë të rrezikshme dhe përbëjnë kërcënim serioz për jetën e viktimës. Janë ndërmarrë masa për të garantuar sa më mirë mbrojtjen dhe mbështetjen që nevojitet ndaj grave dhe vajzave, me qëllim që të bëhet i mundur sigurimi i dëshmisë kundër trafikantëve.

131. Vetëm gjatë vitit 2006 janë zhvilluar sesione trainimi në të gjithë vendin në fushën e dhënies së ndihmës ligjore dhe psikologjike ndaj viktimave, dëshmitarëve, ose atyre që janë nën rrezikun e trafikimit me moshë të mitur. Gjithashtu, po në këtë kontekst Zyra e Koordinatorit Kombëtar ka organizuar *workshop-e* në tre qarqet kryesore të vendit, pra në veri, në jug dhe në Shqipërinë e mesme me temën: "*Rritja e bashkëpunimit ndërmjet policisë, prokurorisë, gjykatave dhe shërbimeve sociale për një proces të drejtë ligjor, në mbrojtje viktimave të trafikimit*". Këtu, theksi është vënë në profilin e viktimave të trafikimit dhe rritjen e ndërgjegjshmërisë së Prokurorisë e Gjykatës për ndjekjen e trafikantëve dhe autorëve të veprave penale, të cilët janë të lidhur me trafikimin.

132. Në vitin 2007 me miratimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit u ngrit një strukturë e re, e cila është Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Personave të Veçantë. Deri në vitin 2007, Sektori për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, në Drejtorinë Kundër Krimit të Organizuar kryente funksionet, të cilat nga ai moment e në vazhdim po kryhen nga Drejtoria për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Personave të Veçantë. Kjo Drejtori siguron mbrojtje për një gamë të gjerë personash siç janë: dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë, si dhe personat e afërt apo që kanë lidhje me ta. Zbatimi i masave mbrojtëse bëhet për krimet e rënda dhe vetëm në ato raste kur personat ndodhen në gjëndje rreziku real dhe serioz për jetën. Sektori për Mbrojtjen e Dëshmitarëve ka filluar zbatimin e programeve të mbrojtjes që nga prilli 2005.

Trainimi i policisë së kufirit

133. - Për trainimin e efektivave të policisë që merren me rastet e dhunës në familje një rol të rëndësishëm ka luajtur dhe miratimi i ligjit nr. 9669, datë, 18.12.2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare". Në nenin 6, pika ç të këtij ligji flitet pikërisht, për organizimin e kurseve të trainimit rreth dhunës në familje, **a).** me punonjësit e shërbimeve sociale që janë të atashuar pranë çdo njësie vendore, **b).** me strukturat e Policisë së Rendit dhe **c).** me punonjësit e OJF-ve të licencuar për ofrimin e shërbimeve sociale.

134. Kurse Ministria e Brëndshme, në përputhje me nenet 7/1/a dhe 7/1/ b ka për detyrë: **a)** Krijimin e sektorëve të veçantë për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje pranë drejtorive të policisë; **b)** Trainimin e efektivave e policisë që do të merren me trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

135. Për t'i paraprirë miratimit të ligjit të ri për dhunën në familje janë bërë përpjekje për të nxitur donatorët e huaj, me qëllim sigurimin e asistencës së tyre për trainimin e strukturave të zbatimit të ligjit. Konkretisht, *Women's Legal Rights Initiative/USAID* ka realizuar 3 seminare dhe takime në 2005 dhe 2006 me profesionistë të fushave të

ndryshme, të cilët do të jenë përgjegjës për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Në këto seminare kanë marrë pjesë punonjës nga Ministria e Brëndshme, nga Drejtoria e Policisë së Tiranës dhe Drejtoria e Policisë së Durrësit. Në periudhën, tetor 2006 - shtator 2008 ka filluar dhe po vazhdon zbatimi i projektit *“Dhuna ndaj grave jo vetëm problem familjar”*. Ky projekt po zbatohet nga PNUD-i në bashkëpunim me disa organizata të tjera. Ministria e Brëndshme, si një nga partneret e këtij projekti do të përfitojë në trainimin e rreth 150 punonjësve të policisë në këto aspekte kryesore:

- Për evidentimin dhe raportimin e dhunës në familje.
- Për tu ofruar mbështetje grave ndaj të cilave është abuzuar fizikisht.

Trainime të veçanta janë bërë edhe me Policinë e Kufirit.

136. Qëllimi kryesor i trainimit të policisë së kufirit ka qënë rritja e nivelit profesional të kësaj force, në drejtim të dhënies së ndihmës për viktimat e trafikimit. Trainimet e vazhdueshme që janë bërë me oficerët e policisë kufitare kanë patur gjithashtu, si synim kryesor përforcimin e kapaciteteve identifikuese për viktimat potenciale të trafikimit.

137. Policia kufitare dhe migracionit ka bërë përzgjedhjen e personelit që merret me intervistimin e femrave që konsiderohen si viktima të mundshme të trafikimit. Është trainuar personeli i stacioneve të kufirit dhe migracionit duke e njohur atë me aktet ligjore, me aktet nënligjore, me marrëveshjet dhe protokollet e nënshkruara. Gjithashtu, për njohjen e procedurave janë organizuar trainime në çdo stacion të Policisë Kufitare dhe në PKK (Pikat e Kalimit Kufitar) ku janë zhvilluar takime për të siguruar dhe forcuar bashkëpunimin e sektorëve të ndryshëm të Policisë së Shtetit, me Zyrat Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe OJF-të.

138. Këto trainime brenda dhe jashtë vendit janë organizuar nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin dhe në to kanë marrë pjesë përfaqësues të Organizatave Ndërkombëtare si, IOM, UNHCR (Komisioneri i lartë për Refugjatët i Kombeve të Bashkuara), ICITAP (Programi Ndërkombëtar i Asistencës për trainimin dhe hetimin kriminal), Projekti AENEAS, (Projekt i Bashkimit Europian për ripranimet, vizat, migracionin, azilin), OSBE etj. Një hap i rëndësishëm është bërë për hartimin nga policia kufitare të procedurave standarte të intervistimit në Aeroportin Ndërkombëtar *“Nënë Tereza”*; rregjistrimin e të dhënave përkatëse në një sistem të vetëm dhe ngritjen e infrastrukturës së nevojshme logjistike për këtë qëllim. Këto standarte do të vendosen në të gjitha pikat kryesore të kalimit të kufirit në Shqipëri dhe për këtë janë zhvilluar dhe po zhvillohen trainime me personelin e strukturave kryesore policore që janë të përfshira në këtë proces.

139. Janë evidentuar qëndrat e pritjes së viktimave të trafikut, janë vendosur numrat e kontaktit dhe në pjesën me të madhe të pikave të kalimit kufitar, veçanërisht në ato me intensitet të madh kthimesh dhe është siguruar prania e përfaqësuesve të tyre në intervistim. Gjatë vitit 2007, personeli i Policisë Kufitare dhe Migracionit ka arritur të evidentojë 125 viktima të mundshme të trafikimit të qënieve njerëzore, duke treguar vëmendje jo vetëm në intervistimin e shtetasve të kthyer nga shtetet e tjera, por edhe ndaj atyre që hyjnë/dalin si udhëtarë të zakonshëm në pikat e kalimit kufitar. Për këtë proces janë përgatitur procedura standarte për pritjen, shoqërimin, akomodimin, regjistrimin, intervistimin, evidentimin e tyre në sistemin TIMS (Sistemi i administrimit total të informacionit) në Policinë e Shtetit dhe kohët e fundit është hartuar edhe një *Database* për viktimat e trafikut të qënieve njerëzore. Për këtë janë përgatitur dhe

miratuar dy Urdhra të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, nr.871, datë 27.12.2007, “Mbi procedurat që duhet të kryhen për intervistimin e shtetasve të huaj dhe shqiptarë të kthyer nga vendet e tjera” dhe Urdhri nr. 865, datë, 26.12.2007, “Për hedhjen në Database-in për viktimat e trafikut”.

140. Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me OSBE-në dhe Këshillin e Evropës gjatë vitit 2007 zhvilloi një cikël trainimesh “Mbi zhvillimet e reja legjislative në fushën e dhunës në familje - roli i gjyqtarëve, prokurorëve dhe policisë”. Me idenë e krijimit të Skuadrave të Mbrojtjes së viktimave të dhunës familjare, në këto kurse u trainuan gjyqtarë, prokurorë dhe punonjës policie. Gjithashtu në shtator 2007, Zyra e OSBE-së në Shqipëri organizoi me punonjës policie të niveleve të ndryshme një kurs për trajnuesit, lidhur me “Rolin e policisë për rastet e dhunës familjare”.

141. Në muajin Nëntor 2006, Qendra “Të drejtat e njeriut në Demokraci” nisi zbatimin e projektit “Trainimi i efektivave të policisë mbi dhunën në marrëdhëniet familjare”, implementimi i të cilit përkoi dhe me miratimin e ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Ky projekt është zbatuar në të gjitha Komisarariatet e Policisë të Qarkut Tiranë (6 Komisarariatet e Policisë Tiranë dhe Kavajë). Departamenti për Trainimin Policor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë ka programuar gjatë vitit 2008 zhvillimin e një cikli trainimesh me efektiva të policisë së 12 Qarqeve, mbi “Rolin e policisë për rastet e dhunës familjare”. Shkolla e Policisë futi për herë të parë gjatë vitit akademik 2006-2007 lëndën e Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje.

142. Nga Policia e Shtetit janë programuar e zbatuar masa të veçanta për trainimin brenda dhe jashtë vendit të policisë kufitare, në lidhje me luftën kundër trafikut të femrave dhe mbrojtjen e viktimave të trafikut. Kështu, gjatë vitit 2006 janë zhvilluar këto trainime:

- Shkurt 2006, në bashkëpunim me IOM janë trainuar 12 oficerë policie të kufirit për probleme të luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore.
- Qershor 2006, në bashkëpunim me IOM janë trainuar 30 punonjës të policisë kufitare për përgjegjësitë e linjave ajrore dhe kthimin e emigrantëve të parregullt.
- Korrik 2006, nga OSBE janë trainuar 2 oficerë për hetimin e rasteve të trafikimit të qënieve njerëzore.
- Gusht 2006, në Kajro-Egjipt janë trainuar 2 oficerë për luftën kundër trafikimeve ilegale.
- Në kuadër të paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore në nëntor 2006 nga qendra MARRI (The Migration, Asylum, Refugees, Regional Initiative) është kryer trainimi për identifikimin e dokumenteve fallso dhe luftën kundër trafikut të qënieve njerëzore.

KAPITULLI II

Neni 7

JETA POLITIKE DHE PUBLIKE

Kuadri ligjor kundër diskriminimit të gruas në jetën politike dhe publike

143. E drejta për të votuar edhe ajo për t'u zgjedhur iu garantohen qytetarëve shqiptarë nga Kushtetuta, pa dallim seksi. Kjo e drejtë garantohet si për zgjedhjet,

ashtu dhe për referendimet publike. Veç kësaj, Kodi Zgjedhor parashikon që: “Çdo shtetas shqiptar, pa dallim race, etnie, gjinie ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me rregullat e vendosura nga ky Kod” dhe “Zgjedhësit e ushtrojnë lirisht të drejtën e tyre për të votuar, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Kod”.

144. Për më tepër, RSH ka ratifikuar edhe një numër instrumentash të tjera ndërkombëtare që garantojnë të drejtat politike të grave si është psh, Protokollin i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Kushtetuta shqiptare përdor një gjuhë neutrale nga pikpamja gjinore duke i garantuar kujtdo të drejtën e organizimit, e cila përfshin krijimin, ose bashkimin në organizata jo-fitimprurëse (OJF), parti politike dhe organizata të tjera në jetën politike dhe publike. Një gjuhë e tillë përdoret edhe për funksione të tjera të rëndësishme, përfshij kreun e shtetit dhe ministrat. Neni 12 i ligjit për Statusin e Nënpunësit Civil parashikon: “Çdo shtetas shqiptar, me zotësi të plotë, për të vepruar dhe që përmbush kërkesat ligjore, lidhur me nivelin arsimor dhe ka kualifikimin profesional që kërkon vendi i punës ka të drejtë të punësohet në shërbimin civil”.

145. Mund të thuhet se, gratë në Shqipëri kanë marrë pjesë në mënyrë akoma më aktive në jetën publike, në veçanti pas daljes së ligjit “Për Organizatat jo-fitimprurëse” dhe krijimit të një numri të konsiderueshëm Shoqatash të drejtuara nga gratë, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mbarë vendin. Ligji Nr.8788, "Për organizatat jo-fitimprurëse" është miratuar në dt.07.05.2001⁴. Me anë të këtij ligji rregullohen marrëdhëniet e OJF-ve dhe jepen rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e tyre, duke patur synime në të mirë dhe në interes të publikut. Nenet 6 dhe 7 të këtij ligji përcaktojnë parimin e pavarësisë nga shteti, si dhe marrëdhëniet e OJF-ve me organet shtetërore, sipas të cilave "OJF-të e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë të pavarur nga organet shtetërore dhe interesat shtetërore", kurse "organet shtetërore nuk ndërhyjnë në veprimtarinë e OJF-ve".

146. Projekt-ligji “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri” konsideron përfaqësim të barabartë gjinor, përfaqësimin e secilës prej gjinive me jo më pak se 30% në një institucion, nivel drejtues, organ të emëruar, apo parti politike.

Lidhur me vendimarrjen në Kapitullin e III të projekt- ligjit në nenin 20 thuhet që:

- 1.** Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe të institucioneve të tjera publike, arrihet kur:
 - a)** sigurohet përfaqësim në masën mbi 30% i secilës gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese;
 - b)** sigurohet respektimi në mënyrë të njëjtë për secilën gjini, i procedurave dhe kriterëve të konkurrimit, gjate emërimit në këto organe;
 - c)** sigurohet përfshirje mbi 30% e secilës gjini, në listën e kandidatëve për zgjedhjet në organet përfaqësuese vendore. Kjo listë emërore rendit kandidatët femra dhe meshkuj, që nga kreu e në vijim në mënyrë të alternuar;
 - ç)** sigurohet përfshirja jo më pak se 30 % e secilës gjini, në listën e kandidatëve të paraqitur nga partitë politike, apo koalicionet politike, për sistemin proporcional për zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të cilat në zgjedhjet e përgjithshme të fundit kanë arritur një përfaqësim mbi 10% në Kuvendin e RSH. Kjo listë emërore rendit kandidatët femra dhe kandidatët meshkuj në mënyrë të alternuar.

⁴ Ky akt ligjor nuk është pasqyruar në Raportin e Parë dhe të Dytë të Kombinuar

d) sigurohet përfshirja jo më pak se 20 % e secilës gjini, në listën e kandidatëve të paraqitur nga partitë politike, apo koalicionet politike, për sistemin proporcional për zgjedhjet e Kuvendit të RSh, të cilat në zgjedhjet e përgjithshme të fundit kanë arritur një përfaqësim nën 10% në Kuvendin e RSH. Kjo listë emërore rendit kandidatet femra dhe kandidatët meshkuj në mënyrë të alternuar.

e) sigurohet përfshirje mbi 30% të secilës gjini në organet administruese të procesit të zgjedhjeve qendrore dhe vendore.

2. Partitë Politike përcaktojnë metodat dhe masat për të përmbushur kërkesat e përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij neni.

3. Partitë politike dhe OJF-të, nëse shkelin dispozitat e nenit 20 të këtij ligji nuk mund të marrin fonde shtetërore për ushtrimin e veprimtarisë së tyre, deri në ndreqjen e shkeljes.

147. Rritja e nivelit të pjesëmarrjes së grave në jetën politike dhe publike ka gjetur mbështetje konkrete dhe nga institucionet më të larta të vendit, si nga Presidenti, ashtu dhe nga Kryeministri i RSH. Konkretisht, Presidenti i RSH, duke marrë pjesë në promovimin e Raportit “*Gratë dhe fëmijët në Shqipëri në 2007 - Kosto e dyfishtë e pabarazisë dhe diskriminimit gjinor tek gratë dhe fëmijët*”, (aktivitet i organizuar nga Kabineti i Presidentit të Republikës dhe UNICEF-i, dt.18.01.2008) nënvizoi nevojën e fuqizimit të rolit të gruas në shoqërinë shqiptare si në jetën e përditshme, ashtu edhe në vendimmarrje si një ndihmë konkrete për fëmijët për të përmirësuar ndjeshëm gjëndjen e tyre, duke iu garantuar mbijetesën dhe mirëqënien.

148. Duke theksuar se, “Institucioni i Presidentit do jetë shumë bashkëpunues me UNICEF-in për këtë çështje, - Presidenti i RSH u shpreh se, “besoj që, nëpërmjet bashkëpunimit tonë të rritet dhe numuri i institucioneve, të cilat duhet të kenë një program specifik konkret që t’i shërbejnë këtij momenti kaq të rëndësishëm që ka të bëjë me të ardhmen e fëmijëve në shoqërinë shqiptare. Të gjithë së bashku mbi bazën e këtyre të dhënave, të cilat konsiderohen si të dhënat bazë për situatën, të ndërtojmë politika konkrete, realiste, të absorbueshme për shoqërinë tonë, për të bërë progres nga dita në ditë”.

149. Edhe Qeveria Shqiptare ka propozuar kohët e fundit (04.02.2008) hartimin e një *Plani Kombëtar Veprimi*, i cili do të mundësojë përfaqësimin e duhur të grave dhe vajzave në vendimmarrje. Kryeministri shqiptar ka deklaruar se, “E gjykon jashtëzakonisht të rëndësishëm këtë projekt kombëtar për ta ndryshuar me shpejtësi gjëndjen aktuale. Kjo është detyrë e të gjitha partive politike, të cilat ai i ftoi që të ndahen njëherë e përgjithmonë nga ato praktika që ngushtojnë hapësirat për gratë dhe vajzat në vendimmarrje, mbasi ato nuk janë vetëm praktika që rrjedhin nga mentaliteti, por janë të pashpallura edhe në legjislacion. Kjo duhet të fillojë me Kodin Zgjedhor, ku të përcaktohen qartë kuotat e përfaqësimit të grave në Kuvend. Në vitin 1996, në Parlamentin shqiptar ka patur shumë më tepër femra, në krahasim me prezencën e tyre aktuale. Është shumë e rëndësishme që gratë dhe vajzat të marrin kuotat e tyre në Parlament dhe është përcaktuese që ato të luajnë rolin e tyre edhe në vendimmarrje”.

150. *Kryeministri shqiptar* “e konsideron kuotën minimale prej 30 % si hapin e parë dhe të domosdoshëm dhe për këtë ai ftoi drejtuesit e të gjitha partive politike që të respektojnë këtë kuotë në mënyrë rigoroze. Kjo do të jetë e vlefshme në politikë, në shoqëri dhe në shkencë, ndërkohë që kuotat do të funksionojnë në të njëjtën mënyrë

edhe për universitetet. Nëse vendoset ajo nuk do të mund të rikthehet, por do të njohë progres më të madh dhe nivele më të larta”.

151. *“Barazia gjinore reale në një shoqëri, ka deklaruar Kryeministri shqiptar - përbën ndoshta treguesin më kryesor të shkallës së emancipimit të kësaj shoqërie. Kjo barazi përbën një kusht përcaktues për emancipimin tonë kombëtar, përbën një nga faktorët, apo levat më të rëndësishme të zhvillimit të vendit, të shfrytëzimit të gjysmës së potencialit të madh njerëzor të kombit. Kjo nënkupton që hapësirat e pushtuara padrejtësisht nga pala tjetër duhet të lirohen”.*

Masat për eliminimin e diskriminimit të gruas në jetën politike dhe publike

a) E drejta për të votuar

152. Në shoqërinë shqiptare, veçanërisht gjatë viteve të fundit ka ardhur duke u bërë mbizotëruese ideja, që nuk ka tolerancë ndaj dhunimit të të drejtës së individit për të votuar. Megjithatë gratë përgjithësisht e ushtrojnë të drejtën e votës, të dhënat e marra nga përfaqësuesit e OJF-ve tregojnë se, në disa zona respekti për bashkëshortët i bën gratë që të votojnë për kandidatin/en që rekomandon bashkëshorti. Vlen të përmendet këtu edhe një tendencë që vihet re më tepër në komunitetet rurale, ku votimi është më shumë shprehje e procesit të “konsensusit” në familje i imponuar nga burrat, se sa ushtrimi i të drejtës së gruas për të shprehur opinionin e saj në fshehtësi. Një mentalitet specifik gjinor që i sheh gratë si ofruese të kujdesit familjar dhe burrat si udhëheqës në politikë i bën gratë të tërhiqen në një farë mase nga pjesëmarrja në jetën politike. Prandaj, për këtë çështje duhet të tregohet kujdes për një drejtpeshim midis cilësisë dhe sasisë së kandidateve të angazhuara në politikë.

153. Në përgjigje edhe të Rekomandimeve të Komitetit CEDAW, (Paragrafet 38 dhe 39) mund të thuhet se, në përgjithësi dhe në sektorë të caktuar të procesit të vendimmarrjes pjesëmarrja e grave në jetën politike dhe publike të vendit ka ardhur gjithmonë në rritje. Kjo në veçanti në jetën publike. Gjatë dekadës së fundit, pjesëmarrja e grave në Parlament ka qënë thuajse në të njëjtin nivel, midis 6 dhe 7% (Tab. 7.1 - INSTAT). Organizatat ndërkombëtare si PNUD, etj kanë bërë përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin, lidhur me pjesëmarrjen e grave në politikë. Për herë të parë sanksionohet pjesëmarrja e barabartë në vendimmarrje dhe parashikohet marrja e masave të posaçme të përkohshme siç janë kuotat në vendimmarrjen politike dhe publike.

154. Në lidhje me kandidimin, të gjitha kandidatet mbështeten njësoj financiarisht pavarësisht nga përkatësia gjinore, sepse interesi i një partie politike është që të fitojë kandidatja e saj. Gjithashtu, në disa raste OJF-të kanë ndihmuar gratë duke bërë fushata për kandidate dhe duke ngritur fonde për to, por duhet thënë që kjo nuk është një përpjekje e rregullt dhe sistematike. Ekziston mendimi se, gratë që futen në politikë mund të shërbejnë si një model, apo shëmbull konkret i pjesëmarrjes në jetën politike dhe publike. Në fakt, partitë politike nuk kanë një preferencë të deklaruar që gratë nuk duhet të kandidojnë. Përkundrazi, ka patur raste kur gratë janë ftuar të bëhen pjesë e një strukture të caktuar politike dhe nuk kanë pranuar të kandidojnë. Megjithatë, për humbjen e një kandidateje në zgjedhje, partitë politike në shumicën e rasteve fajësojnë elektoratin që nuk tregojnë preferencë për gratë. Rrallë ekzistojnë imazhe negative të grave që i hyjnë politikës në nivelet e larta. Në nivelin e qyteteve të vogla dhe fshatrave gratë hezitojnë të përfshihen në politikë, kurse në disa raste të

tjera vetë gratë tregojnë pak besim për koleget e tyre femra, të cilat provojnë të hyjnë në politikë.

b) E drejta për të formuluar politikë dhe për të patur funksion shtetëror.

155. Legjislacioni shqiptar garanton pjesëmarrjen e grave në të gjitha nivelet e hartimit të politikave, strategjive dhe programeve. Aktualisht mund të thuhet se është krijuar modeli i “femrës politikane”, apo i “femrës lidere”, në të gjitha nivelet e pushtetit qendror dhe lokal. Krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrje në politikë është konsideruar gjithmonë si pjesë e të drejtave të njeriut dhe shprehje e nivelit të demokracisë. Gjithashtu, pjesëmarrja gjithmonë e më shumë e grave në jetën publike dhe politike të vendit dhe në procesin e vendimmarrjes ka krijuar mundësinë që, interesat e grave të reflektohen më mirë në marrjen e nismave në mbrojtje të të drejtave të tyre. (Tab. 7.3 & 7.5 - INSTAT). Pjesëmarrja e grave në politikë është thelbësore në arritjen e Qëllimit të Tretë të Zhvillimit të Mileniumit (mbi barazinë gjinore) për shoqërinë shqiptare.

156. Nga një analizë e programeve të partive politike dhe të platformave të tyre elektorale të shpalosura në zgjedhjet e fundit elektorale të 3 korrikut 2005 u vu re një rritje e ndërgjegjësimit të forcave politike, në lidhje me rëndësinë e pjesëmarrjes së gruas në politikë dhe në drejtim. (megjithatë kjo nuk vlen për të gjitha forcat politike). Kjo pasqyrohet në programet e tyre, në platformat elektorale, si dhe në futjen e kuotës në statutin e partive politike.

157. Në Statutin e Partisë Demokratike (PD) thuhet që: *Numri i zonjave fituese të mos jetë më pak se 25% e numrit të antarëve të Kryesisë që del prej votimit. Në rast se ky kriter nuk plotësohet në renditjen e dalë pas votimit, atëhere renditja e tyre veçohet nga ajo e përgjithshme.*

158. Në Statutin e Partisë Socialiste (PS) thuhet që: *Lista e kandidatëve për antarë forumesh drejtuese të partisë dhe për përfaqësues të partisë në organet e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv për të gjitha nivelet duhet të përmbajë jo më pak se 20% femra.* Në programin e kësaj partie në pjesën: “Vlerat tona themelore”, flitet edhe për Barazinë Gjinore.

159. Edhe firmosja nga forcat politike e Kodit të Sjelljes (27.05.2005 - inisiativë kjo e Presidentit të Republikës), tregoi një miratim *de jure* nga këto forca politike, të procesit të rritjes së pjesëmarrjes së gruas në politikë dhe në drejtim. Por *de facto*, situata paraqitet ndryshe. Duke iu referuar organizimit të partive politike vihet re, që në poste drejtuese dominues janë meshkujt. Kështu: në PS si antare kryesie gratë përbëjnë 25%, ndërsa në KPD gratë zenë 16.7 %. Në PD – të 9 sekretarët janë meshkuj, ndërsa për sa i përket Kryesisë gratë zenë 27.7 %. LSI (Lëvizja Socialiste për Integrim) - nga 14 antarë kryesie, 3 i ka gra (21.4%). Në partitë e tjera politike pjesëmarrja e grave është shumë e ulët. Në zgjedhjet e fundit elektorale numri i grave në listat një-emërore dhe shumë-emërore ishte tepër i ulët, në raport me angazhimet e ndërmara nga këto forca politike.

160. Për zgjedhjet parlamentare të vitit 2005 media elektronike dhe ajo e shkruar ishin më të sensibilizuara nga aspekti i përkatësisë gjinore. Nga monitorimi i shtypit para zgjedhor numri më i madh i artikujve që trajtonin pabarazinë gjinore në politikë ishte shkruar nga gra (gazetare, analiste, përfaqësuese të shoqërisë civile, kandidate

për deputete, gra të angazhuara në politikë etj.) Një numër i vogël i këtyre artikujve ishte shkruar nga gazetarë dhe analistë burra.

161. Në periudhën 2003-2005, Komiteti për Mundësi të Barabarta ka zhvilluar disa veprimtari për të nxitur rritjen e numrit të grave prezente dhe aktive në vendimmarrje. Si të tilla mund të përmenden:

- Trainime në 12 rrethet e vendit *“Për nxitjen e pjesëmarrjes së gruas në politikë”* që synoi trainimin e gati 350 grave e vajzave potenciale për kandidatë për zgjedhjet vendore të vitit 2003, mbështetur nga NPA. (Ndihma e Popullit Norvegjez)
- Tryeza të rrumbullakta në rrethe të ndryshme me *Fondacionin Friedrich Ebert*, lidhur me ndërgjegjësimin e pushtetit vendor për rritjen e pjesëmarrjes së gruas në politikë.

162. Në kuadrin e Paktit të Stabilitetit, në bashkëpunim me grupimin e shoqatave *“Millenium”* janë organizuar trainime me aktivistë politikë dhe gra me poste drejtuese në sektorin e vendimmarrjes publike. Këto veprimtari u organizuan në shumë rrethe të vendit gjatë fushatave elektorale të përgjithshme dhe vendore. Në kuadrin e projektit *“Gratë në lidërsip”* financuar nga SIDA (Swedish International Development Agency) dhe UNDP (Fondi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim) u realizua trainimi i grave kandidatë për zgjedhjet lokale, antare të forumeve politike të grave, i cili synoi trainimin dhe mbështetjen e kandidatëve femra. Në këtë rast u trainuan rreth 1100 gra e vajza nga gjithë vendi. Pavarësisht nga këto trainime dhe sensibilizime situata konkrete flet për një prezencë jo të lartë të gruas në vendimmarrjen politike.

163. Megjithatë, nga ana e Qeverisë vazhdimisht bëhen përpjekje pozitive për fuqizimin e gruas dhe rritjen e pjesëmarrjes së saj në vendimmarrjen politike dhe publike. Në Strategjinë e Barazisë Gjinore 2007-2010 (e miratuar me VKM nr. 913 dt.19.12.2007) një nga drejtimet është rritja e balancës gjinore në vendimmarrje dhe për këtë thuhet se, *“një nga veprimet që duhet të ndërmerret (sipas Planit të Veprimit) është rishikimi i ligjit elektorale dhe mbështetja e veprimeve që synojnë rritjen e numrit të grave në Parlament, apo në strukturat vendimmarrëse në nivel lokal”*.

164. Aktualisht, Shqipëria shënon standartin më të ulët të përfaqësimit të grave në Europë dhe ka vetëm 7.1% femra deputete në Kuvend, ndonëse në Kodin e Etikës, që u nënshkrua nga të gjitha partitë politike në kuadër të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2005 theksohej shprehimisht se: *“Ne do të nxisim dhe mbështesim konkretisht pjesëmarrjen e plotë të grave, qoftë si kandidatë, apo dhe si antare të komisioneve në procesin zgjedhor”*.

165. Disa nga faktet më domethënëse të pjesëmarrjes së grave shqiptare në të gjitha nivelet e hartimit të politikave, strategjive, apo të caktimit të tyre në funksione publike në të gjitha hallkat e qeverisjes janë vetë postet e larta që mbajnë një pjesë e tyre si në pushtetin legjislativ, ashtu edhe në atë ekzekutiv dhe ligjor. Ndër këto vlen të përmenden: Kryetarja e Parlamentit, Kryetarja e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Kryeprokurorja e RSH, disa Ministre të Kabineteve Qeveritare të viteve të fundit, Inspektorja e Përgjithshme e Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, Kryetarja e Komitetit Shtetëror të Minoriteteve, etj. Në Tabelat, Nr. 7.2 & 7.4 –

(INSTAT), në Kapitullin e Anekseve është pasqyruar në shifra pjesëmarrja e grave në Parlament dhe në Qeveri.

c) E drejta e grave për të marrë pjesë në OJF-të dhe në jetën publike të vendit

166. Gratë janë gjërësisht të përfaqësuara në Shoqatat e tyre dhe në OJF-të, të cilat ju ofrojnë shërbime sociale, kryesisht kategorive më vulnerabël të shoqërisë. Në fakt, OJF-të e grave janë grupi më i madh dhe më i vjetër në përvojë në shoqërinë civile në Shqipëri që daton fillimet e tij në vitin 1990. Aktualisht, në Shqipëri ka rreth 100 OJF të rregjistruara grash, të cilat janë të njohura si pjesa më aktive e shoqërisë civile, që ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimet demokratike në Shqipëri edhe pse shpesh i është dashur të operojë në mjedisin e një shoqërie konservatore.

167. Përveç OJF-ve, në Shqipëri janë të rregjistruara dhe 614 Shoqata, nga të cilat 112 (18.24%) drejtohen nga gratë, gjë që do të thotë se gruaja shqiptare iu përgjigj menjëherë ndryshimeve në vend, madje duke marrë përgjegjësinë dhe rolin e saj në këto zhvillime demokratike. Një vend në tranzicion si Shqipëria ka shumë se ç'të përfitojë nga pjesëmarrja e gruas në këtë sferë, për rrjedhojë dhe nga kontributi i saj në vazhdimësinë e zhvillimit të ekonomisë së tregut dhe të shoqërisë demokratike. Kjo pjesëmarrje thyen stereotipet e dominancës mashkullore. Si pasojë e mundësisë së kufizuar për pjesëmarrje në organizmat vendimmarrëse, gratë kanë arritur mundësi drejtuese nëpërmjet alternativave të tjera, në mënyrë të veçantë në sektorin jo-qeveritar, siç janë mediat, universitetet, etj. (Tab. 7.6 & 7.7 – INSTAT). Në këtë sektor gruaja gjeti më shumë hapësirë dhe liri për një angazhim aktiv në dobi të çështjeve të grave dhe fëmijëve në veçanti, por edhe të komunitetit në tërësi.

168. Shoqatat e grave dhe OJF-të kanë realizuar dhe vazhdojnë të realizojnë shumë aktivitete, që kanë të bëjnë me të drejtat e grave e fëmijëve, me përkujdesjen sociale e shëndetsore, me zhvillimin ekonomik (kryesisht të biznesit të vogël për gratë dhe vajzat), me luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore, etj. Që prej vitit 2000, ka nisur dhe është konsoliduar gjithnjë e më shumë një lëvizje kombëtare për fuqizimin politik të gruas, e cila arriti të ketë impaktet e saj në klimën politike dhe sociale në vend në favor të balancës gjinore. OJF-të shqiptare kanë luajtur një rol të dobishëm në rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë. Megjithëse sporadike, disa OJF të grave kanë ndihmuar për ngritjen e fondeve për kandidatet politike dhe kanë inkurajuar pjesëmarrjen në votime, si dhe votimin e kandidateve të mbështetura nga ana e tyre. OJF-të kanë lobuar me organizmat ndërkombëtare dhe kanë tërhequr vëmendjen e tyre në drejtim të përfaqësimit më të mirë të grave në politikë. Edhe faktori shumë i rëndësishëm i medias filloi të ketë në fokus problemet e barazisë gjinore, veçanërisht atë të pjesëmarrjes së gruas në politikë dhe kjo ecuri progresive kulmoi në fushatën e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2005, me disa programe e debate në mediat kryesore në vend. Një element i rëndësishëm në evoluimin e OJF-ve të grave është dhe përmirësimi i organizimit të tyre.

169. Nga njëra anë, OJF-të kanë përkrahur disa përfaqësuese të tyre të fuqishme, të cilat janë thithur më pas nga strukturat shtetërore. Nga ana tjetër, shteti ka patur nevojë dhe ka kërkuar mbështetjen e OJF-ve, pasi ato kanë specialiste të mira, rekomandimet e të cilave kanë qënë të vlefshme në hartimin e legjislacionit shtetëror dhe politikave të favorshme për gratë. Vlen të përmendet fakti, që Raporti Kombëtar i Zhvillimit Njerëzor i Shqipërisë i vitit 2005 përmënd të dhëna të marra nga "Qendra e

Aleancës Gjimore për Zhvillim”. Gjatë vitit 2007 e në vazhdim i është dhënë akoma më shumë prioritet bashkëpunimit shtet-shoqëri civile. Konkretisht ky kooperim ka sjellë efektivitet dhe rritje të cilësisë së bashkëpunimit në hartim politikash e ligjesh, shkëmbim eksperience, kryerje aktiviteteve të përbashkëta etj.

170. Veçanërisht vlerësohet ekspertiza e dhënë nga përfaqësueset e OJF-ve në këto drejtime:

1. Hartim politikash

SKBGJ & DHF 2007-2010 u hartua gjatë një procesi gjithëpërfshirës, ku një rol të rëndësishëm luajti edhe ekspertiza e dhënë nga përfaqësuesit e OJF-ve të fushës.

2. Hartim Ligjesh

a). Ligji "Për masat për parandalimin e dhunës në marrëdhëniet familjare", inisiativë e 20.000 firmave qytetare është hartuar nga koalicioni i shoqatave: Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Fëmijëve, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Qendra e Këshillimit për Gra e Vajza, Refleksione, Strehëza për Gratë e Dhunuara, Klinika Ligjore për të Miturit, Shoqata në Dobi të Gruas Shqiptare, Qendra për Popullsinë dhe Zhvillimin dhe Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim.

b). Projekt-ligji i ri "Për barazinë gjimore në shoqëri" dhe projekt-ligji "Kundër Diskriminimit". Për të marrë mendime për përsosjen e këtyre projekt-ligjeve, me mbështetjen e UNDP dhe OSBE janë organizuar tryeza me ekspertë, përfaqësues të OJF-ve, etj. Gjithashtu bashkëpunimi është intensifikuar edhe nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme të organizuara nga OJF-të. Edhe në aktivitetet që ka zhvilluar shteti, pjesëmarrja e OJF-ve sipas tematikës, gjithmonë ka qënë e kënaqshme.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen fushat e veprimtarive të OJF-ve dhe roli që kanë luajtur OJF-të i shprehur në përqindje.

Fusha e veprimtarive të OJF-ve në Shqipëri	Përqindja që ze veprimtaria e OJF-ve
Hartim Ligjesh	23 %
Gratë, fëmijët dhe familjet	18 %
Ekonomi	11 %
Kulturë	10 %
Informacion	9 %
Këshillim dhe shërbime direkte	6 %
Gratë fshatare	6 %
Forume politike	4 %
Vendimmarrja e grave, feja, arsimit, media, punësimi dhe antitrafiku	2 %

Burimi: USAID

171. Një nga sfidat kryesore të OJF-ve mbetet koordinimi më i mirë i punës së tyre. Sfida tjetër e OJF-ve të grave është qëndrueshmëria financiare. Lidhur me financimin e OJF-ve në kreun VII të ligjit "Për Organizatat Jo-Fitimprurëse", ku bëhet fjalë për "Liçensimin, të ardhurat dhe veprimtarinë ekonomike" dhe në nenin 35 ("Burimi dhe përdorimi i të ardhurave") thuhet se, "Burimet janë të ardhura nga kuotizimi kur ka të tilla, fonde, grante dhe donacione të ofruara nga subjekte private, ose publike, vëndas ose të huaj, si dhe të ardhura nga veprimtaria ekonomike dhe pasuritë në pronësi të organizatës jo-fitimprurëse". Ndërkohë neni 41 përcakton se, "Kur OJF-të kryejnë

veprimtarinë e tyre me fonde të buxhetit të shtetit, atëherë shteti ka të drejtë të mbikqyrë OJF-të në drejtim të zbatimit të legjislacionit tatimor, doganor dhe atij të sigurimeve shoqërore”. Këtu vlen të përmendet dhe fakti që, tërheqja e donatorëve nga Shqipëria ka kërcënuar ekzistencën e atyre OJF-ve që janë të varura kryesisht nga donatorët.

Neni 8 PERFAQESIMI NDERKOMBETAR DHE PJESEMARRJA

172. Nga pikpamja legislative të gjithë nënshtetasit shqiptarë, pa dallime mes burrave dhe grave, gëzojnë njësoj të drejtën për të përfaqësuar vendin e tyre në organizatat ndërkombëtare, në qoftë se plotësojnë kriteret për Shërbimin e Jashtëm. Ligji nr. 9095, datë, 03.07.2003, “Për Shërbimin e Jashtëm në RSH”, në nenin 27 parashikon që, “në Shërbimin e Jashtëm mund të punësohet kushdo që përmbush këto kriterë”:

- a) ka nënshtetësinë shqiptare dhe banon në Shqipëri;
- b) gëzon zotësi të plotë për të vepruar;
- c) nuk ka qenë ndonjëherë i dënuar për vepra penale;
- d) nuk është pushuar nga ndonjë pozicion në administratën publike;
- e) gëzon shëndet të mirë;
- f) ka diplomë universitare shqiptare, apo të huaj;
- g) flet një gjuhë të huaj në përshtatje me vendin e punës.

173. Sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Jashtme, në Ambasadat dhe në Misionet Diplomatike të Shqipërisë gratë përbëjnë 31% të përfaqësimit. (tabela e mëposhtme përmban informacion të aktualizuar deri në mars 2008)

Përfaqësimi në Ambasadat dhe Misionet Diplomatike të RSH

Pozicioni	Total	Meshkuj	Femra	Femra %
Ambasadore	36	31	5	14
Konsulle e Përgjithshme	5	4	1	20
Ministër Fuqplotë	2	2	-	0
Ministër Këshilltar	8	6	2	25
Këshilltare	27	22	5	18.6
Sekretare e Parë	36	24	12	33.4
Sekretare e Dytë	15	1	14	93.4
Sekretare e Tretë	3	2	1	33.4
Attaché	1	-	1	100
TOTAL	133	92	41	31%

Burimi: MPJ – Mars 2008

174. Nga Organizatat e ndryshme Ndërkombëtare (përfshirë NATO-n, OKB-në, KE-në dhe OSBE-në), ku Shqipëria ka përfaqësuesin e saj, misionet shqiptare në UNESCO dhe në Këshillin e Europës (Strasburg) kanë femra në drejtimin e tyre. Në përputhje me Rezolutën Statutore të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës, të miratuar nga Komiteti i Ministrave dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.855, dt.19.12.2003, në përbërje të delegacionit shqiptar në këtë Kongres janë caktuar edhe dy gra, me cilësinë e zëvendës-antartit të delegacionit. Gjithashtu, një përfaqësuese femër nga Shqipëria, por me cilësinë e zëvendës-antartit të delegacionit bën pjesë edhe në delegacionin e Dhomës së Autoriteteve Lokale të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Europës.

Kuadri ligjor për Shtetësinë

175. Shtetësia e grave. Legjislacioni shqiptar, në lidhje me shtetësinë e grave të martuara është në përputhje me nenin 9 të Konventës CEDAW. Konkretisht, neni 19/2 i Kushtetutës parashikon që: “Shtetasi shqiptar nuk mund ta humbasë shtetësinë, përveçse kur ai heq dorë prej saj.” Ky formulim i vendos burrat dhe gratë në të njëjtin plan dhe kërkon vullnetin e shprehur të qytetarit për të hequr dorë nga shtetësia e tij. Kështu, martesë me një nënshtetas të huaj, nuk sjell automatikisht as humbjen dhe as fitimin e shtetësisë shqiptare. Ligji për Shtetësinë Shqiptare përcakton se, “i huaji që është i martuar me një shtetas shqiptar prej jo më pak se 3 vjetësh, në rast se dëshiron mund të fitojë shtetësinë shqiptare me natyralizim”. Përveç kësaj, zgjidhja e martesës nuk shkakton automatikisht humbjen, ndryshimin apo rifitimin e shtetësisë shqiptare.

176. Shtetësia e fëmijëve. Ligji për Shtetësinë shqiptare parashikon fitimin automatikisht të shtetësisë shqiptare nga ana e fëmijës që e ka të paktën njërin prind shqiptar, pa bërë dallim mes nënës dhe babait të fëmijës. Nëse njëri nga prindërit ndërton më vonë shtetësinë, fëmija mund të ndryshojë shtetësi vetëm nëse të dy prindërit japin pëlqimin. Gjithashtu, ligji nuk bën dallim mes babait dhe nënës.

1. Të drejta të barabarta për të fituar, ndryshuar dhe mbajtur nënshtetësinë.

177. Kombësia e femrave përcaktohet mbi të njëjtat kritere si ato për nënshtetësinë e meshkujve. Në pesëmbëdhjetë vitet e shkuara, ka patur një tendencë si për meshkujt, ashtu dhe për femrat për të ndryshuar nënshtetësinë shqiptare duke u martuar me nënshtetas jo-shqiptarë. Femrat mund të pajisen me pasaportë dhe atyre nuk u kërkohet ligjërisht të kenë një leje nga bashkëshorti, apo kujdesari për të udhëtuar jashtë vendit. Megjithatë, ndryshe nga meshkujt, femrat sidomos në zonat rurale shpesh herë kërkojnë edhe pëlqimin e bashkëshortit nëse kanë nevojë të udhëtojnë jashtë shtetit.

2. Për nënshtetësinë e fëmijëve të tyre femrat kanë të drejta të barabarta me meshkujt.

178. Ajo çka përcaktohet në ligj ka gjetur zbatim edhe në praktikë. Në përgjithësi në Shqipëri nuk ka probleme në lidhje me vendosjen e nënshtetësisë së fëmijës. Minorenët mund të udhëtojnë me pasaportën e secilit prind, por mbas amendimit të ligjit qysh para disa vitesh, fëmijët mund të kenë dhe pasaportën e tyre. Në këtë rast, për lëshimin e kësaj pasaporte kërkohet leja e të dy prindërve.

KAPITULLI III**Kuadri ligjor për arsimin dhe formimin profesional dhe Strategjitë Kombëtare**

179. Arsimi është një e drejtë e garantuar pa dallim, si për vajzat ashtu dhe për djemtë dhe mund të thuhet pa mëdyshje që në fushën e arsimit në Shqipëri nuk ka diskriminime. Për këtë flet jo vetëm kuadri ligjor aktual për arsimin dhe formimin profesional, por edhe arritjet konkrete, të cilat do të pasqyrohen më poshtë sipas pikave të veçanta që përmban neni 10 i Konventës CEDAW.

180. Legjislacioni i ri shqiptar në arsim është hartuar duke e konsideruar barazinë gjinore si një ndër parimet e rëndësishme të përcaktuara në Kushtetutën e RSH, (Neni 18 i së cilës garanton të drejtën për arsim të kujtudo, pa dallim race a seksi) si dhe në angazhimet e dala nga marrëveshjet dhe traktatet ndërkombëtare që ka ratifikuar Shqipëria. Legjislacioni shqiptar për këtë nen dallohet për një përputhje mjaft të mirë *de jure* me CEDAW-n. Ndër ligjet që janë aprovuar duke filluar që nga momenti kur Shqipëria ka nënshkruar dhe ratifikuar Konventën CEDAW mund të përmenden:

181. Ligji nr. 7952, datë 21.06.1995^{5*}, *“Për sistemin arsimor parauniversitar, i ndryshuar”*, në nenin 3 parashikon që, *“shtetasit shqiptarë gëzojnë të drejta të barabarta për arsimin në të gjitha nivelet që mbulon ky ligj, pavarësisht nga kushtet e tyre sociale, kombësia, gjuha, seksi”*. Gjithashtu, ky ligj pengon lënien e shkollës, pa dallim seksi, për të gjithë nxënësit e arsimit të detyrueshëm. Neni 8 i këtij ligji përcakton se: *“Në RSH të gjithë fëmijët e moshës 6-vjeçare duhet të regjistrohen në shkollat e arsimit të detyrueshëm, i cili vazhdon për jo më pak se 8 vjet.”* Kurse neni 24 thotë që: *“Të gjithë prindërit e fëmijëve të moshës shkollore duhet t’i dërgojnë fëmijët në institucione të arsimit të detyruar shkollor, publike apo private”*. Ndërkohë, në nenin 59 të po këtij ligji përcaktohet se, *“kur nxënësit lënë shkollën prindërit e tyre gjohiten për kundërvajtje administrative deri në 10 000 lekë (afërsisht 120 \$ USD)”*. Barazia gjinore mbahet parasysh në këtë ligj edhe në procesin e hartimit të programeve për zhvillimin e arsimit, të cilat bëhen në përputhje me prirjet dhe zhvillimet arsimore ndërkombëtare dhe me veçoritë kombëtare, rajonale, social-ekonomike dhe demografike të Shqipërisë.

182. Ligji Nr. 8387, datë 30.07.1998^{*}, (i hartuar nga ndryshimet në ligjin nr. 7952, datë 21.06.1995) në nenin 3, thuhet që: *“Shtetasit e RSH gëzojnë të drejta të barabarta për t’u arsimuar në të gjitha nivelet e arsimit që përcakton ky ligj, pavarësisht nga gjendja sociale, kombësia, gjuha, seksi, feja, raca, bindjet politike, gjendja shëndetsore dhe niveli ekonomik”*.

183. Ligji nr. 8461, datë 25.02.1999^{*}, *“Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”*, që aktualisht është ndryshuar tërësisht i ka dhënë një zhvillim më të madh arsimit të lartë shqiptar, duke e përfshirë atë në zonën europiane të kësaj fushe. Ky ligj në përmbajtje reflekton parimin e barazisë gjinore. Të gjitha subjektet që janë pjesë e këtij ligji, apo preken prej tij trajtohen në mënyrë të barabartë dhe pa dallim gjinie. Gjithashtu, ky ligj garanton mundësinë e të mësuarit gjatë gjithë jetës duke siguruar mjete dhe shanse të barabarta për të gjithë, mundësi për lëvizje të lirë, si dhe mundësi për njohje të studimeve të kryera në të gjithë zonën europiane.

184. Ligji nr. 8872, datë 29.3.2002^{*}, *“Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”* në pikën 3 të nenit 1 të tij, përveç qëllimeve të tjera

^{5*} Këto Akte Ligjore nuk janë pasqyruar në Raportin e Parë dhe të Dytë të Kombinuar

shprehet se, *“ky ligj garanton të drejtën e shprehur në Kushtetutën e RSH për arsimin dhe formimin profesional gjatë gjithë jetës, mundësinë e kryerjes së arsimit fillestar profesional, si dhe të fitimit të njohurive profesionale të nevojshme për punësim, duke krijuar shanse të barabarta për të gjithë”*. Edhe në nene të tjera të ligjit ndihet fryma e barazisë gjinore, pasi për të gjithë subjektet, të cilët preken nga ligji “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” pavarësisht nga seksi, sigurohet një trajtim i barabartë i tyre. Pra, përfitimet nga ligji në lidhje me pranimet në arsimin dhe formimin profesional, apo këshillimin dhe orientimin e individëve në këto fusha janë të njëjta, si për meshkujt, ashtu dhe për femrat.

185. Nga ky ligj (sipas pikës, c) përfitojnë, përveç nxënësve dhe personave që kanë mbushur 18 vjeç edhe *“grupe të veçanta, që dëshirojnë riaftësim profesional, siç janë personat me aftësi të kufizuar, nënat me shumë fëmijë, personat nën 18 vjeç, të papunët afatgjatë, personat nga familje nën nivelin e varfërisë dhe çdo kategori tjetër që do përcaktohet si e tillë me Vendim të Këshillit të Ministrave”*.

186. Në ligjin nr. 9741, datë, 21.05.2007, *“Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”*, në nenin 2, pika ç, përcaktohet që: *“Misioni i arsimit të lartë është të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë”*. Ndërsa në nenin 3, pika 4, përcaktohet që: *“Arsimi i lartë në RSH zhvillohet në përputhje me rregullat dhe parimet e hapësirës europiane të arsimit të lartë”*.

187. Në kuadër të Marrëveshjes për Asociim dhe Stabilizim si dhe përafrimit të legjislacionit tonë me legjislacionin e BE, ligji *“Për sistemin arsimor parauniversitar”* është parashikuar të ndryshohet duke u përshtatur me frymën aktuale legjislative, me marrëveshjet dhe traktatet ndërkombëtare dhe me ligjet bazë europiane. Duke u parë çështjen e përafrimit të legjislacionit në këtë këndvështrim qëllimi kryesor është formulimi i aspekteve të barazisë gjinore në nivele sa më bashkëkohore.

188. Kuadri ligjor që rregullon të tre nivelet e arsimit dhe formimit profesional, jo vetëm përdor gjuhë neutrale nga pikëpamja gjinore me terma të tilla, si: “kushdo”, “specialistë”, “shkencëtarë”, “individë” etj, por në disa dispozita ndalon diskriminimin dhe nxit barazinë, duke përcaktuar shprehimisht që: *“Ky ligj garanton të drejtën e shprehur në Kushtetutën e RSH për arsim dhe formim profesional, nëpërmjet krijimit të shanseve të barabarta për të gjithë”*.

189. Në disa raste legjislacioni shqiptar tregon kujdes të veçantë për arsimimin e grave. Konkretisht, Kushtetuta shpall arsimimin e grave në vështirësi ekonomike apo sociale si një nga objektivat sociale të RSH. Po ashtu, kategoria e personave që përfitojnë nga ligji “Për Arsimin dhe Formimin Profesional” përfshin vajzat-nëna të papuna, vajzat dhe gratë e trafikuar, si dhe gratë e divorcuara me probleme sociale. Po në këtë aspekt mund të përmendet edhe Urdhri nr. 394, datë, 23.02.2004 i Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, “Për tarifat e Sistemit të Formimit Profesional”, i cili përcakton se, *“tarifat e regjistrimit për kategori të tilla si: komuniteti rom, vajzat dhe gratë e trafikuar, etj janë falas për kurset e profesioneve të ofruara nga Qëndrat Publike të Formimit Profesional”*.

190. Gjatë periudhës 2003-2007, edhe në fushën e sportit kanë ndodhur ndryshime legjislative, të cilat ndër të tjera, kanë patur si synim edhe respektimin e barazisë

gjinore. Konkretisht, ligji nr. 9376, datë, 21.04.2005 “Për Sportin”, neni 5, pika 3 siguron barazinë gjinore për sa i takon pjesëmarrjes në aktivitetet sportive. Në këtë pikë thuhet shprehimisht se, “Ndalohet diskriminimi në veprimtaritë sportive për shkaqe të tilla, si bindjet politike e fetare, raca, etnia, gjuha, gjinia, gjëndja ekonomike, ose shoqërore”.

Strategjitë Kombëtare për Arsimin, Sportin dhe Rininë

191. Bazuar në këtë kuadër ligjor, në ndryshimet dhe zhvillimin progresiv të shoqërisë shqiptare, në veçanti gjatë dekadës së fundit, Qeveria e RSH ka hartuar disa strategji kombëtare të cilat kanë patur si qëllim: **a).** promovimin e barazisë gjinore, **b).** krijimin e mundësive të njëjta për arsim cilësor pa bërë dallime gjinore, **c).** përmirësimin në tërësi të sistemit arsimor dhe të institucioneve të tij, etj. Ndër strategjitë kryesore mund të përmenden:

192. Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar për periudhën 2007-2013. Në këtë Strategji, në kapitullin “Racionalizimi i shpërndarjes së shkollave, krijimi i shanseve të barabarta” thuhet që: “Me mjaft kujdes duhet të trajtohen në dokumentacionin shkollor dhe në procesin mësimor zhvillimet, lidhur me ratifikimin e dokumenteve të rëndësishme ndërkombëtare si, ligji për barazinë gjinore dhe ndryshimet në kodin e familjes, të cilët reflektojnë problematikat që i shoqërojnë”.

193. Strategjia e Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje. Ndër objektivat e kësaj strategjie parashikohet fuqizimi i gruas dhe rritja e mundësive të saj për kualifikim profesional, si dhe promovimi i aksesit të barabartë të grave dhe vajzave në arsimin cilësor. Objektivat dhe veprimet janë tepër ambicioze dhe për vitet 2007-2010 synohen:

1- Përmirësimi i programeve shkollore që promovojnë barazinë gjinore, si dhe përmirësimi i pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në mësimdhënie, në planifikimin dhe menaxhimin e arsimit.

2- Forcimi i kapaciteteve të institucioneve arsimore për të integruar çështjet dhe konceptet e barazisë gjinore në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e arsimit.

3- Përmirësimi i qëndrimeve shoqërore dhe kulturore të komuniteteve dhe familjeve që promovojnë vlerat dhe rëndësinë e arsimit të vajzave, duke përfshirë rolet dhe kontributet e grave dhe vajzave në zhvillim.

194. Gjithashtu, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) po monitoron zbatimin e dy strategjive të tjera, të cilat janë:

a) Strategjia Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom”.

b) Strategjia e “Personave me aftësi të kufizuara”, e cila synon rritjen e pjesëmarrjes së nxënësve e në veçanti të vajzave në sistemin arsimor.

195. Me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr.782, datë, 16.11.2006 është miratuar Strategjia e Rinisë 2007-2013, e cila parashikon në vizionin e saj ndërgjegjësimin e të rinjve për rolin dhe pjesëmarrjen e tyre në formulimin e politikave dhe procesin e vendimmarrjes në nivel kombëtar. Në këtë strategji rinia përkufizohet si një grup, duke mos krijuar diferencime në bazë gjinie dhe duke shprehur qartë barazinë midis femrave dhe meshkujve. Në disa fusha të caktuara ku është i dallueshëm diferencimi i femrave dhe meshkujve si, trafikimi dhe shfrytëzimi i të rinjve ku vajzat e reja janë viktimat kryesore janë parashikuar politika dhe aktivitete që nxisin femrat të përfshihen drejtpërdrejt në luftën kundër dhunës.

196. Eshtë hartuar Draft-Strategjia Kombëtare e Sportit 2008-2013, e cila pritet të kalojë për miratim në Këshillin e Ministrave brenda qershorit 2008. Në gamën e objektivave për vitin 2013, kjo strategji parashikon edhe sigurimin e ekuilibrit gjinor në dy aspekte specifike: **1).** inkurajimi i grave pjesëmarrëse në aktivitetet sportive dhe **2).** rritja e pjesëmarrjes aktive të grave në vendimmarrje dhe në bordet drejtuese të rëndësishme sportive. Në këtë strategji parashikohet sanksionimi i statuteve të federatave sportive, duke bërë të detyrueshëm zgjedhjen e femrave në Komitetin Ekzekutiv në kuotën prej 30% të antarëve të tij.

197. Në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës funksionon Qendra e Studimeve Gjinore dhe në vitin akademik 2006-2007 është hapur dega e studimeve pasuniversitare për studimet gjinore. Kjo ka qënë dhe një nga Rekomandimet e Komitetit CEDAW (Paragrafi 10).

Masat për eliminimin e diskriminimit në fushën e arsimit

(a) Marrja pa diskriminim e udhëzimeve për shkollim dhe profesione.

198. E drejta për arsim është një nga fushat ku Shqipëria ka arritur suksese. Asnjë nxënësi, apo nxënëseje nuk i mohohet e drejta për arsim. Arsimi është fusha në të cilën ka patur arritje të mira në drejtim të aksesit si për femrat, ashtu dhe për meshkujt. Në shkolla rregjistrohen më shumë vajza se djem, pjesërisht sepse djemtë emigrojnë jashtë shtetit dhe kërkojnë mundësi për t'u punësuar në një moshë më të re. (Tab. 3.1-INSTAT). Bazuar në statistikat e MASH dhe sipas Raportit të Rregjistrimit Bruto (GER-Gross Enrolment Ratio) rregjistrimi i nxënësve në arsimin e detyruar dhe të mesëm dhe niveli i frekuentimit në arsimin e detyruar nga nxënëset femra rezulton të jetë në këto shifra: arsimi fillor 99%, arsimi i mesëm i ulët 102%, arsimi i detyruar 101%, arsimi i mesëm 64%. Referuar Raportit të Regjistrimit Neto (NER-Net Enrolment Ratio), arsimi i detyruar dhe ai i mesëm frekuentohen në këto nivele: arsimi fillor 89%, arsimi i ulët 98%, arsimi i detyruar 94% dhe arsimi i mesëm 53.4%.

199. Një pjesë e vajzave nuk e frekuentojnë arsimin e detyruar dhe shkaqet janë të lidhura kryesisht me mentalitetin, me mungesën e sigurisë në përgjithësi për ato shkolla që janë larg vendbanimit të nxënësve, si dhe me zënien me punë kryesisht brenda familjeve. Shkalla neto e rregjistrimit gjatë periudhës 2001-2006 flet për një pjesëmarrje në rritje të femrave në veçanti në nivelin universitar, ku numri i femrave është më i madh se ai i meshkujve, gjë e cila reflektohet edhe në numrin e të diplomuarve (Tab.3.4-INSTAT). Edhe në nivelet e tjera të arsimit parashkollor dhe atij 8-vjeçar diferenca midis meshkujve dhe femrave, megjithëse në favor të meshkujve, nuk është sinjifikative. (Tab. 3.1-INSTAT).

188. Në nivelin e lartë arsimor pjesëmarrja e grave është e ulët (49%, kundrejt 51% burra) në të gjitha nivelet, si në administratë, ashtu edhe në stafin pedagogjik. Në drejtoritë dhe zyrat arsimore ka një përfaqësim prej 59% nga burrat dhe 41% nga gratë. Në pozicione drejtuese, 92% e drejtorëve janë meshkuj, kurse 8% femra. Në zyrat rajonale 83% e drejtorëve janë meshkuj, kurse 17% janë femra. Megjithëse në nivelin e specialistëve dhe punonjësve ndihmës në këto institucione gratë kanë përqindje më të lartë, ato ende mbeten më poshtë se burrat (48% specialiste femra

kundrejt 52% meshkuj. Po ashtu, 40% e punonjëseve ndihmëse janë femra, kurse 60% janë meshkuj.

200. Me gjithë përqindjen më të lartë të femrave në universitete vërehet një disproporcion në degë të veçanta si në ato të inxhinierive, fakultetin e pyjeve dhe akademinë e sporteve për shkak të ekzistencës së mentalitetit mashkullor për këto profesione. Me qëllim orientimin më të mirë të maturantëve drejt arsimit të lartë dhe për rrjedhojë eliminimin e preferencave gjinore në profesione e degë të ndryshme, MASH ka ndër marrë nismën *“Ditët e gjimnazistit në universitet”*. Bazuar në këtë nismë maturantët bëjnë vizita në universitete të ndryshme dhe njihen me hapësirat e punësimit për çdo degë duke krijuar natyrshëm dhe bindjen se, mundësia për frekuentim është e njëjtë për të gjithë. Për vitin shkollor 2007-2008 niveli i frekuentimit paraqitet si më poshtë:

- Arsimin e detyruar e frekuentuan 410.077 nxënës, nga të cilët 197.963 (48.2%) janë femra.
- Arsimin e mesëm të përgjithshëm e frekuentuan 144.824 nxënës, nga të cilët 49% (70897) janë femra.
- Arsimin e mesëm profesional e frekuentuan 27.288 nxënës, nga të cilët 35.3% (9637) janë femra.
- Arsimin e lartë e frekuentuan 80.069 studentë, nga të cilët 55.6% (44.454) janë femra.

201. Përsa i takon numrit të mësuesve që shërbejnë në sistemin arsimor bie në sy dominimi i seksit femër. Konkretisht, për vitin shkollor 2007-2008 po shërbejnë:

- Në arsimin e detyruar 24.418 mësues, nga të cilët 68.5% (16.732) janë femra.
- Në arsimin e mesëm të përgjithshëm 7405 mësues, nga të cilët 60.3% (4468) janë femra.
- Në arsimin e lartë 2017 pedagogë, nga të cilët 45.3% (914) janë femra.

202. Me qëllim rritjen e frekuentimit të nxënësve në arsimin e detyruar e për rrjedhojë e të atyre femra (Raportit të Regjistrimit Neto) MASH ka realizuar njëkohësisht dy studime:

- Studimi për “Mbledhjen e të dhënave statistikore dhe evidentimin e situatës së arsimimit të romëve në Shqipëri”.
- Studimi për “Shkaqet që favorizojnë analfabetizmin dhe masat që duhen marrë në luftën kundër kësaj dukurie”.

203. Mbi bazën e rekomandimeve që kanë dalë prej këtyre studimeve, MASH ka ndërtuar platforma të veçanta pune për:

- Trainimin të veçantë të mësuesve për punën me nxënës që vijnë nga shtresat e marginalizuara (500 mësues për çdo vit) dhe përmirësimin e raportit nxënës-mësues për arsimin parauniversitar. (Tab. 3.3-INSTAT).
- Trajtimin e diferencuar (pagesë për orët mësimore shtesë) të mësuesve që punojnë me fëmijë të cilët kanë braktisur shkollën.
- Transportin e diferencuar për nxënësit me aftësi të kufizuara.
- Ndërtimi i 10 konvikteve të reja për zonat në nevojë, ku në krahasim me rajonet e tjera ka një numur të lartë të nxënësve që kanë braktisur shkollën. Nga këto, 7 janë planifikuar në buxhetin e vitit 2008 dhe janë në proces realizimi në rrethet Krujë, Kukës, Dibër, Durrës, Tropojë, Sarandë dhe Shkodër dhe 3 të

tjera në rrethet Korçë, Elbasan, Fier, ku aktualisht po bëhen përpjekje për të siguruar financimin e tyre.

(b) Akses i barabartë tek të njëjtat programe shkollore, tekste mësimore, provime, kualifikime të mësuesve, trainime, mjedise dhe mjete mësimore.

204. Në dokumentacionin ligjor të hartimit dhe të miratimit të programeve dhe teksteve shkollore, një ndër kriteret sociale është dhe ai i barazisë gjinore. Si në zonat urbane, ashtu dhe ato rurale vajzat përfitojnë nga të njëjtat plane mësimore, të njëjtat mjedise dhe mjete mësimore, ashtu si dhe djemtë. Politika e vlerësimit të njohurive është e njëjtë si për djemtë, ashtu dhe për dhe vajzat.

(c) Bashkëarsimimi dhe eliminimi i stereotipeve gjinore në librat dhe programet shkollore.

205. MASH me mbështetjen e donatorëve të ndryshëm ka bërë një analizë gjinore të programeve dhe teksteve në përdorim. Pas kësaj, në kuadër të reformave të nisura MASH po zbaton dhe reformën e “*Altertekstii*” (tekstet alternative). Sipas kësaj reforme tekstet hartohen nga autorë, të cilët nuk caktohen paraprakisht dhe për botimin e tyre konkurohet nga shtëpi botuese të ndryshme. Përsa ju takon teksteve që do të përdoren në shkollë, ato zgjidhen nga vetë mësuesit. Baza e kësaj reforme është konkurrenca e lirë e botuesve. MASH në këtë proces mer pjesë nëpërmjet paraqitjes së programeve dhe kriterëve, që duhen patur parasysh gjatë punës për hartimin dhe miratimin e teksteve. Në të njëjtën kohë, MASH ka bërë të njohura qartësisht edhe kriteret për barazinë gjinore, të cilat duhet të meren në konsideratë nga ana e autorëve të teksteve. Në bashkëpunim me OJF-të, MASH ka bërë trainimin e autorëve të teksteve dhe të shtëpive botuese, lidhur me mënyrën e pasqyritit sa më të mirë të barazisë gjinore në librat shkollorë.

(d) Akses për bursa dhe grante të tjera për studime.

206. Nuk ekzistojnë diskriminime në lidhje me akordimin e bursave. Kriteret për marrjen e bursave janë të njëjta për djemtë dhe vajzat. Në disa studime që janë bërë për këtë çështje është vënë re që vajzat përfitojnë më shumë se djemtë nga bursat dhe grantet, sepse vajzat janë të prirura që të qëndrojnë në shkollë për një kohë më të gjatë se sa djemtë. Në zonat urbane, ndërsa prindërit presin që djemtë e tyre të punësohen, për vajzat ata janë më të prirur që t'i inkurajojnë ato që të qëndrojnë në shkollë dhe të vazhdojnë studimet.

(e) Akses për vazhdimin e arsimit për të rriturit.

207. Arsimi për të rriturit është në kompetencë të qeverive lokale. Për të gjithë qytetarët që nuk kanë mbaruar shkollën janë të disponueshme shkollat me kohë të pjesshme. Këto shkolla zakonisht frekuentohen nga meshkujt, meqenëse shumica e femrave tentojnë të vazhdojnë shkollën e mesme. Gjithashtu, për mendësinë e tanishme, nëse vajzat nuk arrijnë të mbarojnë shkollën e mesme, ato duhet të orientohen nga kujdesi për familjen dhe të rrisin fëmijë, prandaj në këto kushte arsimimi i mëtejshëm nuk është objektivi kryesor i tyre. Herë pas here edhe nga OJF-të janë bërë përpjekje për të trainuar të rriturit dhe sidomos gratë e marginalizuara për t'i ndihmuar ato që të integrohen në tregun e punës.

(f) Reduktimi i braktisjes së shkollës nga femrat.

208. Ndërkohë që rregjistrimi i vajzave në shkolla në përgjithësi është në nivele të konsiderueshme, dukuritë që hasen më shpesh në praktikë janë, braktisja konkrete e shkollës dhe braktisja e fshehtë e shkollës. Dukuria e braktisjes së shkollës është në ulje por, varfëria, problemet e infrastrukturës, mungesa e sigurisë në veçanti për vajzat influencojnë në braktisjen e shkollës.

209. Për të pasqyruar ndryshimet gjinore në nivelin e ndjekjes së shkollës nga meshkujt dhe femrat mund ti referohemi rezultateve të vrojtimit të MICS 2005. Sipas Vrojtimit të MICS 2005⁶, për fëmijët 14-17 vjeç shkalla e ndjekjes së shkollës në zonën rurale është më e ulët (51%), kundrejt fëmijëve që jetojnë në zonat urbane (69%). Rezultatet⁷ që lidhen me Indeksën e barazisë gjinore (GPI - Gender Parity Index) përlllogaritur mbi shkallën neto të ndjekjes së shkollës (NAR-Net Attendance Ratio) venë në dukje faktin që, barazia gjinore është pranë 1.00, gjë që tregon se nuk ka diferenca në nivelin e frekuentimit të shkollës midis vajzave dhe djemve që ndjekin shkollën fillore dhe 8- vjeçare. Kurse, për arsimin e mesëm ky tregues bie në nivelin 0.96. Karakteristike për zonat rurale është se, NAR i djemve është 0.6% më i lartë se NAR i vajzave, ndërsa në zonat urbane NAR i vajzave është 0.4% më i lartë. Shkalla neto e ndjekjes së shkollës (NAR) lidhet edhe me nivelin e mirëqënies. Familjet që kanë një nivel mirëqënie të ulët priren nga tendenca që të dërgojnë djemtë në shkollë (NAR i djemve është 0.10% më i lartë se NAR i vajzave). Në lidhje me këtë fenomen mund të thuhet se, vihet re një braktisje nga femrat, si në vlerë absolute, ashtu edhe në përqindje (gjatë vitit akademik 2005-2006 nga rreth 217.950 vajza të arsimit 9-vjeçar, 1.1% e tyre kanë braktisur shkollën).

210. Për të arritur barazinë gjinore në arsim, përpjekjet duhet të fokusohen në zonat rurale të Shqipërisë dhe në ato familje që preken më shumë nga varfëria. Infrastruktura e shkatërruar, ose jo-ekzistente që çon në pasigurinë e udhëtimit, mungesa e mjediseve sanitare (tualetet) dhe mungesa e ujit të pijshëm janë disa nga faktorët që i detyrojnë vajzat të braktisin shkollën. Një sfidë reale për ndjekjen e shkollës janë kostot “jo-formale” për arsimin, të cilat u japin familjeve të varfëra një ngarkesë financiare që mund të lidhet me mos shkuarjen në shkollë të fëmijëve, sidomos në zonat rurale dhe më të varfëra të vendit. Për më tepër, realiteti shoqëror dhe kulturor mbështet mendimin se, vajzat më shpesh dhe më shpejt se djemtë braktisin shkollën për të kontribuar në ekonominë familjare, apo për t’u martuar në moshë tepër të re.

211. Për të luftuar braktisjen e shkollës një ndihmë të madhe kanë dhënë OJF-të. Konkretisht, për të mundësuar arsimimin e vajzave që vijnë nga zona të largëta (në rastin konkret të vendosura në qytetin verior të Shkodrës) u arrit një marrëveshje me shkollën për aftësimin profesional, e cila është e licencuar për të dhënë edukim tetëvjeçar dhe të mesëm. Në bazë të ligjit, përtej një moshe të caktuar vajzat dhe djemtë nuk mund të vazhdojnë më shkollën e mesme. Megjithatë, nisur nga fakti që këto vajza janë vendosur në qytet duke emigruar nga një zonë e largët ku nuk kishin mundësi të arsimoheshin, Fondacioni “*Refleksione*” lehtësoi rregjistrimin e tyre në

⁶ Vrojtimi i MICS - 2005, INSTAT & UNICEF

⁷ Vrojtimi i MICS - 2005, INSTAT & UNICEF

shkollë pavarësisht se ato ishin mbi moshën e parashikuar nga ligji. Shkollën e mesme zakonisht nuk e frekuentonin gratë e komunitetit rom, por Fondacioni “Refleksione” nëpërmjet një bashkëpunimi me Drejtorinë Arsimore Rajonale bëri të mundur hapjen e një shkollë fillore për komunitetin rom të atij rajoni.

212. Në shumë zona në Shqipëri ku ka patur emigracion të brëndshëm të konsiderueshëm, popullsia nuk është rregjistruar ende dhe kjo ka kontribuar në nënvlerësimin e madhësisë së problemit. UNICEF-i ka krijuar një bankë të dhënash për të dokumentuar përmasat e kësaj dukurie dhe po punon me PNUD-in për të ndërtuar një strategji ndërhyrjeje. Kjo strategji do të përqëndrohet veçanërisht në vendosjen e politikave për trainimin dhe ngritjen e ndërgjegjësisimit për grupet e marginalizuara përfshirë këtu dhe komunitetet rome.

(g) Pjesëmarrja në sporte dhe edukimin fizik në shkollë.

213. Megjithëse legjislacioni shqiptar nuk përmban dispozita diskriminuese për sa i përket përkatësisë gjinore në lidhje me pjesëmarrjen në sporte, në praktikë kjo mbetet një fushë e dominuar nga meshkujt. Vlen të përmendet shëmbulli i një shkolle tetëvjeçare private, në të cilën është krijuar një skuadër futbollit për vajzat. Në fushën e mësimdhënies ka pasur disa arritje konkrete si psh. fakti që numri i mësueseve të edukimit fizik është shumë më i lartë se sa i meshkujve. Qeveria shqiptare ka qënë vazhdimisht e interesuar për hartimin e programeve specifike që inkurajojnë përfshirjen e femrave në sporte. Një nga politikat prioritare në fushën e sportit është edhe inkurajimi i pjesëmarrjes së grave në sporte të cilësuar si sporte burrërore, ku pjesëmarrja dominohet nga burrat. Këtu mund të përmendet disiplina e mundjes, ndërsa në sportin e peshëngritjes pjesëmarrja e femrave po rritet, madje edhe me nivel cilësor duke përfaqësuar veten dhe vendin në arenën ndërkombëtare. Vlen për t'u përmendur arritja e një sportisteje shqiptare (R.Begaj) në disiplinën e peshëngritjes, e cila mori medalje ari në stilin e shtytjes dhe medalje argjendi në dygarësh, në Kampionatin Evropian të Peshëngritjes në Itali (Prill 2008).

(h) Arsimi shëndetsor dhe planifikimi familjar.

214. Në dhjetë vitet e fundit, konceptet e arsimit shëndetsor dhe planifikimit familjar janë prezantuar në shkollat shtetërore, por në këtë drejtim ngelet akoma për të bërë, pasi më shumë vëmendje i duhet kushtuar programeve mësimore. Ndërkohë që ka një klasë të edukimit seksual të integruar në programin mësimor, tema të caktura janë të vështira veçanërisht për mësuesit/et, sepse edukimi për shëndetin seksual nuk inkurajohet si i tillë nga mentaliteti shqiptar.

215. Në periferi dhe në zonat rurale të Shqipërisë të folurit për seksin është tabu. Gjithashtu, mësuesve/eve u duhet të përballen me një mendësi që përcakton një nxënës/e si të formuar dhe të përgjegjshëm/me, nëse ai/ajo njeh një gjuhë të huaj, apo ka njohuri të mira kompjuterike. Kjo është ambicia kryesore e prindërve në ditët e sotme. Ndërkohë që edukimi për shëndetin dhe planifikimin familjar është i ngarkuar me probleme, ekspertët besojnë që nuk ka pengesa ligjore për të trajtuar këto çështje të lidhura me shëndetin në shkolla. Në lëndën e biologjisë dhe edukimit shëndetsor të klasës së tetë, në një kapitull të veçantë trajtohet edhe edukimi seksual. Me futjen e shërbimit psikologjik në shkollë kjo tematikë trajtohet dhe nga psikologu i shkollës.

Vlen të theksohet dhe fakti që shkollat kanë një plan edukativ, në të cilin planifikojnë aktivitete ekstrakurrikulare edhe për edukimin seksual.

216. Duke synuar gjithmonë përmirësimin e barazisë gjinore në fushën e edukimit, MASH në bashkëpunim me shoqërinë civile ka kryer një numur aktivitete të tjera në funksion të këtij qëllimi, ndër të cilat mund të përmenden:

- Krijimi i një ekipi trajnerësh lidhur me integrimin gjinor në arsim – 2004.
- Botimi i manualit teorik dhe praktik me titull “Integrimi Gjinor në Arsim”-2004.
- Organizimi i kurseve të trainimit me mësues dhe përfaqësues të Drejtorive Arsimore, në rrethe të ndryshme të vendit (niveli fillor, tetëvjeçar dhe i mesëm) - 2005;
- Analiza Gjinore e teksteve të Shkollës Fillore, i cili është një aktivitet që u realizua për herë të parë në Shqipëri. Kjo ishte një sfidë edhe për vetë ekspertët që punuan për përgatitjen dhe realizimin e tij. Reagimi pozitiv që u mor nga profesionistët që punojnë në fushën e arsimit dhe barazisë gjinore në Shqipëri, së bashku me komentet dhe rekomandimet që ata ofruan, shërbyen si një bazë e mirë për integrimin e perspektivës gjinore në sektorin e arsimit - 2005;
- Botimi i disa eseve: “Përkatësia Gjinore dhe Arsimit” - 2005;
- Krijimi dhe forcimi i kapaciteteve, lidhur me integrimin gjinor në arsim në Qëndrat e Edukimit Qytetar Demokratik (të themeluara pranë Universiteteve Pedagogjike), në qytetet Shkodër, Elbasan, Gjirokastër dhe Korçë – 2005.
- Analiza e Strategjisë Kombëtare për Arsimin Parauniversitar 2006, në këndvështrimin e perspektivës gjinore.
- Përgatitja, botimi dhe përfshirja e paketës burimore për përkatësinë gjinore, si pjesë e kurrikulës zyrtare të Universiteteve Pedagogjike – 2006.
- Organizimi i trainimeve të përkatësisë gjinore për mësues të shkollave fillore në rrethet Shkodër, Korçë, Gjirokastër, Elbasan dhe Tiranë, lidhur me përdorimin e paketës burimore të përkatësisë gjinore – 2007.
- Organizimi i kurseve për trajnerët në bashkëpunim me UNDP-in, lidhur me integrimin gjinor në arsim - 2007, ku kanë marrë pjesë antarë të Bordit Vlerësues të Teksteve Shkollore, përfaqësues nga Instituti i Kurrikulës dhe Vlerësimit, si dhe përfaqësues nga MASH.
- Për vitin 2008 po zbatohet projekti “Nxitja e Kurrikulës së Ndjeshme Gjinore për Arsimin Fillor dhe Tetëvjeçar”. Në kuadër të këtij projekti është parashikuar përgatitja dhe botimi i një Udhëzuesi për edukimin gjinor si dhe organizimi i trainimeve me autorë dhe vlerësues tekstesh shkollore, mbi mënyrën e përdorimit të këtij udhëzuesi në punën e tyre.

Neni 11

PUNESIMI

Kuadri ligjor për Punësimin

217. Legjislacioni shqiptar ndalon diskriminimin në fushën e punësimit, veprimtarisë profesionale dhe përfitimeve nga sigurimet shoqërore. Pa hezitim mund të thuhet që, legjislacioni është përmirësuar vazhdimisht në përshtatje me ndryshimet që ndodhin në tregun e punës dhe në funksion të përmbushjes së Rekomandimeve të Komitetit CEDAW (Paragrafet 34 dhe 35).

218. Në Kushtetutën e RSH në nenin 18 është përcaktuar se, të gjithë shtetasit janë të barabartë përpara ligjit dhe se askush nuk mund të diskriminohet për shkak të racës,

gjinisë, bindjeve fetare, filozofike dhe politike, gjuhës, gjëndjes ekonomike, arsimore dhe sociale. Më tej, ne Kreun IV “Për liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore”, ligji themelor i shtetit shqiptar në nenin 49/1 parashikon të drejtën për t’u punësuar. “Çdo njeri ka të drejtën të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur, ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës si dhe sistemin e kualifikimit të tij profesional”.

219. Neni 115 i Kodit të Punës përmban të njëjtin parim. Gjithashtu, neni 9 i këtij kodi sanksionon se, ndalohej çdo lloj diskriminimi si në drejtim të marrjes në punë, ashtu dhe në atë të profesionit. Kodi Punës ndalon diskriminimin në bazë të seksit që cënon të drejtën e individit për të qënë i barabartë në punësim dhe trainim, në procedurat e marrjes në punë, në kushtet e punës, në kryerjen e detyrave, në shpërblim, asistencë sociale, në përfundimin e kontratës së punës, si dhe pjesëmarrjen në sindikata. Kodi i Punës, i cili mbulon pjesën më të madhe të marrëdhënieve të punës përmend shprehimisht në një dispozitë parimin “*pagë e barabartë për punë me të njëjtën vlerë*”.

220. Kodi i Punës në nenin 146 paragrafi 2 trajton mbrojtjen në rastet e pushimit nga puna. Ky nen përcakton rastet e zgjidhjes së kontratës nga punëdhënësi pa shkaqe të arsyeshme. Në këto raste punëmarrësi ka të drejtë të ngrejë padi kundër punëdhënësit në gjykatë, brenda 180 ditëve nga dita e përfundimit të afatit të njoftimit. Gjykata vendos në rastet e pushimit pa shkaqe të arsyeshme që punëdhënësi t’i japë detyrimisht punëmarrësit një dëmshpërblim deri në 1 vit pagesë, ose rikthim në vendin e punës. Kodi i Punës e ndalon diferencimin për zgjedhjen e punonjësve/eve në bazë të racës, moshës, apo seksit.

221. Gjithashtu, Ligji për Shërbimin Civil rregullon punësimin në administratën civile dhe shtetërore duke shmangur punësimin nëpërmjet emërimit të drejtpërdrejtë. Konkursi, testimi, intervistimi dhe zgjedhja me kujdes e kriterëve ka bërë që të merret në punë një personel i kualifikuar intelektualisht dhe profesionalisht pa diskriminim gjinor. Mbrojta sigurohet si nga legjislacioni shqiptar, ashtu edhe nga konventat e ratifikuara nga Parlamenti shqiptar. Sikundër është evidentuar edhe më lart, sipas Kushtetutës së RSH marrëveshjet e ratifikuara me ligj nga Parlamenti janë pjesë e sistemit të brëndshëm juridik dhe kanë epërsi mbi legjislacionin vendas, kur ky nuk pajtohet me marrëveshjet ndërkombëtare. Nga ana tjetër, sipas Protokollit CEDAW çdo person, ose grup që e ndjen veten të diskriminuar, në lidhje me të drejtat e parashikuara në Konventë ka të drejtë të ankohet në Komitetin e Konventës, sipas një procedure të caktuar. Si rrjedhim në rastin kur individët, ose grupe personash diskriminohen në të drejtën e tyre të punës, të drejtën për shpërblim të barabartë, të drejtën për punë me vlerë të barabartë, të drejtën për sigurime shoqërore etj, kanë mundësi t’i drejtohen Komitetit të Konventës, pasi të kenë kaluar shkallët e gjykimit në vend.

222. Kodi Penal, në nenin 253, në të cilin bëhet fjalë për “Shkeljen e barazisë së shtetasve”, vendos sanksionin me gjobë, ose me burgim deri në 5 vjet, kur për shkak të detyrës e në ushtrim të saj nga ana e punonjësit me funksion shtetëror, apo në shërbim publik bëhen dallime mbi bazën e origjinës, seksit, gjëndjes shëndetsore, bindjeve fetare, politike, veprimtarisë sindikale, ose për shkak të përkatësisë në një etni, komb, racë apo fe të caktuar, të cilat çojnë në krijimin e privilegjeve të padrejta, ose në refuzimin e një të drejte, ose përfitimi që buron nga ligji.

223. Për trainimin dhe formimin profesional, krahas ligjit nr.8872, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", vlen të përmendet dhe Udhëzimi i Ministrit të Punës nr.2222, datë, 31.10.2002 "Mbi këshillimin dhe orientimin në formimin profesional". Shërbimi Kombëtar i Punësimit është i ngarkuar për zbatimin e këtij udhëzimi nëpërmjet Zyrave të Punësimit, ku janë caktuar punonjës për të realizuar këshillim dhe orientim profesional për të gjithë personat që kanë nevojë dhe i kërkojnë këto shërbime. Kujdes i veçantë në këshillim dhe orientim u kushtohet grupeve të caktuara, të cilat sipas përcaktimit në ligj janë punëkërkuesit ku futen: nënat me shumë fëmijë, personat me moshë mbi 50 vjeç, të rinjtë nën 18 vjeç, të papunët afatgjatë, personat nga familje nën nivelin e varfërisë, viktimat e trafikut, personat që përfitojnë nga programet e mbështetjes me të ardhura, personat që dalin të papunë nga ndërmarrjet dhe institucionet në proces reformimi, ristrukturimi dhe privatizimi, vajzat-nëna të papuna, femrat e divorcuara me probleme sociale, personat që kthehen nga emigracioni me probleme ekonomike, personat e sapo diplomuar dhe të pa orientuar në tregun e punës, personat që kanë vuajtur dënimin me burgim, personat me aftësi të kufizuar, romët dhe jetimët që e kanë fituar këtë status.

224. Legjislati shqiptar nuk është diskriminues as në drejtim të sigurimit të një shpërblimi të barabartë. Për punë të njëjtë midis burrave dhe grave neni 115 i Kodit të Punës, në paragrafin 3 parashikon që punëdhënësi t'u japë burrave dhe grave pagë të barabartë. Ky formulim është në përputhje me të gjitha instrumentat ndërkombëtare, në të cilat Shqipëria është palë (ILO - Konventa nr.100, "Mbi Shpërblimin e Barabartë" - 1951). Përsëri sipas Kodit të Punës, në rastin e shkeljes së këtij parimi punëdhënësi detyrohet t'i paguajë punëmarrëses/it të diskriminuar një shpërblim që përfshin të gjithë avantazhet që ka punëmarrësi i seksit tjetër (neni 115, paragrafi 4 i Kodit të Punës).

225. Të drejta të barabarta për burrin dhe gruan janë parashikuar dhe në projekt-ligjin e ri "Për Barazinë Gjinore", i cili konsiston në vendosjen në pozita të barabarta të dy seksëve në fushën e punësimit, si dhe dispozita të veçanta për ngacmimin seksual në vendin e punës. Aktualisht, nga MPÇSSHB po kryhet një studim lidhur me shpërblimin e barabartë, i cili pritet të përfundojë në qershor 2008. Pritet që ky studim të japë një analizë të situatës dhe rekomandime konkrete. Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje (SKBGJ & DHF) si një strategji ndërsektoriale, e cila u mbështet nga UNDP (United Nations Development Program) dhe OSBE, duke bërë fjalë për fuqizimin ekonomik të gruas jep këto rekomandime:

- 1) Rritja e numrit të projekteve dhe programeve, që nxisin formimin profesional dhe punësimin e femrave, si dhe shtrirja e këtyre projekteve edhe në zonat rurale.
- 2) Rritja e numrit të grave dhe vajzave sipërmarrëse, nëpërmjet dhënies së mundësive për më shumë akses në pronë, kapital dhe kreditime.

Masat për eliminimin e diskriminimit në fushën e punësimit

1- Eliminimi i diskriminimit dhe promovimi i barazisë në punësim.

(a) E drejta për punë.

226. E drejta për punë garantohet pa asnjë lloj diskriminimi për të gjithë shtetasit shqiptarë të moshës për punë. Kjo e drejtë është e shprehur qartë në nenin 32 të Kodit të Punës. Punësimi është një nga indekset më të rëndësishëm për vlerësimin e

barazisë gjinore, por për forcimin e rolit të grave në shoqëri një impakt të konsiderueshëm kanë edhe politikatat sociale jo-diskriminuese, programet dhe shërbimet mbështetëse, të cilat përbëjnë një prioritet tjetër të Programit të Qeverisë Shqiptare.

Situata e tregut të punës në Shqipëri

227. Gratë në Shqipëri vazhdojnë të përjetojnë pasojat e tranzicionit, të emigracionit, të papunësisë dhe të mbartin peshën e fenomeneve negative si, trafikimi, prostitucioni, dhuna në familje, etj. Krahas këtyre, kalimi në ekonominë e tregut në Shqipëri u shoqërua me një rënie drastike të pjesëmarrjes së krahut të punës në tregun e ri. (Tab. 4.1- INSTAT). Në vitin 2000 më pak se dy të tretat e popullsisë në moshë pune ishin aktive në tregun e punës, ndërsa në vitin 2005 ky tregues, për fat të keq ka pësuar rënie. Pjesëmarrja e grave në moshë pune në tregun e punës gjatë viteve të fundit ka rezultuar: 46,7%, në vitin 2003, 47,2% në vitin 2004 dhe 46,8% në vitin 2005. Kjo pjesëmarrje e ulët në punë shpjegohet me punësimin ende mjaft të lartë në sektorin informal, me dekurajimin nga pritmëria e gjatë për të patur akses në punë, me emigrimin e të rinjve dhe tërheqjen e një pjese të konsiderueshme të grave nga procesi i integritimit në tregun e punës.

228. Sipas metodologjisë në fuqi, papunësia aktualisht është në masën 13.2% dhe gratë përbëjnë 49% të numrit të përgjithshëm të të papunëve. Të papunët afatgjatë përbëjnë 65% të të papunëve të rregjistruar, ku përsëri gratë zenë gati gjysmën e tyre. Kryefamiljarët përbëjnë 40% të numrit të të papunëve të rregjistruar. Sipas tabelës së mëposhtme, në fund të 2007 numroheshin 142.871 persona të rregjistruar si të papunë, nga të cilët 69.801 ishin femra.

Numri i të papunëve të rregjistruar sipas gjinisë (2000-2007)

Viti	2000	2001	2002	2004	2005	2006	2007
Numri total i të papunëve të rregjistruar	215.085	180.513	172.385	157.008	153.250	149.739	142.871
Numri i femrave të papuna	101.919	85.420	81.326	75.150	74.031	72.102	69.801

Burimi: MPÇSSHB.

229. Analiza e strukturës së punëkërkesve të papunë sipas gjinisë dëshmon se, femrat zenë një peshë të konsiderueshme në totalin e punëkërkesve të papunë. Kjo ka ardhur kryesisht: **(a)** prej lënies së punës dhe angazhimi me mirërritjen e fëmijëve dhe administrimin e ekonomisë familjare, **(b)** nga mbyllja e shumë ndërmarrjeve industriale të specializuara për punësimin e femrave. Përveç kësaj, kjo forcë pune ndryshe nga meshkujt ka treguar që e ka patur më të vështirë të adoptohet me situatën e re të tregut të punës në vend.

230. Në analizën e grupit të të papunëve sipas gjinisë dhe shkallës arsimore vihet re se, të papunët me arsim tetëvjeçar dhe të mesëm përbëjnë respektivisht 54% dhe 32%. Kjo dukuri vihet re dhe në grupin e të papunëve femra, ku peshën më të madhe e zenë ato me arsim tetëvjeçar e të mesëm. Gjithashtu, ky tregues ishte më i lartë në grupmoshat e reja, kurse diferenca femra-meshkuj është prezente në të gjitha grupmoshat.

Diferenca në shkallën e papunësisë ndërmjet femrave dhe meshkujve është më e theksuar në zonën urbane, në krahasim me atë rurale. Femrat përbëjnë 46% të totalit të punëkërkesve të papunë. Mundësia për të gjetur punë për këtë kontigjent është më e madhe në sektorin e konfeksioneve dhe në atë të shërbimeve. Por edhe në këtë rast pengesë është moshë, pasi edhe punëkërkesit e papunë afat-gjatë i përkasin po kësaj grupmoshe. Kjo përqindje varion në rajone të ndryshme të vendit. Në zonën veriore ajo kap shifrën 44% të totalit, në zonën qendrore 50%, ndërsa në zonën jugore përbën 54% të totalit.

231. Niveli i papunësisë shënon një shifër më të lartë për kategorinë femra krahasuar me atë të meshkujve (18% femra, kundrejt 12.8% meshkuj). Ky tregues është më i lartë në grupmoshat e reja, ndërsa mundësia për tu punësuar në grupmoshat mbi 45 vjeç është pothuajse e njëjtë. (Tab. 4.2 - INSTAT). Gjithashtu, diferenca sa vjen e bëhet më e theksuar në zonën urbane, përkundrejt asaj rurale. Përveç kësaj, në zonën veriore dhe veri-lindore të vendit ky ndryshim theksohet më shumë, jo vetëm prej mundësive më të pakta për punësim të femrave të kësaj zone, por edhe prej emigracionit masiv të meshkujve.

232. Punëkërkeset femra, të cilat janë edhe kryefamiljare përbëjnë 12% të numrit total të tyre. Pjesa më e madhe e këtyre familjeve kanë nivel të lartë varfërie (Tab. 6.2- INSTAT) dhe trajtohen kryesisht me ndihmë ekonomike. Niveli arsimor i femrave të këtyre familjeve, krahasuar me atë të meshkujve është më i lartë. Studimet tregojnë se, 27% e femrave në moshën 16 vjeç e lart kanë mbaruar shkollën e mesme, ndërsa 13% e tyre kanë kryer studimet e larta. Femrat që ndjekin shkollën e lartë përbëjnë 62% të studentëve. Kjo ndodh sepse, pas përfundimit të shkollës 8- vjeçare, apo viteve të para të shkollës së mesme meshkujt futen në punë, ose emigrojnë, ndërsa femrat preferojnë të kryejnë studimet e larta. Por në zona demografike të ndryshme ky përfundim nuk është i njëjtë. Në zonën malore dhe në atë veri-lindore niveli arsimor i femrave është më i ulët. Në këto zona femrat shpesh herë, pasi kryejnë ciklin 8 vjeçar të shkollës priren të krijojnë familje dhe të kthehen në shtëpiake. Femrat e arsimuara kanë vështirësi për tu punësuar, për arsye se sektori shtetëror sa vjen e reformohet, duke mbyllur shumë vende pune të përshtatshme për këtë kategori. Kurse sektori privat në këto zona parapëlqen fushën e ndërtimit, por në këtë sektor mundësia e femrave për tu punësuar është shumë më e vogël.

233. Për punësimin e grave janë zbatuar programe të nxitjes së punësimit që favorizojnë gratë e vajzat dhe janë lehtësuar tarifat e sistemit të formimit profesional për gratë dhe vajzat në qendrat publike të formimit profesional. Gjithashtu, janë licensuar subjekte që ofrojnë kryesisht kurse për profesione që iu pershtaten grave e vajzave dhe i aftësojnë ato. Në rrethet Tiranë, Elbasan, Berat etj, nga ana e OJF-ve janë hapur qendra punësimi, qendra informimi dhe ndërmjetësimi për gratë dhe vajzat. Kurse, për problemet e punësimit janë ngritur një sërë institucionesh, ku mund të përmenden 12 Zyrrat Rajonale dhe Lokale të punësimit.

234. Në lidhje me profesionet që zotërojnë punëkërkesit e papunë sipas statistikave, për vitin 2007 u bë një ndarje e totalit të punëkërkesve jo vetëm sipas nivelit arsimor të tyre, por edhe sipas profesioneve që zotëronin. Nga kjo ndarje rezultoi se, 2% e punëkërkesve të papunë të rregjistruar ishin specialistë me arsim të lartë, ku

dominojnë arsimtarët (514 vetë), ekonomistët (440), agronomët (302), oficerët (374) dhe inxhinierët (kryesisht inxhinierë gjeologë dhe minierash 245 vetë).

235. Nga skema e pagesës së papunësisë përfituan 9500 punëkërkues të papunë, kurse nga skema e ndihmës ekonomike përfituan 95.781 punëkërkues të papunë. Punëkërkues nga grupet e veçanta rezultuan të jenë 8036 persona, nga të cilët 3380 janë romë, 33 vajza dhe gra të trafikuar, 1838 persona me aftësi të kufizuar dhe 3059 ishin nga kategori të tjera, të cilët figuronin të regjistruar në zyrat e punësimit në shkallë vendi.

(b) Mundësi të barabarta punësimi.

236. Legjislacioni i punës jo vetëm që nuk i diskriminon gratë, por disa kategorive të grave si psh, nënave me shumë fëmijë u jepet prioritet në sferën e punësimit. Gratë përbëjnë rreth 51% të popullsisë në vend dhe ato janë të angazhuara në këto forma të aktivitetit ekonomik: **a)** të punësuar në sektorin shtetëror (arsim, shëndetsi, administratë publike, institucione të qeverisjes qendrore dhe vendore); **b)** të punësuar në sektorin privat (kompani, ndërrmarje të vogla dhe të mesme, shërbime); **c)** të vetëpunësuar në bizneset e vogla, ose në ato familjare; **d)** të punësuar, ose në punë private në bujqësi; **e)** të punësuar në shtëpi. Të punësuarat femra zenë një përqindje të lartë në sektorin shtetëror: (telekomunikacion, aktivitete financiare, administrim publik, arsim, shëndetsi dhe veprimtaritë sociale), kurse në ekonominë private sektorët kryesorë janë, industria përpunuese, industria tekstil-veshje, industria ushqimore, bujqësia, industria e këpucëve dhe lëkurës, shërbimet kolektive. Nga kontrollet e bëra prej Inspektoriatit Shtetëror të Punës rezulton që gratë zenë: **a)** rreth 47% të të punësuarve në shërbimet dhe ndërrmarjet e biznesit të vogël, **b)** rreth 12% të punësuarve në ndërtim dhe në prodhimin e materialeve të ndërtimit, **c)** rreth 71% në sektorin e prodhimit të veshjeve.

237. Gratë e punësuar në Shqipëri në sektorin privat (Tab.4.3-INSTAT), në industrinë përpunuese, në industrinë tekstil-veshje, industrinë ushqimore, bujqësi, industrinë e këpucëve dhe lëkurëve dhe në shërbimet kolektive kanë kryesisht arsim 8-vjeçar dhe të mesëm, ndërkohë që niveli mesatar i pagave varion nga 11.000 - 25.000 Lek në muaj (afërsisht 250-270 \$ usd). Shpesh gratë e intervistuar ankohen për monotoni në vendin e punës dhe për nivel të ulët teknologjik, i cili kërkon një përqëndrim më të madh në vendin e punës. Këto mangësi ndikojnë në gjëndjen psiko-fizike të të punësuarve dhe në veçanti të femrave. Një tregues interesant i të punësuarave femra në këto sektorë është mosha e tyre e re, e cila varion nga 16-30 vjeç. Interesi i punëdhënësve për këtë kategori shpjegohet me shkathtësinë më të madhe të të punësuarave në këto mosha për të kryer më mirë përpunimin e materialeve dhe ambientimi më i shpejtë i tyre me vendin dhe mjetet e punës.

238. Përveç nivelit arsimor dhe marrjes së një kualifikimi profesional të kufizuar, në punësimin e femrave në këto kategori punësh ndikojnë dhe disa faktorë subjektive të tillë si, niveli i papunësisë, faktori ekonomik, patriarkalizmi i shoqërisë shqiptare dhe ndikimi i autoritetit familjar që i detyron gratë të punësohen në sektorë të vështirë. Në këtë aspekt ndikojnë gjithashtu, nevoja për integrim e të shpërngulurve në zonat më të civilizuar dhe aftësitë e kufizuara të personave për një arsimim në nivelin mesatar.

239. Programet për Nxitjen e Punësimit. Aplikimi i projekteve të programeve të punësimit dhe në veçanti i atyre të formimit nëpërmjet punësimit është një nga format e zbutjes së tregut informal të punës. I tillë është dhe programi për nxitjen e punësimit të punëkërkesve të papunë femra, i cili është përgatitur në kuadrin e objektivit që ka Qeveria Shqiptare për zhvillimin e politikave sociale aktive nëpërmjet nxitjes së punësimit. Ky program synon të nxisë drejtuesit dhe manaxheret shqiptarë që të bëjnë përpjekje për të punësuar në afate të ndryshme punëkërkes të papunë femra. Programi është hartuar në zbatim të Strategjisë së Punësimit dhe Formimit Profesional miratuar me VKM nr. 67, datë 10.01.2003. Në programet e nxitjes së punësimit që janë zbatuar tre vitet e fundit, MPCSSH B i ka trajtuar me prioritet gratë.

240. Duke e konsideruar të lartë nivelin e papunësisë tek femrat, pavarësisht nga pjesëmarrja e gjërë të tyre në programet e nxitjes së punësimit, MPCSSH B ka marrë masa konkrete për zbatimin e politikave aktive për punësimin e grave. Programi i nxitjes së punësimit synon punësimin e femrave të papuna dhe nxitjen e punëdhënësve për të marrë në punë punëkërkes të papunë femra. Megjithëse në dukje kjo përbën një diskriminim për meshkujt, në realitet i përgjigjet zgjidhjes së situatës së papunësisë së lartë tek femrat. Mbështetja konsiston në financimin e masës së detyrimeve për sigurime shoqërore, kurse për femrat mbi 35 vjeç, të trafikuarat, gratë nga komuniteti rom dhe femrat me aftësi të kufizuara bëhet kompensimi për një pjesë të pagës deri në nivelin e pagës minimale. Ky program mbështetet nga buxheti i shtetit për MPCSSH B dhe ka filluar zbatimin e tij pas 1 janarit 2004. Programi synon punësimin afatgjatë, duke nxitur punëdhënësit të aktivizohen për të zgjedhur krahë pune të rregullt. Punëkërkesit e papunë femra përfshihen në aktivitete konkrete ku kanë mundësi: **(a)** të punësohen përkohësisht dhe të përfitojnë më shumë të ardhura; **(b)** të përfitojnë kualifikim nëpërmjet punës; **(c)** të kenë shanse reale për punësim, nëqoftëse tregojnë aftësi të mira për punë e biznes.

241. Duke llogaritur përdorimin me efektivitet të fondeve për ndihmë ekonomike, pagesën e papunësisë, subvencionet e buxhetit të shtetit për fondet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore, si dhe përfitimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta financiare kostoja reale e këtij programi është më e ulët se sa ajo që i korrespondon shpenzimeve të dukshme për zbatimin e tij. Nga ana tjetër, përfitimet ekonomiko-sociale janë të mëdha duke patur parasysh situatën kritike në fushën e papunësisë dhe varfërisë. Nga zbatimi i programeve të nxitjes së punësimit dhe kryesisht i programit për punëkërkesit e papunë femra në vitin 2004 u punësuan rreth 1200 femra, të cilat vazhduan edhe për vitin 2005, kurse në vitin 2006 u punësuan 2040 femra, pra 92% e totalit të punësimeve nga këto programe. (Tab. 4.5 - INSTAT)

242. Në Shqipëri grave u garantohen mundësi të barabarta punësimi dhe kjo reflektohet edhe në konkurrencën e hapur për pozicione në sektorin shtetëror, ose privat. Megjithatë, në sektorin privat kjo varet shumë nga preferencat e punëdhënësit. Femrat e punësuar aktualisht zenë 46% të totalit të punësimeve. Analiza e nivelit të punësimeve ndër vite tregon se, gjatë gjithë periudhës 1993-2007 niveli i punësimit të femrave ka qënë dukshëm më i ulët se ai i meshkujve. Kjo diferencë vazhdon të ruhet dhe të qëndrojë në të njëjtat nivele. Si pasojë e lëvizjes rurale urbane që vazhdon edhe në ditët e sotme, për femrat që kanë emigruar krijohen vështirësi për të hyrë në tregun urban të punës. Në industrinë përpunuese përfaqësimi i tyre është në masën 68%, në shërbime 58%, në banka, arsim dhe shëndetsi 54%, ndërsa në ndërtim 18%.

243. Për numrin e të punësuarve sipas grupmoshave mund të thuhet që, në grupmoshën 16-25 vjeç të punësuarit me arsim 8 vjeçar zenë përqindjen më të madhe dhe numri i femrave të punësuar është më i lartë. Në grupmoshat e mëdha numri i të punësuarve me arsim të lartë është më i madh dhe këtu shumica janë femra. Kjo flet për vështirësitë që has moshë e re për të hyrë në mënyrë të suksesshme në tregun e punës. Përveç kësaj, hyrjet e reja në tregun e punës ndodhin në masë deri në moshën 30 vjeç, si për meshkujt ashtu dhe për femrat. Kjo ka bërë që niveli i pjesëmarrjes në punë i moshave të rritura të vijë duke rënë dhe niveli i pjesëmarrjes në punë i moshave të reja të vijë duke u rritur. Shkak për këtë bëhet tendenca në rritje e kësaj moshe për të fituar të mira materiale nëpërmjet punës dhe për rrjedhojë një tendencë në ulje për të studiuar. Ky fenomen është më i theksuar tek meshkujt.

244. Disproporcione vihen re në pjesëmarrjen e femrave në punë në nivele të ndryshme të administratës publike qendrore dhe lokale. Femrat zenë 40% të të punësuarve në ministritë dhe në institucionet e tjera të larta shtetërore. Ndërsa në administratën lokale përqindja që zenë femrat është më e ulët (31.6%). Kjo pjesëmarrje është disi më e lartë në bashkitë, ku femrat zenë rreth 45% të të punësuarve. Ndërkohë që në komuna pjesëmarrja e femrave në administratën publike është 22%, në prefektura ato zenë 24% të të punësuarve të këtij sektori. (Tab.4.4-INSTAT). Aktivitetet ku femrat e zonës urbane zenë përqindjen më të madhe në punësim janë: 64% në arsim, 77% në shëndetsi, ndërsa në sektorët e industrisë, hoteleri dhe restorante dominuese është prezenca e meshkujve. Kjo e fundit është më e theksuar në zonat e tjera urbane, ndërsa në Tiranë vetëm 18% punojnë në industri. Kurse në zonën rurale, femrat zenë 52.6% të numrit total të të punësuarve në bujqësi.

245. Gratë që janë vendosur vitet e fundit në qytetet kryesore nëpërmjet emigrimit të brëndshëm, si dhe gratë rome që jo rallë kanë manifestuar mungesë të theksuar aftësish për të rritur nivelin e tyre profesional, janë ndihmuar me anë të kurseve të trainimit për rrobaqepësi dhe kurseve për përpunimin e produkteve bujqësore. Në Shërbimin Shtetëror Shoqëror funksionon një njësi, e cila punon për të përmirësuar nivelin e shkrim leximit për gratë dhe fëmijët romë. Të mbështetura nga OJF-të këto gra kanë mundur të integrohen në tregun e punës.

246 Në kushtet e lulëzimit të ekonomisë jo formale shumë femra shqiptare kanë filluar të punojnë në shtëpi, por nuk dihet mirë se cilat janë kushtet në të cilat ato ushtrojnë aftësitë e tyre. Ashtu si Finlanda, Irlanda dhe Holanda, Shqipëria ka ratifikuar Konventën 177 të ILO-s "Për Punën në Shtëp", e cila rekomandon hartimin e një politike kombëtare për këtë lloj punësimi, me qëllim që të përmirësohen kushtet e personave që punojnë në shtëpi, ku siç dihet shumica janë femra. Megjithatë, për hapat që duhen ndërmarrë për zbatimin e rekomandimeve të kësaj Konvente duhen bërë fushata të veçanta.

(c) Zgjedhja e lirë e profesionit; kritere të njëjta për promovimin dhe përfitimet, përfshirë trainimin profesional dhe rikualifikimet e pandërprera.

247. Gratë në mjaft rajone kanë mbetur prapa burrave në arritjet e edukimit në të gjitha nivelet. Megjithëse në pjesën më të madhe sistemet e edukimit formal janë bazuar në principet e krijimit të mundësive të barabarta me pjesëmarrjen e djemve dhe të vajzave, në realitet në vendet që janë duke u zhvilluar kjo shoqërohet me diferenca të dukshme. Mundësitë për t'u zhvilluar shpesh herë janë në varësi të

përkatësisë gjinore. Kudo roli i përcaktuar i grave është të martohen dhe të bëjnë fëmijë, prandaj edukimi mund të mos jetë në vëmendje, ose i dëshiruar për vajzat. Përveç kësaj, shumë prindër shikojnë me përparësi formimin profesional. Kjo shpjegohet dhe me faktin se, gratë nuk shpresojnë të sigurojnë një vënd të mirë punësimi dhe si pasojë bie interesi dhe rezulton e vogël nevoja për të marrë masa për të arritur një nivel të lartë edukimi.

248. Nevojat në rritje të tregut të punës për njerëz të kualifikuar dhe për profesione të reja në përshtatje me zhvillimet aktuale të ekonomisë kanë bërë të domosdoshme rritjen e numrit dhe të cilësisë së trainimeve. Tregues konkret është kujdesi nga ana e Qeverisë për rikonstruktimin dhe vënien në funksionim të qendrave të reja publike të formimit profesional brënda këtij viti në rrethet Fier dhe Elbasan. Qeveria ka mbështetur krijimin e kapaciteteve për formim profesional në sasi dhe cilësi, nëpërmjet zhvillimit të sistemit të formimit profesional publik. Kurset për edukimin profesional liçensohen nga MPÇSSHB.

249. Aktualisht, funksionojnë 10 Drejtori Rajonale të Formimit Profesional Publik, (DRFPP) dhe konkretisht: DRFPP nr.1 dhe nr.4 në Tiranë, DRFPP në Shkodër, në Elbasan, Korçë, Durrës, Vlorë, Fier, Gjirokastër dhe Qendra e Lëvizshme e Formimit Profesional Publik për Zonën Verilindore të vendit. Këto drejtori ofrojnë kurse të profesioneve, kryesisht për kategorinë e punëkërkuësve të papunë, si dhe për persona të tjerë të moshave dhe niveleve arsimore të ndryshme, që duan të vazhdojnë këto kurse dhe të marrin një profesion të caktuar, që janë të shkëputur nga puna për arsye ristrukturimi, ose që duan të mbajnë vendin e punës nëpërmjet zhvillimit të njohurive dhe kapaciteteve. Drejtoria e Marrëdhënieve të Punës rregullon zgjidhjen e konfliktit dhe merr përsipër marrëveshjet me sektorin privat dhe sindikatat dhe kjo ka ndihmuar në zgjidhjen e çështjeve konfliktuale për individët me paaftësi dhe ata që punojnë në sektorë të vështirë si, minatorët, pilotët, etj. Kurse trainimi për barazinë gjinore ka organizuar edhe Instituti i Trainimit të Administratës Publike (ITAP). Në rrethin e nënpunësve që trainohen nga ITAP bën pjesë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Projektet e Donatorëve të huaj për Formimin Profesional.

250. Donatorët e huaj kanë dhënë dhe japin një kontribut të madh në mbështetje të sistemit të formimit profesional në Shqipëri. Aktualisht formimi profesional është vlerësuar nga ana e Qeverisë si prioritet dhe kjo është e materializuar në ndihmat që Shqipëria merr nga BE në kuadrin e *Programit CARDS*, “*Mbështetje për reformën në fushën e AFP*”. Në bashkëpunim me MPÇSSHB është krijuar Agjensia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP), e cila mbështetet nga një projekt binjakëzimi i financuar nga *Programi CARDS* në vitin 2004. Kjo Agjensi është një institucion shumë i rëndësishëm në fushën e arsimit dhe formimit profesional dhe po luan një rol të madh në reformën e nisur në këtë drejtim. Edhe MASH po bashkëpunon ngushtësisht në Projektin e binjakëzimit duke mbështetur këtë Agjensi për fuqizimin e saj dhe për rritjen e efektivitetit të Këshillit Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional. MASH po bashkëpunon gjithashtu edhe në Projektin “*Mbështetje për reformën në fushën e AFP -Faza II*”, i cili financohet nga BE në kuadrin e *Programit CARDS*. Në funksion të këtij projekti janë duke u hartuar Korniza Shqiptare e Kualifikimeve dhe Ligji përkatës.

251. Bazuar tek *Projekti "AlbVET"*, i cili financohet nga qeveria zvicerane, MPÇSSHB ka krijuar Qendrën e Lëvizshme të Formimit Profesional për zonën verilindore, e cila është një zonë me nivel të lartë papunësie. Kjo qendër ka filluar aktivitetin duke synuar ofrimin e shërbimit të formimit profesional me kurse profesionale të kërkuara në tregun e punës dhe duke iu ardhur në ndihmë punëkërkuësve të papunë me qëllim integrimin e tyre në tregun e punës. Kjo është realizuar duke hapur kurse të ndryshme aftësimi profesional të tilla si, kursi i hidraulikës, rrobaqepësisë, instalimeve elektrike, riparimeve elektroshtëpiake dhe parukerisë. Këto kurse qarkullojnë çdo 6 muaj nga njëri rajon në tjetrin. Edhe qeveria gjermane nëpërmjet *Fondacionit PARSH* ka financuar për zbatimin e projektit "Të mësuarit gjatë gjithë jetës". Nëpërmjet zbatimit të këtyre projekteve donatorët e ndryshëm realisht kanë ndihmuar në përmirësimin e sistemit të formimit profesional dhe në zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me sigurimin e paisjeve, zhvillimin e kurrikulave, kurset e trainerëve, hartimin e standarteve etj.

Formimi Profesional në Qendrat Publike

252. Me fonde të buxhetit të shtetit po vazhdon puna e nisur në drejtim të investimeve për zgjerimin e rrjetit të qendrave publike të formimit profesional. Krahas qendrave në qytetet e Elbasanit dhe Fierit po punohet për ngritjen e tyre edhe në qytetet e Durrësit dhe Gjirokastrës, kurse në bashkëpunim me Projektin "*Mbështetje për Reformën në fushën e AFP - Faza II*" po rikonstruhet qendra e formimit profesional në qytetin e Korçës. Gjatë vitit 2006 janë trainuar 6200 persona, nga të cilët 3700 femra. Tendencat e vitit 2007 ka qënë hapja e kurseve të reja për ato profesione, të cilat afrojnë mundësi më të mëdha për punësim pas përfundimit të kursit. Të tilla kurse për profesionet hidraulik, elektrikist, rrobaqepës, kuzhinier etj janë hapur në Gjirokastrë, Elbasan, Tiranë, Vlorë etj. Në vitin 2007 në këto kurse janë regjistruar 7400 persona. Në përfundim u çertifikuan 7028 persona, nga të cilët 1700 kanë qënë punëkërkuës të papunë. Nga grupet e veçanta janë trainuar 72 romë, 35 jetimë, 10 femra të trafikuar dhe 29 me aftësi të kufizuara. Kurset e formimit profesional publik janë frekuentuar nga 4923 persona të moshës 16-24 vjeç, të cilët përbëjnë 66.5% të numrit total të personave të trainuar. Gjatë vitit 2007 janë trainuar 3899 femra, ose 53% e totalit. Mosha 25-34 vjeç përbën 20% të totalit, kurse mosha mbi 34 vjeç ze vetëm 13.5% të totalit. Sipas nivelit arsimor, peshën më të madhe të personave që ndjekin formimin profesional publik e ze arsimit i mesëm me 3400 persona, (ose 46% e totalit), më pas vijon arsimi 8-vjeçar me 2032 (28 %) dhe ai i lartë me 1968 persona (26 %).

Formimi Profesional Privat

253. Në shkallë vendi, për periudhën janar-dhjetor 2007 janë licensuar 166 subjekte. Nga këto, 92 janë rilicensime dhe 74 janë licensime. Nga totali i subjekteve të licesuara, ajo që bie në sy është fakti që 100 prej tyre (ose 60.2%) janë licensime për parukeri-estetikë. Në kurset e parukeri-estetikës janë trainuar e çertifikuar 1921 persona (ose 23% e totalit), për kompjuter janë trainuar 2378 persona (ose 28.5%), për gjuhë të huaj 1545 persona (18.6%) dhe pjesa tjetër janë trainuar për kurse të ndryshme në fushën e turizmit, konfeksioneve, industrisë mekanike, kurse sociale etj.

254. Për periudhën janar-dhjetor 2007, në qendrat private janë trainuar 8308 persona, nga të cilat 5421 janë femra (65% të totalit) dhe 5204 janë të papunë (63%). Mosha deri 21 vjeç ze 45.4% (ose 3777 persona), kurse mosha 21-34 vjeç ze 41.2%

(ose 3426 persona). Personat me arsim të mesëm përbëjnë 44% të totalit, me arsim 8-vjecar 35.1% dhe ata me arsim të lartë 20.6%. Pjesa më e madhe e subjekteve të licensuara (86, ose 51.8% e totalit) janë në Tiranë. Nga totali i subjekteve të licensuara në Tiranë, vetëm në parukeri-estetikë janë 51 subjekte, ose 57.3% e totalit në raport me Tiranën. Në subjektet private në Tiranë janë trainuar 4037 persona, ose 48.5% e totalit në raport me trainimin në shkallë vendi.

255. Rritja e nivelit të punësimit dhe e pjesëmarrjes së femrave në forcat e punës është arritur nëpërmjet:

- Formave të ndryshme motivuese dhe mbështetëse, siç janë trainimet për profesione të reja që kërkohen nga tregu i punës, nxitja e hapjes së bizneseve të vogla etj.
- Njohjes më të mirë të problemit të papunësisë tek gratë dhe burrat nëpërmjet sigurimit të të dhënave të plota e të sakta, ç'ka ka bërë që të identifikohet më mirë kontigjenti i të papunëve femra dhe meshkuj, niveli i arsimit dhe karakteristika të tjera të tyre. Kjo ka mundësuar dhënien e përgjigjeve më efikase dhe hartimin e programeve më të suksesshme për punësimin e tyre.
- Mbajtja parasysh e perspektivës gjinore në fushën e formimit profesional ka bërë që të vijë duke u rritur numri i grave dhe vajzave prezente në tregun e punës.
- Zgjerimit të mundësive për kreditim nëpërmjet krijimit të lehtësirave, në veçanti për gratë është konsideruar si një mënyrë efikase për stimulimin e bizneseve në sektorin bujqësor dhe jo bujqësor dhe për rritjen e numrit të grave që drejtojnë këto biznese. Për të monitoruar progresin e këtyre programeve janë hartuar programe të përbashkëta midis MPÇSSHB, Ministrisë së Ekonomisë dhe Energjitikës, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Bujqësisë, në bashkëpunim edhe me Agjensitë Ndërkombëtare.

256. Në përgjithësi, avancimi në karierrë është më i vështirë për gratë dhe në disa raste nuk bazohen kritere që lidhen me profesionin. Psh. Në sektorin e arsimit, mësuesit/et rekrutohen nëpërmjet procedurave të konkurimit, të cilat krijojnë mundësi që të vlerësohen aftësitë individuale profesionale, por kur vjen rasti për t'u bërë drejtorë shkolle nuk organizohen procedura konkursi. Çështja është se, në përfundim rezultojnë më shumë drejtorë burra, kurse gratë në numrin më të madh të tyre janë mësuese. Megjithatë, ligji "Për statusin e nëpunësit civil", (kreu IV i nenit 15) parashikon zhvillimin e karrierës duke përfshirë ngritjen në detyrë për nëpunësit civilë pa bërë dallim seksi. Ky ligj përcakton dhe procedurat për ngritjen në detyrë nëpërmjet konkurimit.

(d) Pagesë e njëjtë për punë të njëjtë.

257. Në mjaft rajone sektori informal rivalizon në punësim dhe në pagë sektorin formal, duke qënë një burim pune si për burrat, ashtu dhe për gratë, të cilat janë më prezente në sektorin informal. Punësimi për gratë në sektorin informal bëhet më tepër në vënde pune, të cilat janë të pa sigurta dhe nuk garantojnë një punësim me kohë të plotë, por gjenerojnë të ardhura të ulta dhe produktivitet relativisht të ulët. Problemi *de facto* që evidentohet është pjesëmarrja e ulët e gruas në poste drejtuese. Pavarësisht nga fakti që femrat janë të arsimuara dhe të kualifikuara, në përgjithësi, vëndet drejtuese në sektorin publik, por edhe atë privat i mbajnë burrat, të cilët rrjedhimisht do të kenë

edhe shpërblimin më të lartë. *De facto* gratë punojnë në sektorë ku shpërblimi është më i ulët. (Tab.4.6-INSTAT). Ato punojnë në punë të tilla si infermiere, punonjëse në sistemin parashkollor, mësuese në arsimin nëntëvjeçar dhe atë të mesëm, kurse në sektorin privat në përgjithësi bëjnë punë që janë më pak të paguara.

(e) Sigurimet shoqërore dhe përfitime të tjera..

258. Përsa i përket sigurimeve shoqërore dhe përfitimeve prej tyre, Kushtetuta e RSH i garanton kujtdo të drejtën e përfitimeve nga sigurimet shoqërore me mbushjen e moshës së pensionit, ose në rast paaftësie për punë, ashtu siç garanton edhe përfitimet në rast papunësie. Ligji për Sigurimet Shoqërore ndjek të njëjtën linjë, ndonëse bën një dallim përsa i përket pagesës së kompensimit dhe përfitimeve nga sigurimet shoqërore për barrë lindje, ku përfshihen shtatzania dhe periudha pas lindjes së fëmijës, të cilat gjejnë aplikim vetëm për gratë.

259. Leja e lindjes është një element tjetër dallues midis punonjëseve femra dhe atyre meshkuj. Legjislacioni shqiptar nuk jep leje lindje për babanë, ndonëse njeh të drejtën e pushimit 3 ditor për baballarët e rinj. Ndërkohë pushimet e tjera dhe pushimet vjetore zbatohen njëjloj si për burrat, ashtu dhe për gratë. Shëmbull tjetër i trajtimit të ndryshëm të burrave dhe grave është edhe neni 31 i ligjit “Për Sigurimet Shoqërore”, i cili përcakton se, personat e siguruar kanë të drejtë të marrin pensionin e plotë të pleqërisë me mbushjen e moshës 65-vjeçare për burrat dhe 60 për gratë. Vjetërsia në punë është e njëjtë për të dy gjinitë (35 vjet punë). Pra, që të gëzojë pension të plotë, individi duhet të ketë paguar të paktën për 35 vjet kontribute në skemën e sigurimeve shoqërore.

260. Duke marrë parasysh kushtet familjare dhe rolin e gruas në familje, ligji parashikon disa dallime të tjera në favor të grave. Konkretisht, nënat që kanë lindur 6 fëmijë e sipër dhe që kanë plotësuar 30 vjet punë mund të dalin në pension 10 vjet përpara, pra qysh në moshën 50 vjeç. Një dallim tjetër është edhe pensioni familjar që i jepet gruas së ve kur ka arritur moshën 50 vjeç dhe në të njëjtën kohë nuk përmbush as kushtet për të dalë në pension nga puna e saj. Kurse burri i ve merr pension nga puna e bashkëshortes së tij, vetëm pasi të ketë plotësuar moshën 60 vjeç. Përsa i takon papunësisë, sëmundjeve, apo invaliditetit mund të thuhet që nuk ka diferencime midis gjinive.

261. Legjislacioni shqiptar parashikon mbrojtjen e veçantë të shtetit për nënat e reja dhe gratë shtatzëna. Sipas Kodit të Punës shtatzania nuk duhet të përbëjë shkak për diskriminim në fushën e punës. Kështu, psh. neni 105/a ndalon kryerjen e testeve të shtatzanisë përpara marrjes së gruas në punë. Për më tepër, kur gruaja pushohet nga puna gjatë periudhës së shtatzanisë, ose pas kthimit nga leja e lindjes përgjegjësia dhe detyrimi i mbetet punëdhënësit për të bindur gjykatën, për faktin që prishja e kontratës nuk ka ardhur si pasojë e shtatzanisë, apo e lindjes së fëmijëve.

(f) E drejta për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në kushtet e punës, duke përfshirë sigurimin e funksionit të riprodhimit.

262. Kodi i Punës i ndalon punëdhënësit vendosjen e punonjëses në kushte të vështira dhe të rrezikshme për shtatzaninë, apo fëmijën e saj. VKM nr. 207, datë, 09.05.2002 “Për përcaktimin e punëve të vështira, ose të rrezikshme” përcakton pikërisht listën e

punëve të vështira dhe të rrezikshme. Sipas këtij vendimi, vetëm punonjësit që paraqesin çertifikatë mjekësore dhe për të cilët evidentohet që klinikisht janë shëndoshë mund të punësohen në punë të tilla. Leja e lindjes llogaritet si vit pune për gruan dhe ajo nuk e humbet vjetërsinë në punë për shkak të shtatzanisë, apo të lindjes së fëmijës.

263. Në Shqipëri gratë janë të angazhuara si në familje, ashtu dhe në shoqëri, por duhet thënë se një angazhim i tillë vihet re më tepër në zonat urbane. Nga ana tjetër, roli i tyre është shumë i rëndësishëm në aspektin prodhues e riprodhues, prandaj në këtë këndvështrim Inspektorati i Punës mbikqyr respektimin e legjislacionit që ka të bëjë me kushtet e punës dhe sigurimin e shëndetit të tyre. Kodi i rishikuar i Punës ka përmirësuar masat për mbrojtjen e punëtorëve, të grave dhe sidomos të grave shtatzëna. Kapitulli 10 i këtij Kodi mbron veçanërisht gratë shtatzëna dhe ato që kanë fëmijën në gji dhe ndalon për gratë shtatzëna punët në turnin e natës. Megjithatë, ka raste që gratë shtatzëna iu nënshtrohen kushteve të këqija të punës dhe presioneve nga familjet e tyre, për të bërë punë suplementare.

264. Lidhur me ngacmimin seksual në vëndin e punës legjislacioni shqiptar e trajton këtë çështje në Kodin e Punës dhe në ligjin "Për barazinë gjinore në shoqëri". Megjithëse në Kodin e Punës është e përfshirë një dispozitë për ngacmimin seksual në vëndin e punës përsëri nuk ekzistojnë procedura të saktësuar, ku të përcaktohet se si mund të nisat procedura në një rast ngacmimi seksual në vëndin e punës. Përveç kësaj, nuk ka të dhëna statistikore zyrtare që të tregojnë nëse këto çështje kanë shkuar dhe janë zgjidhur, ose jo, në gjykatë. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se këto raste nuk ekzistojnë. Në media disa herë është shkruar për fenomenin dhe mënyrën se si trajtohet kjo çështje nga opinioni publik dhe nga legjislacioni.

265. Kodi i Punës në nenin 32, paragrafi 3 jep përkufizimin e ngacmimit seksual në vëndin e punës sipas të cilit, "*Me shqetësim seksual kuptohet çdo shqetësim që dëmton në mënyrë të dukshme gjëndjen psikologjike të punëmarrësit për shkak të seksit*". Punëdhënësi ndalohet të kryejë çdo veprim që përbën shqetësim seksual karshi punëmarrësit dhe nuk lejon kryerjen e veprimeve të tilla nga punëmarrësit e tjerë. Gjithashtu, projekt-ligji i ri "Për Barazinë Gjinore" ka dispozita të veçanta, ku parashikohen mbrojtja e punëmarrësit nga diskriminimi, ngacmimet dhe shqetësimet seksuale në vëndin e punës, veçanërisht në institucionet arsimore.

266. Vështirësitë që hasen në gjetjen e një vendi pune i dekurajojnë gratë në drejtim të raportimit në rastet e ngacmimeve seksuale. Gratë nuk janë shumë të ndërgjegjësuar për faktin që, ligji i mbron ato nëqoftëse nga ana e tyre raportohen raste të tilla. Kodi i Punës ndalon shprehimisht çdo veprim nga ana e punëdhënësit që mund të konsiderohet ngacmim seksual i punonjësit dhe vendos mbi të parin detyrimin që punonjësi të jetë i mbrojtur prej ngacmimit seksual nga ana e punonjësve të tjerë. Ligji për Barazinë Gjinore detyron punëdhënësit të ndërmarrin masa disiplinore dhe masa të tjera organizative për të luftuar ngacmimin seksual ndaj punonjësve të tij.

2. Parandalimi i diskriminimit mbi bazë të martesës apo mëmësisë.

267. Megjithëse dispozitat ligjore ndalojnë diskriminimin mbi bazë të martesës ose mëmësisë, ka raste kur konstatohet që punëdhënësit refuzojnë të punësojnë gratë shtatzëna, ose venë kufizime për gratë në lidhje me lejen e lindjes.

(a) Moslejimi i largimit për arsye të shtatzanisë, lejes së lindjes, apo ndryshimit në statusin martesor.

268. Kodi i Punës i ndalon punëdhënësit të kërkojnë që gratë të bëjnë teste të shtatzanisë para punësimit, apo të ndërpresin kontratën e punës gjatë kohës kur gratë janë shtatzëna. Pra punëdhënësi duhet të presë derisa gratë të kthehen nga leja e lindjes. Për më tepër, neni 146 i Kodit të Punës, e konsideron të pajustificueshme prishjen e kontratës së punës për motive që lidhen me shtatzaninë, gjëndjen civile, detyrimet familjare, etj. Përsa i takon diskriminimit për shkak të martesës, ai nuk ekziston si fenomen dhe për këtë arsye kjo pikë nuk përmendet posaçërisht në legjislacionin shqiptar të punës. Sidoqoftë, neni 9 i Kodit të Punës e ndalon diskriminimin për shkak të lidhjeve familjare. Punëdhënësi nuk mund të mbledhë informacione personale për punëmarrësin, përveçse kur informacioni ka lidhje me aftësitë profesionale, ose nqs përmban të dhëna të rëndësishme që kanë të bëjnë me ekzekutimin e kontratës. Prishja e kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme është e pavlefshme dhe punëdhënësi i paguan punëmarrësit një dëmshpërblim të barabartë me pagën vjetore.

(b) E drejta për lejen e lindjes me pagesë dhe përfitime.

269. Legjislacioni shqiptar ofron mbrojtje të posaçme për funksionin riprodhues të grave. Puna 35 ditë përpara dhe 42 ditë pas lindjes së fëmijës është absolutisht e ndaluar dhe kur gruaja ka në barrë më shumë se një fëmijë, kjo periudhë është edhe më e gjatë. Pas kalimit të këtyre ditëve, punonjësja ka të drejtë të zgjedhë nëse dëshiron të kthehet në punë, apo të vazhdojë të kujdeset për fëmijën e saj. Nëse ajo zgjedh të dytën, punëdhënësi është i detyruar t'i ruajë vendin e punës për një periudhë 12-mujore. Leja iu garantohet edhe nënave që adoptojnë fëmijë.

(c) Masa mbështetëse sociale për të ndihmuar prindërit të ndajnë detyrimet në familje dhe punë.

270. Shërbimet shtetërore për kujdesin e fëmijëve mungojnë në shumë zona urbane dhe rurale. Ekzistojnë nisma private për kujdesin e fëmijëve, por këto nuk mbulojnë gjithë nevojat e komuniteteve. Fondacioni Soros, "Shoqëria e Hapur" ka ofruar trainime dhe ka hapur qendra për kujdesin e fëmijëve në shumë zona në Shqipëri. Programi i tyre mësimor është aprovuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

(d) Mbrojtja e grave shtatzëna në vendin e punës.

271. Drejtoria e Shëndetit Publik bën studime periodike për të përcaktuar punët që janë të dëmshme për shtatzaninë dhe publikon rezultatet e tyre për të ndihmuar institucionet shtetërore dhe private për marrjen e masave parandaluese në mbrojtje të shëndetit të grave shtatzëna.

3. Rishikimi legjislativ i masave mbrojtëse.

272. Përsa i përket shpeshtësisë së rishikimit të legjislacionit mbrojtës për të pasqyruar kërkimet dhe konkluzionet më të fundit shkencore mund të thuhet se, legjislacioni shqiptar mund të rishikohet dhe të përmirësohet më tej në mënyrë që të

përputhet gjithmonë e më shumë me kërkesat e Konventës CEDAW. Kështu psh, rishikimi i kategorive të vëndeve të punës që konsiderohen të rrezikshme për gratë, mund të bëhet në mënyrë më frekvente me iniciativën e ministrisë përkatëse, në bashkëpunim me OJF-të, apo organizatat ndërkombëtare.

Neni 12

KUJDESI SHËNDETSOR

Kuadri ligjor për kujdesin shëndetsor

273. Legjislacioni shqiptar i ofron mbështetje të posaçme dhe shërbime shëndetsore të veçanta nënës dhe fëmijës. Neni 55 i Kushtetutës shqiptare i garanton cilitdo të drejta të barabarta për kujdesin shëndetsor që ofrohet nga shteti. *“Të gjitha gratë shtatzëna përfitojnë falas ndjekjen periodike mjekësore të shtatzanisë, të lindjes dhe të paslindjes, veçanërisht ekzaminimet e paralindjes dhe të paslindjes, të detyrueshme, që caktohen me akt të Ministrit të Shëndetsisë.”*

274. Në Ligjin nr. 8876, datë, 04.04.2002, “Për Shëndetin Riprodhues”⁸ ka një dispozitë (neni 6) që përdor termin “diskriminim” dhe akordon dhënien e shërbimeve pa dallim gjinie, apo kategorie tjetër demografike. Konkretisht në nenin 6 thuhet që: *“Çdo grua, e lirë dhe e përjashtuar nga çdo formë diskriminimi, detyrimi dhe dhuna ka të drejtë për t’u kontrolluar e për të vendosur lirisht për të gjitha çështjet që lidhen me seksualitetin e saj dhe shëndetin seksual e riprodhues”*. Neni 8 i këtij ligji e përgjithëson më tej këtë parim duke përfshirë të dy sekset dhe për këtë thuhet që: *“Ky ligj i garanton çdo individ vendimmarrjen për ushtrimin e të drejtave riprodhuese sipas dëshirës dhe interesit të tyre, të lirë nga diskriminimi, detyrimi dhe dhuna.”* Ligji “Për Shëndetin Riprodhues” ofron mbështetje të veçantë për shërbimet e kujdesit shëndetsor për nënat dhe fëmijët (neni 13/2) dhe vizita kontrolli mjekësore periodike para dhe pas lindjes, sidomos kontrole të detyruara para dhe pas lindjes (neni 24/1). Ky ligj parashikon të drejtën e çdokujt për informacion, këshillim, edukim dhe shërbime sociale të nevojshme për një shëndet të mirë riprodhues.

275. Qëllimi i këtij ligji është njohja dhe pranimi i të drejtave riprodhuese, si dhe mbrojtja e shëndetit riprodhues të çdo individ. Ky ligj, i cili mbështetet në Kushtetutën e RSH, Konventën CEDAW dhe Konventën “Për të Drejtat e Fëmijëve” përcakton se, *“shëndeti riprodhues është pjesë e rëndësishme e shëndetit në përgjithësi. Ai jo vetëm që është një refleksion i masave për mbrojtjen e shëndetit gjatë adoleshencës dhe moshës së rritur, por përcakton dhe parimet bazë të kujdesit shëndetsor gjatë viteve riprodhuese për gratë dhe burrat”*. Ligji respekton edhe parimin e mosdiskriminimit të sanksionuar në Kushtetutë dhe dokumentet e rëndësishme ndërkombëtare. Ai ka edhe efekte të rëndësishme mbi gjeneratat e ardhshme. Neni 37 i ligjit, i cili bën fjalë për përdorimin e metodave të teknologjive riprodhuese të asistuara ndalon zgjedhjen e seksit të fëmijës, me përjashtim të rasteve kur ka mundësi për të trashëguar sëmundje të lidhura me seksin. Sipas nenit 10 paragrafi 2 të këtij ligji, *“Të gjithë individët dhe çiftet kanë të drejtë të përfitojnë shërbime të përshtatshme të kujdesit shëndetsor për të pasur shtatzani dhe lindje të sigurt dhe një fëmijë të shëndetshëm.”*

⁸ Ky akt ligjor nuk është pasqyruar në Raportin e I dhe të II të Kombinuar

276. Gjithashtu, në kreun VI, neni 37 thuhet se, gjatë përdorimit të teknologjive riprodhuese të asistuara nuk lejohet zgjedhja e seksit të ardhshëm të fëmijës dhe ky përcaktim ka lidhje përsëri, me zbatimin e parimit të mosdiskriminimit në bazë seksi. Gjithashtu, ligji përcakton se fëmijët e përfituar nëpërmjet metodave të ndryshme nga ajo natyrale nuk mund të përdoren për qëllime industriale, tregtare etj. Neni 11, paragrafi 3 i këtij ligji përcakton se, “Çdo grua ka të drejtë për mbrojtje shëndetsore gjatë shtatzanisë së saj, për asistencë gjatë lindjes dhe të përfitojë zbatimin e metodave dhe praktikave që minimizojnë rrezikun për shëndetin e saj, ose shëndetin e fetusit, të porsalindurit dhe të fëmijës.”.

277. Kurse neni 3/pika c parashikon dhënien e shërbimeve për edukimin e fëmijëve, adoleshentëve etj. Neni 7 i po këtij ligji parashikon mëmësi të sigurt, gjë që është e drejta e çdo gruaje për të marrë kujdesin që i nevojitet, në mënyrë që të gëzojë një shëndet të mirë gjatë shtatzanisë deri në lindjen e fëmijës. Po kështu, në disa nene thuhet se, adoleshentët dhe të rinjtë gezojnë të drejtën për informim dhe shërbime për shëndetin riprodhues, për informim dhe programe që synojnë në parandalimin e shtatzanive të padëshiruara, abuzimeve dhe për gjithçka që lidhet me sjelljen e tyre aktive seksuale në përputhje me moshën. Me anë të dispozitave të tilla ligjore, jo vetëm i atribuohet mbrojtje e veçantë fetusit, por garantohet lindje e sigurt dhe shëndet i mirë në vazhdimësi.

278. Ligji për mbrojtjen e ushqyerjes me gji është hartuar për të ç’inkurajuar zëvendësimin e qumështit të gjirit me atë artificial, për të rregulluar tregëtimin e ushqimeve për fëmijë dhe përhapjen e informacionit për përparësitë që ka ushqyerja me gji. Mbrojtja që i siguron legjislacioni shqiptar ushqyerjes me gji është relativisht e kufizuar dhe në përgjithësi ndihet nevoja e hartimit të dispozitave të reja, apo programeve bashkëkohore për t’iu siguruar ushqimin e përshtatshëm nënave të reja.

279. Deri në vitin 1992 ndërprerja e shtatzanisë ishte e paligjshme në Shqipëri, ndërsa tashmë aborti lejohet deri në javën e 12-të të shtatzanisë dhe pas kësaj periudhe, në varësi të shëndetit të nënës dhe fetusit nevojitet leje e veçantë që jepet nga një komision mjekësor i specilaizuar. Kodi Penal parashikon si sanksion deri në 5 vjet heqje lirie kur: **a).** shtatzania ndërpritet pa pëlqimin e gruas, **b).** kryhen aborte në mjedise të pa autorizuar, **c).** abortet kryhen nga persona të pa licensuar, **d).** si dhe kur gruas shtatzënë i jepen mjete të posaçme me qëllim që ajo të kryejë vetë ndërprerjen e shtatzanisë.

280. Disa nga këto aspekte trajtohen edhe në ato Konventa të ILO-s që ka ratifikuar Shqipëria, nga koha e dorëzimit të Raportit të Parë dhe të Dytë të Kombinuar. Ndër Konventat më të rëndësishme dhe që kanë lidhje direkte, ose indirekte me mbrojtjen e shëndetit të nënës dhe të fëmijës mund të përmenden:

Titulli i Konventës, Numuri, Viti, Data e ratifikimit

- Konventa për Mbrojtjen e Amësisë, 183-2000, 24.07.2004
- Konventa për Inspektimin e Punës, 81-1947, 18.08.2004
- Konventa për Punën në Shtëpi, 177-1996, 24.07.2004
- Konventa për Sigurinë dhe Ruajtjen e Shëndetit në Miniera, 176-1995, 03.03.2003

- Konventa për Parandalimin e Aksidenteve të Mëdha Industriale, 174-1993 03.03.2003
- Konventa për Punën me Kohë të Pjesshme, 175-1994, 03.03.2003
- Konventa për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë, 155-1981, 09.02.2004
- Konventa për Përfaqësuesit e Punonjësve, 135-971, 18.08.2004
- Konventa për Fiksimin e Moshës Minimale, 131-1970, 18.08.2004
- Konventa për Punën e Natës, 171-1990, 28.06.2004
- Konventa për Organizatat e Punëtorëve Ruralë, 141-1975, 18.08.2004
- Konventa për Mbrojtjen e Pretendimeve të Punonjësve, 173-1992, 03.02.2005

281. Në mars 2008, MSH ka kaluar për miratim në Qeveri ligjin bazë të sistemit shëndetsor, duke rinovuar ligjin nr. 766, datë 17.12.1963, “Për kujdesin shëndetsor në Republikën e Shqipërisë”. Përgatitja e këtij ligji është një domosdoshmëri dhe për arsyen e përfshirjes së Shqipërisë në procesin e stabilizim-asocimit, pasi ashtu si gjithë fushat e tjera dhe sektori i shëndetsisë ka për detyrim zbatimin e angazhimeve përkatëse dhe përafrimin e legjislacionit vëndas me atë të vendeve të BE-së.

282. Në projekt-ligjin “Për Kujdesin Shëndetsor në Republikën e Shqipërisë” (i përbërë nga 15 kapituj dhe 52 nene) parashikohen dispozita të përgjithshme, nëpërmjet të cilave jepet qëllimi i ligjit në zbatim të së drejtës kushtetuese të shtetasve vëndas dhe të huaj në RSH për mbrojtjen e shëndetit dhe për kujdesin shëndetsor, si dhe fusha e veprimit të sektorit të shëndetsisë. Gjithashtu trajtohen parime bazë të tilla si, e drejta për kujdes shëndetsor si e drejtë themelore e individit, efikasiteti dhe cilësia e shërbimeve të kujdesit shëndetsor, transparenca dhe mbrojtja e shtresave dhe grupeve të varfëra prej faktorëve të dëmshëm që lidhen me shëndetin.

283. Mjaft të rëndësishme janë parashikimet ku përcaktohen përgjegjësitë që kanë shteti dhe shtetasit, si dhe të drejtat e tyre në raport me sistemin e ofrimit dhe përfitimit të kujdesit shëndetsor në RSH. Këtu jepen dhe detyrimet e shtetasve, gjë e cila përbën një deklaram të ri të papërfaqësuar ndonjëherë më parë në legjislacionin shqiptar, duke përcaktuar përgjegjësitë që kanë për shëndetin e tyre personat rezidentë në RSH, si dhe detyrimin që kanë ata për të kontribuar në zhvillimin e kushteve të shëndetshme të jetesës nëpërmjet bashkëfinancimit.

284. Në këtë projekt-ligj jepet struktura dhe organizimi i sistemit shëndetsor si një sistem i integruar shërbimesh në të cilin bëjnë pjesë: kujdesi parësor i specializuar (outpatient), kujdesi spitalor, si dhe një sërë shërbimesh të tjera specifike të tilla si, shërbimi i urgjencës, shëndeti publik, sektori farmaceutik, mjekësia e punës, mjekësia e sportit, mjekësia alternative, shëndeti mendor, shërbimi dentar, shërbimi optik, etj. Njëkohësisht, përcaktohet mënyra e krijimit dhe organizimit të institucioneve shëndetsore, si një rrjet i planifikuar i institucioneve publike, private, apo formë tjetër pronësie, mbështetja për përgatitjen e planit të rrjetit të institucioneve, si dhe e drejta për themelimin e këtyre institucioneve. Gjithashtu, në këtë projekt-ligj përcaktohen edhe sektorët e shëndetsisë, në të cilat ndalohet ushtrimi i aktivitetit privat.

285. Në të njëjtën kohë janë parashikuar përcaktimi i standarteve për shërbimet e veçanta të kujdesit shëndetsor, miratimi dhe zbatimi i tyre, si dhe standartet që duhet të përmbushin institucionet për infrastrukturën ndërtimore, pajisjet mjekësore dhe

burimet njerëzore. Është parashikuar procesi i akreditimit të institucioneve prej Qendrës Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit, rregjistrimi i punonjësve të shëndetsisë, licensimi i institucioneve dhe punonjësve të tyre si një detyrim, i cili iu jep të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë mjekësore. Kjo përbën praktikisht diçka krejt të re për legjislacionin shqiptar dhe në përgjithësi për kujdesin shëndetsor në RSH. Ai trajton konceptin e *akreditimit*, i cili synon të përmirësojë performancën e dhënësve të kujdesit shëndetsor. Në të përcaktohet se, akreditimi është një proces i vazhdueshëm vlerësimi në mënyrë periodike, që synon ruajtjen e standarteve të larta në shërbimet shëndetsore që iu ofrohen individëve. Njëkohësisht, është parashikuar edhe detyrimi i Ministrisë së Shëndetsisë për krijimin dhe mbajtjen e një sistemi të përshtatshëm kombëtar në funksion të akreditimit.

286. Përveç këtyre, në këtë projekt-ligj parashikohet dhe rikonfirmohet një nga liritë e shtetasve, ajo për të zgjedhur vetë në mënyrë individuale dhënësin e shërbimeve të tyre shëndetsore, duke e vendosur pacientin shqiptar, ashtu si çdo shtetas i Europës, në pozita të barabarta në raport me të drejtat e tij për kujdesin shëndetsor. Rëndësi e veçantë i kushtohet përcaktimit të politikave shëndetsore për planifikimin dhe financimin e shërbimit shëndetsor. Në të përcaktohet përgjegjësia e Ministrisë së Shëndetsisë (MSH) për hartimin e strategjive afat mesme e afat gjata, për planet e veprimt, për vlerësimin e kostove dhe burimeve financiare e njerëzore.

287. Gjithashtu janë formuluar edhe disa Strategji të MSH, të cilat kanë në bazë të tyre parimet e mosdiskriminimit dhe të barazisë gjinore. Këtu mund të përmenden:

- Strategjia dhjetevjeçare për reformën në sistemin shëndetsor (2000-2010), në të cilën përcaktohen prioritetet dhe ndërhyrjet strategjike për përmirësimin e shëndetit të popullsisë. Në këtë strategji, përsëri prioritet i jepet përmirësimit të shëndetit të nënës dhe fëmijës.
- Strategjia kombëtare për HIV/AIDS, e cila synon mbajtjen e Shqipërisë si një vend me prevalencë të ulët për infeksionet seksualisht të transmetueshme.
- Strategjia e Promocionit dhe Edukimit Shëndetsor, ku përfshihen objektivat dhe aktivitetet për promocionin dhe edukimin shëndetsor, lidhur me shëndetin e nënës dhe fëmijës.

Masat për eliminimin e diskriminimit në fushën e kujdesit shëndetsor

1. Aksesit në kujdesin shëndetsor.

288. Aksesit në shërbimet e kujdesit shëndetsor është i njëjtë si për burrat, ashtu dhe për gratë. Në fakt, në disa raste legjislacioni është më bujar ndaj grave për arsye të specifikave të shëndetit të grave, duke përfshirë sëmundjet e organeve riprodhuese, ose ekzaminimet si mamografia, apo *Pap-testi*, të cilat ndihmojnë në diagnostikimin e sëmundjeve serioze.

289. Në përgjigje të protokolleve ndërkombëtare për mbrojtjen e shëndetit, institucionet e këtij sektori në Shqipëri kanë krijuar në vazhdimësi shërbime specifike për mbrojtjen e shëndetit të grave. Një nga këto shërbime specifike ofrohet nëpërmjet rrjetit të Konsultoreve të gruas, të cilat funksionojnë në të gjithë vendin. (Tab.5.4-INSTAT). Synimi kryesor gjithmonë ka qënë kalimi nga mjekësia kurative drejt asaj

parandaluese, duke i ndërgjegjësuar gratë që të marrin përgjegjësi për veten e tyre dhe në vijim të kontribuojnë aktivisht në ruajtjen e shëndetit. Në këtë kontekst, një rëndësi të veçantë kanë patur masat e programuara për të krijuar mundësinë e bashkërendimit të kërkesave të grave, jo vetëm në drejtim të jetës familjare, por edhe në ambientet e punës së tyre. Marrja e informacionit mbi kujdesin shëndetsor për meshkujt dhe femrat bëhet në shërbimet e publike të ofruara nga MSH dhe donatorët, ku bëjnë pjesë Organizata Ndërkombëtare të tilla si, UNFPA (United Nations Population Fund), USAID-i, UNICEF-i, si dhe OJF-të e ndryshme.

Gjëndja Shëndetsore e Gruas

290. Për Ministrinë e Shëndetsisë (MSH) mbrojtja e shëndetit të gruas, gjithmonë është konsideruar si një prioritet i punës së saj. Për këtë arsye, politikat dhe strategjitë e MSH të mbështetura dhe nga UNFPA, si një nga donatorët kryesorë në këtë fushë e vendosin gruan dhe vajzën në qendër të shërbimeve të shëndetit riprodhues, duke synuar të integrojnë këto shërbime në të tre nivelet e kujdesit shëndetsor, duke i dhënë prioritet kujdesit shëndetsor parësor. Përmirësimi i vazhdueshëm i shëndetit mbetet një sfidë e madhe si për gratë dhe vajzat, ashtu edhe për djemtë dhe burrat. Marrja e një kujdesi shëndetsor cilësor është faktor kyç për mirëqënien, zhvillimin dhe ecurinë e përgjithshme të të gjithë shoqërisë. Sfidë më e madhe në lidhje me paraqitjen e situatës dhe ndërthurjes së çështjeve të barazisë gjinore në shëndetësi qëndron në faktin që, nuk ka shumë të dhëna të ndara në bazë gjinore. Për këtë arsye, prezantimi i situatës së barazisë gjinore në shëndetësi bazohet kryesisht në raportimet jo të shpeshta dhe në informacionin e mbledhur në mënyrë jo sistematike, nga organizata të ndryshme me bazë komunitare apo jo-fitimprurëse.

291. Gratë në Shqipëri përfaqësojnë rreth 50,1% të popullsisë (Tab.2.1-INSTAT). Prej vitesh, Shqipëria është një nga shtetet që ka firmosur Planin e Veprimit të Konferencës Ndërkombëtare të Kajros mbi Popullsinë dhe Zhvillimin, i cili kërkonte që, *“vendi të zgjeronte integrimin e shëndetit riprodhues dhe shërbimet e kujdesit për fëmijët, duke përfshirë mëmësinë e sigurt për të gjithë popullsinë dhe veçanërisht për grupet më të prekshme dhe më pak të shërbyera”*. Bazuar në këtë plan veprimi, politikat dhe strategjitë e MSH e konsiderojnë shëndetin e gruas dhe të fëmijës si një pjesë shumë të rëndësishme të të drejtave njerëzore dhe e vendosin atë në qendër të shërbimeve të shëndetit riprodhues, duke synuar të integrojnë shërbimet që lidhen me shëndetin riprodhues në tre nivelet e kujdesit shëndetsor, me prioritet kujdesin shëndetsor parësor. Ministria e Shëndetsisë synon përmirësimin e vazhdueshëm të shëndetit të grave dhe fëmijëve dhe të cilësisë së jetës, duke ndikuar në uljen progresive të vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë së tyre.


292. Për të dhënë një tablo sa më të saktë për gjëndjen shëndetsore të gruas shtatzanë, në vijim janë marrë në konsideratë tregues të tillë si: fertiliteti, vdekshmëria amtare, abortet dhe strategjia e MSH për këtë çështje, kujdesi para lindjes dhe protokollit përkatës, kujdesi në lindje dhe pas saj, planifikimi familjar, ushqyerja me gji, infeksionet seksualisht të transmetueshme, si dhe problemet e shëndetit riprodhues.

Fertiliteti.

293. Shqipëria është një nga vendet me fertilitet të lartë në Europë. Para viteve 1990, treguesi i fertilitetit ka qënë mjaft i lartë rreth 6,9 dhe gjatë këtij dhjetëvjeçari ky tregues vazhdon të pësojë një ulje të ndjeshme nga 6,9 në vitet 1990, në 2.0 në vitin 2006, por përsëri duke mbetur një vënd me fertilitet të lartë. (Tab. 2.2, 2.3 dhe 2.4 – INSTAT). Sipasurvejimit mbi Shëndëtin riprodhues në Shqipëri të kryer nga MSH, Instituti i Shëndetit Publik, USAID, UNFPA dhe UNICEF, në vitin 2002 nivelet më të larta të fertilitetit në Shqipëri janë midis grave të moshave 20-24 vjeç dhe 25-29 vjeç, duke zënë respektivisht 33% dhe 32%, të indeksit total të fertilitetit (TFR - total fertility rate). Niveli i fertilitetit të adoleshentëve është shumë i ulët, vetëm 35 lindje gjallë për 1000 gra të moshës 15-19 vjeç, shifër e cila përbën 7% të nivelit total të fertilitetit. Megjithëse numri i lindjeve në vend vazhdon të pësojë një ulje të ndjeshme, mesatarisht me 5000-7000 lindje më pak në vit, Shqipëria vazhdon të ketë nivel të lartë lindshmërie në Europë (Tab.2.3 & 2.4 - INSTAT)

Vdekshmëria amtare

294. Një nga treguesit më domethënës të shëndetit të nënës është vdekshmëria amtare. Studimi i dinamikës së vdekshmërisë amtare flet për ulje të nivelit të saj nga viti në vit, duke arritur në 1/2 e nivelit të vitit 1990 (Tab. 5.2 & 5.3 - INSTAT). Konkretisht: sipas të dhënave të Drejtorisë së Statistikës Shëndetsore në MSH vdekshmëria amtare nga 50 për 100.000 lindje gjallë që ishte në vitin 1990, arriti në 22.3/100000 lindje gjallë në vitin 2005. Në vijim, në vitin 2006 ishte 16.7/100.000 lindje gjallë, kurse për vitin 2007, ky tregues ka qënë 14.6/100.000 lindje gjallë.



Burimi: M.Sh.

295. Shkaqet direkte të vdekjeve amtare të viteve të fundit në Shqipëri rezultojnë të jenë të njëjta me ato që raportohen në vënde të tjera të botës dhe konkretisht ndër to evidentohen: **1.** hemorragjia gjatë dhe pas lindjes, **2.** eklampsia, **3.** lindjet e vështira dhe patologjitë ekzistuese ku mbivendoset shtatzania. Shkaqet e tjera indirekte që ndikojnë mbi shëndetin amtar janë:

- Gjëndja shëndetsore dhe nutricionale e gruas që nga fëmijëria deri në periudhën e shtatzanisë.
- Njohuritë e pakta, qëndrimet, sjelljet e papërshtatshme të gruas, familjeve të tyre dhe komunitetit, lidhur me shëndetin.
- Statusi dhe pozita e vajzave dhe grave në shoqëri dhe familje, veçanërisht në zonat rurale .
- Niveli i aksesit të gruas për të përdorur shërbimet shëndetsore.

Abortet

296. Aktualisht ndërprerja e shtatzanisë është rregulluar me ligj. Gjatë dekadës së fundit, numri i aborteve të raportuara në MSH nga ana e institucioneve publike ka ardhur duke u reduktuar. Për vitin 2006 raporti i aborteve me lindjet ka qënë 1:4,1. Këtu duhet thënë se shifrat e raportuara të abortit fillimisht vinin vetëm nga institucionet shëndetsore publike dhe deri në vitin 2006 mungonin shifrat e aborteve që kryheshin në klinikat private. (Tab. 2.5 & 2.6 - INSTAT). Ministria e Shëndetsisë (MSH) në bashkëpunim më INSTAT dhe Institutin e Shëndetit Publik në korrik të vitit 2006 filloi punën për mbledhjen e informacionit mbi abortin edhe nga klinikat private që ofrojnë këtë shërbim. Aktualisht, çdo klinikë private në kriteret e saj për licensimin ka të detyrueshëm mbledhjen dhe raportimin e informacionit mbi abortet që janë kryer në ambientet e saj. Gjithashtu është ripunuar edhe skeda personale për abortin, e cila ka filluar të përdoret nga të gjitha institucionet publike dhe private në Shqipëri. Duke filluar nga viti 2008, në numrin total të aborteve të kryera në Shqipëri do të përlllogariten edhe ndërprerjet e kryera nga institucionet shëndetsore private.

297. Për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të kujdesit shëndetsor dhe për të ofruar abort të sigurt nga ana e MSH u hartua një strategji e veçantë, e cila ka këto synime:

- Përshtatjen e kujdesit për abortin e sigurt për çdo grua, sipas nevojave të saj sociale dhe individuale.
- Përmirësimin e punës për dhënien e këshillimit dhe informacionit të saktë që mbështet gratë në zgjedhjen e tyre. Përdorimin e teknologjive mjekësore të rekomanduara dhe bashkëkohore, veçanërisht aspirimi manual me vakum dhe aborti mjekësor.
- Aplikimin e standarteve bashkëkohore, duke vënë në zbatim protokolle të reja për parandalimin e infeksioneve, manaxhimin e dhimbjes, komplikacionet dhe elementet e tjera klinike të kujdesit.
- Zgjerimin e shërbimeve të planifikimit familjar pas abortit, përfshirë kontracepsionin e emergjencës për të ndihmuar gruan të parandalojë shtatzaninë e padëshiruar, të praktikojë hapësirën midis lindjeve dhe të mënjanojë abortet e përsëritura.
- Integrimin me shërbime të tjera të shëndetit riprodhues si, depistimi dhe diagnoza e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme (SST), këshillimi mbi dhunën, shërbimet speciale për adoleshentët, etj

Planifikimi Familjar

298. Pas vitit 1993, me miratimin e dhënë nga Qeveria, në Shqipëri filluan të ofrohen edhe Shërbimet e Planifikimit Familjar (PF). Qëllimi kryesor i ofrimit të këtyre shërbimeve ka qënë dhe mbetet përmirësimi i shëndetit të nënës dhe fëmijës, pasi PF luan rol në shëndetin riprodhues. Pas miratimit të aktiviteteve të PF është përpunuar një politikë dhe strategji në funksion të tij, e cila ndiqet dhe zbatohet në të gjithë vendin. (Tab. 5.5 – INSTAT). Protokollat dhe udhëzimet për PF janë hartuar dhe përdoren në të gjitha klinikat e specializuara për këtë qëllim.

299. Niveli i shërbimit parësor të PF përfaqësohet nga qendrat e PF në rrethe, të cilat janë hapur në 36 qytetet kryesore të vendit. Qendrat e PF janë të pajisura me mjete trainimi dhe staf të spacializuar për këtë shërbim. Gjithashtu, 28 maternitetet e spitaleve të vendit kanë të përfshirë brenda tyre shërbimin e PF dhe japin kontraktivë. Shërbimin e PF e ofrojnë dhe konsultoret e gruas në qytete. Ka më

shumë se një dekadë që kontraktivët shpërndahen falas në të gjithë shërbimet shëndetsore publike. Nga viti 1996 e në vazhdim, në të gjithë vendin ekziston dhe marketingu social i kontraktivëve.

300. Ministria e Shëndetsisë (MSH) në politikat e saj ka synuar shtrirjen e shërbimeve të PF në kujdesin shëndetsor parësor dhe veçanërisht në qendrat shëndetsore të zonave rurale. Për këtë qëllim, në bashkëpunim me donatorë dhe organizata ndërkombëtare si, UNFPA, USAID, Kryqi i Kuq Shqiptar, Amerikan, etj janë trainuar dhe vazhdojnë të trainohen mjekët e familjes dhe stafi infermiere - mami në nivel komune, lidhur me mënyrën e dhënies së këshillimit dhe ofrimit të metodave të kontraksionit. Gjithashtu, që nga viti 2003 në MSH është vendosur sistemi LMIS (menaxhimi i logjistikës së informacionit të kontraktivëve), i cili mbledh informacion nga 36 rrethet e vendit, lidhur me përdorimin e kontraktivëve, shpërndarjen e tyre, etj. Pjesa më e madhe e shërbimeve të PF, duke përfshirë informacionin për këto shërbime ofrohen falas, por jo të gjitha gratë përfitojnë nga këto shërbime, pasi ato nuk janë të sigurta që fshehtësia e tyre do të ruhet nga personeli shëndetsor. Gratë mund të shkojnë në vende të ndryshme nga vendi i banimit, atje ku ato nuk njihen për të marrë kontraktivë falas. Planifikimi familjar si një masë e lënies së hapësirave kohore midis fëmijëve nuk pranohet ende, sidomos nga burrat dhe për këtë temë duhet të bëhen më shumë fushata për rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit.

301. Sipas mendimit të femrave dhe meshkujve të moshave 15-44 vjeç, në lidhje me PF, vendimet për madhësinë e familjes duhet të merren kryesisht nga të dy bashkëshortët. Megjithatë, përqindja e burrave që bien dakort me këtë pohim është më e ulët se ajo e grave (afërsisht 96%, kundrejt 89%). Nuk ekzistojnë studime ku të raportohen diferenca gjinie për njohuritë dhe qëndrimet në lidhje me vendimet për fertilitetin. Megjithatë, këto tre vitet e fundit vihet re një përmirësim të situatës në lidhje me treguesit e përdorimit të metodave moderne të kontraksionit dhe vihet re që përqindja është rritur, nga 8% që ishte në vitin 2002, në 22% për vitin 2005 (sipas një studimi të INSTAT dhe UNICEF). Kjo ka qënë rezultat i politikave që janë zbatuar nga ana e MSH, për rritjen e cilësisë së shërbimeve të PF dhe zgjerimin e këtyre shërbimeve në zonat rurale. Po kështu numri i qendrave shëndetsore publike që ofrojnë shërbime të PF është trefishuar krahasuar me 5 vite më parë. Metodatat e kontraksionit në këto shërbime ofrohen falas.

Përdorimi i metodave kontraktive.

302. Në studimet e fundit që janë kryer mbi kontraksionin ka rezultuar që, 97% e personave ishin të ndërgjegjshëm për ndonjë metodë, 90% njihnin një metodë moderne dhe 84% metodën tradicionale. Studimi tregoi se, shkalla e njohjes së metodave kontraktive ishte relativisht e lartë respektivisht, 75% për gratë e martuara dhe 77% për burrat e martuar. Në vitet e para shkalla e përdorimit të metodave kontraktive moderne ka qënë në një nivel të ulët, rreth 8% (viti 2002)⁹ dhe burrat, në krahasim me gratë kanë patur një nivel më të ulët të përdorimit të kontraksionit modern.

303. Duke patur parasysh këto tregues të ulët për kontraksionin modern, MSH gjatë viteve 2003-2006 e në vazhdim ka hartuar një strategji ku janë parashikuar disa

⁹ Sipas vrojtimit MICS - 2005 të kryer nga INSTAT dhe UNICEF

ndërhyrje që synojnë: **a).** zgjerimin e shërbimeve të PF në zonat rurale, **b).** trainimin e personelit shëndetsor në drejtim të përdorimit të kontraktivëve modernë dhe **c).** realizimin e fushatave kombëtare promociuese në media dhe në komunitet, në lidhje me PF. Marrja e këtyre masave bëri që në dy vitet e fundit të rritet ndjeshëm numri i përdoruesve të metodave kontraktive moderne dhe numri i qendrave që ofrojnë shërbime të PF. Për vitin 2006 në shkallë vendi kishte 430 qendra të PF, nga 97 të tilla që kishte në vitin 2000. Në një studim të kryer nga UNICEF në vitin 2005 (MICS - Multi Indicator Cluster Survey) rezultoi që, përqindja e përdorimit të metodave kontraktive moderne të ishte rritur nga, 8% (që ishte në vitin 2002), në 23%.

304. Në vitin 2004 Shqipëria ka miratuar edhe Strategjinë Kombëtare për sigurinë kontraktive, e cila ka patur si synime kryesore:

- Sigurimin e kontraktivëve nëpërmjet furnizimit të garantuar afatgjatë me kontraktive cilësorë.
- Pavarësinë financiare, që nënkupton përballimin nga vendi me burimet e veta financiare të blerjes dhe sigurimit të kontraktivëve deri në vitin 2010. Duke filluar që nga viti 2005 kontraktivët që shpërndahen falas në shërbimet shëndetsore publike sigurohen edhe me kontributin financiar të shtetit shqiptar dhe në vitin 2010 ky kontribut do të arrijë në 100%.

305. Sidoqoftë, lidhur me aksesin në shërbimet e kujdesit shëndetsor për gratë ka akoma shumë vënd për përmirësime dhe kjo është e lidhur kryesisht me përmirësimin e vetë strukturës së shërbimit shëndetsor në tërësi. Sipas mendimit të specialistëve, aksesin i pamjaftueshëm për kujdesin shëndetsor, zakonisht justifikohet me faktin që sistemi i kujdesit shëndetsor është në krizë. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar dhe luftës kundër korrupsionit për të minimizuar dhe evituar sa më shumë rastet kur personeli mjekësor paguhet nën dorë, çka do të thotë që, jo për të gjithë pacientët manifestohet e njëjta vëmendje për kujdes shëndetsor.

2. Dhënia e shërbimeve falas dhe ushqyerja e duhur gjatë shtatzanisë dhe kohës së qumshtit (laktacioni)

Kujdesi para Lindjes (antenatal)

306. Synimi kryesor i kujdesit antenatal në Shqipëri, vazhdimisht ka qënë sigurimi i përkrahjes për gruan shtatzanë dhe dhënia e udhëzimeve të nevojshme jo vetëm për të, por edhe për partnerin e familjen e saj. Për këtë arsye bashkëshortëve iu është ofruar ndihmë në periudhën e tranzicionit, ndërkohë që ata presin të bëhen prindër. Protokollin e kujdesit të paralindjes në Shqipëri përfshin vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut nëpërmjet disa ekzaminimeve dhe analizave laboratorike, depistimin për infeksione seksualisht të transmetueshme, izoimunizimin Rhesus, edukimin shëndetsor për shënjat e rrezikut gjatë shtatzanisë, ushqyerjes me gji, etj. (Tab.5.7 - INSTAT)

307. Një tregues me rëndësi, që flet për përmirësimin e kujdesit të para lindjes, është rritja e numrit të grave shtatzëna, të cilat kanë marrë kujdes antenatal nga një personel i aftë mjekësor. Sipas një studimi të kryer në vitin 2002 për shëndetin riprodhues (RHS - reproductive health survey) rezultoi që, kujdesi para lindjes të ishte marrë nga nënat, në 81% të lindjeve që kishin ndodhur në intervalin kohor 1997–2002. Studimi MICS - INSTAT dhe UNICEF (MICS – Multi Indicator Cluster Survey) i kryer

në vitin 2005 rikonfirmoi përsëri këtë konstatim mbasi rezultoi që, 97.1% e grave kishin përfituar kujdes gjatë shtatzanisë nga një personel i aftë mjekësor. Kjo shifër është e njëjtë me atë të konstatuar në raportimet e bëra nga Departamenti i Teknologjisë dhe Informacionit Shëndetsor në MSH. Konkretisht, gjatë shtatzanisë kishin përfituar kujdes shëndetsor 97% e grave dhe nga këto, 43% i kishin filluar vizitat mjekësore në tremujorin e parë të shtatzanisë.

308. Kujdesi para lindjes jo vetëm që ka filluar herët, por në përputhje me standartet periodike që rekomandohen ai ka vazhduar gjatë gjithë shtatzanisë. Për të vlerësuar efikasitetin e kujdesit të ofruar në javët e fundit para lindjes është monitoruar koha e vizitës së parë dhe numri i vizitave të kujdesit para lindjes. Studimet e kryera nga UNICEF, UNFPA dhe USAID për vitet 2003-2007 treguan që, pjesa më e madhe e grave kanë kryer 1-3 vizita dhe numuri mesatar i vizitave para lindjes ishte rreth 3.

309. Një komponent me rëndësi në paketën e kujdesit para lindjes që ofrohet nga qendrat shëndetsore të kujdesit për nënën ka qënë dhe shpërndarja e informacionit shëndetsor. Gjatë këshillimit janë dhënë materiale informative për mënyrën e mbrojtjes së nënës ndaj ekspozimeve që mund të prekin shëndetin e fetusit, për ushqyerjen, pushimin, si dhe për shënjat dhe simptomat e hershme të komplikacioneve të shtatzanisë. Më tej, me afrimin e kohës së lindjes këshillimi ka patur si synim përgatitjen e gruas për situatën që ajo do të përballet gjatë lindjes, shpërndarjen e informacionit të saktë në lidhje me aktivitetin e lindjes dhe këshillimin e gruas mbi teknikat për të pakësuar dhimbjen dhe ankthin gjatë lindjes. Gjithashtu gjatë periudhës para lindjes grave ju janë dhënë këshilla rreth ushqyerjes me gji dhe planifikimit familjar pas lindjes.

Kujdesi në Lindje

310. Përsa i takon vëndit të lindjes, në Shqipëri rekomandohet që të gjitha lindjet të kryhen në institucionet shëndetsore nën kujdesin e personelit mjekësor të kualifikuar profesionalisht, i cili duhet të monitorojë përparimin e aktivitetit të lindjes dhe vetë aktin e lindjes. Për periudhën 2003-2007, sipas raportimeve të MSH rezultoi që, 93 % e lindjeve të jenë kryer në institucionet shëndetsore, ndërsa vetëm 7% e tyre në shtëpi. Nga lindjet në shtëpi rreth 6.8% janë me asistencë nga një personel mjekësor dhe 0.2% pa asnjë asistencë mjekësore. Studimet e kryera në vitin 2005 (MICS në vitin 2005) treguan të njëjtat rezultate, me ato të RHS ¹⁰ (Reproductive Health Survey) që ishte kryer më parë.

311. Sipas të dhënave të MSH, nga numri total i lindjeve për vitin 2006 (35.186) rezultoi që, në maternitetet e vëndit ishin kryer gjithsej 33134 lindje, nga të cilat 2081 ishin kryer në shtëpitë e lindjes të integruara në qendrat shëndetsore në fshat. Për vitet 2003-2007 rezultoi se, lindjet nën peshë (1000-2500 gr.) përbëjnë rreth 8.5% të të gjitha lindjeve. Lindjet e ndodhura në shtëpi mund të shpjegohen me:

- dëshirën e vetë nënës për të lindur në shtëpi, kur lindja është fiziologjike,
- lëvizjen e pakontrolluar të popullatës, e cila shpesh ndryshon adresat e për rrjedhojë nuk ndiqet dot nga mamia e patronazhit të zonës,
- mungesën e personelit të specializuar, sidomos mamitë në fshatra e në veçanti në zonat verilindore të vëndit,

¹⁰ Studimi i shëndetit riprodhues, ISHP & INSTAT - 2002

- kushtet jo të mira të shtëpive të lindjes që jo rallë kanë mungesa në ujë, ngrohje dhe energji elektrike.

Kujdesi pas lindjes (postnatal)

312. Një element me rëndësi në kujdesin për nënën ka qënë dhe ndjekja e saj në javët e para pas lindjes. Jo vetëm shëndeti i gruas, por edhe ai i fëmijës ndiqen periodikisht nga një mjek/e në Konsultoret e Nënës dhe Fëmijës. (qendra të specializuara për nënën dhe fëmijën). Nënata janë të pajisura me një fletore të dhënash për të shënuar të gjitha vaksinimet, të cilat janë falas si për nënën, ashtu dhe për fëmijën e porsalindur. Një shqetësim kryesor përbën fakti që nënave të reja nuk u bëhet një training i veçantë në të gjitha rastet, lidhur me kujdesjen që duhet të tregojnë ato për fëmijën e porsalindur, ndërkohë që ka raste kur ato inkurajohen për të lënë maternitetin brenda 24 orëve, mbas lindjes.

313. Përfundimet e nxjerra nga disa survejime tregojnë që vetëm një përqindje e vogël e grave shkon për kontroll rutinë postnatal tek mjeku në javën e parë pas lindjes. Jo vetëm para lindjes, por edhe pas lindjes numuri i vizitave shpesh rezulton të jetë i ulët dhe shkaqet janë thujse të njëjta më ato që u përmëndën më lart, (aksesi, cilësia e shërbimeve të nënës, pengesat social-kulturore, roli i gruas në familje, sidomos në zonat rurale). Nga ana tjetër, kjo ndikon indirekt edhe në nivelin e vdekshmërisë foshnjore, sepse fëmija është më larg kujdesit mjekësor. Megjithatë, gjatë viteve të fundit në Shqipëri konstatohet një ulje e treguesve të vdekshmërisë foshnjore (Tab. 5.1-INSTAT).

314. Gjatë pesëvjeçarit të fundit një rol të rëndësishëm për informimin dhe edukimin e nënave, lidhur me rëndësinë e kujdesit pas lindjes, kanë luajtur edhe Programet Kombëtare për Mëmësinë e sigurt dhe Për Kujdesin Efektiv Perinatal, që MSH ka zbatuar së bashku me OBSH dhe UNICEF. Për vitet 2005-2006 përqindja e grave që kanë marrë kujdes pas lindjes, sipas të dhënave të raportuara nga institucionet shëndetsore publike të vendit është rreth 60%, shifër kjo në rritje nqs krahasohet me atë të vitit 2002, e cila nuk ishte më shumë se 19%.

Ushqyerja me gji

315. Në Shqipëri ushqyerja me gji ka qënë traditë, por pas viteve 1990 filluan të futen edhe qumështet industriale, si zëvendësues të qumështit të gjirit. Kjo erdhi si rrjedhojë e përdorimit të medikamenteve qetësues dhe mjeteve të tjera gjatë lindjes (të cilat mund shkaktojnë frenimin e ardhjes së qumështit), e lindjeve në maternitete, si dhe nga hapja e vendit drejt ekonomisë së tregut. Për të monitoruar situatën e ushqyerjes me gji, në bashkëpunim me UNICEF-in dhe shoqata të ndryshme, MSH ka realizuar disa studime në shkallë kombëtare gjatë periudhës 2001-2006. Përfundimet e këtyre studimeve treguan se, përqindja e ushqyerjes ekskluzive me gji për 6 muajt e parë është rreth 38%, ndërsa vazhdimi i ushqyerjes me gji në vitin e dytë të jetës arrin deri në 74%.

316. Për të përmirësuar ushqyerjen gjatë shtatzanisë janë marrë masa që gjatë kësaj periudhe të shpërndahen suplemente hekuri dhe acidi folik. Duke marrë për bazë rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetsisë dhe Kodin Ndërkombëtar të Marketingut të Zëvendësuesve të Qumështit të Gjirit, u hartua ligji që inkurajon

ushqyerjen me gji. Ky ligj përcakton se, gjatë gjashtë muajve të parë të jetës gratë duhet t'i ushqejnë me gji fëmijët e tyre. Ligji nuk ndalon marketimin e zëvendësuesve, por rregullon shitjen e këtyre produkteve, duke ndaluar njëkohësisht personat që shërbejnë në institucionet e kujdesit shëndetsor që të lëshojnë receta për to pa rekomandimin e mjekut/es.

317. Spitali nuk merr masa në lidhje me ushqyerjen e grave shtatzëna, por promovon ushqyerjen me gji. Nëse një nënë nuk ka mundësi të ushqejë me gji, atëhere fëmija ushqehet nga gra të tjera të shëndetshme që janë në gjëndje të ushqejnë me gji. Duhet thënë se, gjatë shtatzanisë dhe periudhës së qumështit është e nevojshme që, për gratë të sigurohet më shumë ndihmë ekonomike. Megjithëse gratë marrin informacion se si duhet të ushqejnë veten dhe fëmijën, jo rrallë nuk sigurohen mjetet e përshtatshme për ta kryer siç duhet ushqyerjen. Në përgjithësi, veprimet praktike që kryhen gjatë sesioneve të trainimit të grave për kontrollin e gjirit janë korrekte dhe rezultative. Gratë që kanë marrë pjesë në këto sesione trainimi konsultohen me mjekët më shumë se ato që nuk marrin pjesë në sesione të tilla trainimi.

Infeksionet seksualisht të transmetueshme (IST) dhe HIV/AIDS

318. Për personat e infektuar me HIV/AIDS nuk ka ligje diskriminuese, kurse përsa i takon konfidencialitetit të trajtimit mund të thuhet që ai është i garantuar. Infeksioni HIV/AIDS u regjistrua për herë të parë në vitin 1993, ndërsa në vitin 1995 pas një periudhe të gjatë të mos diagnostikimit të rasteve të tilla u evidentuan raste me sifiliz. Shqipëria është një nga vendet me përqindje më të ulët të HIV/AIDS dhe deri më sot (viti 2008) janë raportuar 266 raste. Nga ana tjetër, edhe pse jo i shpeshtë si fenomen, transmetimi i infeksionit HIV nga nëna tek fëmija është diagnostikuar në 13 raste¹¹. Nuk ka të dhëna të sakta për numrin e grave që testohen për HIV dhe për këtë arsye, në Shqipëri është e vështirë të parashikohet pritshmëria e kalimit të infeksionit nga nëna tek fëmija. Në total numri i femrave të infektuara me HIV është më i ulët se ai i meshkujve dhe për këtë gjë një rol të rëndësishëm kanë luajtur përpjekjet e vazhdueshme parandaluese, që janë bërë në formën e fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit të grave. Gratë shtatzëna dhe gratë e moshës që mund të lindin fëmijë marrin informacion për testimin e HIV/AIDS, për pasojat e të infektuarit nga virusi dhe për terapinë retrovirale. Megjithatë, niveli i ndërgjegjësimit për HIV/AIDS mbetet i ulët, sidomos në radhët e popullsisë femërore rome.

319. Që në vitin 1997 është hartuar Programi Kombëtar HIV/AIDS/IST i vendosur pranë Institutit të Shëndetit Publik, me synim koordinimin e përgjigjes kombëtare ndaj HIV/AIDS. Hartimi i Strategjisë Kombëtare për parandalimin dhe kontrollin e përhapjes së HIV/AIDS në Shqipëri, për vitet 2004-2010, lindi si rezultat i shfaqjes së disa faktorëve të tillë si: rritja e numrit të rasteve të diagnostikuara, evoluimi i sjelljeve të popullsisë, siç është psh, prirja për të patur marrëdhënie seksuale në moshë më të re, përdorimi i drogës etj. Strategjia Kombëtare për parandalimin dhe kontrollin e përhapjes së HIV/AIDS në Shqipëri në vitet 2004-2010, ve theksin në rrezikun e prekjes nga HIV/AIDS të grave dhe vajzave në vend dhe synon aplikimin e masave parandaluese të karakterit ndërgjegjësues, si dhe të metodave bashkëkohore për trajtimin e femrave të infektuara.

¹¹ Burimi i informacionit: Instituti i Shëndetit Publik, (ISHP)

320. Infeksionet e tjera seksualisht të transmetueshme (IST) kanë një tendencë rritjeje në popullatë, megjithëse cilësia e raportimit le për të dëshiruar dhe në mjaft raste nuk është e mundur të vlerësohet me saktësi shkalla e infeksionit. Diagnostikimi i këtyre infeksioneve bëhet në Tiranë pranë laboratorëve të shëndetit publik dhe laboratorit mikrobiologjik të Spitalit Universitar Obstetrik-Gjinekologjik. Qendra e Referencës Kombëtare për HIV/AIDS dhe sifilizin është Instituti i Shëndetit Publik .

321. Pas viteve 90 në Shqipëri ka patur valë masive emigrimi, kryesisht drejt vendeve fqinjë (Greqi, Itali) dhe 40% e këtyre emigrantëve vlerësohet të jenë femra. Në vitet e fundit është vënë re një model i ri, ai i emigrimit të grave vetëm, pa antarë të tjerë të familjes. Në këto rrethana është shtuar dhe prostitucioni si një nga format e trafikimit të qënieve njërëzore. Prostitucioni, në kombinim me nivelin e ulët të përdorimit të kondomëve përbën një kërcënim të mundshëm për përhapjen e IST-ve. Ndër kategoritë e grave që paraqesin vulnerabilitet të lartë, përveç femrave të trafikuar (që shpesh vijnë nga zonat rurale) janë dhe gratë e emigrantëve.

322. Shërbimet e përqëndruara vetëm në mjekimin e IST kanë si anë negative pengesat për akses nga ana a grave për këto shërbime. Ndryshimet sociale lidhen gjithashtu dhe me migrimin e brëndshëm të popullsisë drejt qyteteve të mëdha dhe në mënyrë të veçantë drejt kryeqytetit. Migrimi i brëndshëm i këtyre viteve solli ndryshime në raportin popullsi urbane/rurale. Në vitin 1989 popullsia urbane përbënte 36% të popullsisë së përgjithshme, kurse në vitin 2001 ajo u rrit në 42 %.

323. Gjatë dekadave të izolimit të Shqipërisë (1960-1990), IST të tilla si sifilizi dhe gonorea virtualisht u eliminuan. Megjithatë, deri në fund të vitit 2003 u identifikuan 138 raste me sifiliz, ku femrat përbënin 48% të rasteve dhe meshkujt 42%. Nga këto, 138 raste, (45%) kishin sifiliz primar (ISHP - 2004). Në 3 vitet e fundit 4.5% e personave me sifiliz ishin edhe HIV pozitivë. Aktualisht, për gonorrenë është vendosur një ndjekje laboratorike, pasi vërehet një rritje e numrit të rasteve me gonorre të zbuluara nëpërmjet kontrollit rutinë spitalor. Gjithashtu, studimet e viteve të fundit dëshmojnë për praninë e viruseve *herpes* tek femrat në moshën e riprodhimit. Një studim tjetër i kryer nga ISHP dokumenton rrjedhjen vaginale dhe praninë e *Chlamydia trachomatis* në 25 % të një kontigjenti prej 527 grash të ekzaminuara në Tiranë. Ndjekja e IST-ve përfshihet në raportimin e detyruar. Infeksioni HIV, Sifilizi dhe Gonorea janë pjesë e 73 nozologjive të sëmundjeve të komunikueshme që raportohen në mënyrë të detyruar. Deri në fund të vitit 2006 ishin diagnostikuar 211 raste HIV pozitiv. Kurse, me sifiliz, gjatë vitit 2005 u diagnostikuan 157 raste, në 2006 janë raportuar 14 raste dhe për vitin 2007 u raportuan 32 raste, nga të cilat 81% janë meshkuj dhe 19% femra.

324. Konkluzioni është se, ato IST që janë të detyrueshme për tu raportuar paraqiten në shifra të ulta dhe nuk tregojnë situatën reale epidemiologjike. Raportimi i pakët i sifilizit dhe gonorresë lidhet me nën raportimin dhe të dhëna jo të besueshme. Sigurisht që këto të dhëna mungojnë edhe nga mos funksionimi i dispancerive të sëmundjeve dermo-veneriane. Maternitetet e Tiranës dhe ato të rretheve nuk raportojnë mbi rastet pozitive në Institutin e Shëndetit Publik (ISHP). Depistimet e kryera nga ISHP në një kontigjent të grave me probleme gjinekologjike, apo ekzaminimet e kryera pranë Laboratorit të Mikrobiologjisë të Qendrës Spitalore Universitare, “Nënë Tereza”, në Tiranë (QSUT) dëshmojnë për nivele të larta të IST-ve.

325. Për të kompletuar ndjekjen biologjike për rastet që paraqesin rrezikshmëri për IST dhe HIV/AIDS janë vënë në përdorim këto skeda: **1).** Skeda për personat që testohen për HIV/AIDS, **2).** Skeda për përdoruesit e drogës, **3).** Skeda për personat që testohen për sifiliz dhe **4).** Skeda për femrat që ushtrojnë prostitucionin. Këto skeda më të dhënat mbi sjelljet me risk ndaj HIV/AIDS/IST janë hedhur në programe të veçanta kompjuterike për të bërë të mundur në vijim, analizimin dhe përpunimin e informacionit të tyre.

Prevalenca e vizitave gjinekologjike rutinë ndërmjet grave me aktivitet seksual.

326. Studimi i shëndetit riprodhues në Shqipëri tregoi se vetëm 32% e grave që kanë aktivitet seksual kanë kryer një ekzaminim gjinekologjik rutinë. Rekomandimi është bërë që, gratë të bëjnë një ekzaminim gjinekologjik rutinë çdo vit pas moshës 18 vjeç, madje edhe më herët, nëqoftëse gruaja ka filluar jetën seksuale. Kur u pyetën për ekzaminimin gjinekologjik rutinë të vitit të fundit, vetëm 16% e grave të kampionit të anketimit me aktivitet seksual rezultuan që të kishin bërë një ekzaminim të tillë.

327. Vendbanimi urban dhe veçanërisht në Tiranë rrit mundësinë për të kryer më shpesh ekzaminimin gjinekologjik rutinë, në krahasim me gratë e zonave rurale (20%, kundrejt 14%, gjatë vitit 2007). Frekuenca e kryerjes së këtij ekzaminimi paraqitet e ndryshme nëqoftëse bëhen krahasime ndërmjet grave të martuara, të pamartuara dhe grave të martuara më parë dhe me sa duket, kjo është e lidhur me rolin që ka moshë në këtë çështje. Kur u pyetën rreth arsyes më të rëndësishme, përse ato nuk kanë bërë kurrë një ekzaminim gjinekologjik rutinë (vetëm për gratë me aktivitet seksual), shumë nga ato që ishin përzgjedhur u përgjigjën se ishin të shëndetshme, ose që nuk kishin nevojë të bënin një ekzaminim gjinekologjik. Një përqindje shumë e ulët (2%) përmendën probleme të lidhura me ofruesin e shërbimit. Kjo tregon për një nivel të ulët ndërgjegjësimit të grave, lidhur me rëndësinë e parandalimit të kancerit dhe një mungësë informacioni nga ana e tyre, për nevojën e ekzaminimit gjinekologjik rutinë.

328. Prevalenca e ulët e ekzaminimit gjinekologjik rutinë mund të këtë një ndikim negativ të rëndësishëm në drejtim të depistimit, këshillimit dhe edukimit shëndetsor. Këto konstatime flasin në favor të faktit që duhen bërë më shumë përpjekje, si për të modifikuar besimin dhe qëndrimin e përgjithshëm për kujdesin shëndetsor, ashtu edhe për edukimin e grave rreth procedurave të depistimit dhe parandalimit të sëmundjeve. Këto përpjekje duhet të shoqërohen nga ndërhyrje të tjera, të cilat duhet të kenë si qëllim rritjen e aksesit ndaj shërbimeve, rritjen e cilësisë së tyre, si dhe rritjen e shkallës së mbulimit gjeografik. Studimet e kryera për shëndetin riprodhues nga USAID, MSH, UNFPA në periudhën 2003-2007 kanë treguar që, prevalenca e sëmundjeve inflamatore pelvike ndërmjet grave me përvojë seksuale në Shqipëri është më e ulta në krahasim më vëndet e tjera që kanë karakteristika të ngjashme. Kështu, në vëndet e përzgjedhura të Europës Lindore dhe në Kaukaz kjo prevalencë shkon nga 17%-44% (Informacion i Qendrës për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve në Atlanta - CDC - 2004), kurse në Shqipëri kjo prevalencë është rreth 11%.

329. Qëndrat e Këshillimit dhe Testimit Vullnetar (VCT) janë një dukuri e re në Shqipëri. Këshillimi dhe Testimi Vullnetar konfidencial kryhet në ISHP dhe QSUT në Tiranë. Këto qëndra janë planifikuar që të shtrihen në të gjitha prefekturat e vëndit gjatë periudhës 2007-2008. QSUT ofron gjithashtu mjekimin falas me anti-retroviralë (ART), për personat që jetojnë me HIV/AIDS. Përsa i përket AIDS dhe personave që

jetojnë me HIV/AIDS mund të thuhet se, ndër ta ekziston ndjenja e turpit, (njollosjes), diskriminimit dhe mospranimit në të gjitha nivelet e shoqërisë. Një situatë e tillë bën që individët dhe familjarët e tyre të tentojnë të mos flasin për HIV/AIDS.

330. Studimi i Shëndetit Riprodhues i kryer në vitin 2002 njihet si përpjekja e parë sistematike për të mbledhur të dhëna përgjithësuere në shkallë kombëtare mbi popullsinë dhe çështjet e shëndetit riprodhues në Shqipëri. Lidhur me shkallën e rrezikshmërisë që paraqesin rastet me HIV/AIDS, ky studim tregoi se, vetëm 16% e personave me moshë 15-24 vjeç përdornin kondom. Një e treta e grave të reja (32%) dhe 29% e meshkujve të rinj raportuan që kishin kryer marrëdhënie seksuale. Vetëm 17% e grave dhe 33% e burrave kishin dijeni, se ku mund të kryhej testi HIV.

331. Në vitet 2002 dhe 2004 u kryen dy studime të tjera të tipit Vlerësim i Shpejtë dhe Përgjigje (RAR - Rapid Assessment Response) me të rinj nga grupe vulnerabël të tilla si, të rinjtë romë, homoseksualët, femrat që ushtrojnë prostitucionin, përdoruesit e drogës dhe popullata e lëvizshme. Në një kampion prej 170 përdoruesish të drogave, rreth 64% e tyre injektonin drogë. Gjithashtu, 2 në çdo 3 përdorues të drogave me injeksione kanë raportuar shkëmbimin e ageve dhe të shiringave, ndërsa dezinfektimi me klor përdorej pak. Shkëmbimi i shiringave nuk perceptohej si risk për HIV-in, ndërsa njohuritë rreth HIV-it dhe IST-ve kanë qënë të ulta në rradhët e kësaj popullate. Gjithashtu shumë përdorues të drogave kanë raportuar që kanë patur shumë partnerë seksualë dhe pak prej tyre kanë raportuar për përdorimin e kondomit.

332. Në vitin 2005-2006 në Tiranë u krye studimi biologjik dhe i sjelljes në lidhje me HIV dhe IST, tek grupet e riskut në kryeqytet. Në përgjithësi, prevalenca e infeksioneve biologjike në popullatat e marra në studim ishte e ulët. Nuk u zbuluan raste me infeksionin HIV, si tek përdoruesit e drogave intravenoze (PDI), ashtu dhe në popullatën e përgjithshme. Prevalenca në popullatën rome rezultoi të jetë 0.3%, kurse tek homoseksualët 0.8%.

333. Prevalenca e sifilizit rezultoi të ishte më e lartë në popullatën rome (2.5%), ç'ka tregon një rrezik të mundshëm për transmetimin e infeksionit HIV, ndërsa në grupet e tjera ajo ishte më e ulët, respektivisht 0.6% për përdoruesit e drogës dhe 1.2% për homoseksualët. Afërsisht 30% e femrave rome raportuan se, kundër dëshirës së tyre janë detyruar nga një partner për të kryer marrëdhënie seksuale në 12 muajt e fundit, krahasuar me 8.7% të femrave në popullatën e përgjithshme. Një përqindje e lartë e të intervistuarve raportuan se kanë dijeni për mundësinë e testimit konfidencial në Tiranë (61.1% e popullatës rome dhe 81.1% e asaj të përgjithshme). Megjithatë, ndërkohë që shkalla e ndërjegjësimit ishte e lartë, vetëm një pjesë e vogël e pjesëmarrësve në studim kishin kryer testin HIV (3.1% e popullatës rome, ndaj 7.7% të popullatës së përgjithshme).

334. Nga raportimet e bëra në ISHP rezulton që deri në vitin 2007, në Shqipëri janë regjistruar 254 raste me HIV/AIDS. Për vitin 2007 janë raportuar 43 raste të reja me HIV/AIDS, prej të cilave 30 meshkuj dhe 13 femra. Në total femrat përbëjnë 29% të rasteve me HIV/AIDS në Shqipëri. Bazuar në numrin e personave të diagnostikuar dhe të raportuar, Shqipëria konsiderohet si një vend me prevalencë të ulët të infeksionit HIV. Ndërkohë, të dhëna të tjera tregojnë se, vendi po përballet me një rritje të shpejtë të numrit të rasteve.

335. Në përgjigje të Rekomandimeve të Komitetit CEDAW (Paragrafi 33), Ministria e Shëndetsisë, krahas institucioneve të tjera u ka dhënë prioritet masave që kanë të bëjnë me eliminimin e dhunës ndaj grave, si në familje, ashtu dhe në shoqëri. Në mënyrë të veçantë është vënë theksi për kryerjen e sensibilizimit pranë organeve shëndetsore për rastet kur gratë janë kthyer në viktimat e dhunës në familje. Përveç faktit që dhuna në tërësi konsiderohet si shkelje e të drejtave të njeriut, dhuna në familje po trajtohet gjithnjë e më shumë si një çështje e shëndetit publik.

336. Pasojat më të dukshme shëndetsore të viktimave të dhunës në familje konsistojnë në dëmtimet fizike, sëmundjet e zgjatura dhe çrregullimet psikologjike, apo mendore. Për këtë arsye, punonjësit e shëndetsisë janë ndër të paktët njerëz në jetën e pacientëve, viktimat e dhunës në familje që mund të ndryshojnë dhe të shpëtojnë jetë që janë në rrezik. Sipas studimit kombëtar për shëndetin riprodhues që u krye në Shqipëri në vitin 2002, ndërmjet grave shqiptare të moshës 15-44 vjeç, 11.5 % e tyre rezultoi se kanë qenë dëshmitare të abuzimit të prindërve të tyre dhe 27.2% raportuan se, edhe me to ka patur abuzime gjatë fëmijërisë. Prevalenca e këtyre dy treguesve ishte më e madhe ndërmjet banorëve që jetonin në zonat rurale, në krahasim me ato që jetonin në zonat urbane. Prevalenca e personave dëshmitarë në abuzim dhe atyre që kanë provuar dhunë në fëmijëri ishte më e madhe ndërmjet grave me katër, ose më shumë fëmijë, me nivel të ulët arsimor, me status social-ekonomik të ulët dhe ndërmjet atyre që nuk ishin të punësuar.

337. Përveç kësaj, bie në sy fakti që vetëm 7 prej femrave që raportuan dëmtime fizike të shkaktuara prej dhunës ishin vizituar tek një mjek dhe 4 ishin shtruar në spital. Këto shifra tregojnë për nën-raportimin e pasojave të dhunës edhe kur këto përbëjnë rrezik për shëndetin. Gjithashtu, ato flasin dhe për kufizimin e kujdesit vetëm për shëndetin fizik dhe nënvlerësimin e atij mendor. Mbi të gjitha, shifrat e mësipërme janë tregues për “turpin” prej stigmës, si dhe skepticizmin e pacienteve – viktimat, ndaj punonjësve të kujdesit shëndetsor. Më tepër se sa çështje ndërgjegjësimi e personelit shëndetsor, rënia e predispozicionit të stafit mjekësor për tu përballur me viktimat e dhunës ka të bëjë me barrierat dhe eksperiencat personale të dhunës, të cilat deri në fund të vitit 2006 kanë qënë të ndërthurura me mungesën e detyrimit ligjor për të trajtuar dhe mbështetur viktimat dhe të mbijetuarat.

338. Ulja e shkallës së këtij fenomeni negativ ndikohet ndjeshëm nga disa faktorë të tillë si, shërbimi mjekësor i specializuar dhe trainimi i personelit mjekësor për identifikimin e rasteve, dhënia e ndihmës së parë të kualifikuar, trajtimi afatgjatë i kësaj teme në familje, etj. Sipas një studimi të Shoqatës Kombëtare të Punonjësve Sociale (SHKPS -2006) të kryer në rrethet Dibër, Shkodër, Pogradec, Tiranë dhe Vlorë u konstatua se, punonjësit e shëndetsisë karakterizohen nga një ambiguitet në lidhje me qëndrimin ndaj dhunës me bazë gjinore. Të pyetur me shkrim, 37% e tyre e quajnë dhunën si një çështje të brendshme të familjes, ndërsa në diskutime të hapura ata e kundërshtojnë këtë duke e konsideruar si një çështje të gjithë shoqërisë. Nga njëra anë, punonjësit e kujdesit shëndetsor e kanë potencialin për të identifikuar, vlerësuar dhe trajtuar viktimat e dhunës, por nga ana tjetër atyre iu mungojnë ndërgjegjësimi dhe shprehitë bazë për të kapërcyer barrierat personale ndaj çështjes së dhunës në familje. Praktika botërore në fushën e trajtimit mjekësor të viktimave të dhunës në familje ka provuar efektivitetin e ekipeve multidisiplinare. Mungesa e këtyre ekipeve është një ndër faktorët që ndikon drejtpërdrejt në kufizimet për vlerësimin dhe trajtimin e plotë të viktimave të dhunës në familje.

339. Sipas studimit të Shoqatës Kombëtare të Punonjësve Socialë (2006) vetëm 13% e punonjësve të shëndetit publik pohuan se i dokumentojnë rastet e dhunës, nga të cilët vetëm 4% shprehen se dokumentojnë jo vetëm rastin, por edhe shkakun e dhunës. Pra, regjistrimet që u bëhen pacientëve lidhen vetëm me protokollimin e diagnozës dhe të të dhënave personale. Shkak për këtë janë: **a).** mungesa e detyrimit me ligj për të dokumentuar rastet e dhunës, **b).** mungesa e protokollit të qartë **c).** mungesa e njohurive mbi vlerat e dokumentimit dhe **d).** mungesa e shprehive të sakta dhe profesionale për ta trajtuar këtë çështje delikate me pacienten, pa e vënë në rrezik atë.

340. Për të diagnostikuar dhe trajtuar rastet e dhunës në familje janë trainuar dhe vazhdojnë të trainohen mjekë të përgjithshëm, por megjithëse ky trainim ka një rëndësi të veçantë për të luftuar dhunën në familje, ai kryhet në mënyrë sporadike. Në Kodin e Deontologjisë Mjekësore shqiptare, ndër Detyrat e Përgjithshme të Mjekut, në nenin 8 citohet “...nëse mjeku konstaton që personi (me heqje lirie) ka pasur keqtrajtim, pas miratimit të këtij fakti nga i interesuari, mjeku duhet të informojë autoritetet ligjore”. Ndërsa ndër Detyrat ndaj të Sëmureve në po këtë Kod, në nenin 43 thuhet se, “Kur gjatë vizitës konstaton se fëmija është keqtrajtuar, mjeku duhet të marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës. Këtë ai duhet ta kryejë me kujdes e maturi, por nëse e gjykon të arsyeshme, sidomos për fëmijët nën moshën 15 vjeç ai duhet të njoftojë autoritetet kompetente”. Në këtë Kod nuk parashikohet si detyrë e mjekut, trajtimi i veçantë i pacienteve/viktima të dhunës në familje. Edhe në rastin e sipërpërmendur të keqtrajtimit të fëmijëve nuk specifikohet keqtrajtimi nga antarët e familjes, e për më tepër mbetet “në dorën, apo gjykimin e mjekut” dhe nuk shihet si detyrim, raportimi i viktimave tek autoritetet kompetente. Akoma më shumë nuk përcaktohen qartë “autoritetet kompetente”. Kjo është e lidhur me mungesën e një konteksti të caktuar ligjor, social, kulturor e ekonomik për adresimin e fenomenit të dhunës në familje. Nëpërmjet bashkëpunimit me Universitetin e Montreal-it është zhvilluar një kurs i veçantë me mjekët e përgjithshëm në Tiranë, për ti aftësuar në diagnostikimin dhe trajtimin e atyre rasteve, ndaj të cilave abuzohet me mënyra të ndryshme.

341. Ligji i ri “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (Nr. 9669, dt. 18.12.2006) parashikon në nene të veçantë të tij, (si neni 5 - për autoritetet përgjegjëse të linjës dhe neni 7-detyrat e autoriteteve përgjegjëse të linjës) detyrimet që ka sektori shëndetsor për identifikimin dhe trajtimin dhe referimin e viktimave të dhunës në familje. Për zbatimin e nenit 7 të këtij ligji, MSH ka ndërmarë një sërë masash, ndër të cilat mund të përmenden:

- Përgatitja e akteve nënligjore (Urdhëra, VKM, etj) për zbatimin e ligjit nga personeli shëndetsor
- Përgatitja e protokolleve dhe udhëzimeve për identifikimin dhe manaxhimin e formave të dhunës në familje nga personeli i kujdesit shëndetsor. Këto udhëzime përfshijnë ndjekjen, trajtimin dhe këshillimin e viktimave të dhunës nga personeli i kujdesit shëndetsor parësor
- Trainimi i personelit të Shërbimeve të Kujdesit për Nënë dhe Fëmijën, për çështjet që janë të bëjnë me dhunën në familje. Për dhunën me bazë gjinore janë zhvilluar trainime me mjekët e familjes, infermierët, mjekët e konsultoreve të nënës dhe fëmijës në disa rrethe të vendit, nën drejtimin e UNICEF-it dhe Shoqatës Kombëtare të Punonjësve Socialë.
- Hartimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje 2007-2010 dhe i Planit të Veprimit për zbatimin e saj, ku janë përshkruar qartë

objektivat dhe aktivitetet që do të kryhen. Në këtë strategji një kapitull i veçantë i është kushtuar shëndetsisë.

Neni 13

NDIHMAT SOCIALE DHE EKONOMIKE

Kuadri ligjor për kujdesin social dhe ekonomik

342. Legjislacioni shqiptar i viteve të fundit ka njohur përmirësime në drejtim të sigurimit të barazisë, apo mos diskriminimit të grave në fushën e së drejtës civile. Megjithatë Kodi Civil, legjislacioni bankar dhe ligje të tjera përdorin gjuhë neutrale nga pikëpamja gjinore, të tilla si “çdo person”, “palët”, “personat fizikë”. Kështu Kodi Civil përcakton se, të gjithë personat fitojnë zotësinë për të vepruar kur mbushin moshën 18 vjeç dhe nga ai moment mund të kryejnë lirisht çdo lloj veprimi juridik. Ka raste kur Kodi Civil përdor terma të tilla si “kreditor”, apo “pronar” në gjininë mashkullore. Por kjo ndodh kudo në tekstet e ligjeve në Shqipëri dhe të gjithë, (përfshi edhe juristët) nënkuptojnë të dy gjinitë me këto terma, ndërkohë që në ligjet e reja ka përpjekje për të përdorur një gjuhë të veçantë për të dy gjinitë dhe hartuesit janë ndërgjegjësuar më shumë për problemet gjinore dhe lidhjen e tyre me legjislacionin. Po ashtu, Kushtetuta shqiptare i garanton kujtdo lirinë artistike dhe krijuese, si dhe pjesëmarrjen në kërkimet shkencore (neni 58), ndërsa neni 59 parashikon lirinë e pjesëmarrjes në sporte dhe veprimtari zbavitëse. Sërish gjuha e përdorur është neutrale nga pikëpamja gjinore, prandaj është marrë në konsideratë hartimi i dispozitave të posaçme për barazinë dhe mosdiskriminimin e grave në këto fusha të jetës ekonomike e sociale.

343. Këtu vlen të përmendet miratimi i ligjit nr. 8889, datë, 25.04.2002 ¹², “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.05.1995, Për sigurimet shoqërore në RSH”, meqënëse ky ligj nuk është komentuar në Raportin e Parë dhe të Dytë të Kombinuar CEDAW, që Shqipëria ka paraqitur në OKB. Ky ligj solli këto ndryshime:

1- ulje të normës së kontributeve që duhet të paguajnë punëdhënësit dhe punëmarrësit nga 42.5%, në 38.5% duke filluar nga data, 01.07.2002 dhe

2- ndryshime në moshën e pensionit, duke realizuar një rritje graduale për gratë nga 55 në 60 vjeç dhe për burrat nga 60 në 65 vjeç. *Pra, ende ruhet një farë diskriminimi pozitiv i gruas në lidhje me përfitimin për pension, duke shtuar këtu edhe faktin që, për shkak të jetëgjatësisë më të madhe se burrat, ato e gëzojnë për një periudhë më të gjatë kohe pensionin e tyre të pleqërisë.*

344. Me sigurimin vullnetar, që realizohet sipas Rregullores nr.35/1, viti 2005, sistemi i sigurimeve shoqërore i përgjigjet kërkesave të qytetarëve që dëshirojnë të futen në skemën e sigurimeve shoqërore, pa qënë ekonomikisht aktivë dhe në këtë drejtim gratë përbëjnë peshën specifike më të madhe të popullsisë jo ekonomikisht aktive. Kjo skemë gjithashtu krijoi mundësinë që personi të sigurohet për përfitime maksimale, ku edhe në këtë rast femrat, si më pak të paguara në tregun e punës kanë mundësi që nëpërmjet sigurimit të rritin përfitimet sociale për pensione maksimale. Sigurimin e saj vullnetar mund ta bëjë një person i tretë pa qënë ajo domosdoshmërisht prezente.

345. Ndryshimet e ndodhura në vend, si dhe në nevojat për shërbime të reja sociale bënë që në vijim të hartohet ligji i ri “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”, (nr. 9355, datë, 10.03.2005, i cili zëvendësoi ligjin e mëparshëm nr.7710, datë, 18.05.1993

¹² Ky akt ligjor nuk është pasqyruar në Raportin e I dhe të II të Kombinuar CEDAW

“Për Ndhimën dhe Përkujdesjen Shoqërore”. Ligji i ri u plotësua më pas me udhëzime dhe akte nënligjore. (të gjitha këto VKM dhe Udhëzimet përkatëse janë pasqyruar tek Aneksët e këtij Raporti)

Masat për eliminimin e diskriminimit në fushën ekonomike dhe shoqërore

(a) Përfitimet për antarët e familjes.

346. Reformat politike dhe ekonomike të viteve '90-të u shoqëruan me rritje të numrit të personave të ekspozuar ndaj varfërisë dhe përjashtimit social. Për zbutjen e këtyre pasojave është ndërtuar një sistem i posaçëm i mbrojtjes sociale i bazuar në programet e: **(1)** sigurimeve shoqërore, **(2)** ndihmës ekonomike, **(3)** mbështetjes me të ardhura të personave me aftësi të kufizuar dhe **(4)** shërbimeve shoqërore. Vlerësimi i vulnerabilitetit dhe problemeve sociale të individëve, (grave/vajzave dhe burrave/djemve) shpesh nënkupton përkufizimin e shkallës së përjashtimit të tyre social nga jeta normale e shoqërisë, mungesën e politikave dhe masave për mbrojtjen e të drejtave të tyre, si dhe mungesën e mundësisë për t'i përdorur shërbimet që ekzistojnë në komunitetin e tyre.

347. Renditja e vulnerabilitetit i ka përkufizuar gratë dhe vajzat e papuna si një nga grupet kryesore më të riskuara dhe me probleme sociale. Vitet e fundit është rritur numri i grave kryefamiljare ku kryesisht bëjnë pjesë, gratë e veja, të divorcuarat dhe ato që i kanë burrat në emigracion. Gratë kryefamiljare përfitojnë ndihmë ekonomike apo pensione familjare, kur bashkëshorti ka qenë i punësuar. Këto gra përfitojnë gjithashtu, ndihma humanitare dhe shërbime punësimi nga OJF-të. Vetëm për tre mujorin e parë të vitit 2007 mund të renditen këto shifra: numri i grave të papuna rezulton 7688, me pagesë papunësie trajtohen rreth 1141 gra, me ndihmë ekonomike rreth 5598 gra, kurse numri i familjeve me kryefamiljare gra rezulton të jetë 5844.

348. Ndryshimet demografike në Shqipëri kanë sjellë ndryshime në vetë strukturën e familjes shqiptare. Së pari, familjet synojnë të jenë më të vogla se para viteve '90-të, ku familjet me shumë fëmijë ishin më të shpeshta dhe familja e zgjeruar ishte një formë e rëndësishme e mbështetjes sociale dhe ekonomike. Shqipëria karakterizohej nga një profil demografik, i cili dallohej nga martesat në moshë të hershme, lindja e fëmijëve në moshë relativisht të re dhe martesat të qëndrueshme. Këto tendenca tani kanë ndryshuar, por në familjen shqiptare si probleme sociale janë prezantuar disa fenomene të reja. Kështu, ngelja e grave si prindër të vetëm është një fenomen i ri që erdhi si rezultat i emigrimit ndërkombëtar. Gratë e vetmuara kryefamiljare përballojnë sfida tepër të vështira dhe shpesh ndeshen me papunësinë dhe mungesën e sistemit të përkujdesjes për fëmijët. Balancimi i rolit të kryefamiljarit dhe të përkujdesit të vetmuar është një detyrë e vështirë, e cila kërkon prezencën e skemave të mbrojtjes sociale.

349. Për grupet e grave në nevojë, arësyet kryesore të qënies në disavantazh social janë: **(a)** papunësia në vend, e cila bën që një pjesë e madhe e grave të punësohen në sektorin privat/informal, **(b)** marrja përsipër e përgjegjësive familjare të sigurimit të ushqimit dhe të përkujdesjes ndaj fëmijëve. Kjo i detyron gratë dhe vajzat të punësohen në punë me orare të shkurtuara që nuk kërkojnë lëvizshmëri, apo orare të zgjatura dhe njohuri të avancuara profesionale. Për pasojë, grupet e grave në nevojë kanë paga të ulta (përfitimet për meshkujt dhe femrat jepen veças dhe duke u bazuar

në kohëzgjatjen e punës), pasiguri të vendit të punës, mos sigurim shoqëror dhe shëndetsor. Gjithashtu, ato janë të mbingarkuara (punë me pagesë në tregun e punës dhe pa pagesë në shtëpi), janë të nënpaguara, janë përkujdesëse të vetme dhe shpesh sigurose të vetme të ushqimit, janë të konsumuara psikologjikisht e për rrjedhojë reflektojnë gjithçka edhe tek fëmijët e familjet e tyre.

(b) Huatë bankare dhe forma të tjera të kreditit financiar.

350. Gratë rrallë aplikojnë për kredi, sepse ato perceptohen zakonisht sikur kanë një rol mbështetës në aktivitetet e biznesit. Gjithashtu, për shumë banka politika e huasë kërkon që aplikuesi/sja të ketë kapital, ndërsa në të vërtetë pak gra e kanë një gjë të tillë. E drejta e gruas ndaj pronës zakonisht humbet kur prona rregjistrohet në emrin e burrit. Jo në pak raste ndodh që, banesa martesore e çiftit të rregjistrohet (ilegalisht) nën emrin e bashkëshortit, megjithëse të dy bashkëshortët kanë të drejta pronësie mbi pasurinë. Zakonisht gratë nuk kanë mbështetjen e burrave në marrjen e nismave të biznesit, ose në disa raste ato nuk kanë kurajo që të ndërmarrin një nismë të tillë. Mungesa e informacionit kontribuon gjithashtu në paaftësinë për të përdorur efektivisht bankat.

351. Gratë dhe vajzat kanë ngritur bizneset e tyre kryesisht në aktivitete ekonomike të tilla si tregëti, shitje me shumicë, dyqane, shërbime të ndryshme si dentist, noteri, avokati, parukeri, agro-biznes, industri, prodhimin e bulmetit, tekstil, botime librash, rrobaqepësi dhe punime artizanale. Aksesit i ulët ndaj pronës (vetëm 8% e grave zotërojnë ligjërisht prona), si dhe mungesa e politikave favorizuese që nxisin sipërmarrjen private të grave dhe vajzave ka çuar në një nivel të ulët të numrit të atyre që drejtojnë biznese të vogla, të mesme ose të mëdha.

352. Sipas statistikave të INSTAT-it, 17% e drejtuesve të biznesit privat janë gra dhe vajza. Numri më i madh i bizneseve të rregjistruara që drejtohen nga gratë dhe vajzat është përqëndruar në Tiranë (31%), Durrës (8.7%) dhe Elbasan (6.2%). Në zonat urbane ndodhen 85% e këtyre bizneseve të drejtuara prej tyre, kurse 15% janë në zonat rurale. Dhënia e kredive bujqësore me më shumë lehtësira për gratë, do të ndihmonte për një rritje më të shpejtë të numrit të grave fermere.

353. Nga dy studime të kryera nga Qendra Shqiptare për Studime Ekonomike (ACER) rezulton se, 78% e kërkesave për huamarrje bëhet nga kryefamiljarë meshkuj, ndërsa 5-7% e fermereve (gra) marrin hua nga të afërmit e tyre. Në SKBGJ & DHF (Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje) rekomandohet, që nëpërmjet veprimeve konkrete të rritet numri i grave dhe vajzave sipërmarrëse, duke ju krijuar lehtësira për më shumë akses në pronë, kapital dhe kreditime. Shteti i mirëqënies sociale iu siguron mbrojtjen sociale familjeve me shumë fëmijë, familjeve rome dhe egjiptiane, familjeve me fëmijë jetimë, jetimëve pas moshës 18 vjeç, etj, nëpërmjet dy mekanizmave kryesorë: **1)** transfertave *cash* në formën e ndihmës ekonomike; **2)** shërbimeve publike, apo private për personat në nevojë.

354. Disavantazhi i transfertës *cash* për gruan. Transfertat *cash* synojnë të garantojnë një jetë dinjitoze mbi kufirin e minimumit jetik (pension pleqërie, invaliditeti, pagesë paaftësie, ndihmë ekonomike për varfërinë). Shumë prej transfertave *cash* lidhen me sigurimin shoqëror dhe jepen në formën e pensioneve familjare për personat në varësi të titullarit të sigurimit. Transfertat *cash* lidhen me titullarin burrë dhe i jepen atij për

familjen, nëse ai bie nga të ardhurat. Kjo le jashtë përfitimit si titullare gratë kryefamiljare, të cilat nuk janë të punësuar për shkak të modelit tradicional gjinor, i cili inkurajon qëndrimin në shtëpi të gruas për t'u përkujdesur për fëmijët. Gratë që kanë qënë në punë nuk kanë qënë kryefamiljare në momentin e krijimit të familjes, pasi kryefamiljari është burri dhe për pasojë, shpesh nuk nxiten të kenë punë të paguara mirë dhe me kohë të plotë, por punë me kohë të pjesshme, ose punë të paguara pak. Prandaj edhe kontributi për sigurimin e tyre është i ulët.

355. Programi i ndihmës ekonomike përfaqëson një komponent të rëndësishëm të politikave të mbrojtjes sociale në mbështetje të familjeve të varfëra, të cilat në kushtet e ekonomisë së tregut janë më të prekshme nga varfëria dhe rreziku i marxhinalizimit social. Nëpërmjet këtij programi ofrohet një minimum i garantuar të ardhurash me mjete monetare (transferta mujore në *cash*) për plotësimin e nevojave më elementare të jetesës për familjet pa të ardhura, ose me të ardhura nën nivelin e përcaktuar si “*vija zyrtare e varfërisë*”. Ndihma ekonomike u jepet familjeve të shtetasve shqiptarë që kanë të ardhura të pamjaftueshme, ose që nuk kanë të ardhura materiale jetese nga veprimtaria ekonomike e tyre, nga antarë të familjes që janë jashtë shtetit, etj. Për këtë çështje, në SKBGJ & DHF rekomandohet:

- 1) Mbështetja e familjeve të varfëra dhe individëve e grupeve në nevojë për reduktimin e varfërisë me pagesa *cash* dhe shërbime sociale, duke patur si prioritet familjet me kryefamiljare gra, nënat me shumë fëmijë dhe fëmijët jetimë.
- 2) Shtirja në të gjithë vendin e shërbimeve komunitare për gratë dhe vajzat me probleme sociale.

356. Gjatë periudhës 2003-2007, në kuadër të forcimit dhe përmirësimit të kapaciteteve dhe aftësive për të siguruar përparimin e gruas në fushën ekonomike janë organizuar rreth 150 trainime dhe seminare të shpërndara në zona të ndryshme të vendit, me temë “*Gruaja në biznes*”. Këto trainime janë financuar kryesisht nga donatorë të huaj, ku rolin më të rëndësishëm e ka luajtur Fondacioni “*Soros*”. Nëpërmjet këtyre trainimeve është synuar të krijohet një mbështetje dhe përkrahje për gruan, në funksion të zhvillimit të saj në fushën ekonomike, për marrjen e informacioneve bazë dhe atyre më të rëndësishme, lidhur me botën e biznesit dhe rregullat e tij. Rezultati i këtyre trainimeve ka qënë, forcimi i pozitës së gruas në jetën ekonomike, nëpërmjet rritjes së aftësive të tyre në drejtim të marrjes së iniciativave dhe menaxhimit të biznesit, duke synuar kështu arritjen e një ekuilibri të drejtë mes numrit të femrave dhe meshkujve që operojnë në fushën e biznesit.

357. Programi Strategjik i Zhvillimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, (SME-Small & Medium Enterprise) për periudhën 2007-2009 është miratuar para pak kohësh nga Këshilli i Ministrave i RSH. Në pikën 2.4/A të këtij programi është parashikuar si objektiv, “*Nxitja e kulturës së sipërmarrjes*”. Ky program është pjesë integrale e Strategjisë Sektoriale të Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve për periudhën 2007-2013. Nëpërmjet këtij objektiv synohet të hartohet një strategji e nxitjes së sipërmarrjes, me një plan veprimi konkret që do të përqëndrohet në futjen e edukimit formal dhe jo-formal, me anë të trainimeve të ndryshme. Masat që janë parashikuar për këtë janë:

- krijimi dhe përmirësimi i aftësive menaxhuese dhe trainuese, duke synuar zhvillimin e një sjelljeje të re për gruan;
- nxitja e sipërmarrjeve kreative nëpërmjet programeve për nxitjen e sipërmarrjes me grupe specifike, siç janë gratë dhe të rinjtë.

358. Vlen të përmendet këtu dhe rinovimi në vitin 2006, i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Qeverisë Shqiptare dhe UNICEF-it. Kjo marrëveshje kishte si synim kryesor mbështetjen e Qeverisë Shqiptare në përmbushjen e detyrimeve dhe përgjegjësisë të saj ndaj Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventës CEDAW. Sipas angazhimeve të ndërmarra në këtë marrëveshje, Qeveria Shqiptare dhe UNICEF-i kanë punuar për sigurimin e shërbimeve bazë të grupeve më në nevojë në Shqipëri, në veçanti për gratë dhe fëmijët, grupet etnike dhe banorët e zonave rurale. Ky program u zbatua në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor në bashkëpunim me institucionet qeveritare, Agjensitë e OKB-së, OJF-të dhe Organizatat e tjera Ndërkombëtare që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri.

(c) Pjesëmarrja në sporte, aktivitete çlodhëse, dhe të gjitha aspektet e jetës kulturore.

359. Femrat në Shqipëri mund të angazhohen me çdo sport dhe aktivitet tjetër çlodhës që ato e zgjedhin vetë. Burimet ekonomike mund të influencojnë pjesëmarrjen e njëjtit të femrave dhe meshkujve në aktivitetet çlodhëse, megjithatë femrat janë aktive në disa prej këtyre fushave. Ekzistojnë një numur shoqatash të udhëhequra nga gra që organizojnë veprimtari të ndryshme, (piktura, ekspozita, festivale muzikore, shfaqje televizive, etj.) të cilat financohen nga qeveria dhe donatorë të tjerë që ndihmojnë aktivisht për organizimin e këtyre aktiviteteve kulturore.

360. Është hartuar draft Strategjia Kombëtare për Kulturën në të cilën sigurohet trajtimi i barabartë i artistëve pa dallim gjinie. Një nga prioritetet në fushën e kulturës për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MTKRS) është edhe mbështetja e femrës artiste, në fusha të ndryshme si artet pamore, libri etj. Kjo shpehet kryesisht në mbështetjen që MTKRS iu jep projekteve kulturore ku pjesëmarrëse janë femrat, si dhe në numrin e organizatave kulturore që drejtohen nga femrat. Ndër aktivitetet kryesore që janë organizuar në funksion të promovimit të barazisë gjinore mund të përmendim:

- a).** Organizimin e Ditëve Informativ me tematikë “Njohja dhe Zbatimi i të Drejtave të Njeriut”, ku një vend të rëndësishëm ka zënë edhe çështja e barazisë gjinore.
- b).** Organizimi i përvitshëm i Festivalit të filmit “Për të drejtat e njeriut”, aktivitet ky i mbështetur nga MTKRS, ku sërish një vend të rëndësishëm ka zënë barazia gjinore.
- c).** Organizimi i përvitshëm i një aktiviteti me temë “Kinematë e të drejtave”, ku promovohen të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore. Një nga synimet kryesore të këtyre aktiviteteve është njohja dhe përballja e grave me kulturën ndërkombëtare.

361. Barazia në pjesëmarrje në aktivitetet sportive, si e femrave, ashtu dhe e meshkujve në të gjitha nivelet shkollore, ka qenë dhe është prioritet i Drejtorisë së Politikave të Sportit në MTKRS. Kjo shprehet qartë edhe në Strategjinë Kombëtare të Sportit 2007-2013. Është e rëndësishme të theksohet se, pjesëmarrja e femrave dhe meshkujve në fushat që mbulon MTKRS si sporti, arti apo kultura, pikë së pari bazohet në meritat individuale dhe nuk mund të flitet për vendosje kuotash, apo për marrje masash të veçanta për të krijuar barazi gjinore. Hapi konkret që po ndërmeret, është garantimi i barazisë gjinore si një vlerë e shoqërisë shqiptare, e cila duhet promovuar.

362. Duke ju referuar Opinioneve të Komitetit CEDAW për Raportin e Parë dhe të Dytë të Kombinuar, ku shprehimisht thuhet se, “*pjesëmarrja e femrave në sport është e ulët si pasojë e paragjyqimeve, përgjegjësive familjare dhe kushteve financiare*”, vlen të qartësohet dhe një koncept tjetër i rëndësishëm. Konkretisht, midis pjesëmarrjes së femrave në aktivitete sportive dhe pjesëmarrjes së femrave në postet drejtuese të institucioneve sportive ka një ndryshim thelbësor. Për këtë çështje mund të thuhet se, pjesëmarrja e femrave në aktivitete sportive është e konsiderueshme dhe kjo është në varësi të disiplinës sportive. Instituti i Statistikës nuk i ndan të dhënat për pjesëmarrjen në sport sipas përkatësisë gjinore dhe kjo bën që të vështirësohet përcaktimi me saktësi i nivelit të pjesëmarrjes në sporte të ndryshme të grave dhe vajzave. Gjithashtu, bie në sy fakti që në sportet individuale si, atletikë, gjimnastikë, etj numri i femrave sportiste është më i madh se numri i meshkujve sportistë. Megjithatë, mund të thuhet që mungesa e fondeve dhe stereotipet për pjesëmarrjen e grave në sporte të caktuara i dekurajojnë femrat për të marrë pjesë më masivisht në këto lloj sportesh.

Neni 14

GRUAJA FSHATARE

Kuadri ligjor për problemet e Gruas Fshatare

363. Legjislacioni shqiptar nuk bën dallim midis grave në zonat rurale dhe jo rurale, ndonëse në praktikë jeta e grave fshatare mund të jetë më e vështirë. Po kështu nuk bëhet dallim në zbatimin e CEDAW-t për gratë fshatare dhe jo-fshatare. Duke patur parasysh mungesën e legjislacionit të veçantë për gratë fshatare, këto gra ose organizatat e shoqërisë civile që përfaqësojnë gratë mund të paraqesin ankesë në gjykatë dhe t'i kërkojnë shtetit të zbatojë drejtpërdrejt Konventën CEDAW. Në Ligjin e hartuar nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK), Nr.9039, datë 27.03.2003, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.8088, datë, 21.03.1996 Për Shoqëritë e Bashkëpunimit reciprok” ndër të tjera thuhet që, “*gratë ashtu sikurse dhe burrat kanë të drejta të barabarta për hapjen e aktivitetit privat në fushën e bujqësisë*”.

364. MBUMK, po bashkëpunon me Kooperacionin Spanjoll për ndihmë dhe zhvillim nëpërmjet projektit të AECI-t në fushën e kooperativizmit në bujqësi dhe në veçanti në përmirësimin e legjislacionit ekzistues. Pavarësisht se ligji ekzistues në tërësinë e tij e parashikon barazinë e gruas dhe burrit në krijimin e shoqatave, jo të gjitha gratë për vetë kushtet ekonomike, arsimore kanë mundur të përfitojnë nga ky ligj. Mendohet që në rishikimin e tij të futen nene të veçanta që parashikojnë rolin e gjinisë në të.

365. Në dy vitet e fundit janë aplikuar me sukses “Skemat e nxitjes në Bujqësi”, në përputhje me Udhëzimet e MBUMK (Udhëzimi nr.1, datë 16.01.2007 dhe nr.1/1 datë, 13.02.2008). Këto Udhëzime janë dhënë në funksion të zbatimit të V.K.M. nr.3, datë, 10.01.2006 “Për nxitjen e zhvillimit të vreshtarisë, pemtarisë dhe ullirit” dhe të V.K.M. nr.10, datë, 04.01.2008, “Për mbështetjen e Prodhimit Bujqësor”, në të cilat gratë janë trajtuar si të barabarta në shpërblimet apo dhënien e subvencioneve nga ana e MBUMK. Edhe legjislacioni bankar i ofron mundësinë e marrjes së huave kujtdo, pa dallim në lidhje me seksin, apo vendbanimin. Shteti ofron kushte më të leverdisshme për pagesën e huave bujqësore, por sërish asnjë dallim nuk bëhet në varësi të gjinisë.

366. Edhe në Kodin Civil disa nene iu referohen familjeve bujqësore. Pronësia e kësaj familjeje iu përket të gjithë anëtarëve, të cilët përmes punës apo të drejtave të tjera kanë kontribuar në krijimin dhe mbajtjen e kësaj veprimtarie të përbashkët ekonomike. Sipas nenit 224 të Kodit Civil familja bujqësore përfaqësohet nga kryetari i saj në marrëdhëniet tregtare, ose pasurore me të tretët. Antarët e familjes bujqësore zgjedhin kryetarin e tyre, i cili ndonëse ligjërisht mund të jetë si femër, ashtu edhe mashkull, në praktikë dhe me marrëveshje të heshtur është thuar se gjithmonë burrë. Edhe rastet e regjistrimit të pasurisë në emër të burrit nuk janë të rralla. Po të kemi parasysh vështirësitë në jetën e përditshme që hasin gratë fshatare, ndoshta më mirë do të ishte që të ndërmerren masa legjislative dhe akte të tjera nënligjore, që praktikisht t'u ofrojnë atyre më shumë mundësi reale. Më mirë duhet të funksionojnë institucionet, dhe autoritetet e ngarkuara me detyrën specifike që të monitorojnë zbatimin e legjislacionit që mbron të drejtat e grave në zonat rurale në nivelin lokal.

367. MBUMK në strategjitë e saj sektoriale të bujqësisë dhe të zhvillimit rural për vitet 2007-2013 e ka përcaktuar prioritarë rolin e gruas fshatare në formimin e kooperativave të prodhimit. Kjo strategji e ka përcaktuar si prioritar edhe trajtimin e barabartë që ju duhet bërë këtyre grave në drejtim të dhënies së kredive, apo të pagesave direkte. Përfshirja e një numri të madh të grave në procesin e kooperativizimit konsiderohet si primar, pasi dihet roli i tyre (edhe pse jo i dukshëm), si në vendimmarrje, ashtu dhe vetë brenda familjeve fermere. Gjithashtu në Strategjitë e Bujqësisë për vitet 2007-2013, janë parashikuar dhe programe bashkëpunimi me pushtetin vendor për promovimin e gruas rurale, sidomos në aktivizimin direkt të saj në vendimmarrje, si dhe sigurimi i ndihmave financiare për zhvillimin e aktiviteteve të organizuara prej tyre. Kjo strategji e hartuar si një nevojë e Qeverisë së RSH për një politikë të integruar, koherente dhe rajonale ka si objektivi strategjik, pikërisht reduktimin e pabarazisë aktuale ekonomike dhe sociale ndërmjet rajoneve të vendit.

Situata e përgjithshme e grave në zonat rurale dhe masat për eliminimin e diskriminimit ndaj tyre

1. Situata e përgjithshme e grave në zonat rurale

368. Diskriminimi i grave në zonat rurale është jo pak i dukshëm, pasi në këto zona njerëzit akoma ushqejnë mjaft zakone dhe praktika kulturore të prapambetura që pengojnë gratë në arritjet e tyre. Duhet theksuar se, zbatimi në jetën e përditshme dhe gëzimi në realitet i të drejtave të grave në zonat rurale ballafaqohet me vështirësi, pengesa, paragjykime dhe praktika diskriminuese të trashëguara nga e kaluara dhe të ringjallura nga rrethanat e jetës social ekonomike të vendit. Sipas mendimeve të disa analistëve dhe studiuesve të problemeve sociale, gratë në zonat rurale në përgjithësi nuk trajtohen me të njëjtin respekt që vihet re ndaj grave në zonat urbane, pasi zonat rurale nuk ecin me hap të njëjtë zhvillimi me atë të zonave urbane. Në mënyrën e të menduarit dhe të vepruarit janë rrënjësor shumë norma dhe zakone të vjetra dhe këto pranohen nga të gjithë. Në një vend si Shqipëria kultura diskriminuese me bazë gjinore nuk është thjesht një çështje e shkeljes së të drejtave të grave e vajzave, por pabarazia gjinore përbën një pengesë serioze për procesin e përshtetimit të reduktimit të varfërisë.

369. Shifrat tregojnë se, në Shqipëri varfëria është prezente dhe në mënyrë të veçantë në zonat rurale. (Tab.6.1 & 6.3-INSTAT). Sipas vëzhgimeve të fundit të LSMS 2005

rezulton se, 18.5% e shqiptarëve janë të varfër. Kjo shifër është edhe më e lartë në zonat rurale ku ajo rezulton të jetë 24.2%. Krahasuar me vitin 2002 varfëria rurale është ulur me (-18 %), pra me ritme më të ulta se ajo urbane (-38%). Duke ju referuar varfërisë absolute (LSMS 2005) mund të thuhet se, përqindja e grave të varfra me moshë 15 vjeç e lart në zonat rurale, është dy herë më e lartë (22%) në krahasim me nivelin e varfërisë së grave të kësaj moshe, por që jetojnë në zonat urbane (10%). Në kuadër të politikave sociale për zbutjen e varfërisë dhe mbështetjen e familjeve të varfëra, një rol të rëndësishëm po luan sistemi i mbrojtjes sociale. Pjesë përbërëse e tij është skema e ndihmës ekonomike\asistencës sociale, e cila funksionon që prej vitit 1993 në MPÇSSHB. Nëpërmjet këtij programi ofrohet një minimum të ardhurash nga shteti për plotësimin e nevojave të domosdoshme për familjet pa të ardhura, ose me të ardhurave të pamjaftueshme në zonat urbane dhe rurale.

370. Në shoqërinë shqiptare e në mënyrë të veçantë në zonat rurale, tradicionalisht gratë mbajnë barrën kryesore të punëve në familje. Megjithatë, ato kanë akses më të ulët se burrat ndaj burimeve dhe oportuniteteve që nevojiten për të përmbushur përgjegjësitë familjare dhe shoqërore. Parë në këtë këndvështrim dhe në përpjekje për t'iu përgjigjur sa më mirë edhe Rekomandimeve të Komitetit CEDAW (Paragrafet 36 dhe 37), institucionet zyrtare në bashkëpunim edhe me OJF-të kanë ndërmarrë një sërë masash që synojnë zbutjen dhe eliminimin e diskriminimit ndaj gruas fshatare. Megjithëse të gjithë janë koshientë për faktin, që akoma ngelet shumë për të bërë në këtë drejtim, nuk mund të mos evidentohen edhe ato masa që janë ndërmarrë për të luftuar diskriminimin ndaj grave fshatare, ndër të cilat mund të përmëndim:

2. (a) Pjesëmarrja aktive në zhvillimin e fshatit dhe në avantazhet që të sjell ai.

371. Gratë në zonat rurale në Shqipëri mund të jenë të interesuara që të marrin pjesë aktive në planifikimin e zhvillimit në të gjithë nivelet, por ndryshimet strukturore dhe ndryshimet në teknologji janë një ngarkesë suplementare në mënyrë të veçantë për to. Shumë lehtësira komunitare dhe sociale si psh, kopshtet nuk ekzistojnë më, ndërkohë që më parë jo vetëm që funksiononin, por ishin falas, ose shërbimet ishin lehtësisht të përballueshme. Bujqësia nuk është akoma aq e mekanizuar, sa të krijojë mundësi reale për pakësimin e orëve të punës prodhuese dhe shtimin e orëve të lira, si për çlodhjen personale, ashtu dhe për kujdesjen ndaj fëmijëve, apo punët e tjera në familje. Si rrjedhojë, ngarkesa e dyfishtë e punës prodhuese dhe riprodhuese ju lë grave pak kohë dhe energji për të marrë pjesë aktivisht në çështjet komunitare. Megjithatë, të dhënat në terren tregojnë, që gratë janë të përfshira në takimet në nivel komunitar dhe vendimet e dala nga këto takime marrin në konsideratë edhe komentet e grave.

2. (b) Përfitimi i shërbimeve të përshtatshme shëndetsore në zonat rurale.

372. Në zonat rurale ekzistojnë mundësitë për të marrë informacion specifik mbi kujdesin shëndetsor. Kur kujdesi mjekësor profesionist nuk është i disponueshëm gratë iu referohen qëndrave mjekësore në qytet, ku shërbimet për shëndetin riprodhues të grave, planifikimin familjar, shëndetin amtar, etj janë falas. OJF-të në bashkëpunim me qeveritë vendore punojnë për të mbushur hendekun informativ në drejtim të kujdesit të përgjithshëm shëndetsor dhe në veçanti për shëndetin riprodhues. Në zonat e largëta është vënë re një migrim i gjerë, ose para disa vitesh konstatoheshin edhe braktisje të detyrës nga ana e stafit mjekësor dhe si rrjedhojë një

numur qëndrash shëndetësore detyroheshin të mbylleshin, por aktualisht ky fenomen thuhet të jetë zhdukur. Përveç kësaj, në komunitetet e mëdha prej 2000-3000 banorësh po ndërtohen qendra të reja shëndetësore.

373. Për të inkurajuar mjekët e përgjithshëm për të shërbyer në zonat e largëta me pak, ose aspak kujdes shëndetësor jepet pagë shtesë. Përsa ju takon stomatologëve dhe farmacistëve, këto janë shërbime të privatizuara krejtësisht dhe ofrimi i këtyre shërbimeve varet nga interesat e individëve, prandaj këto shërbime janë më tepër prezent në zonat fushore, se sa në zonat e thella malore të vendit. Duke qenë se mjekët/et dhe kirurgët/et kanë emigruar në qytetet kryesore të vendit, mungesa e personelit të kualifikuar mjekësor në zonat më të vogla dhe të largëta ka krijuar vështirësi në këto shërbime. Shumica e pacientëve ende shkojnë në Tiranë për të zgjidhur problemet e karakterit shëndetësor. Gratë dhe burrat përballen njësoj me vështirësi në drejtim të sigurimit të shërbimeve për kujdesin shëndetësor. Duhet thënë se, 98% e lindjeve kryhen në Institucionet Shëndetësore dhe vetëm në disa raste (0,2%) ka të dhëna që gratë ende lindin në shtëpi dhe pa asistencë mjekësore. Kjo mund të shpjegohet me nivelin arsimor dhe statusin social-ekonomik. Grupet me status më të ulët social-ekonomik kanë më pak akses në shërbimet e kujdesit para lindjes dhe gratë me arsim më të lartë e kuptojnë më mirë nevojën për të kërkuar shërbim shëndetësor para lindjes.

374. Kushtet e qëndrave shëndetësore në zonat rurale shpesh herë nuk janë optimale. Megjithëse stafi mjekësor në zonat rurale merr pjesë në trainime të shpeshta, individët mund të sigurojnë shërbim të specializuar shëndetësor vetëm në zonat urbane. Zgjedhja e bazuar në informacion nuk është ende e zakonshme për gratë në zonat rurale. Ato veçanërisht nuk kanë informacion mbi shëndetin mendor. Ndërkohë që gratë duan të informohen, ka raste që ato pengohen nga shoqëria, familja dhe bashkëshortët e tyre. Sipas observacioneve të kryera nga OJF-të rezulton që, nëqoftëse një gruaje i duhet të marrë informacion dhe këshilla për planifikimin familjar, asaj shpesh i duhet të marrë leje nga bashkëshorti, ose nga vjehrra. Aksesit i dobët në shërbimet shëndetësore dhe arsim, mungesa e lirisë së përdorimit të metodave të planifikimit familjar, të qënurit objekt i dhunës, i keqtrajtimit dhe veprimeve arbitrare brenda familjes ndikojnë në agravimin e varfërisë në këtë kategori të popullsisë.

375. Meqënëse puna në zonat rurale është më e vështirë nevojiten fushata sistematike për ngritjen e ndërgjegjësimit për rritjen e shkallës së përkujdesjes për shëndetin. Gratë zakonisht kërkojnë ndihmë vetëm kur ato sëmuren dhe në përgjithësi i shmangin kontrollet periodike. Në zonat rurale 85% e grave marrin kujdes gjatë shtatzanisë, kurse 15% e tyre ende nuk shkojnë për ekzaminime periodike gjatë shtatzanisë, kryerja e rregullt e të cilave ndihmon për të shmangur shumë komplikime që mund të shfaqen gjatë dhe pas lindjes. Ekzaminimet e rregullta mjekësore nuk janë bërë pjesë e përkujdesjes për shëndetin, si për gratë e moshuara, ashtu edhe për ato me paaftësi. Pacientet femra mund të zgjedhin shërbimet dhe në këtë aspekt ato mund të preferojnë doktorëshat për ekzaminimet dhe doktorët për ndërhyrjet kirurgjikale. Gjithashtu, më shumë vëmendje i duhet dhënë grave më të moshuara gjatë kohës së menopauzës.

2. (c) Përfitimi i drejtpërdrejtë nga programet e sigurimeve shoqërore.

376. Në ligjin nr.7703, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe në VKM nr.167, datë, 29.03.2006 “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë, 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në RSH i ndryshuar”, ndër të tjera është trajtuar dhe problemi i përfitimit të drejtpërdrejtë të grave fshatare nga programet e sigurimeve shoqërore. Konkretisht, në VKM nr.167, datë, 29.03.2006, thuhet që: “Në zonat rurale të vetëpunësuarit në bujqësi (përfshirë edhe gratë fshatare, bujkeshat) duke qënë se kanë tokë (dhënë sipas ligjit për tokën), kryejnë aktivitet bujqësor e blegtoral dhe sipas skemës së sigurimeve shoqërore konsiderohen të siguruara. Për rrjedhojë ato përfitojnë pensione pleqërie, invaliditeti, familjar dhe pagesë në rast barrë-lindje. Kontributet e sigurimeve shoqërore për të vetëpunësuarit në bujqësi përballohen, një pjesë nga vetë të vetëpunësuarit në këtë sektor, kurse pjesa më e konsiderueshme përballohet nga buxheti i shtetit. Nga ky program përfitojnë pa dallim burrat dhe gratë, të cilët janë të vetëpunësuar në bujqësi”.

3. (d) Arsimimi

377. Kultura e familjes fshatare në fshat është e lidhur ngushtë me nivelin e edukimit të pjestarëve të saj. Në këtë periudhë si shumë probleme të tjera edhe çështja e arsimit në fshat shfaq prirje kontradiktore, madje bie në sy një sens negativ. Në fshat vihet re një tendencë neglizhimi për shkollën nga minorenët, ku si shkaqe kryesore evidentohen: faktori ekonomik, dëshira për tu punësuar në fermën e tyre, si dhe motive të tjera sociale siç janë pengesa nga familja, hasmeritë, pasiguria e vajzave për të vazhduar shkollën, etj. Për këto arsye, vajzat në zonat rurale e kanë më të vështirë të vazhdojnë arsimin në shkollat e mesme dhe kjo ka bërë që numuri i vajzave në zonat fshatare, të cilat ndjekin shkollat e mesme të vijë në rënie. Faktet tregojnë që, në zonat rurale brezi i ri i grave në fshat do të vuajë “dënimin” shtesë të analfabetizimit, i cili është ende një dukuri e pranishme tek gratë fshatare. Në zonat rurale 7% e grave janë analfabete dhe kjo shifër është rreth 2 herë më e lartë, në krahasim me zonat urbane (3.5%, sipas LSMS 2005). Nga një kënd vështrim etnografik i fshatrave në veri të Shqipërisë vihet re se, braktisja e shkollës nga vajzat me moshë mbi 14 vjeç është në shifra të larta.

378. Diskriminimi arsimor i vajzave në fshat ka tendencë të thellohet edhe për shkaqe të tjera morale si, martesat në moshë të re, rregullat dhe zakonet që i shoqërojnë ato, punët e rënda dhe të përditshme të shtëpisë etj. Përveç këtyre, shkollat e mesme më të afërta shpesh janë në qytet dhe frika reale e sulmeve apo rrëmbimeve të vajzave bëjnë që frekuentimi të konsiderohet më i rrezikshëm në sytë e shumë prindërve të tyre. Në kuadrin e Ligjit për Qeverinë Vendore dhe decentralizimin e qeverisë vendore, problemet që lidhen me shkuarjen e vajzave në shkollë, njësoj si djemtë janë zgjidhur individualisht nga komunat. Për shëmbull, megjithëse nuk parashikohet si detyrim ligjor, në disa zona të thella malore si në komunat e Fushë Arrëzit, Malësisë së Madhe etj, apo në jug të vendit në komunën e Delvinës kanë funksionuar shërbime me autobuzë urbanë që mbledhin nxënësit dhe i dërgojnë në shkollë çdo ditë. Ky shërbim nuk është kombëtarizuar, por nisma të tilla ndodhin vetëm në zona ku qeveria vendore është më e ndërgjegjësuar për çështjet e barazisë gjinore.

379. Gjithashtu, më shumë duhet bërë në lidhje me integrimin e grave rurale që kanë emigruar së fundi në zonat urbane. Këto gra që janë vetëm me arsim fillor dhe punojnë në kushte të vështira, kanë familje të mëdha me 5-6 fëmijë të vegjël, të cilët kanë nevojë për kujdesin e prindërve. Nga ana tjetër, mungesa e një transporti urban

të rregullt e vështirëson edhe më shumë problemin. Për integrimin në shoqëri të kësaj kategorie grash ndihet nevoja e hartimit të politikave të reja konkrete, pa bërë dallime midis zonave urbane dhe atyre rurale.

380. Vlen të përmendet si shëmbull pozitiv, mënyra se si është konceptuar për zbatim Strategjia Kombëtare e Sportit 2007-2013, e cila ka shtrirje gjeografike në të gjithë territorin e Shqipërisë pa bërë dallime midis zonave urbane dhe atyre rurale. Në të njëjtën kohë, po kjo strategji i kushton një rëndësi të veçantë decentralizimit të strukturave drejtuese dhe organizuese për sportin, duke i dhënë prefekturave dhe bashkive kompetenca të konsiderueshme në organizimin e sportit në zonat që ato mbulojnë. Edhe pse në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, Strategjia Kombëtare e Sportit 2007-2013 rrit shanset e trajtimit të barabartë mes gruas dhe burrit në aktivitetet sportive, si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale.

2. (e) E drejta për mundësi ekonomike nëpërmjet punësimit, ose vetë-punësimit.

381. Ekzistenca e një shkalle të lartë papunësie, kryerja e shumë punëve në bujqësi, mungesa e mundësive kualifikuese, por dhe niveli arsimor i ulët i bën gratë fshatare shumë më të prekshme nga papunësia dhe varfëria. Përderisa nuk ekzistojnë ndërmarrje të mëdha gratë kanë më pak mundësi për punësim. Kjo nuk është e njëjtë për burrat që mund të emigrojnë për punë sezonale dhe të punësohen në qytet, ose jashtë shtetit. Megjithëse disa agjensi zhvillimi i kanë ndihmuar gratë të fillojnë biznesin e tyre, në përgjithësi ekzistojnë pak mundësi reale për të zhvilluar një biznes të njëjtë nëpërmjet kredisë, si për burrat ashtu dhe gratë.

382. Me politikat e saj, sidomos vitet e fundit MBUMK ka nxitur dhe përkrahur ato projekte që u krijojnë mundësi grave fshatare për të marrë një rol drejtues në aktivitete të ndryshme të komunitetit. Në bashkëpunim dhe me USAID, SNV (Organizatë Hollandeze për Zhvillim), GTZ (Organizatë Gjermane për Bashkëpunim Teknik), Kooperacionin Spanjoll, Kooperacionin Italian, FAO, etj, po punohet sistematikisht me programe të caktuara për përfshirjen e grave fshatare në bizneset e prodhimit, apo të përpunimit të produkteve bujqësore. Sipas Raportit Kombëtar për Zhvillimin Njerëzor (2005) për zonat rurale mungojnë të dhëna zyrtare, në lidhje me hyrjen në programet e kreditit dhe institucionet financiare, si dhe për numrin e grave të vetëpunësuar në këto zona. Në intervistat e kryera për këtë qëllim gratë raportojnë se, kur ndodhi privatizimi i tokave dhe objekteve të tjera, të gjitha pronat që i takonin kooperativave bujqësore ju shpërndanë njësoj femrave dhe meshkujve sipas rregullave zyrtare.

2. (f) E drejta për të marrë pjesë në të gjithë aktivitetet e komunitetit.

383. Tek gratë që jetojnë në zonat rurale, padyshim që nuk mungon dëshira që ato të marrin pjesë në aktivitetet me karakter shoqëror dhe kulturor. Nga ana tjetër, gratë mbajnë peshën kryesore të kujdesit për fëmijët dhe kjo bën që pjesëmarrja e tyre në aktivitetet e komunitetit të influencohet shumë nga nevoja për të përmbushur këtë detyrim të rëndësishëm familjar. Në zonat rurale ka shumë pak shërbime cilësore të nevojshme për të lehtësuar ngarkesën e madhe që kanë gratë në punët e ndryshme. Kështu psh, në shumë zona malore nuk ka çerdhe dhe kopshte dhe kjo i detyron gratë, ose anëtare të tjera të familjes që të kujdesen vetë për fëmijët e tyre.

384. Për më tepër, emigracioni i burrave jashtë shtetit, apo aktiviteti tregtar i burrave i lë gratë të përballojnë vetë pjesën më të madhe të punëve bujqësore. I vetmi argëtim për gratë mbeten festat familjare dhe ato fetare. Ndjekja e programeve televizive mund të jetë një mundësi tjetër argëtuese, por kjo është e lidhur dhe me mundësitë e pakta reale që kanë gratë për kohë të lirë në dispozicion të tyre për aktivitete argëtuese. Në përgjithësi ka nevojë që të punohet më shumë për të orientuar më mirë pjesëmarrjen e grave në jetën komunitare.

385. Ulja e nivelit arsimor ka ndikuar në largimin e gruas fshatare nga jeta publike, politike e shoqërore. Dominanca maskiliste në jetën publike është shumë e evidente në fshat. Numri i burrave në të gjitha strukturat legale të jetës publike e politike në fshat, apo prezenca e tyre në funksione të rëndësishme të strukturave të pushtetit lokal është tepër e lartë, ndërkohë që prania e grave në këto struktura është tepër e ulët. Gruaja në fshat shfaqet kryesisht në nivele të ulta angazhimi në jetën publike dhe në përgjithësi ato janë të privuara nga pjesëmarrja aktive në partitë politike dhe aq më pak në lidërshpin e saj. Sa më i ulët është niveli i saj arsimor, aq më e ulët është edhe fuqia e saj vendimmarëse.

386. Vlen të evidentohet fakti që, pas vitit 2004 e në vazhdim ka ardhur gjithnjë në rritje numuri i shoqatave fshatare të drejtuara nga gratë. Konkretisht, për vitin 2006 në shkallë vendi në tërësi numuroheshin 26.518 shoqata dhe nga këto 1884 (7.1%) janë shoqata fshatare të drejtuara nga gratë. Me ndihmën e shoqatave jeta e grave në fshat ka njohur përmirësime progresive dhe numri i grave pjesëmarrëse në aktivitetet e komunitetit sa vjen e rritet. Kështu psh. Me ndihmën e organizatës CEFA (European Committee for Training and Agriculture) në Elbasan, është bërë e mundur që të punësohen 40 gra në shoqatën agropërpunuese "Koxhas". Në këto lloj veprimtarish akoma nuk pretendohet për vendimmarje nga ana e grave dhe më shumë rëndësi i kushtohet punësimit të tyre nëpërmjet këtyre shoqatave. Shoqata "Tjetër vision", e cila bashkëpunon ngushtë me Bashkinë e Elbasanit, Shërbimet Sociale, Departamentin e Edukimit dhe Policinë ka bërë të mundur aktivizimin e grave të Qarkut të Elbasanit në Qendrën "Hëna e Re", e cila merret me luftën kundër trafikimit dhe dhunës në familje.

4. (g) Marrja e kreditit dhe borxhit bujqësor, si dhe reforma e tokës.

387. Në Kodin Civil parashikohet barazi ndërmjet burrit dhe gruas në lidhje me zotërimin e tokës si pronë e përbashkët e antarëve të familjes bujqësore. Megjithatë, në praktikën administrative gruaja në mjaft raste diskriminohet duke ju mohuar e drejta e barabartë mbi pronësinë, sidomos në transaksionet e ndryshme, të cilat sipas praktikës zakonore, mentalitetit dhe kulturës tradicionale janë një e drejtë ekskluzive e burrit. Edhe në çështjet e trashëgimisë së pronës, në praktikë është burri që e trashëgon atë, pasi femra trajtohet si pjesëtar i familjes që pas martesës shkon në familjen e burrit. Trashëgimi i tokës sipas së drejtës zakonore realizohet në vijën mashkullore, duke përjashtuar vajzat si pjestare të tokës bujqësore. Sidoqoftë, në rastet kur gratë trashëgojnë tokë, zakonisht e trashëgojnë atë nga baballarët e tyre. Sipas zakonit dhe traditës, nëse një grua ka të drejtën e tokës në familjen e origjinës, ajo duhet t'ia dorëzojë familjes këtë pronë kur martohet.

388. Toka në përgjithësi është e regjistruar në emrin e kryetarit të familjes që është në të njëjtën kohë dhe pronari i ligjshëm i pronës, duke i mohuar kështu gruas të drejtën mbi pronën e përbashkët pas martesës. E njëjta gjë zbatohet edhe për regjistrimin e

bizneseve private pavarësisht se kontributi i gruas mund të jetë i barabartë me atë të burrit. Tjetërsimi i pasurisë së familjes bujqësore, shitja, apo dhënia me qira bëhet shpesh pa pëlqimin e gruas dhe duke shkelur vullnetin e saj. Edhe kur toka i takon gruas, ajo konsiderohet pronë e të gjithë familjes dhe gratë zakonisht nuk lejohen të administrojnë tokën sipas dëshirës së tyre. Kjo bën që respektimi i të drejtës së grave për tu njohur dhe pranuar prej burrave si pronare të tokës, apo dhe të objekteve të tjera private që ju takojnë atyre, jo rrallë të jetë në dorë të burrave.

389. Kontributi i gruas në ekonominë e familjes bujqësore është i rëndësishëm, por as ky fakt nuk e favorizon atë për të patur një vend kryesor në drejtimin e saj. Ligjërisht gruaja fshatare është antare e familjes bujqësore dhe ka të drejtën e bashkëpronësisë me antarë të tjerë të familjes, por rrallë herë ajo ka rolin e kryetares së familjes. Nga të dhënat e sondazheve të kryera me familjet bujqësore rezulton se, gruaja mban rolin e kryefamiljarit vetëm në rastet kur është e ve, kur është e divorcuar, ose kur burri është larguar në emigracion afatgjatë.

390. Kur lindin konflikte për tokën, femrat dhe meshkujt kanë të drejtë të mbrojnë pronën e tyre dhe këto raste zakonisht zgjidhen në gjyq. Deri tani nuk është raportuar asnjë rast diskriminimi ndaj grave në këtë fushë. Për shkak të konflikteve të lidhura me pronësinë, lëvizjen demografike dhe mosmarrëveshjet e ndryshme zbatimi i ligjit të tokës (nr. 7501, viti 1991) ka lënë pa tokë një numër të konsiderueshëm të familjeve në fshat. Nga të dhënat e anketimeve 49% e grave të intervistuar thënë që, ligji i tokës nuk është zbatuar plotësisht, ose mënyra e zbatimit të tij ka krijuar mosmarrëveshje midis familjeve. Gjithashtu, 65% e grave të intervistuar deklarojnë se, janë pak të informuara mbi të drejtat e tyre në çështjet e pronësisë. Pjestimi i pasurisë, ku përfshihet edhe toka bëhet nëpërmjet procedurave të ndërlikuara juridike. Për shkak të mosnjohjes së legjislacionit dhe mentalitetit patriarkal gruaja fshatare duke qënë në një pozitë të disfavorshme gjatë këtyre proceseve rrezikohet të humbasë të drejtën e pronësisë. Kjo situatë ndërlikohet më tej edhe nga fakti se në kuadër të zbatimit të ligjit të tokës rregjistrimi i pasurisë sipas Kodit Civil bëhet në emër të burrit si kryetar i familjes dhe vetëm kur ai ka vdekur, rolin e kryefamiljarit e merr gruaja. Prandaj, edukimi me frymën e respektimit të të drejtave të grave fshatare duhet të jetë pjesë integrale e projekteve dhe programeve të adresuara në zhvillimin e zonave rurale.

2. (h) Kushtet e jetesës.

391. Në shoqërinë shqiptare dhe veçanërisht në zonat rurale, tradicionalisht gratë mbajnë barrën kryesore të mirëqënies në familje. Megjithatë, ato kanë akses më të ulët se burrat ndaj burimeve dhe oportuniteteve që nevojiten për të përmbushur përgjegjësitë që ju takojnë. Gruaja në zonat rurale ka nevojë për kushte më të mira materiale për punësim dhe pjesëmarrje në jetën social kulturore, por edhe për më shumë dije, informacion kulturor, asistencë dhe këshillim ligjor. Kushtet e strehimit, higjenës, elektricitetit, furnizimit me ujë, shërbimet e transportit dhe komunikimit të duhur nuk janë njësoj kudo. Megjithëse kushtet e jetesës janë përmirësuar në një shkallë të caktuar, standartet e jetesës në zonat rurale janë më të ulta në krahasim me ato të zonave urbane. Aksesin jo i mirë në infrastrukturën bazë e vështirëson edhe më shumë gjëndjen e grave në zonat rurale duke i bërë ndjeshëm ato, më të pa favorizuara se sa burrat. Shumë prej tyre jetojnë në familje që ende nuk kanë aksesin e ujit të rrjedhshëm në shtëpi (37.5%) dhe të një tualeti (WC) brenda në banesë (51%).

Një pjesë e konsiderueshme e familjeve fshatare, në veçanti në zonat fushore kanë ujë në shtëpitë e tyre. Megjithatë, të dhënat statistikore tregojnë se, rreth 15% e familjeve e bëjnë furnizimin me ujë jashtë ndërtesës dhe rreth 23% përdorin puse, ose depo (Tab.9.1 dhe 9.2 - INSTAT).

392. Ashtu si në zonat urbane, shtëpitë në zonat rurale i plotësojnë nevojat e tyre për ngrohje në mënyrë individuale. Nuk ekziston sistemi i ngrohjes qëndrore., kurse furnizimi me energji elektrike është njësoj problematik si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale, nëse jo më problematik në këto të fundit. Siç tregojnë të dhënat e INSTAT, (Anekset-Tab.9) shtëpitë të fshat paraqiten në gjëndje më të keqe, në krahasim me shtëpitë në zonat urbane. Po kështu mund të thuhet edhe për kushtet e jetesës dhe të punës në tërësi, të cilat janë më të vështira për gratë që jetojnë në fshat. Përsa i takon transportit, në zonat urbane ekziston mundësia për transport, por ky është një shërbim i privatizuar dhe nevojiten burime financiare për të përballuar shpenzimet.

KAPITULLI IV

Neni 15 BARAZIA PARA LIGJIT EDHE NE ÇESHTJET CIVILE

Kuadri Ligjor për Barazinë para ligjit edhe në Çështjet Civile

393. Legjislacioni i Republikës së Shqipërisë (RSH) ka në themel garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, ku parashikohen të drejta sociale, ekonomike dhe politike për të gjithë individët në përputhje të plotë me parimin e mos diskriminimit. Ratifikimi i akteve më të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut është një tregues i përjasjes bashkëkohore të respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri, pa dallim *gjinie*, race, apo bindje.

394. Kushtetuta e RSH përcakton se, në Shqipëri të drejtat dhe liritë themelore të njeriut qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. Neni 18 i Kushtetutës përcakton që, “të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. *Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare, ose filozofike, gjëndja ekonomike, arsimore, sociale, ose përkatësia prindërore.* Askush nuk mund të diskriminohet nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive”. Kushtetuta parashikon që, kufizimet e të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë akt themelor, të cilat mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik, ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kushtetuta nuk e ndalon diskriminimin pozitiv, duke lejuar trajtimin e veçantë, ose mbrojtjen e përkrahjen e veçantë që mund ti bëhet disa kategorive individësh, si për shëmbull të drejtën e mbrojtjes së veçantë nga shteti për martesën, familjen, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja.

395. Sipas Kushtetutës shqiptare, kushdo ka të drejtë të paraqesë padi, ose ankesa para organeve shtetërore. Kodet e Procedurës Penale e Civile i garantojnë cilitdo të drejta të barabarta në të gjitha shkallët e gjykimit. Pjesëmarrja e tyre në gjykim mund të jetë në cilësinë e paditësit, të paditurit, ose dëshmitarit. Kodi Civil përdor gjuhë neutrale nga pikëpamja gjinore, prandaj për për gratë nuk ka kurrfarë pengese ligjore për të marrë pjesë në gjykime dhe gjykata. Përveç kësaj, gratë mund të marrin pjesë

në proces edhe si gjyqtare, prokurore, avokate, eksperte, etj. Ndonëse për këto funksione ka kufizime apo kritere që lidhen me kualifikimin e personit, këto nuk lidhen me gjininë e tij/saj.

396. Së fundi, ligji shqiptar i garanton kujtdo lirinë e lëvizjes. Në bazë të nenit 38 të Kushtetutës, gjithkush ka të drejtën të zgjedhë vendbanimin dhe të lëvizë lirisht nëpër çdo pjesë të territorit shqiptar. Askush nuk mund të ndalohej të udhëtojë lirisht jashtë shtetit. Ligji parashikon, që të gjithë qytetarët kanë të drejtën e pajisjes me pasaportë. Të miturit mund ta marrin pasaportën vetëm me kërkesën e prindërve, ose të kujdestarit. Në këtë rast ligji nuk bën dallim për gruan ose burrin, nënën ose babanë. Gjuha e përdorur nga ky nen i përfshin të dy sekset, pra është jo-diskriminuese. Veç këtyre, neni 12 i Kodit Civil i ofron çdo personi madhor të drejtën për të caktuar lirisht vendbanimin e tij.

397. Barazia në Çështjet Civile. Legjislacioni shqiptar nuk përmban ndonjë dispozitë që të ndalojë diskriminimin e gruas në çështjet civile, por megjithatë përmban një dispozitë që sanksionon të drejta të barabarta. Neni 1 i Kodit Civil përcakton se, “*çdo person fizik gëzon zotësi të plotë dhe të barabartë për të patur të drejta civile dhe për të marrë përsipër detyrime brenda kufijve të përcaktuar me ligj*”. Një person që mbush moshën madhore fiton zotësinë e plotë për të ndërmarrë të drejta e detyrime. Për gratë që martohen para moshës 18 vjeç, kjo ndodh më herët. Neni 4 i Kodit Civil parashikon se, të drejtat civile të një personi mund të kufizohen vetëm me ligj. Ndonëse jo i formuluar posaçërisht për femrat, neni 11 parashikon se: “*çdo veprim juridik, apo akt që synon të kufizojë zotësinë për të vepruar të një individi është i pavlefshëm. Gratë, ashtu si dhe burrat gëzojnë zotësi të plotë për të hyrë në marrëdhënie kontraktore, apo për të nënshkruar instrumente të tjera private, për të administruar prona, të përfshihen në marrëdhënie tregtare, etj, pavarësisht nga gjëndja civile. Çdo akt tjetër që ka për qëllim të kufizojë zotësinë e tyre për të vepruar është i pavlefshëm*”.

398. Programi i Qeverisë përmban tek kapitulli “Natyra sociale e shtetit” një rubrikë të veçantë në lidhje me barazinë gjinore, në të cilin shprehet qartë vendosmëria dhe angazhimi: **a).** për të parandaluar dhe luftuar ushtrimin e dhunës ndaj grave dhe krimin në familje, **b).** për të frenuar përdorimin e tyre për qëllime prostitucioni, apo qëllime të tjera shfrytëzuese, **c).** për të patur një akses më të lartë të gruas në tregun e punës, në shanset për karrierë zyrtare, politike, biznes, **d).** si dhe për ti dhënë përparësi politikave që nxitin dhe promovojnë barazinë gjinore në zonat rurale e të papambetura të vendit.

399. Pikërisht, duke qënë i bazuar në këtë program projekt-ligji “Për barazinë gjinore” ka si qëllim: **1).** të sigurojë mbrojtje efikase nga diskriminimi gjinor dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin gjinor; **2).** të përcaktojë masa për garantimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave e burrave për të eliminuar diskriminimin e bazuar në gjini, në çfarëdo lloj forme që ai mund të shfaqet; **3).** të përcaktojë përgjegjësitë e autoriteteve shtetërore, qëndrore dhe vendore për të hartuar dhe zbatuar aktet normative, si dhe politikatat që mbështesin zhvillimin dhe nxitjen e barazisë gjinore në shoqëri.

400. Po ashtu, ligji nr.9669, datë,18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” ka si qëllim, “*Parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj me anën e masave të përshtatshme ligjore, si dhe garantimin e mbrojtjes me*

masa ligjore të pjestarëve të familjes, të cilët janë viktima të dhunës në familje duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar". Ky ligj administrativo-civil sanksionon krijimin e rrjetit të koordinuar të institucioneve qeveritare për t'iu përgjigjur në kohë rasteve të dhunës në familje, si dhe lëshimit të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrave të mbrojtjes nga gjykatat.

Masat për garantimin e barazisë para ligjit në Çështjet Civile

1. Barazia e njëjtë para ligjit.

401. Ndërkohë që ekziston baza ligjore, nevojitet kryerja e më shumë analizave studimore për të identifikuar fushat në të cilat gratë nuk trajtohen njësoj me burrat, përse ju takon çështjeve civile. Përpjekjet për të informuar publikun e gjerë mbi barazinë gjinore janë bërë, kryesisht nëpërmjet ish-Komitetit për Mundësi të Barabarta (KMB) gjatë periudhës 2002-2005. Nga marsi i vitit 2006 e në vazhdim sensibilizimin për çështjet gjinore e ka si detyrë Sektori i Barazisë Gjinore në Drejtorinë e Politikave dhe Shanseve të Barabarta (DPSHB). KMB-ja dhe më pas DPSHB-ja kanë organizuar sesione trainimi në zona të ndryshme të Shqipërisë për të ndërgjegjësuar përfaqësuesit/et e OJF-ve dhe qeverive lokale, në lidhje me legjislacionin shqiptar dhe atë ndërkombëtar për të drejtat e grave, përfshirë dhe leksione mbi Platformën e Veprimit të Qeverisë Shqiptare, si dhe Konventën CEDAW duke e komentuar atë nen për nen. Këto përpjekje u financuan nga donatorë të ndryshëm si Organizata Ndërkombëtare e Punës, Fondacioni Soros "Shoqëria e Hapur për Shqipërinë", PNUD-i, Fondacioni *Friedrich Ebert*, OKB dhe OSBE.

2. Njohja e zotësive juridike të njëjta me burrat, duke përfshirë dhe të drejtën për të përfunduar kontrata.

402. Pjesëmarrja e grave në nisma biznesi është e ulët, rreth 27 %. Shumica e grave janë të angazhuara në ndërmarrje të vogla biznesi. Kjo ndodh sepse pronësia e biznesit nuk konsiderohet si partneritet midis burrit dhe gruas, por si pronë e burrit dhe gruaja përfshihet për të lehtësuar detyrimet fiskale. Një nga arsyet që ndalon gratë të angazhohen në biznes është se, shumë individë ende perceptojnë angazhimin në biznes, si një aktivitet korruptiv që nuk është i përshtatshëm për gratë. Gjithashtu, nevojitet hartimi i politikave specifike, që të inkurajojnë gratë për t'u angazhuar në aktivitetet e biznesit.

3. Mbrojtja e zotësisë juridike të gruas.

403. Duke marrë në konsideratë legjislacionin shqiptar mund të thuhet se ai i del në mbrojtje grave, pasi nëqoftëse në praktikë konstatohen kontrata, ose instrumente legale që kufizojnë aftësitë juridike të grave, ato konsiderohen të pavlefshme. Sidoqoftë, deri në momentin aktual nuk ka të dhëna konkrete, të cilat mund të nxirren nga studimet që bëhen për të përcaktuar nëse ka ndonjë anshmëri mbi bazë të përkatësisë gjinore në arsyetimin, praktikat, apo në vendimet juridike.

4. Sigurimi i lirisë së lëvizjes dhe zgjedhjes së vëndbanimit.

404. Në Shqipëri, gratë në përgjithësi, nuk janë aq të lira sa burrat për t'u angazhuar në aktivitete jashtë shtëpisë. Megjithëse gratë mund të duan të largohen nga shtëpia

vetëm, kjo shpesh është e vështirë në praktikë, sidomos në zonat rurale përderisa burrat nuk janë të mësuar me zgjedhje të tilla. Duke u bazuar në intervistat e grave në zonat rurale, rezulton që gruaja shpesh duhet marrë aprovimin e burrit kur shkon në një aktivitet, me përjashtim të rasteve kur bëhet fjalë për shërbime mjekësore, kurse “urgjencat për sëmundje përjashtohen nga ky rregull”. Po ashtu, gratë që jetojnë në zonat urbane zakonisht konsultohen me bashkëshortët, nëse duan të punojnë jashtë shtëpisë, apo të udhëtojnë jashtë shtetit. Miratimi që ju jepet grave për të vizituar një qëndër sociale, ose për t’u angazhuar në aktivitete jashtë shtëpisë në zonat rurale, ndonjëherë është e lidhur me interesin e burrave për të siguruar nga komuna një nxitje, apo mbështetje ekonomike. Kërkimi i këtij miratimi perceptohet nga gratë e intervistuarat për këtë çështje, si traditë dhe si shënjë respekti për brezat që jetojnë së bashku.

Neni 16

MARTESA DHE JETA NE FAMILJE

Kuadri ligjor për martesën dhe jetën në familje

405. Legjislacioni shqiptar për martesën dhe jetën familjare përputhet mirë me Nenin 16 të Konventës CEDAW. Kushtetuta (neni 53) i garanton çdokujt të drejtën për t’u martuar dhe për të patur familje. Pas një pune të gjatë disavjeçare në tetor 2004 u publikua Kodi i ri i Familjes, i cili parashikon barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve. (miratuar me ligjin Nr. 9062, datë, 08.05.2003). Në këtë kod janë reflektuar të gjitha aktet ndërkombëtare të kësaj fushe, ku Shqipëria është palë. Neni 1 i këtij kodi parashikon gjithashtu se, “*martesa, si një bashkëjetesë ligjore mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza e unitetit në familje. Martesa dhe familja gëzojnë mbështetjen e veçantë të shtetit. Pëlqimi i lirë i të dy bashkëshortëve i shprehur para nëpunësit të gjendjes civile përbën një kusht të rëndësishëm për vlefshmërinë e martesës*”.

406. Miratimi i Kodit të ri të Familjes eliminoi diskriminimin për moshën minimale të martesës që figuronte në Kodin e mëparshëm të vitit 1982, i cili parashikonte moshën të ndryshme për martesë, respektivisht për djalin 18 vjeç, kurse për vajzën 16 vjeç. Kodi i ri i Familjes parashikon, që martesë mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç. Gjykata e vendit ku lidhet martesë, për shkaqe me rëndësi, mund të lejojë martesën edhe para kësaj moshe. Pra, kodi i ri nuk përmban klauzola diskriminuese ndërmjet gjinive. Për shkaqe me rëndësi (kryesisht shtatzania) gjykata mund të autorizojë martesën para mbushjes së moshës ligjore. Ndërkohë që fejesën, ligji shqiptar nuk e njeh dhe nuk e rregullon, martesën e të miturve e konsideron të pavlefshme.

407. Kodi i Familjes, kur jep përkufizimin e martesës deklaroi barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve si një parim bazë të rëndësishëm. Në martesë, burri dhe gruaja kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime, përsa i përket besnikërisë, dashurisë dhe respektit reciprok, mbështetjes morale dhe materiale, bashkëpunimit, rritjes dhe edukimit të fëmijëve. Kur njëri nga bashkëshortët nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga martesë, bashkëshorti tjetër (pa bërë dallim gjinor) mund të kërkojë nga gjykata marrjen e masave urgjente. Qëllimi i tyre është të detyrojnë bashkëshortin të zbatojë detyrimet e tij ndaj familjes. Kodi i Familjes kërkon mirëkuptimin reciprok dhe pëlqimin e të dy bashkëshortëve për çështje që kanë të bëjnë me banesën e tyre

bashkëshortore, me administrimin e pasurisë, lidhjen e kontratave martesore, zgjedhjen e regjimit pasuror, madje kërkon pëlqimin e palëve edhe për rastet e zgjidhjes së martesës. Rastet e tjera të zgjidhjes së martesës bëhen me ngritjen e padisë nga njëri prej bashkëshortëve. Përsa i përket rregjistrimit të martesës, neni 30/2 i Kodit të Familjes përcakton që: “*Akti i martesës hartohet menjëherë, nënshkruhet nga bashkëshortët, dëshmitarët dhe nëpunësi i Zyrës së Gjëndjes Civile dhe rregjistrohet në rregjistrin e martesave*”. Ndërkohë, Ligji për Gjëndjen Civile vendos detyrimin për regjistrimin e martesës në Librin e Martesave dhe krahas kësaj parashikon edhe rregullat procedurale për këtë veprim.

408. Vlen të evidentohet fakti që, legjislacioni shqiptar e trajton dhunën mbi baza gjinore, duke përfshirë dhe dhunën në familje. Për herë të parë, neni 62 i Kodit të Familjes parashikon mundësinë që një bashkëshort të kërkojë nga gjykata largimin e bashkëshortit të dhunshëm nga banesa bashkëshortore për një kohëzgjatje deri në 3 vjet. Kjo dispozitë përdor një gjuhë neutrale nga pikëpamja gjinore, por studimet dhe vëzhgimet në Shqipëri tregojnë se gratë janë më të rrezikuara nga kjo formë dhune, gjë që të çon në konkluzionin se, kjo dispozitë synon të mbrojë kryesisht gratë. Mirëpo kjo dispozitë e vetme është e vështirë të zbatohet nga gjykatat pasi ka nevojë të shoqërohet me dispozita të tjera procedurale. Kodi Penal shqiptar penalizon dhunën ndaj grave, ose në mënyrë specifike, ose nëpërmjet dispozitave më të përgjithshme. Edhe në ligjin për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare (Ligji nr.9669, datë, 18.12.2006) parashikohen, ndër të tjera, masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje, subjektet që kanë të drejtën për të kërkuar urdhrin e mbrojtjes, rrethanat për ndryshimin, ndërprerjen dhe vazhdimin e urdhrin të mbrojtjes e të tjera dispozita relevante.

409. Legjislacioni shqiptar tregon gjithashtu, kujdes të veçantë për pëlqimin dhe mbrojtjen e jetës familjare. Kështu, Kodi Penal i kushton një seksion të veçantë mbrojtjes së fëmijëve, martesës dhe familjes. Kodi Penal konsideron si vepra penale dhe vendos sanksione (gjobë ose burgim) për veprimet e mëposhtme:

- (a) braktisjen e fëmijëve të mitur;
- (b) mosdhënien e mjeteve për jetesë fëmijëve dhe familjes;
- (c) mosnjohimin e ndryshimit të vëndbanimit;
- (d) marrjen e padrejtë të fëmijës dhe
- (e) shtrëngimin, apo pengimin për të bashkëjetuar, ose për të zgjidhur martesë.

Mbrojtje e mëtejshme sigurohet gjithashtu, nga dispozitat që trajtojnë abuzimin seksual me të mitur. Në legjislacionin shqiptar nuk ka ndonjë rregullim për robërinë shtëpiake (mbajtjen e detyruar të një personi në shtëpi si shërbëtor/e).

410. Barazia e bashkëshortëve është parim në legjislacionin shqiptar dhe gjen zbatim edhe pas zgjidhjes së martesës, kur bëhet fjalë për pjesëtimin e pasurisë dhe zgjidhjen e çështjeve të tjera. Neni 147 parashikon që, gjykata mund të urdhërojë njërin bashkëshort që t'i paguajë tjetrit një kontribut që ka për qëllim të kompensojë pabarazinë në nivelin e jetesës që mund të rrjedhë nga pjesëtimi i pasurisë. Neni 153, nga ana tjetër, i jep të drejtën bashkëshortit jo-pronar të vazhdojë të përdorë banesën bashkëshortore edhe pas zgjidhjes së martesës, kur atij/asaj i besohet përgjegjësia prindërore, ose kur bashkëshorti pronar ka braktisur familjen.

411. Familja, si institucioni më i qëndrueshëm i shoqërisë shqiptare, mbetet një element i rëndësishëm në luftën kundër diskriminimit dhe dhunës ndaj vajzave dhe

grave. Jo rrallë herë, konstatohet një ndarje e pabarabartë në lidhje me punët e shtëpisë dhe kujdesin në familje, si dhe një prirje e grave për të kontribuar më shumë në familje, se sa në shoqëri. Nga neni 215 i Kodit të Familjes, përkufizimi i përgjegjësisë prindërore jepet si, *“tërësia e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqënien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij”*. E drejta familjare shqiptare parashikon të njëjtat të drejta dhe detyrime për të dy prindërit kundrejt fëmijëve të tyre, pavarësisht nga gjendja e tyre martesore. Ndonëse janë kryesisht gratë ato që mbajnë barrën më të madhe, Kodi i Familjes përdor nga pikëpamja gjinore, termin neutral *“prind”*. Kushtetuta dhe Kodi i Familjes vendosin barazinë e fëmijëve të lindur nga martesë, apo jashtë martesë. Neni 3/1 i Kodit të Familjes e përforcon këtë parim: *“Prindërit kanë detyrë dhe të drejtë të kujdesen për mirërritjen, zhvillimin, mirëqënien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të lindur nga martesë, ose jashtë martesë”*.

412. Po kështu, zgjidhja e martesës nuk i ndryshon këto të drejta dhe përgjegjësi ndaj fëmijëve, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ky Kod. Prindi, të cilit nuk i është besuar fëmija për rritje dhe edukim, ruan të drejtën të mbikqyrë rritjen dhe edukimin e fëmijës si dhe të informohet në lidhje me zgjedhjet e rëndësishme për jetën e fëmijës. Gjithashtu ky prind ruan edhe të drejtën e vizitës. Për birësimin kërkohet pëlqimi i të dy prindërve biologjikë. Kodi nuk bën ndonjë dallim mbi bazën e seksit për prindërit adoptivë dhe përdor termin *“prind adoptiv”*. Një ndryshim që ka lidhje me seksin është ai që ka të bëjë me mbiemrin e fëmijës, si në rastin kur ky është natyral, ashtu dhe në rastin kur është i adoptuar. Fëmija merr mbiemrin e përbashkët të prindërve, ose mbiemrin që prindërit vendosin me marrëveshje, nqs ata mbajnë mbiemra të ndryshëm. Në rast mosmarrëveshjeje fëmija merr mbiemrin e babait. Gratë bashkëshorte gëzojnë të njëjtat të drejta në lidhje me mbiemrin e tyre. Ato janë të lira të mbajnë mbiemrin e vet, apo të marrin mbiemrin e bashkëshortit (nuk bëhet dallim për nga seksi).

413. E drejta mbi pronësinë. Neni 63 i Kodit të Familjes parashikon të drejtën e secilit bashkëshort (burrit apo gruas) për të ushtruar një profesion dhe për të disponuar të ardhurat nga puna apo nga burime të tjera, në bazë të regjimit pasuror të zgjedhur, pasi të kenë kontribuar në detyrimet që rrjedhin nga martesë. *Bashkëshortët kanë të njëjtat të drejta mbi pronësinë, përfshi fitimin, administrimin, gëzimin dhe disponimin*. Ndërsa secili nga bashkëshortët ka të drejtën të administrojë dhe disponojë lirisht pasurinë vetjake, pëlqimi i bashkëshortit tjetër është i domosdoshëm në rastin e disponimit të banesës bashkëshortore dhe pajisjeve të saj. Gjithashtu, bashkëshortët janë të lirë të lidhin një kontratë paramartesore, ose një kontratë të mëvonshme martesore, ku ata mund të zgjedhin rregjimin pasuror martesor që i përshtatet më shumë mënyrës së tyre të jetesës.

414. Të drejtat dhe detyrimet e prindërve për mirërritjen, zhvillimin, mirëqënien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të lindur nga martesë, ose jashtë martesë janë të njëjta, pa parashikuar ndonjë diferencim të bazuar në gjini. Në përputhje me Konventën për të drejtat e fëmijëve Kodi parashikon, që fëmijët e lindur jashtë martesë kanë të njëjtat të drejta dhe detyra, ashtu si dhe fëmijët e lindur nga martesë. Sipas nenit 220 me titull, *“Ushtrimi i përbashkët i përgjegjësisë prindërore”*, përgjegjësia prindërore u përket dhe ushtrohet së bashku nga të dy prindërit në lidhje me fëmijën

e lindur gjatë martesës së tyre, ose jashtë martesë, nëse fëmija është njohur nga të dy prindërit. Kreu II i këtij Kodi parashikon dispozita në lidhje me rregjimin pasuror martesor në bashkësi, dispozita të cilat nuk bazohen në veçoritë gjinore të bashkëshortëve.

Eliminimi i diskriminimit të grave, në lidhje me të drejtat e martesës dhe jetës familjare

1(a) E njëjta e drejtë për të lidhur martesë.

415. Materialet informative për të drejtat e barabarta në martesë, për regjistrimin në zyrën e gjëndjes civile dhe për zgjidhjen e martesës janë të disponueshme dhe iu jepen njësoj si burrave, ashtu dhe grave. Por në praktikë ndodh që individët për të siguruar dhe shkëmbyer këtë lloj informacionesh mbështeten kryesisht në rrjetet e tyre shoqërore. Kurse në zonat rurale, informacioni në këto fusha jepet në formën e normave dhe vlerave shoqërore që respektohen dhe vlerësohen nga të gjithë antarët e komunitetit. Moshë mesatare e grave që lidhin martesë gjithmonë ka rezultuar të jetë më e vogël se ajo e burrave, ndërkohë që mjaft karakteristik është fakti që, si për burrat, ashtu dhe për gratë moshë mesatare e lidhjes së martesës ka qënë thajse e pandryshuar ndër vite, për burrat 27-28 vjeç dhe për gratë rreth 23 vjeç. (Tab. 2.7-INSTAT).

1(b) E njëjta e drejtë për të zgjedhur lirisht bashkëshortin/en dhe për të lidhur martesë vetëm lirisht dhe me pëlqim të plotë.

416. Gratë në Shqipëri kanë të drejtë të zgjedhin burrin lirisht dhe të hyjnë në martesë lirisht dhe me pëlqimin e tyre të plotë. Megjithatë, martesë është e ndërtuar si një normë dhe është e dëshirueshme për statusin shoqëror të gruas. Burrat dhe gratë shqiptare kanë tendencë të martohen herët. Sipas MICS- 2005¹³, (i cili pasqyrohet në tabelën e mëposhtme) më pak se 1% e grave të moshës 15-49 vjeç janë martuar përpara se të mbushin 15 vjeç, ndërsa rreth 8% e grave të moshës 20-49 vjeç janë martuar përpara se të mbushin moshën 18 vjeç. Tendencë që karakterizon këtë fenomen lidhet më shumë me qëndrime sociale të grupeve të caktuara të popullsisë, të cilat kanë trashëguar besime që lidhen me rëndësinë e krijimit të familjes në moshë të hershme. Prandaj ato preferojnë më mirë të martohen se sa të ndjekin shkollën, apo të zhvillojnë aftësitë e tyre për një përfshirje më aktive në shoqëri.

Grupmoshat	Meshkuj	Femra
Deri 19 vjeç	22 %	1 %
20-24 vjeç	49 %	21%
25-29 vjeç	18 %	43 %
30-34 vjeç	6 %	23 %
35-39 vjeç	2 %	7 %
40-44 vjeç	1 %	3 %
45-49 vjeç	1 %	1 %
Mbi 50 vjeç	1 %	1 %
INSTAT - 2004		

¹³ Vrojtimi kombëtar MICS - 2005, INSTAT & UNICEF

417. Përveç kësaj, studimet tregojnë se martesë shpesh perceptohet si qëllim i jetës, megjithëse femrat shqiptare mund të zgjedhin të martohen për t'i shpëtuar varfërisë dhe ndikimeve, apo presioneve në shtëpinë e prindërve. Traditat patriarkale të martesave të rregulluara nëpërmjet autoritetit prindëror janë ende të shpeshta. Vajzat e reja në zonat rurale zakonisht presin që familja e tyre t'u zgjedhë bashkëshortin dhe rrallë e kundërshtojnë zgjedhjen e familjes.

1(c) Të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi gjatë martesës dhe në zgjedhjen e saj.

418. Gratë dhe burrat kanë të njëjta të drejta dhe përgjegjësi, megjithatë gratë perceptohen se kanë pjesën më të madhe të ngarkesës në mirëmbajtjen e shtëpisë. Ndërsa gratë kanë ligjërisht të drejtën të shkurorëzohen bashkëshortin, stigma social-kulturore e bën më të vështirë marrjen e këtij vendimi nga ana e tyre, veçanërisht në zonat rurale.

1(d) Të drejtat dhe përgjegjësitë e prindërve në lidhje me fëmijët.

419. Të dy prindërit kanë të drejta dhe përgjegjësi ndaj fëmijëve, megjithatë gratë janë ato që mbajnë përgjegjësitë më të shumta për kujdesin e fëmijëve. Kjo çështje është trajtuar edhe në pjesën e parë të Nenit 16, tek masat me karakter ligjor për martesën dhe jetën në familje, paragrafi i përgjegjësisë prindërore.

1(e) Numri dhe planifikimi i fëmijëve dhe marrja e informacionit për planifikimin familjar.

420. Edhe çështja e sigurimit të informacionit në lidhje me planifikimin familjar është trajtuar më gjërësisht në Nenet 10, 12, dhe 15 të këtij Raporti.

1(f) Kujdestaria dhe birësimi i fëmijëve.

421. Në lidhje me barazinë para ligjit për kujdestarinë dhe neglizhencën e fëmijëve, të dy prindërit mund t'i drejtohen gjyqit për t'ia hequr të drejtën e kujdestarisë nga prindi tjetër. Vetë përfaqësuesit/et e ligjit pohojnë që, zakonisht gruaja favorizohet më shumë, pasi në shumicën e rasteve kujdestaria e fëmijës i jepet grave. Gjithashtu, gjykatësit/et shpesh bëjnë më shumë lëshime me gratë në rastet e gjyqeve për çështjet familjare.

1(g) E drejta për të zgjedhur mbiemrin, profesionin dhe vendin e punës.

422. Kjo e drejtë ushtrohet nga të gjitha gratë, por sidomos nga ato që jetojnë në zonat urbane. Stereotipet lidhur me profesionin dhe vendin e punës janë të shumta. Vajzat e reja gjenden më shumë të punësuar në shkencat shoqërore dhe filologjike.

1(h) Të drejtat e pronës.

423. Megjithëse gratë mund të trashëgojnë pronë nga baballarët e tyre të drejtat e pronës zakonisht i takojnë të gjithë familjes dhe ndoshta mund të transferohen te

kryetari i familjes. Kjo çështje është trajtuar më me detaje në Nenet 13 dhe 14 të këtij Raporti.

2. Martesa para moshës së pëlqimit dhe vendosja e një rregjistri zyrtar të martesave.

424. Megjithëse mosha ligjore për martesë është 18 vjeç, konstatohen edhe raste të vajzave të reja që martohen në moshën 16 vjeç, sidomos në zonat rurale. Megjithatë nuk ka informacione të sakta mbi shpeshësinë e kësaj dukurie. Martesa para moshës së pëlqimit nuk deklarohet në zyrën e gjëndjes civile, sepse kjo lloj martesë është e dënueshme nga ligji. Në këtë pikë ka vend për t'u përmirësuar puna në drejtim të zhvillimit të fushatave specifike për ndërgjegjësimin e njerëzve, në lidhje me martesën para moshës së pëlqimit. Megjithëse shpesh të padukshme, ende konstatohen martesat në moshë të hershme edhe pse problemet me të cilat duhet të përballen këto vajza të martuara, ose fëmijë-nëna i kufizojnë ndjeshëm shanset e tyre për të ecur përpara në jetë.

IV. KONKLUZIONE

425. Ndonëse gjatë periudhës kohore që ka kaluar prej momentit të dorëzimit të Raportit të Parë dhe të Dytë të Kombinuar CEDAW (2003-2007) nga ana e Qeverisë Shqiptare ka patur progres dhe arritje konkrete pozitive, përsëri ngelet akoma mjaft punë për të bërë, në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të standarteve të barazisë gjinore në shumë fusha të jetës në Shqipëri. Prandaj, në këto konkluzione, krahas arritjeve reflektohen, ndër të tjera edhe sugjerime për punën në të ardhmen në disa nga drejtimet kryesore, ku ndjehet më shumë nevoja e përmirësimit të mëtejshëm të legjislacionit, në kuadrin e përpjekjeve për eliminimin e diskriminimit ndaj grave dhe mbrojtjen nga dhunimi të të drejtave të tyre.

426. Barazia Gjinore ka qënë dhe është pjesë përbërëse e strategjisë zyrtare gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm të shoqërisë shqiptare, në mënyrë të veçantë e aspiratave të Shqipërisë për t'u bërë në një të ardhme afat-mesme, pjesë integrale e Bashkimit European. Në këtë këndvështrim, përpjekjet e vazhdueshme institucionale për një status të ri të gruas shqiptare janë element konstitutiv i politikës së brëndshme dhe të jashtme të Qeverisë së RSH, për të mbrojtur të drejtat e njeriut sipas standarteve të njohura ndërkombëtare.

427. Duke marrë në konsideratë shkallën e implementimit të Konventës CEDAW dhe zbatimin e Rekomandimeve të këtij Komiteti, në intervalin kohor që ka kaluar prej momentit të paraqitjes nga ana e Qeverisë së RSH, të Raportit të Parë dhe të Dytë të Kombinuar, mund të thuhet pa mëdyshje se, janë shënuar hapa përpara dhe progresive, përsa i përket plotësimit të paketës së legjislacionit, që ka të bëjë me sigurimin e barazisë ndërmjet burrit dhe gruas dhe përmirësimit në tërësi të statusit të saj.

428. Megjithë tablonë legjislative përgjithësisht pozitive, zbatimi i ligjit ende përbën sfidë për Shqipërinë. Përmirësimet që i janë bërë legjislacionit shqiptar kanë krijuar mundësinë që gjithmonë e më shumë grave t'u afrohen procedura të përshtatshme, të hapura dhe të përballueshme si mjete ligjore në mbrojtje të dhunimit të të drejtave të tyre. Miratimi nga Parlamenti Shqiptar i Ligjit "Për Barazinë Gjinore" dhe rinovimi i tij

nëpërmjet Projekt-ligjit të ri që pritet të miratohet së shpejti kanë bërë që, në Shqipëri të instalohen për herë të parë dy koncepte shumë të rëndësishme e me karakter detyrues para drejtësisë, siç janë “shoqëria gjinore” dhe “dhunimi i të drejtave të barabarta për gratë dhe burrat”. Integrimi i perspektivës gjinore në të gjitha ligjet dhe politikat, si një koncept i avancuar dhe strategji në vetvete për arritjen e barazisë gjinore do të përbëjë edhe në të ardhmen, një nga objektivat kryesore të punës për të gjithë organet ligjvënëse dhe ligjzbatuese.

429. Krahas forcimit të mekanizmit ekzistues për barazinë gjinore në nivel kombëtar dhe lokal, si arritje për tu evidentuar është dhe ngritja nga ana e Qeverisë Shqiptare e një numri të konsiderueshëm mekanizmash, apo strukturash të reja administrative në funksion të garantimit të barazisë gjinore. Mbi bazën e tyre është arritur një angazhim më i suksesshëm nga ana e institucioneve qeveritare dhe jo qeveritare, në drejtim të hartimit dhe zbatimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2007-2010, si dhe të Programeve specifike që synojnë t’i presin rrugën njëherë e mirë dhunës ndaj grave e vajzave dhe shfrytëzimit të tyre për qëllime trafikimi e prostitucioni, apo synimeve të tjera denigruese.

430. Rritja e nivelit dhe e numrit të përfaqësimit të grave në jetën politike dhe publike do të vazhdojë të jetë një nga prioritetet e Qeverisë shqiptare nisur nga fakti që, interesimi i grave për të marrë pjesë në politikë dhe në vendimmarrje ka ardhur vazhdimisht në rritje. Plani Kombëtar i Veprimit, i cili ka filluar të zbatohet nga Qeveria Shqiptare qysh në fillim të vitit 2008, do të mundësojë përfaqësimin e duhur të grave dhe vajzave në vendimmarrje. Për herë të parë do të sanksionohet pjesëmarrja e barabartë në vendimmarrje, nëpërmjet futjes së kuotave në masën mbi 30 % për postet drejtuese në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv, gjyqësor dhe në institucionet e tjera publike, si dhe nëpërmjet futjes në listat për kandidatë në zgjedhjet vendore.

431. Fusha e luftës kundër krimit të organizuar dhe trafikëve të paligjshme është konsideruar një ndër fushat prioritare për Qeverinë Shqiptare, si dhe një element shumë i rëndësishëm në kuadër të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Angazhimet e ndërmarrja dhe objektivat e përcaktuara kanë shkuar në një linjë me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me BE-në. Në raportet kombëtare e ndërkombëtare Shqipëria nuk konsiderohet një vend tranziti, apo destinacioni për trafikimin e njerëzve, por mbetet ende një vend origjine. Gjatë viteve të fundit, në sajë të seriozitetit të treguar nga ana e Qeverisë Shqiptare, mbështetjes së dhënë nga Organizatat Ndërkombëtare dhe Europiane, si dhe kontrolleve më të shpeshta e më efektive nga ana e autoriteteve të zbatimit të ligjit, është bërë e mundur marrja e rezultateve pozitive në goditjen e këtij fenomeni, ku ndër të tjera evidentohet arrestimi dhe dënimi i shumë autorëve të trafikimit të femrave dhe të fëmijëve.

432. Shqipëria ka bërë përparime, jo vetëm në goditjen e autorëve të krimit të organizuar dhe trafikëve të paligjshme, por edhe të veprave të tjera penale që kanë lidhje me to. Masat ligjore dhe ato organizativo-operacionale që janë ndërmarrë në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikëve të paligjshme kanë mbuluar në mënyrë efektive, në veçanti fushën e investigimit dhe të ndjekjes penale, por pa harruar dhe atë të mbrojtjes dhe parandalimit, fusha në të cilat besohet se përsëri ka nevojë për një punë akoma më e madhe në të ardhmen.

433. Pa mëdyshje mund të arrihet në konkluzionin, se në fushën e arsimit në Shqipëri nuk ka diskriminime. Arsimimi ka qënë jo vetëm një e drejtë e garantuar njësoj, si për vajzat, ashtu dhe për djemtë, por dhe një nga fushat ku ka patur arritje akoma më pozitive në shumë drejtime, në krahasim me vitet e mëparshme. Indeksi i përgjithshëm i rregjistrimit gjatë periudhës 2001-2006 flet për një pjesëmarrje në rritje të femrave në veçanti në nivelin universitar, ku numri më i madh i femrave, në raport me atë të meshkujve reflektohet në të njëjtën mënyrë edhe në shifrat e të diplomuarve. Një arritje pozitive për tu shënuar përbën dhe fakti i konsiderimit të barazisë gjinore, si një kriter i domosdoshëm në procesin e hartimit dhe miratimit të teksteve shkollore të të gjitha niveleve.

434. Eshtë arritur përmirësimi i vazhdueshëm i shëndetit dhe cilësisë së jetës të grave dhe fëmijëve, gjë e cila ka çuar në uljen progresive të vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë së tyre, ndërkohë që Shqipëria vazhdon të ketë nivel të lartë lindshmërie në Europë. Megjithëse Shqipëria konsiderohet një vend me prevalencë të ulët të infeksionit HIV faktet tregojnë, se vendi po përballet me një rritje të shpejtë të numrit të rasteve me këtë infeksion. Prandaj, më shumë përpjekje duhen bërë për të modifikuar besimin dhe qëndrimin e përgjithshëm të grave për kujdesin shëndetsor, për ngritjen e ndërgjegjësimit për planifikimin familjar dhe për edukimin e tyre rreth procedurave të depistimit dhe parandalimit të sëmundjeve.

435. Në zonat rurale e të prapambetura të vendit, ndër të tjera, janë përqëndruar me përparësi politikatat nxitëse e promovuese të barazisë gjinore. Sidoqoftë, hartimi i politikave të reja me frymën e respektimit në një nivel më të lartë, të të drejtave të grave fshatare, duhet të jetë akoma më tepër pjesë integrale e projekteve dhe programeve të adresuara në zhvillimin e zonave rurale.

436. Barazia gjinore arrihet nëpërmjet punës së shumë aktorëve. Eshtë pranuar dhe vlerësuar në të njëjtën mënyrë fakti që, ekspertiza e sektorit të tretë (OJF-të dhe Avokati i Popullit) ka përbërë një kontribut të vyer në sfidën e përmbushjes së objektivave për zhdukjen e diskriminimit të çdo lloj forme ndaj grave, në të mirë të një shoqërie të barazisë, e cila respekton të drejtat e njeriut. Qeveria Shqiptare ka bashkëpunuar sistematikisht në fushatat e ndërgjegjësimit që kanë ndërmarrë OJF-të, me synim kryesor përmirësimin e statusit të grave duke i dhënë akoma më shumë prioritet bashkëpunimit shtet-shoqëri civile. Ky kooperim ka sjellë efektivitet dhe rritje të cilësisë së bashkëpunimit në hartim politikash e ligjesh, shkëmbim eksperience, kryerje aktiviteteve të përbashkëta, hartim raportesh etj. Shoqatat dhe OJF-të e grave kanë udhëhequr punën për përmirësimin e pozicionit të grave në shoqërinë shqiptare. Ato kanë shërbyer kryesisht si agjente të advokacisë dhe burime për opinione dhe sugjerime të rëndësishme alternative. Megjithatë, ato ende kanë nevojë të koordinojnë punën e tyre dhe të përmirësojnë aftësitë dhe përvojën e tyre për të planifikuar, vlerësuar dhe zbatuar projekte që kanë për qëllim të përmirësojnë jetën e vajzave dhe grave.

437. Për të kuptuar rëndësinë e njohjes dhe respektimit të legjislacionit mbi përkatësinë gjinore një rol vendimtar në bërjen e fushatave informuese dhe edukimin e publikut kanë luajtur mediat. Në kushtet e një shoqërie me nuanca të theksuara të patriarkalitetit, puna duhet të përqëndrohet veçanërisht në eliminimin e stereotipeve që diskriminojnë gratë në media. Në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore një nga objektivat që parashikohet të arrihet për periudhën 2007-2010, në funksion të

mirë informimit është përkthimi dhe publikimi i të gjithë dokumentave ndërkombëtarë për çështjet e barazisë gjinore, ashtu sikundër u veprua fillimisht me vetë Konventën CEDAW.

438. Së fundi, duke analizuar ndikimin që shpenzimet dhe të ardhurat shtetërore kanë tek gratë dhe vajzat, krahasuar me burrat dhe djemtë mund të sugjerohet që, të hartohet një buxhet më i prirur ndaj gjinisë, i cili përbën një element të rëndësishëm për arritjen e objektivave që synojnë përmirësimin e barazisë gjinore.

V. ANEKSET

A. Avokati i Popullit dhe Komentet e tij, lidhur me zbatimin e CEDAW-t, në Shqipëri

Avokati i Popullit është një institucion i ri në sistemin juridik dhe shtetëror shqiptar. Avokati i Popullit mund të kryejë hetime, apo të hartojë raporte në bazë të ankesave nga qytetarët për veprime të ndërmarra nga organet publike, duke përfshirë këtu edhe diskriminimin për çfarëdolloj shkak. Megjithatë, duhet thënë se Avokati i Popullit nuk ka ndonjë seksion të veçantë për çështjet gjinore. Institucioni i Avokatit të Popullit bazuar në kompetencat e parashikuara në Ligjin Nr.8454, datë, 04.02.1999, plotësuar me Ligjin nr.8600, datë, 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin nr.9398, datë, 12.05.2005 mund të fillojë shqyrtimin e një çështjeje në dy forma:

1- Forma e parë ka të bëjë me ankesat, apo kërkesat dhe njoftimet që paraqesin drejtpërsëdrejti individët pranë Zyrës së Avokatit të Popullit. Neni 12 i ligjit të sipërcituar parashikon të drejtën për t'u ankuar, ose drejtuar ankesë pranë Avokatit të Popullit: *“Çdo individ, grup individësh, ose organizata joqeveritare, që pretendojnë se u janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e tyre të liqishme nga veprimet, ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike kanë të drejtë të ankohen, ose të njoftojnë Avokatin e Popullit dhe të kërkojnë ndërhyrjen e tij për vënien në vënd të së drejtës, ose lirisë së shkelur.”*

2- Po kështu, kuadri ligjor i mësipërm i njeh të drejtën Institucionit për fillimin e shqyrtimit të çështjes me nismën e tij, për rastet e bëra publike. Kështu, ligji nr.8454, datë, 04.02.1999, në neni 13 parashikon se, *“Avokati i Popullit fillon proçedurën e shqyrtimit të çështjes me nismën e vet për raste të veçanta të bëra publike, por me pëlqimin e të interesuarit, ose të dëmtuarit ”.*

Ligji nr. 9398, datë, 12.05.2005, “Për disa ndryshime në Ligjin për Avokatin e Popullit” hoqi kufizimin ligjor për fillimin e rasteve *ex officio* nga Avokati i Popullit *“pëlqimi i të interesuarit, ose të dëmtuarve”*, kur trajtohen rastet e të dëmtuarve të mitur, ose persona me aftësi të kufizuar. Neni 13 i këtij ligji parashikon se: *“Në rastet kur Avokati i Popullit fillon proçedurën e shqyrtimit të çështjes me nismën e vet dhe kur kujdestari, ose përfaqësuesi i tij ligjor nuk vepron, nuk kërkohet pëlqimi i të dëmtuarit kur është i mitur, apo i paaftë mendërisht, apo me aftësi të kufizuara, ose për mbrojtjen e të drejtave të një numri të madh të individëve.* Po kështu, ky Ligj në Nenin, 13 paragrafi 3 parashikon të drejtën e Avokatit të Popullit për të nisur proçedim administrativ *“...në mbrojtje të interesave të një komuniteti të gjërë, të cilët mund të preken nga proçedimi administrativ...”*. Kjo e drejtë pasqyrohet edhe në Nenin 45/2 të Kodit të Procedurës Administrative.

1- Institucioni i Avokatit të Popullit e ka ndjekur me shqetësim zbatimin në Shqipëri të Nenit 7 të Konventes CEDAW, në drejtim të eliminimit të diskriminimit të gruas në jetën politike. Pjesëmarrja e grave në jetën publike dhe politike në Shqipëri si dhe në proçesin e vendimmarrjes mbetet e kufizuar. Realiteti tregon se pjesëmarrja e grave në politikë në Shqipëri nga viti në vit ka ardhur në rënie. Për të përmirësuar këtë situatë nevojitet një rregullim në Kodin Zgjedhor duke vendosur sistemin e kuotave dhe të “vendeve të përcaktuara” në Parlament, në Këshillat Bashkiake dhe në ato të Komunave, së bashku me sanksionet për moszbatimin e tyre.

Aktualisht Shqipëria shënon standartin më të ulët të përfaqësimit të grave në Europë dhe paraqitet vetëm me 7.1% gra në Kuvend, ndonëse në Kodin e Etikës që u nënshkrua nga të gjitha partitë politike, në kuadër të Zgjedhjeve Parlamentare të vitit 2005 theksohej shprehimisht se, “*Ne do të nxisim dhe mbështesim konkretisht pjesëmarrjen e plotë të grave, qoftë si kandidatë edhe si antare e komisioneve në procesin zgjedhor*”.

Duke marrë shkas nga kjo situatë, Institucioni i Avokatit të Popullit, në 25 tetor 2006 përgatiti një rekomandim drejtuar Bashkë-Kryetarëve të Komisionit Parlamentar të Reformës Zgjedhore dhe Kryetarit të Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Në këtë rekomandim thuhej që, “Kodi Zgjedhor duhet të parashikojë që, kuota e pjesëmarrjes së grave në politikë nuk duhet të jetë më pak se 30% dhe kjo duhet të jetë një kuotë e detyrueshme e përfaqësimit të grave në organet e zgjedhura, si ato të pushtetit vendor, ashtu dhe në zgjedhjet politike. Më specifikisht rekomandimi kërkonte që Kodi Zgjedhor të përcaktonte:

a). Në lidhje me listat një-emërore:

Çdo parti politike që paraqet kandidatë për deputet, kandidatë për kryetarë bashkie dhe komune, apo këshilltarë në këshillin e bashkisë apo të komunës, 30% e këtyre kandidatëve duhet të jenë gra, ose vajza. Partitë politike, ose koalicionet, partitë antare të të cilave kanë fituar së bashku më shumë se 20% të votave në zgjedhjet e përgjithshme pararendëse janë të detyruara, që të paraqesin minimumi 30% të kandidatëve në të gjitha zonat zgjedhore gra, ose vajza.

b). Në lidhje me listat shumëemërore:

Renditja e kandidatëve në listë caktohet nga subjekti zgjedhor që e paraqet atë, duke ruajtur gjithmonë një balancë të drejtë gjinore me jo më pak se 30% gra, ose vajza. Në listën e renditjes së paraqitur nga subjekti zgjedhor një ndër tre emra duhet të jetë grua, ose vajzë. “

Në vijim rezulton se, me Vendimin nr.61, datë, 28.01.2008, të Këshillit të Ministrave është paraqitur në Kuvend për miratim projekt-ligji “Për barazinë gjinore në Shqipëri” i cili i ka rregulluar çështjet e propozuara më lart.

2. Nga Avokati i Popullit është ofruar mbrojtje për viktimat në rastet e diskriminimit të grave nga ana e autoriteteve shtetërore dhe institucioneve të tjera, si dhe në rastet e ushtrimit të dhunës në familje.

Institucioni i Avokatit të Popullit në periudhën kohore për të cilën po raportohet (2003-2007) ka trajtuar 6 raste, kur subjekte të cilët janë ankuar, gra apo vajza kanë pretenduar për mosveprim të organeve të policisë, apo prokurorisë në drejtim të rasteve të denoncuara prej tyre. Pas hetimit të çështjes nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit, vetëm në një rast është provuar ushtrimi i dhunës në familje për një shtetase, e cila si pasojë e dhunës ka tentuar të vetëvaret. Ky rast është rregjistruar me iniciativë si rast i veçantë dhe është bërë publik në media. Në përfundim të hetimit të kesaj çështjeje, nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit i është paraqitur një Rekomandim Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit në të cilin kërkohet:

1- Rishikimi i “Planeve të dislokimit të shërbimeve të Reparteve të Policisë së Rendit në situatë normale” në Komisariatit e Policisë Elbasan dhe në të gjithë Komisariatet e

Policisë në shkallë vendi, si dhe plotësimi i tyre me numrin e punonjësve të policisë të domosdoshëm për të kryer sa më mirë dhe me cilësi të lartë detyrat funksionale.

2- Rasti i varjes së mbetur në tentativë të shtetases dhe pakujdesia e treguar nga punonjësit e policisë të Komisarariatit të Policisë Elbasan të përgjithësohet në të gjitha organet e policisë vendore, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit policor dhe parandalimin e ngjarjeve të ngjashme në të ardhmen.

3- Në vazhdimësi të trajtimit të kësaj ankese Institucioni i është drejtuar me rekomandim Zv. Ministres së Brëndshme për marrjen në mbrojtje dhe strehimin e shtetases në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit. Rekomandimet u shqyrtuan, u vlerësuan me seriozitet dhe u mirëpritën nga këto organe.

B. OJF-të dhe Komentet e tyre, lidhur me zbatimin e CEDAW-t në Shqipëri

• QENDRA PER NISMA LIGJORE QYTETARE (QNL)

Personeli pranë Qendrës për Nisma Ligjore (QNL) përbëhet nga juristë me eksperiencë të cilët janë të familjarizuar me Konventën CEDAW dhe përdorin këtë Konventë, Protokollin Opsional të kësaj Konvente dhe Rekomandimet e Komitetit CEDAW, si mjet lobimi dhe advokacie në të gjithë aktivitetin e qendrës, në workshope, trainime, apo seminare ku avokatët e qendrës janë ftuar si lektorë. QNL ka pasur një bashkëpunim më të mirë me institucionet shtetërore si Ministria e Brendshme, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, etj në lidhje me zbatimin e programeve për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave.

QNL është e mendimit se, komuniteti donator ka kontribuar ndjeshëm me mbështetjen e projekteve të ndryshme që janë fokusuar në ndërgjegjësimin e njerëzve dhe në mënyrë të veçantë të grave dhe vajzave për të drejtat e tyre, për njohjen me situatën ligjore dhe faktike në lidhje me këto të drejta dhe aftësimin e grave dhe vajzave për t'i përdorur këto të drejta.

Në lidhje me të dhënat statistikore mund të pohojmë se OJF-të e ndryshme, antare të rrjetit kundër dhunës me bazë gjinore dhe trafikimit dhe organizata të tjera që punojnë në këtë fushë kanë të dhëna periodike që bazohen në aktivitetin dhe shërbimet e këtyre organizatave. Gjithashtu, Ministria e Brëndshme që prej vitit 2005 disponon të dhëna statistikore për dhunën në familje. Këto të dhëna janë përfshirë në botimin e përbashkët të Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim dhe MPÇSSHB, të titulluar, "Paraqitja e situatës aktuale në Shqipëri" (Prill 2006). Vjetari Statistikor i Ministrisë së Drejtësisë jep një informacion të kufizuar, lidhur me veprat penale. QNL mendon se, vetëm një analizë e detajuar e subjekteve në këto vepra përmes vendimeve të gjykatave mund të na japë informacion më të detajuar mbi veprat penale që ndodhin në marrëdhëniet familjare. INSTAT është duke përgatitur studimin e parë sasior mbi përhapjen e dhunës në marrëdhënie familjare në Shqipëri, i cili është në proces.

Eshtë në aktivitetin e QNL të përgatisë raporte, studime mbi zbatimin e legjislacionit si një mjet për progresin e të drejtave të grave. Këto raporte kanë konsistuar në një analizë të akteve ndërkombe të ratifikuara nga Shqipëria, një prej të cilave është Konventa CEDAW dhe në një analizë të detyrimeve që i burojnë shtetit tonë nga ratifikimi i kësaj Konvente. Pjesë e kësaj analize ka qenë edhe përjasja e legjislacionit të brëndshëm me këto akte ndërkombe. Në rastet kur është konstatuar boshllëk

ligjor ky fakt ka përbërë një bazë për sugjerime. Studimet dhe raportet e përgatitura nga QNL janë shpërndarë në aktorë të ndryshëm që punojnë në këtë fushë, me qëllim përmirësimin e punës përmes përmbushjes së këtyre detyrimeve.

Gjatë viteve të fundit në kuadrin e aktiviteteve në formën e workshopeve, trainimeve, apo seminareve me pikësynim grupe të ndryshme nga komuniteti, në mënyrë të veçantë gratë dhe vajzat, profesionistët e sistemit të drejtësisë, studentët e Fakultetit të Drejtësisë, etj QNL ka përfshirë në axhendën e këtyre aktiviteteve Konventën CEDAW dhe Protokollin Opsional të kësaj Konvente. Gjithashtu, në të gjithë aktivitetin lobues të saj QNL ju është referuar rekomandimeve të Komitetit CEDAW për Shqipërinë. Kështu, gjatë vitit 2006 QNL u përfshi në një proces lobimi me qëllim miratimin e një ligji specifik, për mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare, duke përmbushur kështu një nga rekomandimet më të rëndësishme të Komitetit CEDAW për Shqipërinë. Detyrimet e shtetit shqiptar që burojnë nga kjo Konventë dhe rekomandimet e Komitetit CEDAW kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm për realizimin e një lobimi të suksesshëm. Këto rekomandime kanë shërbyer si pika referimi në analiza të ndryshme që QNL ka përgatitur në mënyrë të veçantë në lidhje me dhunën me bazë gjinore, si dhuna në familje, trafikimi etj.

Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i cili ka hyrë në fuqi në 01.07.2007 është një ligj administrativo-civil, i cili synon të parandalojë dhunën në marrëdhëniet familjare dhe të garantojë masa ligjore për mbrojtjen e antarëve të familjes nga dhuna. Po përgatiten aktet nënligjore, të cilat priten të miratohen në fillim të vitit 2008.. Zbatimi i këtij ligji përbën një sfidë, jo vetëm për institucionet qeveritare, por edhe për OJF-të. Në këtë ligj parashikohet edhe ndihma ligjore falas për viktimat e dhunës në familje, e cila ende nuk përbën një realitet të prekshëm për viktimat e dhunës. Në lidhje me dëmshpërblimin, ekzistojnë mundësi dhe mjete ligjore si në legjislacionin civil, ashtu edhe në atë penal, por për arsye nga më të ndryshmet këto mjete ligjore nuk përdoren.

Me miratimin e Strategjisë për Barazinë Gjinore dhe të Planit për Veprim mendojmë se do të bëhet e mundur krijimi i hapësirare për ngritjen e strehëzave për mbrojtjen e grave viktimat të dhunës. Në lidhje me sensibilizimin e gjyqtarëve, QNL dhe organizata të tjera jo-qeveritare kanë organizuar takime, seminare me gjyqtarët, me qëllim sensibilizimin e tyre për zbatimin e ligjit në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje. Qëndrimi i seksionit familjar, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në lidhje me kërkesat për urdhëra mbrojtje të menjëhershme që janë paraqitur pranë kësaj gjykate ka qenë një qëndrim korrekt dhe mbështetës për viktimat e dhunës në familje. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë janë lëshuar urdhërat e menjëhershëm të mbrojtjes.

Në legjislacionin shqiptar nuk parashikohen kuota me qëllim arritjen e balancës gjinore. Masat e marra kanë rezultuar të paefektshme. Ndërtimi i një platforme për të harmonizuar legjislacionin shqiptar në lidhje me barazinë gjinore (Kodi Zgjedhor dhe Projekt-ligji i ri “Për një shoqëri gjinore të barabartë”), do të shtrojnë nevojën e parashikimit në këto akte të masave të veçanta dhe të përkohshme për të arritur balancën gjinore. Ligji “Për një shoqëri gjinore të barabartë”, mund të përmbajë përkufizime që japin koncepte të qarta mbi këto lloje masash, si dhe mbi kuptimin e përfaqësimit të barabartë. Kurse, Kodi zgjedhor mund të përcaktojë një sistem kuotash, ose lejimin e një sistemi kuotash së bashku me sanksionet për mos zbatimin e tyre. Në vijim të rekomandimeve të dhëna për Shqipërinë nga Komiteti CEDAW do të

ishte bindës parashikimi i kuotave legislative neutrale dhe të përkohshme, me një afat të kufizuar. Kjo mund të realizohet në disa mënyra:

1- Të punohet më shumë me partitë politike me qëllim që të aplikohet kuota e partive politike për kandidatë në organet qendrore dhe konkretisht, deri në masën 30% të kandidaturave për të dyja sistemet, ose 50 % për proporcionalin.

2- Për organet vendore të parashikohet një kuotë legislative e përkohshme nga Kodi zgjedhor. Kjo do të ishte më rezultative, pasi organet kolegjiale vendore zgjidhen mbi bazën e sistemit proporcional, që sikurse theksuam i përgjigjet më me lehtësi sistemit të kuotave. Kuota legislative është e rekomandueshme për Shqipërinë sepse, ajo ka potencialin e nevojshëm intelektual për përzgjedhje nga radhët e grave. Njëkohësisht, këtu duhet patur parasysh dhe fakti që, pas viteve 90 numri i grave që marrin pjesë në organet e zgjedhura ka rënë ndjeshëm.

3- Parashikimi i kuotave tranzitore legislative për organet përfaqësuese qendrore mund të vendoset me këndvështrim të posaçëm në proporcional, në të cilin mund të aplikohet edhe kuota e dyfishtë.

4- Ligji mund të parashikojë sanksione të ndryshme për partitë politike që nuk përmbushin kuotat e vendosura (sanksione që përmbushen nga KQZ, si mospranimi i listave, sanksione financiare ndaj partive që nuk realizojnë kuotat e parashikuara për kandidatët, bllokimi i regjistrimit të subjektit dhe kandidatëve deri në balancimin e kuotave në zbatim të kodit, ose të normave statutores të parashikuara nga vetë subjekti, etj.)

5- Kodi zgjedhor mund të parashikojë detyrimin e partive politike për t'u përfaqësuar në njësitë e administrimit të votës mbi baza neutrale gjinore.

Sidoqoftë, vlen të përsëritim faktin se, roli i partive politike në rritjen e pjesëmarrjes së grave në jetën politike të vendit mbetet vendimtar.

• **GRUPI SHQIPTAR PËR TË DREJTAT E NJERIUT (GSHDNJ)**

GSHDNJ ka realizuar vazhdimisht programe trainimi për të familjarizuar stafin e GSHDNJ me përmbajtjen e Konventës CEDAW dhe tashmë është arritur një standart maksimal në njohjen e saj. Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut (GSHDNJ) është i mendimit, që Institucionet qeveritare kanë kontribuar për të rritur shkallën e bashkëpunimit në drejtim të zbatimit të Platformës Kombëtare për Përparimin e Grave në Shqipëri. Nga ana tjetër edhe vetë komuniteti donator përmes programeve specifike ka luajtur një rol determinues në këtë kuadër, sidomos kjo e specifikuar për zonat rurale dhe veriore të vendit. Është pikërisht ndihma e këtij komuniteti që ka angazhuar edhe shoqërinë civile në aplikimin e masave konkrete, lidhur me programet me tema *gender*.

Midis GSHDNJ dhe institucioneve shtetërore është vërejtur një frymë e mirë bashkëpunimi në drejtim të përmirësimit të kapaciteteve dhe burimeve ndihmëse. Roli i GSHDNJ është mirëpritur gjithnjë nga ana e institucioneve shtetërore dhe kjo mbështetje ka çuar në mënyrë të vazhdueshme në arritjen e një progresi të dyanshëm. GSHDNJ ka qënë e ftuar vazhdimisht në takimet e zhvilluara nga institucionet shtetërore për çështje të kësaj natyre dhe nga ana tjetër në aktivitetet e zhvilluara nga GSHDNJ kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve qeveritare.

Përsa ju takon masave që janë marrë gjatë periudhës 2003-2007, në lidhje me stereotipet e trashëguara, rolin dhe përgjegjësitë e grave dhe burrave në familje e shoqëri, GSHDNJ është e mendimit se, efektshmëria e tyre është jo shumë e prekshme për arsye të edukimit të pakët që ka marrë shoqëria shqiptare në këtë fushë. Megjithatë në këtë kuadër, janë marrë masa duke ndikuar në mentalitetin e njerëzve për të kuptuar gjithnjë e më tepër të drejtat dhe detyrimet konkrete. Lidhur me zakonet tradicionale, apo kanunin këto të fundit vazhdojnë të jenë mbizotëruese në zonat veriore të vendit dhe aktualisht nuk ka ndonjë përmirësim të dukshëm për këtë çështje.

Lidhur me masat konkrete që mund të jenë ndërmarrë për të luftuar dhunën ndaj grave në familje, për të siguruar dëmshpërblimin, mbrojtjen, aksesin për ndihmë ligjore të tyre, strehë për gratë viktime të dhunës, si dhe sensibilizimin që mund të jetë bërë për këtë çështje pranë organeve gjyqësore, GSHDNJ ka mendimin se, nuk ka patur ndonjë efekt të dukshëm dhe për rrjedhojë, aktualisht kjo çështje është e konsideruar nga GSHDNJ si poshtë nivelit të normave të kërkuara.

Shkalla e përfaqësimit të grave në forumet e larta si të zgjedhura, ashtu dhe të emëruara në poste të ndryshme të pushtetit qëndror e lokal vazhdon të ngelet në nivele të ulëta dhe progresi është i dobët në krahasim me vitet e mëparshme. Përsa ju takon masave që janë marrë për të garantuar të drejtën e grave për tu përfshirë aktivisht në të gjitha fushat e jetës publike, veçanërisht në nivelet e larta të vendimmarrjes GSHDNJ ka mendimin që, roli i gruas vazhdon të jetë poshtë nivelit të kërkuar, duke marrë parasysh se si paraqitet situata analoge në vendet e rajonit.

Së fundi, lidhur me masat që mund të jenë ndërmarrë për të eliminuar diskriminimin e gruas në zonat fshatare, duke patur parasysh problemet e veçanta që ndesh gruaja fshatare dhe rolin e rëndësishëm që luan ajo për mbijetesën ekonomike të familjes GSHDNJ mendon se, nuk janë marrë masa konkrete në sektorin rural për eliminimin e këtij diskriminimi dhe kjo ka të bëjë dukshëm edhe me nivelin e ulët ekonomik të këtyre zonave në krahasim me ato urbane.

• **SHOQATA NË DOBI TË GRUAS SHQIPTARE (NDGSH)**

Shoqata “Në Dobi të Gruas Shqiptare” (NDGSH), që në fillimet e saj ka ngritur programe, të cilat lidhen direkt me Konventat e ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, kryesisht, ato të cilat kanë të bëjnë me të drejtat e grave, fëmijëve dhe të rinjve, si dhe objektivat e Mileniumit të ri. NDGSH është një shoqatë që punon në bazë dhe si e tillë, ajo ka afruar shërbime efikase sociale dhe edukative, të cilat forcojnë statusin ekonomik të gruas. Të tilla janë qendrat e formimit profesional për fëmijët e lënë në rrugë dhe adoleshentët në vështirësi, agjencitë e punësimit për gra e vajza, fushatat kundër trafikimit, etj. NDGSH është e licencuar nga MPÇSSHB për të gjitha këto shërbime dhe përfituesit e saj direkt, të diplomuar dhe të certifikuar janë mbi 5000 të rinj.

Si një ndër OJF-të e para në Shqipëri, shoqata “Në Dobi të Gruas Shqiptare”, është e mendimit se, bashkëpunimi me institucionet shtetërore, lidhur me platformën e Pekinit ka qenë formal, pasi kjo platformë u hartua me ndihmën e donatorëve të huaj (*institucionet e tyre*) dhe shteti shqiptar e pa shumë formalisht këtë platformë. Duhet theksuar, që roli i donatorëve të huaj ka qenë dominant në Shqipëri, në hedhjen e bazave të sektorit civil, i cili nisi në mënyrë shumë idealiste dhe pa përvojën e duhur,

gjë e cila ekzistonte në vendet e tjera, qoftë këto dhe të Evropës Lindore. Të gjitha projektet dhe programet e hartuara nga donatorët e huaj, në vitet pas Konferencës së Pekinit, i referohen strategjisë për implementim, që hartoi secili shtet. Një strategji e tillë u hartua nga Qeveria Shqiptare në 1996-1998, nën supervizionin dhe konsulencën e institucioneve të huaja në Shqipëri si: UNDP, BE, OSBE, etj.

Ndonëse jemi në shek. XXI, Shqipëria ende jeton në një shoqëri patriarkale, me role dhe përgjegjësi të mirëpërcaktuara të grave dhe të burrave në familje dhe gjatë kësaj periudhe masat e marra për integrimin gjinor janë të pakta, apo pak rezultate për të ndryshuar, apo ndikuar mentalitetin patriarkal të shoqërisë shqiptare. Kjo gjë është më e prekshme, sidomos në disa zona veriore të vendit, ku Kanuni, si një ligj i pashkruar, respektohet me rigorozitet si nga burrat edhe nga gratë, pavarësisht pasojave të dukshme në pabarazinë gjinore, ku gruaja vazhdon të ketë statusin e të diskriminuarës. Kanuni i maleve është i rrënjosur fort në mendësinë e shqiptarit dhe është e vështirë të ndryshohet ky mentalitet i ngurtësuar dhe i trashëguar ndër vite.

Ndonëse qeveria gjatë kësaj periudhe mund të ketë ndërmarrë masa për hartimin e strategjive, apo politikave për integrimin gjinor, ideologjia mbizotëruese vazhdon të jetë patriarkaliteti. Nëse do të bënim një kalim të shpejtë në mendjen tonë të funksionimit të sferave të ndryshme të jetës publike e private, do të pranohim që jetojmë në një shoqëri jo-miqësore për vajzat dhe gratë, ku roli dhe përgjegjësitë e tyre janë inferiore krahasuar me të burrave. E pikërisht, duke qenë pjesë e kësaj shoqërie vërejmë se pabarazia gjinore është ende një problem i hapur, që pengon gratë të kenë një status social dhe ekonomik të barabartë me atë të burrave, si në familje, ashtu dhe në shoqëri. Sigurimi i barazisë gjinore nuk duhet të konsiderohet një problem vetëm i grave, por i të gjithë shoqërisë, pasi vetëm kështu do të mund të thyhen barrierat dhe të arrihet realizimi i një barazie të vërtetë. Për këtë duhet të kontribuojë si qeveria përmes vendosjes së objektivave realiste dhe të matshme, apo strategjive të zbatueshme në praktikë, ashtu edhe shoqëria civile (OJF-të apo organizata të ndryshme), pasi vetëm bashkëpunimi, apo kontributi i përbashkët do të bënte të mundur që t'i jepej gruas roli dhe statusi që i takon për përmirësimin e jetesës së saj dhe shoqërisë në përgjithësi.

Dhuna ndaj gruas në Shqipëri është më shumë temë e kronikës së zezë në media sesa e debatit politik. Edhe raporti i fundit i organizatës Amnesty International e vë gishtin pikërisht mbi këtë plagë të hapur të shoqërisë shqiptare duke theksuar se, *është detyrë e qeverisë që të marrë masa për zgjidhjen e këtij problemi e se kjo e fundit, nuk e ka marrë seriozisht përgjegjësinë e saj për të mbrojtur gratë nga dhuna në familje dhe ka dështuar, në ndjekjen penale dhe ndëshkimin e shkaktareve.* Megjithatë, duhet theksuar se dy vitet e fundit (2006-2007), qeveria ka ndërmarrë disa akte specifike ligjore, duke miratuar në qershor 2007 një ligj për dhunën në familje, falë dhe përpjekjeve të një numri OJF-sh (përfshirë dhe kontributin e shoqatës “Në Dobi të Gruas Shqiptare”), të cilat paraqitën në Parlament firmat e rreth 20.000 qytetarëve, në janar të vitit 2005.

Ndonëse ky ligj ka hyrë në legjislacionin shqiptar, zbatimi i tij në praktikë ende nuk ka dhënë rezultate konkrete dhe efektive dhe kjo, për faktin e një mos koordinimi të mirë të punës së Policisë, Gjykatave dhe Prokurorive, të cilat nuk janë ende në gjëndje të zbatojnë me efikasitet këtë ligj, për të dënuar dhunuesin dhe për të ndihmuar gruan apo fëmijët, të cilët janë viktimat më të shpeshta të dhunës në familje. Pra ndonëse kuadri ligjor ekziston në Shqipëri, përdorimi i tij duhet zgjeruar dhe Prokuroria e

Gjykatat, duhet të bëjnë më tepër përpjekje në këtë drejtim. Duhet marrë masa urgjente për të parë implementimin e ligjit “Kodi i Familjes” dhe pikërisht neni 62, i cili përcakton që, “*dhunuesi të largohet nga shtëpia*”. Në asnjë rast kjo dispozitë nuk është zbatuar dhe asnjë organ nuk e sheh të mundshëm. OJF-të, (në veçanti shoqata “*Në Dobi të Gruas Shqiptare*”) kanë hedhur idenë dhe po llojnë me aktorë të ndryshëm, që ky nen të bëhet real. Ato po luftojnë për një amendim në ligjin ekzistues (“*Kodi i Familjes – Të drejtat dhe detyrimet reciproke të bashkëshortëve*”).

Gjithashtu, ndonëse “Kodi i Familjes” i vitit 2003, parashikon që gratë të kenë mbështetje pas divorcit, të paktën për fëmijët e tyre, duke vendosur një detyrim ushqimor për fëmijët nën kujdestarinë e saj dhe të jetojnë në banesën e familjes pas divorcit, këto dispozita, shpesh herë nuk zbatohen. Prandaj masat e ndërmarra nga qeveria për të garantuar punësimin e grave, strehimin e tyre dhe një formë pavarësie ekonomike, janë thelbësore në drejtim të faktit që, ky kontingjent i grave të keqtrajtuara nga burrat e tyre, të mund të braktisin martesat e dhunshme. Ndonëse janë bërë përpjekje nga OJF të ndryshme për të mbledhur të dhëna mbi gjëndjen reale të dhunës në familje në Shqipëri, statistikave konkrete në rang vendi, ende janë jo të plota, pasi shpesh herë dhuna në familje shfaqet në forma të ndryshme dhe jo të matshme. Megjithatë, në këtë drejtim mund të përmendim studimin “*Dhuna në Familje*” të kryer nga MPÇSSHB, së bashku me *Aleancën Gjimore për Zhvillim*. Nga të dhënat e grumbulluara gjatë studimit në lidhje me dhunën ndaj grave dhe fëmijëve, është evidentuar se dhuna emocionale është forma më shpesh e hasur e dhunës në familje. Dhuna ekonomike takohet më shumë në zonat urbane, ndërsa dhuna fizike raportohet më shumë në zonat rurale, ndërkohë që dhuna seksuale është forma më pak e raportuar. Kodi i Familjes përshkruan marrjen e masave të menjëhershme të përcaktuara nga gjykata, për bashkëshortin që nuk përmbush detyrimet e tij dhe vë në rrezik interesat e familjes. Këto masa merren pas kërkesës së bashkëshortes, për një periudhë jo më shumë se 3 vjet.

Gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë disa masa konkrete në luftën kundër dhunës ndaj grave në familje, si nga qeveria (përmes miratimit të akteve ligjore e hartimit të politikave e strategjive përkatëse), ashtu edhe nga shoqëria civile (OJF të ndryshme), përmes fushatave sensibilizuese dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë për këtë problem serioz, i cili është bërë më i dukshëm kohët e fundit. Janë pikërisht autoritetet zyrtare dhe shoqëria civile, të cilat duhet të përmbysin mentalitetin që ushqen këtë dukuri, pasi jemi padyshim një nga vendet evropiane me treguesit më të lartë të kësaj dhune. Femra shqiptare po pëson forma dhune të shumëllojta e të shumfishta, sidomos dhuna në familje, vitet e fundit është gjithnjë e më e pranishme në familjet shqiptare.

Lidhur me masat e ndërmarra nga qeveria në këtë drejtim, vlen të përmendet fakti që angazhimi i saj në luftën kundër dhunës në familje, mbështetet në Strategjinë Kombëtare kundër Dhunës në Familje (*tetor 2007 - shtator 2008*), e cila ende nuk ka dhënë rezultatet e pritshme dhe të parashikuara, sidomos lidhur me sensibilizimin e organeve kompetente për këtë problem, siç janë Policia e Shtetit, apo Gjyqësori. Nga ana tjetër, OJF të ndryshme e kanë ndërmarrë tashmë këtë rol. Edhe shoqata “NDGSH”, një nga prioritetet e saj ka pikërisht trajtimin e fenomenit të dhunës në familje në dy drejtime:

Së pari, duke ndihmuar konkretisht viktimat e dhunës në familje, përmes asistencës psiko-sociale dhe juridike, punësimit dhe strehimit, në bashkëpunim me OJF të tjera,

të fokusuar në trajtimin e viktimave të dhunës në familje. (*Agjencia e Punësimit për Gra dhe Vajza –NDGSH*)

Së dyti, përmes fushatave të gjPra të sensibilizimit kundër dhunës në familje, me qëllim ndërgjegjësimin e opinionit publik në disa rrethe të Shqipërisë, e sidomos, për t'u thënë grave që ato kanë të drejtën të mos keqtrajtohen. Gjithashtu, këto fushata kanë synuar edhe bashkëpunimin dhe një koordinim më të mirë të punës së Policisë dhe organeve gjyqësore, të cilat luajnë rol primar për mbrojtjen, apo aksesin për ndihmë ligjore të tyre, pasi harmonizimi i punës dhe bashkëpunimi i organeve zyrtare me OJF-të do të bënte të mundur evidentimin dhe luftën e përbashkët kundër këtij fenomeni serioz për të gjithë shoqërinë shqiptare. Për këtë është synuar t'u bëhet e qartë grave, se ato nuk kanë pse t'i nënshtrohen një dhune të tillë, pasi ky është një problem për gjithë shoqërinë civile dhe qeverinë dhe jo vetëm një çështje personale, të cilën ato duhet ta përballojnë të vetme për gjithë jetën.

Shoqata “Në Dobi të Gruas Shqiptare” (NDGSH), sheh si nevojë urgjente adaptimin e ligjit kundër dhunës ndaj gruas, me format bashkëkohore evropiane. E pikërisht në kohën që jetojmë, ajo nuk e sheh të arsyeshme që gratë e dhunuara të largohen nëpër strehëza, pasi më vonë kur të kthehen në shtëpi ato do të përballen me dhjetra probleme të tjera si: humbja e pronës, varfëria më e madhe, dhuna më e egër, humbja e bashkëshortit, pasi ai mund të ketë futur në banesë një grua tjetër, etj, etj. NDGSH kërkon të ndryshohet ligji, duke e detyruar dhunuesin të largohet nga shtëpia, konform disa klauzolare që mund të rregullohen me ligj.

Jeta Politike dhe Publike. Partitë politike, qeveria, pushteti qendror e lokal, arsimit, drejtësia dhe sindikatat, vazhdojnë të jenë pronë e meshkujve, pasi numri i grave në vendimmarrje dhe nivel përfaqësimi në poste të rëndësishme është shumë i vogël. Sipas statistikave të Komitetit për Barazi Gjinore, numri i grave në poste drejtuese vazhdon të jetë në miniaturë përballë meshkujve. Diskriminimi ndaj gruas vazhdon të jetë i dukshëm në të gjitha sferat e shoqërisë. Kështu, po të krahasojmë statistikën për periudhën 2003-2007, do vëmë re se pjesa e grave deputete në Parlament është e papërfillshme në krahasim me numrin e deputetëve meshkuj. Po ashtu, pjesëmarrja e gruas në qeveritë e fundit është shumë e vogël, pasi vetëm një grua është ministre dhe 6 zv/ministre, ndërsa ministra 17 dhe zv/ministra 23. Edhe në misionet diplomatike pjesëmarrja e gruas paraqitet pa perspektivë, pasi numri i ambasadoreve femra është mjaft i vogël në krahasim me numrin e meshkujve në këtë post. Vendosja në kreun e parlamentit shqiptar të një gruaje, është ndoshta fillimi i ndryshimit të mentalitetit, nga vetë politika shqiptare.

Lidhur me sistemin e drejtësisë mund të thuhet që, nuk është treguar shumë “i drejtë” me femrat, pasi përfaqësimi i tyre në poste drejtuese në këtë sistem është sërish i vogël. Le të shpresojmë që zgjedhja e një femre në drejtimin e Prokurorisë së Përgjithshme, do t'i hapë rrugë profesionisteve të vërteta në fushën e drejtësisë. Statistikat tregojnë se ndonëse pjesëmarrja e femrave në sektorin e shëndetësisë dhe arsimit është e konsiderueshme, sërish, kur bëhet fjalë për poste drejtuese, ato dominohen nga meshkujt dhe shpërblimet që ata marrin, janë më të larta se të femrave, ç'ka tregon për një diferencim të padrejtë të roleve gjinore në shoqërinë shqiptare. Edhe po t'i referohemi medias, bazuar në statistika, vërejmë se postet drejtuese të saj janë të mbizotëruara nga meshkujt, pavarësisht se numri i gazetareve femra është më i lartë se i meshkujve. E njëjta gjë vlen edhe për arsimin, pushtetin lokal, etj.

Gratë përbëjnë 50% të popullsisë, megjithatë, pozicioni e statusi i saj ekonomik-social dhe juridik, mbetet në nivele tepër të ulëta, duke përbërë shtresën më vulnerabël të shoqërisë. Të gjitha këto statistika dhe përfundime tregojnë se, gjatë kësaj periudhe progresi i bërë nuk është shumë domethënës, përse i përket nivelit të përfaqësimit të grave në poste drejtuese të pushtetit qendror dhe lokal, apo në fusha të tjera të rëndësishme të veprimtarisë shoqërore.

Duke ju referuar strukturave dhe dinamikave të shoqërisë shqiptare mund të themi se numuri i grave, të cilat kanë pasur mundësinë të jenë pjesë e rëndësishme e vendimmarrjes politike dhe ekonomike në vend është ende relativisht i vogël. Midis femrave dhe meshkujve ekzistojnë dallime të mëdha në punësim. Kështu, pagat e grave janë 20-50% më të ulëta, krahasuar me ato të meshkujve, të cilët zotërojnë 92% të të gjithë pronës private dhe afërsisht 84% të prodhimit vendas bruto. Gjithashtu, vetëm 7.1% e parlamentarëve shqiptarë janë femra, shifra dhe statistika, të cilat tregojnë qartë se përfshirja e grave aktualisht në të gjitha fushat e jetës publike, e sidomos në nivelet e vendimmarrjes, po ecën ende me hapa të ngadaltë. Ndonëse Qeveria në programin e saj, angazhohet t'i kushtojë një rëndësi të veçantë përfshirjes së gruas në jetën politike, ekonomike dhe sociale të vendit, përmes hartimit të strategjive, apo duke promovuar politika aktive për të mbështetur barazinë gjinore dhe integrimin gjinor, përsëri gjatë kësaj periudhe, rezultatet e vërejtura nuk janë ende ato të pritshmet, për realizimin e ndryshimit të synuar.

Megjithatë, nga MPCSSHB janë ndërmarrë masa konkrete për ngritjen e strukturave të reja, si p.sh: *Drejtoria e Politikave të Shanseve të Barabarta*, e cila ka ndihmuar në hartimin e politikave sociale përfshirëse dhe aktive, lidhur me perspektivën gjinore. Në këtë kuadër, mund të përmendim “Strategjinë për Barazi Gjinore”, e cila synonte të kishte impakt në fushën e barazisë gjinore, në arritjen e të drejtave për femrat, në rritjen e dukshme të përfaqësimit të saj në të gjitha nivelet e drejtimit. Po kështu, përpjekje janë bërë edhe nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, nëpërmjet rishikimit të programeve dhe teksteve mësimore, apo trainimit të mësuesve, lidhur me çështjet e barazisë gjinore dhe të integritimit gjinor.

Padyshim strukturat shtetërore kanë rol kryesor në ndërmarrjen e masave konkrete, për nxitjen dhe motivimin e potencialit të femrave dhe përparimin e tyre, për të dhënë një kontribut real në të gjitha fushat e jetës. Kjo gjë mund të realizohet dhe të jetë më efektive, falë bashkëpunimit dhe dialogut me shoqërinë civile. E ndoshta, pikërisht këtu ka “çaluar” dhe puna e qeverisë në realizimin e objektivave për barazi gjinore, pasi bashkëpunimi jo i duhur me OJF-të e ndryshme, ka bërë që të mos arrihen objektivat e synuara dhe të mos bëhet progresi i pritur. Nga ana tjetër, vërehet se gjatë këtyre viteve, në shumë projekte të OJF-ve kanë marrë njohuri dhe janë trajtuar me mijëra gra dhe vajza, si në fushën e barazisë gjinore, ashtu edhe në kualifikime profesionale, apo rritje kapacitetesh. Pikërisht, pjesëmarrëset në lëvizjen e organizuar të gruas në Shqipëri, kanë bërë përpjekje serioze për të rritur rolin e gruas, si në politikë, ashtu dhe në vendimmarrje duke theksuar që për përmirësimin e statusit të femrës në shoqëri, kërkohet një angazhim më i madh dhe aktiv në jetën politike dhe sociale të vendit.

Programet e edukimit dhe trainimit për të bërë të mundur ndërgjegjësimin e personelit që punon pranë OJF-ve kanë qenë të shumta dhe vazhdimisht stafet e OJF-ve kanë marrë pjesë në trainime të kryera jo vetëm nga shoqata jonë, por dhe OJF të tjera, si brenda, ashtu dhe jashtë vendit. Nëse iu referohemi arritjeve të Shoqatës NDGSH, mund të themi që ka pasur rezultate pozitive, ku mund të përmenden: mbi 300 fëmijë të integruar në shkollë, (*Elbasan, Valias, Durrës, Romanat, Burrel*), mbi 2100 të rinj të

diplomuar në profesione, mbi 80 të rinj të rikthyer në shkolla të mesme, 180 gra të varfra të punësuar, mbi 18 vajza të kthyer nga trafikimi, etj. (*shih faqen web të Shoqatës –www.uaw-al.com). Nga viti 1997 e në vazhdim NDGSH ka punuar për ngritjen në Tiranë dhe Elbasan të qendrave që ofrojnë formim profesional, mbështetje ekonomike e ndjekje sociale për fëmijët që punojnë në rrugë dhe adoleshentët në vështirësi nga mosha 14-18 vjeç. Këto qendra të quajtura, “Alternativa Profesionale” mbështeten financiarisht nga donatorë të huaj. (HEKS-Zvicër, EED- Gjermani, ICCO-Hollandë). Aktualisht në këtë qendër janë formuar 2217 persona në kurset, hidraulikë, rrobaqepësi, kuzhinë dhe kozmetikë. Pjesa më e madhe e tyre është punësuar duke ndihmuar ekonomikisht familjet ose i janë rikthyer shkollës. Krahas njohurive profesionale, fëmijët marrin njohuri të përgjithshme në Matematikë, Gjuhë të huaj, Kompjuter dhe Sociologji. Gjithashtu, keto qendra i ofrojnë fëmijëve shërbim mjekësor periodik dhe medikamente në çdo rast sëmundjeje.*

Përsa i takon diskriminimit të gruas në zonat rurale fillimisht mund të thuhet se, në përgjithësi femrat shqiptare, megjithëse përbëjnë numrin më të madh të popullsisë në krahasim me meshkujt, ato zënë përqindjen më të vogël përsa i përket punësimit, nivelit të pagave, apo dhe niveleve drejtuese. Në zonat rurale këto dukuri janë akoma më të theksuara, prandaj dhe është mëse e nevojshme që kjo situatë të ndryshojë. Gratë kanë më të lartë nivelin e papunësisë (17.2%), ndërkohë që ai i meshkujve është më i ulët (12.1%).

Diskriminimi i gruas në zonat rurale është mjaft i theksuar, pasi ato nuk konsiderohen të barabarta as me gratë në qytet dhe kjo dukuri duhet shmangur, pasi nuk është e drejtë. Gruaja në fshat ndeshet me probleme të ndryshme, pavarësisht rolit të rëndësishëm që luan ajo në mbijetesën ekonomike, pasi kurrsesi ajo nuk është e pavarur, qoftë edhe për shkak të arsimit që mund të ketë kryer. Eliminimi i diskriminimit në këto raste është mëse i nevojshëm, duke bërë të mundur edhe integrimin e gruas fshatare në shoqëri. Është për t'u përmendur roli i madh i Organizatave Ndërkombëtare në fshatrat shqiptare, duke përmirësuar jo vetëm infrastrukturën e këtyre fshatrave, por duke kontribuar dhe në përmirësimin e kushteve të jetesës, në veçanti për gratë e fëmijët (*Programet e FSHZH, GTZ, ICCO, BE, UNDP*). Vetëm disa OJF kanë kontribuar konkretisht, ndërsa programet e shtetit pothuajse janë të padukshme. Ndër aktivitet kryesore të OJF-ve mund të përmëdim:

Shoqata “*Ligji, Biznesi dhe Gruaja e Fshatit*” ka implementuar një numër të konsiderueshëm projektesh për përmirësimin e situatës ekonomike dhe social-politike të grave, të cilat jetojnë në zonat rurale të Shqipërisë.

Shoqata “*Emancipimi i Gruas, Progres për Shoqërinë*” në Durrës, krijoi Shkk Teuta, duke promovuar dhe zhvilluar biznesin e vogël, me gratë e zonave rurale të kësaj treve. Shoqata ka ndihmuar me kredi të buta gratë e zonave rurale të Durrësit, për fillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme. Shkk Teuta e Durrësit ka një antarësi me mbi 300 antarë, ku mbi 100, kanë marrë kredi dhe kanë zhvilluar bizneset e tyre bujqësore dhe blegtorale.

Shoqata “*Gruaja Zadrimore*”, e krijuar me gratë e zonave rurale Bushat, Dajç dhe Blinisht, me qëllim për të rritur prodhimet bujqësore dhe blegtorale, për të hedhur hapat e parë drejt biznesit të vogël.

Shoqata “*Shkk Valbona*”, e cila është krijuar në Tropojë, me pjesëmarrjen e 300 grave rurale dhe urbane, për uljen e konflikteve, përgatitjen e specialistëve të shërbimit, rritjen e të ardhurave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në këtë trevë.

Shoqata “*Gruaja e Librazhdit*” me seli në Librazhd, e cila synon përgatitjen e grave të kësaj treve për tu futur në rrugën e biznesit të vogël, emancipimin e tyre dhe rritjen e

të ardhurave. Në Dragostunjë të Librazhdit shoqata ka ndërtuar dhe vënë në funksionim qendrën shëndetësore, e cila u shërben 4000 banorëve të këtij fshati. Gjithashtu, shoqata ka ndihmuar me kredi të buta për zhvillimin e frutikulturës, në fshatra të ndryshëm të Librazhdit.

Shoqata “*Gruaja e Liqenasit*” në komunën e largët të Liqenasit, në kufi me Maqedoninë, e cila përgatit kontigjente grash për t’iu përgjigjur tregut të ri të punës, kryesisht zhvillimit të turizmit në këtë zonë. Në këtë zonë, shoqata me seli në Tiranë ka sjellë në funksionim maternitetin e komunës.

Qeveria shqiptare duhet të hartojë një strategji dhe një plan veprimi kombëtar, me masa konkrete për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna të grave në zonat rurale. Qeveria duhet ta konsiderojë dhunën në familje një akt kriminal. Parlamenti duhet të adoptojë ligjin mbi “Masat kundër Dhunës në Familje”, i cili do të sigurojë shërbime mbrojtëse përveç atyre mbështetëse. Duhet të aprovohen akte ligjore efikase, të cilat duhet të synojnë të japin dënim maksimal për dhunuesin. Qeveria duhet të marrë masa që sigurojnë marrjen e asistencës së menjëhershme nga gratë, vajzat dhe fëmijët pa asnjë diskriminim, nëpërmjet qendrave këshilluese, strehëzave, apo shërbimeve të tjera. Qeveria duhet të marrë masa për të siguruar, që kurrikulat mësimore të niveleve të ndryshme, të përfshijnë informacion mbi dhunën ndaj grave, format e saj, shkaqet, pasojat dhe parandalimin.

Bazuar në ligjin “Masa kundër Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, *dhunë në familje konsiderohet çdo sjellje apo qëndrim, që dëmton mirëqenien fizike, emocionale dhe seksuale të një, apo disa personave dhe që ndikon në zhvillimin normal të pjesëtarit të familjes*. Dhuna është një problem universal dhe si i tillë është trajtuar. Shqipëria tashmë ka ligjin e parë kombëtar të parandalimit të dhunës në familje. Sipas Statistikave, 10 vitet e fundit 1/3 e grave i nënshtrohet dhunës në familje. Viktimat e dhunës në familje i kalojnë të gjithë kufijtë. Në Shqipëri 36.4% e grave dhunohen fizikisht dhe psikologjikisht (*Amnesty International*). Ashtu si viktimat, abuzuesit u përkasin shtresave të ndryshme të shoqërisë. Shpesh herë njerëzit pyesin: “Përse nuk largohen viktimat nga marrëdhënia abuzive?”. Viktimat e dhunës në familje nuk largohen nga abuzuesit për disa arsye: **a)** Viktimat ndjehen të frikësuar se mos vriten nga bashkëshortët e tyre; **b)** Mungesa e një vendstrehimi; **c)** Besimet fetare e kulturore, presionet familjare, si dhe dëshira për ta mbajtur familjen të bashkuar. Në raste jo të shpeshta, ndodh që viktimat të largohet nga abuzuesi.

Duhet të kemi parasysh se dhuna në familje është një çështje publike dhe jo private, për rrjedhojë ajo kërkon vëmendje të veçantë nga e gjithë shoqëria. Shkaku kryesor i dhunës është fuqia e pabarabartë që ekziston në çift. Gratë përjetojnë forma të ndryshme dhune, shpesh herë edhe në të njëjtën kohë. Masat që janë ndërmarre për të luftuar dhunën ndaj grave kanë qenë të ndryshme. Ndërsa ligji ndihmon dhe supozon reduktimin e dhunës dhe mbrojtjen e viktimës, zbatimi i tij dhe pjesëmarrja e aktorëve të ndryshëm në këtë implementim, lë shumë për të dëshiruar. Nga rastet që ne kemi ndjekur në *Klubin e Grave “Teuta e Re”* rezulton se, asnjë nga viktimat nuk ishte dëmshpërblyer, ose mbrojtur me ndihmë ligjore.

Përsa i takon bashkëpunimit shtet-shoqëri civile mund të thuhet se, ka disa përpjekje nga ana e shtetit dhe ndër përvojat tona pozitive janë marrëveshjet që kemi realizuar kryesisht me MPÇSSHB për licencimin e shërbimeve tona. Gjithashtu, marrëveshje është bërë me Universitetin e Tiranës – Fakulteti i Shkencave Sociale për studentët që dëshirojnë të bëjnë praktikën mësimore pranë qendrave tona. Nga ana tjetër, pas 2003 është vënë re një prirje e qeverisë shqiptare për të bashkëpunuar me OJF-të, duke i

parë ato si aktorë të rëndësishëm në hartimin e strategjive shtetërore. Bashkia ka krijuar një rrjet të fuqishëm, i cili ka për qëllim të komplementojë shërbimet që kryen secila OJF, duke bashkërenduar më mirë punën me programet e shtetit.

Së fundi, duam të theksojmë faktin që në gjithë punën tonë, baza kryesore e dokumentacionit mbi të cilin ne ngremë strategjitë dhe projektet tona, janë dokumentet e mëposhtme, të cilave ne ju referohemi dhe konkretisht:

1. *Konventa CEDAW;*
2. *Protokolli Opsional i Konventës CEDAW;*
3. *Komentet Përmbledhëse dhe Rekomandimet e Komitetit të CEDAW, lidhur me Raportin e Parë dhe të Dytë të Kombinuar që ka paraqitur Shqipëria, në Sesionin e 28 të OKB (13-31 janar 2003);*
4. *Deklarata e Përgjithshme e Pekinit dhe Platformën për Veprim;*
5. *Konkluzionet e Sesionit të 23 të Asamblesë së Përgjithshme të titulluar: "Gratë 2000: Barazi gjinore, zhvillim dhe paqe për shekullin e 21-të".*

Kjo është një nga kushtet mbi të cilat ngrihen projektet tona, synimi i të cilave është implementimi i gjithë objektivave të vëna në këto dokumente. Në kuadër të kësaj pune, NDGSH ka organizuar trainime të tipit TOT (*training of trainers*) në rrethe të ndryshme të Shqipërisë, ku shoqata ka degë aktive dhe projekte.

• **FORUMI I PAVARUR I GRUAS SHQIPTARE (FPGSH)**

Meqënëse FPGSH ka qenë një ndër organizatat e para që e ka përkthyer Konventën e CEDAW që në fillim të viteve '90, që herët është bërë një plan pune në lidhje me të. Duke synuar ndërgjegjësimin e gruas, fillimisht FPGSH e ka bërë të njohur Konventën CEDAW në 18 degët e saj në rrethe, në kuadrin e dy projekteve të BE-së për këtë çështje dhe në bashkëpunim me OJF italiane dhe franceze. Broshura e CEDAW-t e përkthyer në shqip ka shoqëruar çdo aktivitet të Forumit të Pavarur të Gruas Shqiptare (FPGSH) në Tiranë dhe në rrethe dhe ka qenë pjesë plotësuese e çdo dosjeje të projekteve.

Shqipëria është pjesë e CEDAW dhe e Platformës për Veprim të Pekinit, por ekziston akoma një mungesë e burimeve dhe vullnetit politik për të zbatuar këto sipërmarrje. Pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të grave në vendimarrje vazhdojnë që ta ndalojnë disa pengesa strukturore dhe kulturore. Për këtë arsye FPGSH në partneritet me shoqata të tjera dhe me mbështetjen e donatorëve të huaj norvegjezë dhe anglezë, po punon për të nxitur gratë dhe të rinjtë që të jenë më aktivë në vendimarrje dhe në politikë. Këto projekte kanë filluar të zbatohen që prej vitit 2003 e në vazhdim.

Ndërkohë që Kushtetuta e Shqipërisë adoptoi barazinë gjinore dhe reflektoi disa nga standartet ndërkombëtare, lidhur me të drejtat e njeriut, politikat e qeverisë nuk kanë pësuar ndryshime të mëdha gjinore dhe institucionet qeveritare vazhdojnë të dominohen nga meshkujt. Mekanizmat gjinore që më parë përfaqësoheshin nga Komiteti për Mundësi të Barabarta, tashmë janë përqëndruar në Drejtorinë e Barazisë Gjinore, pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta. Pjesë e këtyre mekanizmave gjinore janë edhe Strategjia Kombëtare për Gruan si dhe Komisioni i Grave Parlamentare, të cilët akoma nuk janë mjaftueshmërisht aktive.

Në lidhje me ndërgjegjësimin e grave për të drejtat e tyre, FPGSH ka zbatuar dhe po zbaton të tjera projekte, jo vetëm në zonat urbane, por edhe në ato rurale. Këto projekte janë mbështetur nga donatorë suedezë, si *Kvinna till Kvinna*, nga ambasada të ndryshme në Tiranë dhe nga donatorë të tjerë brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu me mbështetjen e donatorëve të huaj FPGSH ka punuar për zbatimin e projekteve për punësimin e grave në zona ndryshme rurale. Mbështetja e donatorëve të huaj ka qënë dhe vazhdon të jetë një faktor i domosdoshëm dhe shumë i rëndësishëm për realizimin e këtyre projekteve dhe nëpërmjet tyre për ndryshimin e situatës së barazisë gjinore në Shqipëri.

Stereotipet gjinore dhe sjelljet diskriminuese paraqesin një situatë serioze në Shqipëri, dhe kjo përbën një pengesë të madhe për pjesëmarrjen e grave në jetën politike të vendit si dhe në vendimmarrje. Statistikat në Shqipëri provojnë, që meshkujt konsiderohen akoma si më të zotë në pozicionet drejtuese edhe pse gratë janë në nivele të barabarta, ose edhe në nivel më të lartë përse i përket arsimimit. Normat sociale që lidhen me rolet gjinore janë komplekse, duke çuar shpesh në hezitim të grave për të marrë rolin e liderit. Sistemi elektorak akoma është diskriminues për gratë si psh. kuotat në listat e partive, të cilat ende nuk janë vendosur dhe zbatuar nga të gjitha partitë politike.

Familja shqiptare ruan ende disa tipare patriarkale dhe dhuna në familje, veçanërisht ndaj grave është një fenomen që ekziston akoma, sidomos në familjet e zonave veriore të Shqipërisë. Pavarësisht migrimit të këtyre familjeve drej zonave urbane dhe sidomos në qytetet më kryesore të vendit, ende vazhdojnë të ekzistojnë kodet tradicionale të sjelljeve të tyre. FPGSH ka punuar në këtë fushë në shumë qytete të vendit, në veri edhe në jug, si dhe në zonat e reja të krijuara nga kjo popullsi imigruese si psh, në Bathore (Rrethi i Tiranës). FPGSH dhe shumë shoqata të tjera kanë punuar në grumbullimin e statistikave lidhur me dhunën në familje, por ende ka mangësi në sistemin e statistikave në rang kombëtar. FPGSH ka realizuar një studim në vitin 2004 në 9 qytete të Shqipërisë lidhur me dhunën në familje studim i mbështetur nga donatorët suedezë. (*Kvinna till Kvinna*).

Përpjekje shumë më të mëdha ka patur edhe nga ana e organizatave të tjera, të cilat kanë luftuar dhunën kundër grave me projekte të ndryshme. FPGSH ka marrë pjesë aktivisht në projekte që kanë patur si objektiv ndërgjegjësimin e grave dhe vajzave të reja nëpërmjet trainimeve, materialeve sensibilizuese, takimeve të ndryshme etj. Po ashtu, ka patur projekte të tjera për trainimin profesional të grave të dhunuara. Nëpërmjet këtyre projekteve ju është dhënë mundësia grave që të kualifikohen dhe të gjejnë një punë të re, duke siguruar pavarësi ekonomike dhe si rrjedhojë zbutjen e dhunës në familje. Edukimi qytetar ka qënë një nga projektet që FPGSH ka realizuar për zbutjen dhe eliminimin e dhunës ndaj grave. Qëndrat e Forumit të Pavarur të Gruas Shqiptare (FPGSH) në Berat, Laç dhe Sarandë, kanë punuar nëpërmjet qëndrave që janë ngritur pranë qyteteve të tyre, duke dhënë këshillime ligjore, shëndetsore dhe sociale për gratë dhe vajzat e dhunuara. Përse i përket aksesit ligjor, përveç FPGSH, ka pasur disa qëndra dhe OJF të tjera, të cilat ju kanë afruar grave strehë dhe këshillim ligjor, por këto struktura janë duke u zhdukur ose janë zhdukur, sepse nuk ka fonde për mbështetjen e tyre. Kuadri ligjor në këtë drejtim është ende i dobët dhe me shumë boshllëqe, megjithë përpjekjet që kanë bërë OJF-të e grave për të sensibilizuar parlamentin.

Gruas fshatare nuk i është dhënë në përgjithësi asnjë ndihmë shtetërore, përveç rolit modest që kanë luajtur shoqatat e grave me projektet e tyre. Nuk ka funksionuar një sistem mikrokrediti për gratë, të cilin duhet ta nxisnin politikat shtetërore, me qëllim që gratë të mund të zhvillojnë ekonomitë e tyre të vogla dhe të mos varen vetëm nga puna e burrave. Ka shumë pak përpjekje për t'iu krijuar grave fshatare mundësi të barabarta me burrat për të marrë pjesë me veprimtarinë e tyre në zhvillimin e fshatit. Kjo duket në numrin e vogël të grave në këshillat komunalë dhe bashkiakë, në numrin pothuaj jo ekzistent të kryetareve dhe gratë nuk i sheh shpesh në aktivitetet e bashkisë, ose të komunës. Kjo vjen, jo vetëm nga mos ndërgjegjësimi i tyre, por edhe nga fakti që në fshat ka ende shumë paragjykime.

Siç është përmendur dhe më sipër, FPGSH ka punuar në fushën e punësimit të grave në zonat rurale, duke patur parasysh problemet e veçanta që kanë gratë fshatare. Janë zbatuar projekte, të cilat kanë synuar të krijojnë mundësi që këto gra të punësohen psh, në serrat biologjike. FPGSH ka punuar shumë edhe në fushën e turizmit duke trainuar gratë, sidomos ato të zonave turistike të Shqipërisë për të përmirësuar cilësinë e shërbimit dhe si rrjedhim rritjen e mundësive për vetëpunësim dhe rritjen e të ardhurave të tyre ekonomike. Nga ana shtetërore nuk janë marrë masa specifike për ndryshimin e gjëndjes së gruas. Masat merren në përgjithësi në zona të caktuara, sipas interesave shtetërore, ose influencës së deputetëve të zonës.

FPGSH ka punuar prej shumë vitesh në projekte të ndryshme për nxitjen e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje dhe politikë. Megjithë punën e madhe që është bërë, niveli i përfaqësimit të gruas si në nivel lokal, ashtu dhe në atë qëndror është akoma shumë i ulët. Në zgjedhjet e vitit 2005 kemi një përfaqësim vetëm 7.1% të grave në parlament, shifër kjo e ulët krahasuar me vitet parardhëse. Në nivel lokal kjo shifër është në nivelin 3%. Tashmë në parlament është duke u paraqitur ligji për barazi gjinore, i cili mund të japë shanse të reja grave me vendosjen e kuotës prej të paktën 30% në të gjitha nivelet drejtuese si dhe në administratë. Një hap përpara në këtë fushë mund të konsiderohet edhe vendosja e kuotave në partitë politike dhe reflektimi i kësaj kuote në pjesëmarrjen në parlament dhe në organet vendimmarrëse. Në të kundërt kuota vetëm në parti mbetet formale.

Në drejtim të bashkëpunimit midis OJF dhe institucioneve shtetërore mendojmë se ka vënd për përmirësim, ndërkohë që kapacitetet që kanë disa OJF, si për shembull FPGSH, mund të shfrytëzohen më mirë për të realizuar kontrata bashkëpunimi me ministri të ndryshme, si ajo e Punëve Sociale, e Bujqësisë, e Mjedisit etj. Për më tepër duke i parë në disa raste OJF-të si veprimtari biznesi, shteti ve rregulla dhe ligje që praktikisht i dobësojnë ato. Kështu rrezikohet të shuhet lëvizja e gruas dhe OJF-të në përgjithësi, që me aq mundim u ngritën në këto vite.

FPGSH ka zhvilluar veprimtari konkrete edhe për propagandimin e dokumentave të tilla si, Konventa CEDAW, Protokollin Opsional i Konventës CEDAW, Komentet Përmbledhëse dhe Rekomandimet e Komitetit CEDAW për Raportin e Parë dhe të Dytë të Kombinuar që ka paraqitur Shqipëria në Sesionin e 28 të OKB-së (13-31 janar 2003), Deklarata e Përgjithshme të Pekinit dhe Platforma për Veprim, etj, të cilat synojnë ndërgjegjësimin e opinionit publik shqiptar. Këtu mund të përmendim punën që ka kryer FPGSH nëpërmjet projekteve të ndryshme, siç janë ai për “Mbështetjen e grave në politikë dhe vendimmarrje” me partneritet *Womankind Worldwide* dhe QSHPHZ (Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin), si dhe projekti *Women Can*

Do It, mbështetur nga Norwegian's People Aid. Këto veprimtari janë shoqëruar gjithnjë me propagandimin e materialeve të ndryshme që kanë lidhje me CEDAW-n.

- **QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINE DHE ZHVILLIMN (QSHPZH)**

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QSHPZH) ka paraqitur opinonet e saj, kryesisht për ato pjesë të Konventës CEDAW që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetsor si dhe masat e ndërmara në këtë aspekt për eliminimin e diskriminimit ndaj grave. QSHPZH (ish Shoqata e Planifikimit Familiar) është themeluar në vitin 1993 dhe gjithmonë ka qënë një shoqatë lider në fushën e shëndertit riprodhues. Ajo ka dhënë një kontribut të veçantë në hartimin dhe lobimin për aprovimin e ligjit mbi abortin (1995), lidjit mbi të drejtat riprodhuese, ligjin për barazinë gjinore, strategjinë për HIV/SIDA. QSHPZH ka përgatitur "Raportin Alternativ" për Shqipërinë mbi CEDAW në vitin 2000. Në partneritet me HOM (Hollandë) ka përgatitur një raport mbi situatën e dhunës në familje në Shqipëri (2005).

Duke u nisur nga aspekti legjislativ, ligji për shëndetin riprodhues parashikon të drejtën e çdokujt për informacion, këshillim, edukim dhe shërbime sociale të nevojshme për një shëndet të mirë riprodhues dhe për ushtrimin e të drejtave dhe përgjegjësi të tyre seksuale dhe riprodhuese. Ky ligj parashikon masa për parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, planifikimin familjar dhe mënjanimin e shtatzanive të padëshiruara. Nenet 6 dhe 8 të këtij ligji synojnë të mbrojnë të drejtat seksuale dhe riprodhuese të grave.

Edhe ligji për shërbimin shëndetsor garanton shërbim shëndetsor për cilindo, duke përfshirë edukimin shëndetsor, masat profilaktike, etj, por përgjithësisht dispozitat e këtij ligji kanë karakter deklarativ dhe me gjithë ndryshimet që ka pësuar me vonë, ky ligj mbetet i vjetër, pasi ai është miratuar që në vitin 1963. Legjislacioni shqiptar nuk përmban ndonjë dispozitë diskriminuese për shkak të gjinisë, në lidhje me pjesëmarrjen në informim.

Ligji për Sigurimet Shoqërore ndjek të njëjtën linjë, ndonëse bën një dallim përsa i përket pagesës së kompensimit dhe përfitimeve nga sigurimet shoqërore për barrë-lindje, ku përfshihen shtatzania dhe periudha pas lindjes së fëmijës. Duke marrë një përqindje të ardhurash gjatë lejës së lindjes, gratë mund t'i dedikohen edukimit të fëmijëve të tyre. Në Shqipëri leja e lindjes është 365 ditë dhe gratë përfitojnë 50-80% të rrogës. Gjithsesi leja e lindjes aplikohet vetëm në administratën shtetërore, pasi kompanitë private e kundërshtojnë aplikimin e këtij sistemi. Gratë dhe vajzat punësohen edhe pa nënshkruar një kontratë punësimi të rregullt. Kështu ato mund humbasin punën e tyre gjatë shtatzanisë, ose kur kërkojnë leje për tu kujdesur për fëmijët e tyre.

Kodi i Punës specifikon se shtatzania nuk duhet të shërbejë si arsye për diskriminim (psh, neni 105/a ndalon punëdhënësit të pyesin rreth testit të shtatzanisë përpara se të punësojnë një grua). Gjithashtu një punëdhënës, i cili përfundon kontratën e një punonjëseje femër në kohën kur ajo është shtatzënë, ose sapo ka lindur një fëmijë i duhet të vërtetojë përpara një gjykatësi se kontrata nuk përfundoi për këto arsye. Leja e lindjes konsiderohet si një periudhë pune dhe si rrjedhojë gruaja ligjërisht nuk humb 1 vit punë. Megjithatë zbatimi i këtij ligji është i vështirë sidomos në sektorin privat. Gratë shtatzëna punojnë në kushte të vështira duke pasur edhe punët e shtëpisë (një punë e papaguar, e cila nuk ka qënë kurrë temë diskutimi nga qeveria).

Zakonisht është e vështirë për këto gra të kalojnë më shumë se 42 ditë lejen e lindjes, pasi puna e tyre nuk është e sigurt.

Sektori publik ka parë anën pozitive të zhvillimit të këtij fenomeni. Mund të thuhet se ekziston një presion indirekt për të bindur gratë të marrin lejen e lindjes për 12 muaj dhe kjo vjen për arsye të listës së gjatë që duhet të presin për tu punësuar. Sektori i edukimit është sektori më i prekur nga kjo situatë. Konkretisht, nëse një mësuese vendos të marrë lejen e lindjes, atëherë një mësuese tjetër punësohet në vend të saj. Pra, sipas interesit të tyre personal gratë mund të vendosin cilën mundësi të zgjedhin, të marrin një leje lindje të shkurtër, apo një leje prej 12 muajsh.

Legjislacioni shqiptar i ofron mbështetje të posaçme dhe shërbime shëndetsore nënës dhe fëmijës. Të gjitha gratë shtatzëna përfitojnë falas ndjekjen periodike mjekësore të shtatzanisë, të lindjes dhe të paslindjes, veçanërisht ekzaminimet e paralindjes dhe të paslindjes, të detyrueshme, që caktohen me akt të Ministrit të Shëndetsisë. Një numër i rëndësishëm i shërbimeve jepen falas, por jo të gjitha gratë përfitojnë nga kjo, sepse shpesh ato nuk janë të informuara për ekzistencën e këtyre shërbimeve, ose thjesht nuk mendojnë se do t'ju repektohet konfidencialiteti. Pavarësisht nga formulimi i tyre, zbatimi i këtyre dispozitave dhe cilësia e shërbimit shëndetsor shpesh lenë për të dëshiruar. Megjithatë legjislacioni shqiptar nuk diskriminon në mënyrë direkte gratë dhe vajzat e infektuara me HIV/ SIDA, në mënyrë indirekte e bën këtë nga mos krijimi i kushteve për të garantuar kujdes dhe mbrojtje të grave dhe vajzave ndaj këtij fenomeni.

Legjislacioni shqiptar nuk bën dallim ndërmjet grave të qytetit dhe fshatit. Kjo nënkupton se të gjitha kanë të njëjtat të drejta dhe të gjithave ju ofrohen mundësi të barabarta pavarësisht ku jetojnë ato, në qytet apo në fshat. Megjithatë realiteti flet ndryshe, pasi të drejtat sociale dhe ekonomike nuk gëzohen njësoj edhe nga gratë e zonave rurale. Problemi nuk qëndron tek legjislacioni, por tek zbatimi i dobët i tij. Kjo vjen nga kushtet e vështira sociale dhe ekonomike në të cilat duhet të jetojnë gratë në zonat rurale, si dhe për shkak të traditave që ekzistojnë në këto zona. Në këtë kontekst, gratë kanë shumë më pak mundësi ekonomike dhe sociale.

Legjislacioni shqiptar nuk dallon as gratë fermere nga gratë jo fermere, pavarësisht nga ndryshimi i madh midis këtyre dy kategorive. Gratë në zonat rurale janë shumë të interesuara të marrin pjesë në planifikimin për zhvillim në të gjitha nivelet. Megjithatë struktura dhe zhvillimet e teknologjisë kanë sjellë përgjegjësi të reja për to. Pësia e tyre tani është e madhe, pasi ato punojnë në fermë me kërkesa më të larta dhe detyrat e tyre në shtëpi janë një përgjegjësi e vazhdueshme. Gratë kanë pak kohë dhe energji për të punuar në komunitet.

Në zonat rurale ekziston mundësia që gratë të informohen rreth kujdesit shëndetsor. OJF-të bashkëpunojnë me autoritetet lokale për të plotësuar boshllëkun e informacionit që ekziston në lidhje me çështjet e shëndetit riprodhues. Kur kujdesi shëndetsor profesional mungon, gratë duhet të shkojnë në qendrat shëndetsore më të afërta të zonës urbane, por jo rallë kanë vështirësi që të shkojnë atje. Mungesa e qëndrave shëndetsore dhe e shërbimeve në zona të largëta mbetet një problem për tu zgjidhur, kurse për qendrat egzistuese orari i kufizuar i hapjes së tyre është një problem tjetër, që gjithashtu ngelet për tu zgjidhur.

QSHPHZ është inisiatore e Koalicionit për Gratë në Politikë dhe çdo vit organizon shkollën verore "Politikanet e reja". Koalicioni është pjesë e një projekti ambicioz që QSHPHZ po ve në zbatim së bashku me FSHPG dhe ka si synim nxitjen e pjesëmarrjes së femrave në politikë dhe vendimmarrje.

C. TE DHENA STATISTIKORE NGA INSTAT-I

Tab 1. Bilanci i buxhetit te Shtetit

Balance of general government budget

Ne million lek (In million)

Vitet	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	Years
Te ardhurat e buxhetit te shtetit	130,642	145,639	154,595	167,224	184,355	204,163	229,444	Budged revenues
% e GDP (çmime korrente)	24.5	24.7	24.5	23.6	23.8	24.4	25.5	% of GDP (current prices)
Shpenzimet e buxhetit te shtetit	170,621	186,049	192,517	201,152	222,439	232,339	258,816	Budged expenditures
% e GDP (çmime korrente)	32.0	31.5	30.5	29.5	28.5	27.8	28.8	% of GDP (current prices)
Deficiti i buxhetit te shtetit	-39,979	-40,410	-37,922	-33,928	-38,083	-28,176	-29,372	Deficit of general gover. budget
% e GDP (çmime korrente)	7.5	6.8	6.0	4.8	4.9	3.4	3.3	% of GDP (current prices)

Burimi: Ministria e Financës


Source: Ministry of Finance

2. Demografia

Demographic figures

Tab 2.1 Piramida e popullsisë, 2006

Pyramid of population, 2006



Burimi: INSTAT, 2006

Source: INSTAT, 2005

Tab 2.2 Të lindur gjallë sipas gjinisë
Live births by sex

Vitet	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Koef.Mashkullinitetit
Year	Total	Male	Female	Sex Ratio
1990	82,125	42,564	39,561	1.08
1995	72,081	38,085	33,996	1.12
2000	51,242	26,686	24,556	1.09
2001	54,283	28,524	25,759	1.11
2002	45,515	24,164	21,351	1.13
2003	47,012	24,894	22,118	1.13
2004	43,022	22,859	20,163	1.13
2005	39,612	21,007	18,605	1.13
2006	34,229	18,250	15,979	1.14

Burimi: INSTAT, 2006

Source: INSTAT, 2006

Tab 2.3 Të lindur gjallë sipas grupmoshës së nënës, ne %
Live birth by age group of mother, in %

Vitet	1990	1995	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	Years
Grupmosha e nënës										Age group of mother
Deri 19	2.89	4.77	4.88	2.23	4.95	5.39	5.23	6.34	5.8	Up to 19
20 - 24	30.16	30.01	31.03	25.44	30.07	31.09	31.42	33.07	32.8	20 - 24
25 - 29	37.33	34.72	34.56	36.10	33.72	33.69	33.65	32.42	32.8	25 - 29
30 - 34	20.84	18.79	19.97	23.82	21.06	20.04	19.74	18.91	18.8	30 - 34
35 - 39	6.63	6.47	7.15	9.22	7.81	7.40	7.53	7.14	7.2	35 - 39
40 - 44	1.62	1.12	1.44	2.25	1.85	1.70	1.71	1.48	1.5	40 - 44
45 - 49	0.17	0.08	0.09	0.17	0.17	0.16	0.15	0.16	0.1	45 - 49
Mbi 50 vjeç	0.05	0.01	0.02	0.15	0.03	0.05	0.03	0.04	0.0	Above 50
Të Panjohur	0.30	4.03	0.87	0.63	0.35	0.49	0.56	0.45	1.0	Unknown
Gjithsej	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	Total

Burimi: INSTAT, 2006,


Source: INSTAT, 2006

Tab 2.4 Lindshmëria sipas grupmoshës për 1000 femra, 1990-2006
Age specific fertility rate per 1000 women, 1990-2006

Vitet Years	Lindjet Live births	Lindshmëria sipas grupmoshës për 1000 femra Group Age specific fertility rate per 1000 women							ISF TFR
		15 - 19	20 - 24	25 - 29	30 - 34	35 - 39	40 - 44	45 - 49	
		1990	82,125	15.3	164.5	213.6	131.6	55.7	
1995	72,081	23.1	160.9	190.0	102.3	38.5	8.5	0.8	2.6
2000	51,242	16.3	119.7	142.5	89.3	30.7	7.2	0.6	2.0
2001	54,283	8.1	114.4	177.3	116.8	45.6	11.5	1.1	2.3
2002	45,515	14.7	108.8	138.4	85.9	32.8	7.7	0.9	1.9
2003	47,012	16.4	111.6	142.0	85.9	32.2	7.3	0.8	2.0
2004	43,022	14.6	99.4	127.7	78.8	30.0	6.7	0.7	1.8
2005	39,162	16.3	92.3	111.4	69.6	26.3	5.3	0.6	1.6
2006	34,229	12.9	79.4	98.0	60.2	23.1	4.6	0.5	1.4

Burimi: INSTAT, 2006,
Source: INSTAT, 2006

Graph. Koeficientët specifikë të fertilitetit
Age specific fertility rate



Tab 2.5 Lindjet dhe abortet
Births and abortions

Lindjet dhe abortet
Live births and abortions

Vitet Years	Lindje Live Births	Aborte Abortions	Aborte/1000 lindje Abortions/1000births
1995	72,081	31,874	442
2000	51,242	21,004	419
2001	54,283	17,125	325
2002	45,515	17,500	384
2003	47,012	12,087	257
2004	43,022	10,517	244
2005	39,612	9,403	237
2006	34,229	9,552	279

Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Tab 2.6 Vdekjet sipas gjinisë
Deaths by gender

Vitet Years	Gjithsej Total	Meshkuj Male	Femra Female
2000	16,421	9,505	6,916
2001	15,813	9,160	6,653
2002	16,248	9,123	7,125
2003	17,967	10,038	7,929
2004	17,749	9,949	7,800
2005	17,423	9,690	7,733
2006	16,935	9,082	7,853

Burimi: INSTAT, 2006,
Source: INSTAT, 2006


Tab 2.7 Mosha mesatare e martesës sipas gjinisë
Average age of marriage by sex

Vitet Years	Meshkuj Male	Femra Female
1990	27.3	23.0
1995	27.8	23.0
2000	28.1	23.0
2002	28.8	23.3
2003	28.9	23.3
2004	29.2	23.8
2005	28.5	23.0
2006	28.5	23.1

Burimi: Femra dhe Meshkuj- INSTAT, 2006,
Source: Female and Male – INSTAT, 2006

2.8 Graf: Divorcet per 100 martesë

Graph: Divorces per 100 marriages



Burimi: INSTAT 2006,
Source: INSTAT 2006

3. Arsimi Education

Tab 3.1 Fëmijë, nxënës dhe studentë sipas gjinisë
Children, pupils and students by sex

	2001 - 2002		2002 - 2003		2003 - 2004		2004 - 2005		2005-2006	
	Meshkuj Male	Femra Female	Meshkuj Male	Femra Female	Meshkuj Male	Femra Female	Meshkuj Male	Femra Female	Meshkuj Male	Femra Female
Gjithsej - Total	346801	372494	380348	370061	384416	370234	402463	385419	399,656	384,366
Fëmijë në kopshte- Children in kindergarden	39900	38573	38472	37693	39022	36733	40902	37863	40,775	37,708
Nxënës - Pupils	290865	307797	325456	305188	325418	300868	336432	309428	328,049	303,333
Studentë - Students	16036	26124	16420	27180	19976	32633	25129	38128	30,832	43,325

*Burimi: INSTAT 2006,
Source: INSTAT 2006*

Tab 3.2 Nxënës e studentë që mbaruan dhe u diplomuan
Pupils and students graduated

Nxënës e studentë	2002-2003	2003-2004	2004-2005	2005 - 2006	Pupils and students
Nxënës që morën dëftesë lirimi arsimit 9 vjeçar	53,185	56,513	59,519	58,216	Pupils graduated on basic 9 years education
Meshkuj	26,382	28,730	30,241	29,886	Male
Femra	26,803	27,783	29,278	28,330	Female
Nxënës që morën dëftesë pjekurie arsimit mesëm	22,182	24,840	29,380	27,905	Pupils graduated on secondary education
Meshkuj	10,432	12,157	14,614	12,762	Male
Femra	11,750	12,683	14,766	15,143	Female
Studentë të diplomuar	5,229	5,977	5,752	7,630	Students graduated
Meshkuj	1,468	1,804	1,649	2,118	Male
Femra	3,761	4,173	4,103	5,512	Female

*Burimi: INSTAT 2006
Source: INSTAT 2006*

Tab 3.3 Raporti nxënës – mësues, arsimi public, 1999-2005

Ratio pupil – teacher, public education, 1999-2005

	1999-2000	2000-2001	2001-2002	2002-2003	2003-2004	2004-2005	
Arsimi parashkollor	21	19	22	22	21	21	Preschool education
Arsimi 8-vjecar	19	22	19	19	19	18	Pupils basic 8//years education
Arsimi i mesem	16	17	18	19	19	22	Secondary education

*Burimi: Ministria e Arsimit, 2005,**Source: Ministry of Education, 2005***Tab 3.4 Studentë të diplomuar në arsimin e lartë -Niveli 5**

Graduated students in the tertiary education- Level 5

Viti shkollor School year	Total	Femra / Female	Sistemi me kohe të plotë Full time		Sistemi me kohë jo të plotë Part time	
			Total	Femra / Female	Total	Femra / Female
1994-95	4,436	2,556	3,711	2,135	725	421
1995-96	4,630	2,606	3,702	2,086	928	520
1996-97	3,708	1,990	3,295	1,761	413	229
1997-98	3,861	2,456	2,861	1,821	1,000	635
1998-99	3,997	2,612	2,953	1,991	1,044	621
1999-00	4,735	3,170	3,545	2,372	1,190	798
2000-01	4,618	3,168	3,442	2,382	1,176	786
2001-02	5,016	3,477	3,734	2,550	1,282	927
2002-03	5,229	3,761	4,064	2,879	1,165	882
2003-04	5,977	4,173	4,760	3,335	1,217	838

*Burimi: Vjetari statistikor, 1995-2004**Source: Statistical yearbook, 1995-2004*

4. Punësimi Employment

Tab 4.1 Bilanci i forcave të punës
Labour force balance

(në mijë - in thousands)

	2005	2006	
Popullsia gjithsej	3,149	3,135	Total population
meshkuj	1,578	1,573	male
femra	1,570	1,566	female
Popullsia në moshë pune	2,003	2,018	Population at working age
meshkuj	1,026	1,033	male
femra	976	985	female
Forca e punës	1,085	1,084	Labour Force
meshkuj	655	655	male
femra	430	429	female
Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës	54.2	53.7	Activity rate
meshkuj	63.8	63.4	male
femra	44	43.6	female
Të punësuar gjithsej	932	935	Total Employment
meshkuj	576	578	male
femra	356	357	female
Niveli i punësimit	45.6	48.7	Employment rate
meshkuj	51.4	58.8	male
femra	38.5	38.1	female
Të papunë gjithsej	153	149	Total registered unemployment
meshkuj	79	78	male
femra	74	72	female
Shkalla e papunësisë	14.1	13.8	Unemployment rate
meshkuj	12.1	11.8	male
femra	17.2	16.8	female

Burimi: INSTAT, 2006,

Source: INSTAT, 2006

Tab 4.2 Të papunë të regjistruar dhe përbërja sipas gjinisë, 1996 – 2006
Registered unemployment by sex, 1996 – 2006

Viti Year	Papunësia e regjistruar Total unemployment	Papunësia femra Unemployment female	Papunësia meshkuj Unemployment male	Niveli i papunësisë Unemployment rate	Niveli i papunësisë femra Unemployment rate female	Niveli i papunësisë meshkuj Unemployment rate male
1996	158,200	70,200	88,000	12.3	13.6	11.4
2000	215,085	101,919	113,166	16.8	19.3	14.9
2001	180,513	85,420	95,093	16.4	19.9	14.2
2002	172,385	81,326	91,059	15.8	19.1	13.6
2003	163,030	77,125	85,905	15.0	18.2	12.9
2004	157,008	74,893	82,115	14.4	17.5	12.4
2005	153,250	74,031	79,219	14.1	17.2	12.1
2006	149,794	72,151	77,643	13.8	16.8	11.8

Burimi: INSTAT 2006,
Source: INSTAT 2006

Tab 4.3 Të punësuar 15 vjeç e lart sipas sektorëve dhe gjinisë
Employed 15 years old and over by sectors and gender

(në % - in %)

	Viti - Year 2005			
	Meshkuj Male	Femra Female	Gjithsej Total	
Spektori shtetëror	57.6	42.4	100.0	Public sector
Spektori privat bujqësor	45.8	54.2	100.0	Agricultural private sector
Spektori privat jo-bujqësor	74.2	25.8	100.0	Non-agricultural private sector
Gjithsej	57.9	42.1	100.0	Total


Burimi, INSTAT, Rezultate të Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës, LSMS 2005
Source: INSTAT, Living Standard Measurement Survey Results, LSMS 2005

Tab 4.4 Të punësuar në administratë për vitin 2006
Employed in administration for the year 2006

	Gjithsej		Femra - Female		Meshkuj - Male		
	Numër Number	Numër Number	%	Numër Number	%		
Të punësuar në administratën qendrore	3,340	1,314	39.3	2,026	60.7	Employed in central administration	
Të punësuar në administratën lokale	10,450	3,306	31.6	7,144	68.4	Employed in local administration	
në komunë	4,842	1,063	21.9	3,779	78.1	in commune	
në bashki	4,158	1,890	45.4	2,268	54.6	in municipality	
në prefekturë	1,450	353	24.3	1,097	75.7	in prefecture	


Burimi: INSTAT 2006
Source: INSTAT 2006

Tab 4.5 Të punësuar sipas grupeve kryesore të profesioneve dhe gjinisë, 2006
Employed by main groups of occupations and sex, 2006
(Sektori shtetëror - Public Sector)



4.6 Grafik : Paga mesatare mujore sipas gjinisë dhe grup- moshave, 2005
 Graph: Average monthly wage by gender and age-group, 2005

Paga mesatare mujore neto sipas gjinisë dhe grupmoshave, 2005



5. Shëndetsia
 Health

Tab 5.1 Treguesit e vdekshmërisë foshnjore
 Infant mortality indicators

Emërtimi							Item
	2001	2002	2003	2004	2005	2006	
Numri i lindjeve	52888	42315	45132	40866	38789	35816	Number of Live births
Numri i vdekjeve (0-1 vjec)	924	730	701	617	569	468	Number of deaths (0-1 years old)
Vdekshmëria foshnjore (për 1000 lindje)	17.5	17.3	15.5	15.1	14.7	13.0	Infant mortality (per 1000 boms)
Vdekjet perinatale (për 1000 lindje të gjalla)	14.1	14.7	13.4	13.1	12.1	12.9	Perinatal deaths (per 1000 L.B)

Burimi: Ministria e Shëndetësisë

Source: Ministry of Health

Shenim: INSTAT ka raportuar per vitin 2002/52180 lindje dhe 2003/50452 lindje, sipas Projektionit te Popullsisë

Tab 5.2 Tregues të vdekshmërisë amtare
Maternal mortality indicators

Emërtimi								Item
	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	
								Number /000
Femra të moshës 15-49 vjeç/ 000	886	791	807	821	830	835	843	Women age 15-49 years
Barra (në mijë)	71	69	56	57	51	48	45	Pregnancies
Lindje (në mijë)	53	53	42	45	41	38	35	Live births
Vdekje në gra (nr absolut)	12	12	11	8	3	9	6	Maternal deaths
Vdekshmëria amtare	22.6	23	21	18	8	23	17	Maternal mortality rate
Vdekje (për 100.000 gra, mosha 15-49vjeç)	1.4	1.5	1.4	1.0	0.4	1.2	0.69	Deaths (per 100.000 women, age 15-49)
Vdekje (për 100.000 barra) = risk	16.9	17	20	14	6	19	13	Deaths (per 100.000 pregnancies)=risk
Vdekje (për 100.000 lindje të gjalla)	22.6	22.7	21.2	17.7	7.3	23.2	16.7	Deaths (per 100.000 life births)
Vdekje gjatë abortit	1	0	0	0	0	1	1	Number of deaths through abortion

Burimi: Ministria e Shëndetësisë,

Source: Ministry of Health

Shenim: Femrat e moshës 15-49 vjeç janë marrë nga INSTAT "Population projectionns for Albania" 2001-2021

Tab. 5.3 Shkaqet e vdekjeve sipas grup-sëmundjeve për 100 mijë banorë
Causes of deaths by group-diseases per 100 thousand inhabitants

	2001	2002	2003	2004	2005	2006	
Shkaqet e vdekjes							Causes of death
për 100 mijë banorë	525	524	575	567	555	538	per 100thousands
sipas gjinisë							inhabitants
- meshkuj	305	294	322	320	309	292	by sex
- femra	220	230	253	247	246	246	- male
							- female
për Aparatin e Qarkullimit	262	261	289	286	281	285	for Circulatory system
- meshkuj	143	138	152	152	147	144	diseases
- femra	119	123	137	134	134	140	- male
							- female
për Aparatin e Frymëmarjes	29	30	33	31	26	25	for Respiratory system
- meshkuj	17	16	18	18	14	15	diseases
- femra	12	14	15	13	12	10	- male
							- female
për Tumoret	83	87	96	93	88	93	for Neoplasm
- meshkuj	53	55	60	59	56	57	- male
- femra	30	32	36	34	32	35	- female
Aksidentale	45	40	39	38	39	32	Accidental
- meshkuj	35	31	30	29	29	24	- male
- femra	10	9	9	9	9	8	- female

Burimi: Shkaqet e vdekjeve, INSTAT, 2006

Source: Causes of death, INSTAT, 2006

Tab 5.4 Aktiviteti i konsultorit të gruas
Activity of women's consultancy

Emërtimi	Viti / Year					2006	Item
	2001	2002	2003	2004	2005		
KONSULTORI I GRUAS							
Konsultoreve	1692	1541	1611	1742	1753	1733	Women's consultation
Në fshat	1589	1449	1516	1654	1665	1643	In rural
Vizita gjithsej	406103	329595	338258	306617	325143	308681	Total visits
Në fshat	226525	181192	204764	174339	182080	174930	In rural

Burimi: Ministria e Shëndetësisë

Source: Ministry of Health

Tab 5.5. Planifikimi Familjar dhe përdorimi i kontraktivëve - MICS 2005
Family Planning, use of contraception, MICS 2005

Perqindja e grave te moshes 15-49 vjec te martuara ose ne nje lidhje, qe perdorin (apo qe partneri i tyre perdor) nje metode kontraceptive	Not using any method	Any modern method	Any traditional method	Any method*	Number of women currently married or in union	Percentage of women aged 15-49 years currently married or in union, who are using (or whose partner is using) a contraceptive method
Vendbanimi						Residence
Urban	37.6	31.3	31.1	62.4	1309	Urban
Rural	41.6	16.5	41.9	58.4	2024	Rural
Mosha						Age
15-19	(65.0)	(16.3)	(18.7)	(35.0)	48	15-19
20-24	57.8	18.3	24.0	42.2	259	20-24
25-29	41.5	26.6	32.0	58.5	466	25-29
30-34	37.0	28.4	34.6	63.0	583	30-34
35-39	33.2	24.4	42.4	66.8	652	35-39
40-44	31.8	21.0	47.2	68.2	705	40-44
45-49	49.0	14.7	36.3	51.0		45-49
Numri i femijeve						Number of living children**
0	87.1	11.6	1.2	12.9	198	0
1	52.6	20.0	27.3	47.4	446	1
2	33.3	28.2	38.5	66.7	1462	2
3	31.5	20.3	48.3	68.5	821	3
4+	44.7	12.9	42.4	55.3	406	4+
Arsimi						Education
Pa arsim/Fillor	60.6	11.4	28.0	39.4	53	None/Primary
8 vjecar	41.7	16.2	42.1	58.3	1810	Lower secondary
E mesme +	37.2	30.2	32.6	62.8	1470	Upper secondary +
Kuantilet e Indeksit te pasurise						Wealth index quintiles
Te varfer	39.1	17.9	42.9	60.9	654	Poorest
Niveli i dyte	45.0	12.8	42.2	55.0	664	Second
I trete	42.8	21.3	35.9	57.2	669	Middle
I kater	38.2	25.9	35.9	61.8	686	Fourth
Te pasur	35.0	33.4	31.5	65.0	660	Richest
Total	40.0	22.3		37.7	3333	Total

Burimi: INSTAT, MICS 2005

Source: INSTAT, MICS 2005


Tab 5.6 Pirja e duhanit për popullsinë 15 vjeç e lart sipas gjinisë, 2005
Smoking behaviour of population 15 years old and over by sex, 2005

Pirë ndonjëherë duhan Ever smoked		(në % - in %)
Meshkuj	35.1	Male
nga të cilët:		of which:
Pijnë akoma	81.0	Still smoke
Femra	2.4	Female
nga të cilët:		of which:
Pijnë akoma	79.7	Still smoke
Gjithsej	18.0	Total
nga të cilët:		of which:
Pijnë akoma	80.9	Still smoke

Burimi LSMS 2005
Source: LSMS 2005

5.7 Graf. Kujdesi antenatal

Graph: Antenatal care,



Burimi: INSTAT, Vrojtimi MICS 2005
Source: INSTAT, Survey MICS 2005

6. Varfëria dhe Niveli i jetesës

Poverty and Living condition

Tab 6.1 Ndryshimi i varfërisë absolute, sipas grup-popullatave dhe shpërndarjes gjeografike (2002 –2005)

The absolute poverty trend, by population groups and geographic distribution (2002 –2005)

Zona	2002			2005			Ndryshimi ne / changes in % 2005/2002		
	Totali	Femra	Femije 0-18 vjec	Totali	Femra	Femije 0-18 vjec	Totali	Femra	Femije 0-18 vjec
Tirana	17.8	15.0	24.7	8.1	6.6	12.6	-54	-56	-49
Zona urbane	20.1	18.1	25.8	12.4	10.4	17.6	-38	-43	-32
Zona rurale	29.6	25.8	36.1	24.2	22.0	30.2	-18	-15	-16
Totali	25.4	22.0	32.1	18.5	16.1	24.7	-27	-27	-23
Area	Total	Female	Chidren 0-18 yrs old	Total	Female	Chidren 0-18 yrs old	Total	Female	Chidren 0-18 yrs old

Shënim: Njësia e matjes është personi Note: Unit of measurements is the individual

Burimi: INSTAT, LSMS 2002 dhe 2005 Source: : INSTAT, LSMS 2002 and 2005

Tab 6.2 Statusi i punësimit për popullsinë nën linjën absolute të varfërisë (grupmosha 15-64 vjeç), 2002-2005

Employment status for the population under the absolute poverty line (age – group 15 -64 yrs old), 2002- 2005

Statusi	2002			2005		
	Meshkuj	Femra	Total	Meshkuj	Femra	Total
I punësuar	66.7	49.8	57.6	68.6	45.0	55.9
I papunë	17.7	15.0	16.3	10.8	9.4	10.1
Inaktivë						
-Shtëpiakë	0.7	16.9	9.4	0.6	23.1	12.7
-Të tjerë inaktivë	14.9	18.3	16.7	20.0	22.4	21.3
Total	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: INSTAT, LSMS 2005

Tab 6.3 Konsumi mesatar mujor sipas gjinisë së kryefamiljarit dhe rajoneve të vendit, 2005

Average monthly consumption by head of household and by regions of the country, 2005

Rajonet	Grupet kryesore të konsumit	Kryefamiljari mashkull		Kryefamiljari femër		Gjithsej vendi		Stratum	Main consumption groups
		Konsum mes mujor	Numri i familjeve	Konsum mes mujor	Numri i familjeve	Konsum mes mujor	Numri i familjeve		
Bregdetar	Ushqim,pije jo-alkoolike	21,959	205,520	18,150	28,419	21,500	233,940	Coastal	Food and non-alcoholic beverage
	Jo-ushqimore	11,351	205,520	8,084	28,419	10,957	233,940		Non-food
	Energji, ujë, telefon,etj	4,757	205,520	3,749	28,419	4,635	233,940		Utilities
	Arsimim	1,293	205,520	921	28,419	1,249	233,940		Education
	Pajisje afatgjatë Shpenzime mujore pa qeranë dhe shëndetin	920	205,520	396	28,419	901	233,940		Durables
Qëndror	Ushqim,pije jo-alkoolike	21,887	294,939	16,134	33,122	21,310	328,061	Central	Food
	Jo-ushqimore	9,423	294,939	5,754	33,122	9,055	328,061		Non-food
	Energji, ujë, telefon,etj	4,186	294,939	3,284	33,122	4,096	328,061		Utilities
	Arsimim	904	294,939	499	33,122	864	328,061		Education
	Pajisje afatgjatë Shpenzime mujore pa qeranë dhe shëndetin	338	294,939	205	33,122	325	328,061		Durables
Malor	Ushqim,pije jo-alkoolike	21,105	62,174	16,736	7,669	20,625	69,844	Mountain	Food
	Jo-ushqimore	10,502	62,174	6,457	7,669	10,058	69,844		Non-food
	Energji, ujë, telefon,etj	3,740	62,174	3,032	7,669	3,662	69,844		Utilities
	Arsimim	1,016	62,174	466	7,669	955	69,844		Education
	Pajisje afatgjatë Shpenzime mujore pa qeranë dhe shëndetin	307	62,174	220	7,669	297	69,884		Durables
Tirana	Ushqim,pije jo-alkoolike	24,454	88,853	15,955	13,162	23,357	102,015	Tirana	Food
	Jo-ushqimore	13,508	88,853	8,184	13,162	12,821	102,015		Non-food
	Energji, ujë, telefon,etj	6,717	88,853	4,296	13,162	6,405	102,015		Utilities
	Arsimim	2,076	88,853	1,260	13,162	1,971	102,015		Education
	Pajisje afatgjatë Shpenzime mujore pa qeranë dhe shëndetin	577	88,853	301	13,162	542	102,015		Durables
Gjithsej	Ushqim,pije jo-alkoolike	22,185	651,487	16,855	82,373	21,589	733,860	Total	Food


Jo-ushqimore	10,691	651,487	7,012	82,373	10,280	733,860	Non-food
Energji, ujë, telefon,etj	4,668	651,487	3,582	82,373	4,547	733,860	Utilities
Arsimim	1,197	651,487	763	82,373	1,149	733,860	Education
Pajisje afatgjatë	566	651,487	287	82,873	535	733,860	Durables
Shpenzime mujore pa qeranë dhe shëndetin	39,309	651,487	28,501	82,373	38,102	733,860	Total monthly cons, without rent and health
	Male_HH_Head		Female_HH_Head		Total country		
	Average monthly cons	Number of households	Average monthly cons	Number of households	Average monthly cons	Number of households	

Burimi: INSTAT,LSMS 2006

7. Pjesëmarrja ne Politike dhe jetën Publike Participation in political and public life

Tab 7.1 Përbërja e parlamentit që nga viti 1920
Composition of parliament since 1920

Viti Year	Numer - Number		Në % - In %	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
	Male	Female	Male	Female
1920	37	0	100	0
1921	78	0	100	0
1925	75	0	100	0
1928	57	0	100	0
1945	76	6	93	7
1950	104	17	86	14
1958	171	17	91	9
1970	192	72	73	27
1974	167	83	67	33
1982	174	76	70	30
1990	169	81	68	32
1991	199	51	80	20
1997	144	11	93	7
2001	132	9	94	6
2005	140	10	93	7



Burimi: Drejtoria e shanseve te barabarta, MPCSShB, 2005
 Source: The directorate of equal opportunities- MOLSAEO, 2005

Tab 7.2 Përbërja e parlamentit, Korrik 2005
 Composition of parliament, July 2005

Posti	Meshkuj	Femra	%	Position
	Male	Female	% Female	
Kryetar Parlamenti	0	1	100	Head of Parliament
Nënkryetar Parlamenti	2	0	0	Spokesperson of Parliament
Deputetë	140	10	7	Member of Parliament (MP)
Kryetarë të Komisioneve Parlamentare	7	1	13	Chairs of Parliamentarian Comm.
Kryetarë të Grupeve Parlamentare	9	0	0	Chairs of Parliamentarian Groups

Burimi: Të dhënat janë marrë nga web-site www.parlament.al
 Source: Web-site of Parliament www.parlament.al

Tab 7.3 Numri i deputetëve sipas partive politike dhe gjinisë, Korrik 2005
 Number of MP by political parties and sex, July 2005

Subjekti politik	Numri i deputetëve - Number of MP			Subject
	Gjithsej	Femra	% Femra	
	Total	Female	% Female	
Partia Socialiste (PS)	42	4	10	Socialist Party
Partia Demokratike (PD)	56	3	5	Democratic Party
Partia Republikane (PR)	11	1	9	Republican Party
Partia Socialdemokrate (PSD)	7	2	29	Social Democrat Party
Partia Demokrate e re (PDR)	4		0	New Democratic Party
Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI)	5			Socialist movement for Integration
Partia BDNJ	2		0	Union for Human Rights Party
Partia Agrare ambientaliste (PAA)	4		0	Agrarian Party
Partia Aleanca Demokratike (PAD)	3		0	Democratic Alliance Party
Partia Demokristiane (PDK)	2			Cristian Democrat Party
Partia Demokracia Sociale (PDS)	2			Social Democracy Party
Bashkimi Liberal Demokrat (BLD)	1			Liberal Democrat Union
Të pavarur	1		0	Independent
Gjithsej	140	10	7	Total

Burimi: Drejtoria e shanseve te barabarta, MPCSS, 2005

Source: The directorate of equal opportunities- MOLSA, 2005

Tab. 7.4 Pjesëmarrja e gruas në qeveri, Korrik 2005
 Participation of women in government, July 2005

Pozicioni	Numri - Number		%		Position
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	
	Male	Female	Male	Female	
Kryeministër	1	0			Prime Minister
Zv/Kryeministër	1	0			Deputy Prime Minister
Ministra	17	1	94	6	Ministers
Zv/Ministra	23	6	79	21	Vice Ministers
Sekretar i Përgjithshëm	15	2	88	12	General Secretary

Burimi: Drejtoria e shanseve te barabarta, MPCSS, 2005

Source: The directorate of equal opportunities- MOLSA, 2005

Tab. 7.5 Pushteti lokal
Local government

Pozicioni	Numri - Number		Në % - In %		Post
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	
	Total	Female	Total	Female	
Kryetar Bashkie	65	0	100	0	Mayors
Kryetarë të Minibashkive	8	3	73	27	Mayors (Mini Municipalities)
Kryetarë të Këshillave të Qarkut	12	0	100	0	Head of District Council
Kryetarë Komune	301	7	98	2	Head of Commune

Burimi: Drejtoria e shanseve te barabarta, MPCSS, 2005

Source: The directorate of equal opportunities- MOLSA, 2005


Tab 7.6 Pjesëmarrja e gruas në postet drejtuese të Universitetit, 2005
Universities staff by sex, 2005

Posti	Numri - Number		%		Post
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	
	Male	Female	Male	Female	
Rektor	11	0	100	0	Rector
Zv/Rektor	7	2	78	22	Deputy Rector
Anëtarë Senati	145	40	78	22	Member of Senate
Dekanë	32	5	87	14	Dean
Zv/Dekan	12	4	75	25	Deputy Dean
Anëtarë të Këshillit të Fakultetit	273	142	66	34	Member Faculty's Council
Përgjegjës Departamenti	98	38	72	28	Chef of department.
Anëtarë i Zgjedhur i Këshillit të Departamentit	61	52	54	46	Member of Department'd Council

Burimi: Drejtoria e shanseve te barabarta, MPCSS, 2005

Source: The directorate of equal opportunities- MOLSA, 2005

Tab 7.7 Pjesëmarja në media, sipas gjinisë 2005
Participation in Media, by sex, 2005



Burimi: Drejtoria e shanseve të barabarta, MPCSS, 2005
Source: The directorate of equal opportunities- MOLSA, 2005

8. Drejtësia Justice

Tab 8.1 Të dënuar sipas Kodit Civil & Penal për vitet 2000-2006
Convicted persons according to Penal & Civil Code for 2000-2006

Të dënuar	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	Convicted
Gjithsej	4,090	4,256	4,370	6,628	6,379	6,317	6,613	Total
Meshkuj	3,817	6,037	5,697	5,534	5,812	Male
Femra	269	283	362	494	533	Female
Të mitur	302	293	274	308	320	289	268	Juveniles
Për krime								For criminal offenses
Gjithsej	3,140	3,329	3,613	5,246	4,654	4,733	4,951	Total
Meshkuj	3,118	4,748	4,083	4,147	4,347	Male
Femra	244	239	258	328	366	Female
Të mitur	292	270	251	259	313	258	238	Juveniles
Për kundërvajtje								For Contraventions
Gjithsej	950	927	757	1,382	1,725	1,584	1,662	Total
Meshkuj	709	1,289	1,614	1,387	1,465	Male
Femra	25	44	104	166	167	Female
Të mitur	10	23	23	49	7	31	30	Juveniles

Burimi i informacionit: Ministria e Drejtësisë

Source of information: Ministry of Justice

Mungesë informacioni - Lack of information

9. Tregues të nivelit të jetesës

Tab. 9.1. Burimet e ujit të pijshëm, LSMS 2005

Burimi kryesor i ujit	Zona Urbane ne %	Zona rurale ne %	Total ne %
Ujë brenda banesave	87.4	27.2	56
Ujë jashtë banesave	4.2	24.9	15
Çezma publike	1.2	9.9	5.7
Çisternë uji	0.1	0.4	0.3
Ujë burimi ose puse	7	37	22.6
Lumë, Liqen, Rezervuar.	0	0.5	0.3
Të tjera	0.1	0.1	0.1
TOTAL	100	100	100

Burimi i informacionit, INSTAT LSMS

Tab. 9.2. Pajisjet shtëpiake, LSMS 2005

Lloji i pajisjeve	Total %	Zona Urbane %	Zona Rurale %
Televizor me ngjyra	94.4	97.9	91.3
Sobë elektrike ose me gaz	64.5	82.7	48.0
Lavatriçe	62.0	84.2	41.8
Veture	13.3	18.0	8.9
Sobë me mikrovalë	4.0	7.6	0.7
Antenë satelitore	15.3	17.9	12.9
Kompjuter	4.8	9.7	0.4
Frigorifer	89.1	95.6	83.1
Kondicioner	4.1	8.0	0.6

Burimi i informacionit, INSTAT, LSMS

VI. BIBLIOGRAFIA

A). Aktet Ligjore, Nënligjore dhe ndryshimet kryesore administrative

1. Aktet Ligjore

- Ligji Nr. 7952, datë, 21.06.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”.
- Ligji Nr.8387, datë, 30.07.1998, Për ndryshime në ligjin Nr.7952, datë 21.06.1995, “Për sistemin arsimor parauniversitar”.
- Ligji Nr.8461, datë, 25.02.1999, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”,
- Ligji Nr.8788, datë, 07.05.2001, "Për Organizatat Jo-Fitimprurëse".
- Ligji Nr. 8872, datë, 29.03.2002, “Per arsimin dhe formimin profesional në RSH”.
- Ligji Nr. 8876, datë, 04.04.2002, “Për Shëndetin Riprodhues” .
- Ligji Nr. 8889, datë, 25.04.2002, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7703, datë 11.05.1995 “Për Sigurimet Shoqërore në RSH”.
- Ligji Nr.9039, datë, 27.03.2003 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.8088, datë, 21.03.1996, Për Shoqëritë e Bashkëpunimit reciprok”.
- Ligji Nr. 9052, datë, 17.04.2003, “Për ratifikimin e Protokollit Opsional të Konventës CEDAW”.
- Ligji Nr. 9062, datë, 08.05.2003, “Kodi i Ri i Familjes”.
- Ligji Nr. 9095, datë, 03.07.2003, “Për Shërbimin e Jashtëm”.
- Ligji Nr. 9188, datë 12.02.2004, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar”.
- Ligji Nr. 9205, datë 15.03.2004, “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”.
- Ligji Nr. 9198, datë, 01.07.2004 "Për barazinë gjinore në shoqëri". Eshtë paraqitur në Parlament Projekt-ligji i ri, "Për barazinë gjinore në shoqëri" (Nr. 9534, datë, 15.05.2006).
- Ligji Nr.9284, datë, 30.09.2004, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”.
- Ligji i ri Nr. 9355, datë, 10.03.2005, “Për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore”, i cili zëvendësoi ligjin e mëparshëm nr. 7710, datë 18.05.1993 “Për Ndhimën dhe Përkujdesjen Shoqërore”.

- Ligji Nr. 7905, datë, 21.03.2005, “Kodi i Proçedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 9376, datë, 21.04.2005, “Për Sportin”.
- Ligji Nr. 9669, datë, 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.
- Ligji Nr. 9509, datë, 03.04.2006, “Për shpalljen e moratoriumit për mjetet motorike lundruese të Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 9642, datë, 20.11.2006, nëpërmjet të cilit u ratifikua nga Parlamenti Shqiptar Konventa e Këshillit të Europës, “Për Masat kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore”.
- Ligji Nr. 9686, datë, 26.02.2007, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë - i ndryshuar”.
- Ligji Nr. 9741, datë, 21.05.2007, “Për Arsimin e Lartë në RSH”.
- Ligji Nr. 9888, datë, 10.03.2008, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
- Ligji Nr. 9859, datë, 21.01.2008, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë - i ndryshuar”.

2. Aktet Nënligjore të Këshillit të Ministrave dhe Urdhëra të Kryeministrit

- VKM Nr. 185, datë, 03.05.2002, "Për mbrojtjen e veçantë të grave shtatzëna dhe të amësisë".
- VKM Nr. 207, datë, 09.05.2002, “Për përcaktimin e punëve të vështira, ose të rrezikshme”.
- Urdhri i MPÇSSHB, Nr. 2222, datë, 31.10.2002, “Mbi këshillimin dhe orientimin në formimin profesional”.
- VKM Nr. 632, datë, 18.09.2003, "Për programin e nxitjes së punësimit të punë-kërkueseve të papuna femra".
- Urdhëri i MPÇSSHB, Nr.394, datë, 23.02.2004, "Për tarifatat e Sistemit të Formimit Profesional".
- VKM Nr. 564, datë, 12.08.2005 “Për licensimin e ofruesve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”.
- VKM Nr. 787, datë, 14.12.2005, “Për përcaktimin e kriterëve, të proçedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”.

- VKM Nr. 265, datë, 28.04.2005 “Për Strategjinë e Shërbimeve Shoqërore”.
- VKM Nr. 563, datë, 12.08.2005 “Për përcaktimin e përgjegjësive të qarkut për shpërndarjen e shërbimeve shoqërore”.
- V.K.M. Nr.167, datë, 29.03.2006 “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë, 11.05.1993, Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar”.
- V.K.M. Nr.209, datë,12.04.2006, “Për përcaktimin e kritereve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe private të përkujdesit shoqëror”.
- VKM Nr. 512, datë, 31.05.2006, “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve shoqërore”.
- VKM Nr. 618, datë, 07.09.2006, “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”.
- VKM Nr. 619, datë, 07.09.2006 “Për disa ndryshime të VKM Nr.31, datë 20.01.2001 “Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik” të ndryshuar.
- V.K.M. Nr. 3, datë, 10.01.2006 “Për nxitjen e zhvillimit të Vreshtarisë, Pemtarisë dhe Ullirit”.
- Urdhri Nr. 338/3, datë, 10.03.2006 “Mbi zbatimin e VKM Nr. 787, datë 14.12.2005, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”.
- Urdhri i Kryeministrit Nr.139, datë, 19.06.2006, "Për krijimin e Komiteteve Rajonale të Luftës Kundër Trafikeve të Qënieve Njerëzore".
- VKM Nr. 913, datë, 19.12.2007, “Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit të Barazisë Gjinore 2007-2010”.
- Urdhri i Kryeministrit Nr. 202, datë, 05.12.2007, “Për ngritjen e strukturës për masa ndaj dhunës në familje”.
- Urdhri MPÇSSHB, Nr.782, datë, 04.04.2006, "Për tarifën e sistemit të formimit profesional”.
- V.K.M. Nr.10, datë, 04.01.2008, “Për mbështetjen e Prodhimit Bujqësor”.

- Urdhri i Ministrit të Brëndshëm, Nr. 379, datë, 03.03.2008, “Për masat që do të merren nga Policia e Shtetit për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje”.
- Urdhri i përbashkët i Ministrit të Brëndshëm, Ministrit të Punëve të Jashtme dhe MPÇSHB, maj 2006, "Për ngritjen e Autoritetit përgjegjës për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave të trafikimit dhe përcaktimin e detyrave të institucioneve të përfshira në këtë proces".

3. Ndryshimet kryesore administrative

- Drejtoria e Politikave të Shanseve të Barabarta (në MPÇSSHB)
- Krijimi i Këshillit Konsultativ i quajtur Komiteti Ndërministror.
- Sektori Për Masa Ndaj Dhunës në Familje (në MPCSSHB).
- Komiteti Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore.
- Zyra e Koordinatorit Kombëtar.
- Autoritetit Përgjegjës për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave të trafikimit.
- Komitetet Rajonale të Luftës Kundër Trafiqeve të Qënieve Njerëzore në nivel lokal.
- Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Personave të Veçantë.
- Sektorët e Mbrojtjes së të Miturve dhe kundër Dhunës në Familje.
- Sektori Kundër Trafiqeve të Paligjshme në Departamentin për Hetimin e Krimeve - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
- Sektorët Antitrafik, në Drejtoritë e Policive në Qarqe.
- Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit (QKPVT)
- Qendra e Përpunimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave”, një strukturë e posaçme, e cila është në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit
- Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.
- Skuadra për Bashkërendimin e Reagimit ndaj Dhunës në Familje.
- Gjykata e Krimeve të Rënda dhe Prokuroria a Krimeve të Rënda. (nga viti 2004).
- Mekanizmi Kombëtar Referues për Identifikim dhe Asistencë të Përmirësuar për Viktimat e trafikut të Qënieve Njerëzore (18.07.2005).

- Agjensia Kombëtare e AFP (Arsimit dhe Formimit Profesional)
- Qendra e Studimeve Gjinore, në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës dhe në vitin akademik 2006-2007 është hapur Dega e Studimeve Pasuniversitare për Studimet Gjinore.

B). PUBLIKIME:

INSTAT

- Botimi statistikor *“Femra dhe meshkuj në Shqipëri”* botohet çdo vit nga INSTAT në bashkepunim me Drejtorinë e Shanseve të Barabarta- MPCSSHB.
- Raporti *“Perspektiva gjinore në statistikë: a ndikon migrimi i brendshëm në mënyra të ndryshme në jetën e grave dhe të burrave shqiptarë”* INSTAT 2004 mbështetur në një analizë të avancuar të rezultateve të Rregjistrimit të Popullsisë 2001.
- Gratë dhe femijët në Shqipëri, Kosto e dyfishtë e pabarazisë dhe e diskriminimit gjinor te gratë dhe fëmijët, INSTAT- UNICEF, 2006.

OSBE

- Ka përgatitur e botuar Manualin *“Si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje”* (2007).

OJF-të

“Qendra për Nisma Ligjore Qytetare”

- Ligji mundësi zhvillimi për gratë, Revistë 3 mujore e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, artikulli *“Të drejtat e grave në vëmendje të Kombeve të Bashkuara”*; - 2005
- Revista *“Ligji Mundësi zhvillimi për gratë”*, Nr.10, Botim i Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, artikulli *“Protokolli Fakultativ i CEDAW, Qeveria dhe Shoqëria Civile shqiptare”*.
- *“Për një zbatim sa më të mirë të ligjit në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje nga organet e drejtësisë”*, - 2005.
- *“Institucionet Shqiptare për mbrojtjen e gruas nga dhuna në familje”*, - 2006
- Bazuar në raportin kombëtar mbi mbrojtjen nga dhuna në familje dy ekspertë rajonale kanë përgatitur botimin: *“International Standards on Domestic Violence and their Implementation in the Western Balkans”*, - 2006
- *“Legjislacioni civil në mbrojtje të së drejtave të gruas”*, - 2006
- Studim, *“Monitorimi i vendimeve të gjykatave të rretheve gjyqësore Tiranë, Shkodër dhe Vlorë, për vitet 2001-2003, në çështjet që lidhen me trafikimin e qënieve njerëzore.”*, - 2005.

“Shoqata ne Dobi të Gruas Shqiptare”

- Prostitucioni – shoqëria në dilemë.

- Droga dhe pasojat e saj
- Situata e fëmijëve të rrugës në Tiranë/Elbasan
- Manual për punonjëse shtëpie
- Postera për varfërinë, trafikimin, edukimin kundër AIDS/ drogës, etj.
- Manual kundër dhunës ndaj gruas.

“Forumi i Pavarur i Gruas Shqiptare”

- Gratë mund t’ia arrijnë, - Manuale për gratë në lidhshp, 2004-2005.
- Gratë mund t’ia arrijnë, - Manuale për gratë në lidhshp, 2005-2006
- Mësime pedagogjike për edukim qytetar-autorë shqiptarë dhe gjermanë.2004
- E drejta ligjore në legjislacioni shqiptar
- Studim mbi situatën pas elektorale - 2006
- Raport vjetor mbi situatën politike të gruas në Shqipëri-2005, 2006, 2007.

“Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin”

- Shëndeti riprodhues - material informues për politikëbërësit - 2008.
- “The Albanian institutions for the protection of women against domestic violence” - 2006.
- Adoleshentët dhe çështjet gjinore. - Manual për të rinjtë dhe mësuesit - 2005
- “Albanian society in the face of challenges of trafficking in women and girls” 2004
- NGO - Shadow Report on CEDAW Convention in Albania - 2002
- Sëmundjet seksuale të transmetueshme - 2008
- Për ju prindër, Tiranë 2007.
- Metodatat kontraceptive - 2000

0 ----- 0

